

UNIVERSITETI I TETOVËS

FAKULTETI FILOZOFIK - DEPARTAMENTI I HISTORISË



***Tema: RIDALJA E NACIONALIZMIT SERB PAS VDEKJES SË TITOS
DHE FORCIMI I POLITIKËS ANTISHQIPTARE NË KOSOVË DHE
MAQEDONI NË VITET 1981- 1989***

(Disertacioni i Doktoraturës)

Kandidati doktorant:

MA.sc. Sedat KRYEZIU

Udhëheqësi shkencor:

Prof.dr. Nebi DERVISHI

Tetovë, 2020

DEKLARATA E AUTORËSISË

© E drejta e autorit: **SEDAT KRYEZIU**

Ky studim është veper origjinale e imja e hartuar në bazë të punës disa vjeçare . Në çdo rast janë respektuar të gjithë elementët e citimit dhe referencave në respekt të të drejtave morale të autorit dhe legjislacionit në fuqi për përdorimin e materialeve dhe literaturës së përfshirë në këtë disertacion. Ndalohet çdo përdorim dhe riprodhim, botim dhe shpërndarje, kopjim dhe shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar pa pëlqimin paraprak me shkrim të autorit.

UNIVERSITETI I TETOVËS

FAKULTETI FILOZOFIK - DEPARTAMENTI I HISTORISË



Disertacion i paraqitur nga **Sedat KRYEZIU**

Në kërkim të gradës shkencore

"DOKTOR"

Fusha: Histori

Specialiteti: Histori bashkëkohore

RIDALJA E NACIONALIZMIT SERB PAS VDEKJES SË TITOS DHE FORCIMI I POLITIKËS ANTISHQIPTARE NË KOSOVË DHE MAQEDONI NË VITET 1981- 1989

Udhëheqësi shkencor:
Prof. dr. Nebi DERVISHI

Komisioni:

- 1..... Kryetar
- 2.....Anëtar (oponent)
- 3..... Anëtar(oponent)
- 4.....Anëtar
- 5.....Anëtar

Tetovë, më _____ / _____

PASQYRA E LËNDËS

ABSTRAKTI.....	7
PARATHËNIE	9
HYRJE.....	12

KREU I

PREMISAT E RISHFAQJES SË NACIONALIZMIT SERB

<i>1.1. Jugosllavia në përfundim të Luftës së Dytë Botërore – ndarja administrative dhe sistemi politik.....</i>	<i>18</i>
<i>1.2. Ndryshimet politike të vitit 1966 dhe reflektimi i tyre në pozitën e shqiptarëve në Kosovë dhe në vise të tjera (Maqedoni Preshevë).....</i>	<i>25</i>
<i>1.3. Kushtetuta e vitit 1974 - nxitëse e rizgjimit të nacionalizmit serb.....</i>	<i>30</i>

KREU II

NGJARJET NË MUAJT MARS - PRILL 1981 DHE SITUATA E KRIJUAR PAS TYRE

<i>2.1. Vështrim i përgjithshëm i gjendjes në Kosovë dhe në Maqedoni pas vdekjes së Titos.....</i>	<i>41</i>
<i>2.2. Shpërthimi i demonstratave të vitit 1981 dhe dhuna policore serbe.....</i>	<i>46</i>
<i>2.3. Fillimi i diferencimeve ideopolitike në Kosovë dhe forcimi i nacionalizmit serb.....</i>	<i>58</i>

KREU III

RISHFAQJA E NACIONALIZMIT TË HESHTUR SERB 1981-1989

<i>3.1. Fillimet e mobilizimit të serbëve në Kosovës dhe rritja e nacionalizmit.....</i>	<i>64</i>
<i>3.2. Propaganda në shërbim të nacionalizmit serb, si dhe inskenimi i disa incidenteve me të cilat Beogradi manipuloi skajshmërisht.....</i>	<i>76</i>

<i>3.3. "Memorandumi" i Akademisë së Shkencës dhe e Arteve të Serbisë (SANU) i vitit 1986 dhe impakti i tij në ringjalljen e ideologjisë nacionaliste serbe.....</i>	<i>89</i>
--	-----------

KREU IV

PËRGATITJA DHE ZBATIMI I PLANIT PËR HEQJEN E AUTONOMISË SË VITIT 1974 DHE REVOLTA E SHQIPTARËVE

<i>4.1. Rrethanat që çuan në ngjitjen e Millosheviqit në krye të KQ LKS</i>	<i>103</i>
<i>4.2 . Mitingjet serbe si shprehje e rritjes së nacionalizmit serb dhe presioni ndaj udhëhajes legjitime të KSA të Kosovës.....</i>	<i>115</i>
<i>4.3. Përgatitjet për suprimimin e rendit politik - kushtetues në Kosovë dhe greva e minatorëve.....</i>	<i>127</i>
<i>4.4. Suprimimi i autonomisë së Kosovës, si uverturë e pushtimit të Kosovës dhe rezistenca e shqiptarëve(demonstratat e marsit dhe të prillit të vitit 1989)</i>	<i>137</i>
<i>4.5 Politika e Millosheviqit për serbizimin e Jugosllavisë</i>	<i>151</i>
<i>PËRFUNDIME</i>	<i>156</i>
<i>SHKURTESAT DHE AKRONIMET</i>	<i>167</i>
<i>BIBLIOGRAFI.....</i>	<i>168</i>

FALËNDERIM

Duke përmbyllur një periudhë të gjatë hulumtuese dëshiroj të përfitoj nga rasti për të shprehur mirënjohjet dhe falënderimet e ngrohta, për gjithë ata që më kanë mbështetur e më kanë ndihmuar në realizimin e këtij punimi.

*Fillimisht, dëshiroj të shpreh falënderimet e veçanta dhe mirënjohjen time të thellë për udhëheqësin shkencor të tezës së doktoratës, **prof. dr. Nebi Dervishin**, i cili më ka orientuar, më ka këshilluar, më ka redaktuar, si dhe më ka mbështetur në të gjitha etapat e këtij punimi. Pa ndihmën e tij të sinqertë dhe profesionale, ky punim nuk do të kishte formën dhe përmbajtjen aktuale.*

Një falënderim të veçantë dëshiroj t'ua dedikoj edhe punonjësve të arkivave dhe të bibliotekave, me të cilët kam bashkëpunuar gjatë viteve në procesin e hulumtimit dhe të grumbullimit të materialeve përgjatë viteve.

Së fundi, përfitoj nga rasti që të shpreh mirënjohjen për familjen time, që me angazhimin e saj maksimal dhe mbështetjen morale të pakursyer, më ka ndihmuar, duke më krijuar kushte optimale për lehtësimin e punës sime studimore.

ABSTRAKT

Teza: **“Ridalja e nacionalizmit serb pas vdekjes së Titos dhe forcimi i politikës antishqiptare në Kosovë dhe në Maqedoni në vitet 1981 - 1989”**, ka për qëllim që përmes një objektiviteti shkencor të shtjellojë zhvillimin e rrethanave dhe të faktorëve, që çuan në rishfaqjen e nacionalizmit serb në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë (më tej: RSFJ), manifestimin e këtij nacionalizmi dhe pasojat, që ai prodhoi për popujt e tjerë jo serbë në Jugosllavi, me theks të veçantë në Kosovë e Maqedoni, si dhe reagimin, ballafaqimin dhe qëndrimin e shqiptarëve kundrejt një politike të tillë gjatë viteve 1981-1989.

Shtjellimi i fenomenit të nacionalizmit serb është një temë e gjerë, trajtimi i së cilës kërkon një studim të thellë e shumëdimensional. Prandaj, teza fokusohet vetëm gjatë periudhës 1981-1989. Përzgjedhja e periudhës në fjalë nuk është e rastësishme. Ajo, në fakt, ngërthen në vete zhvillimin dhe rezultatet finale të nacionalizmit serb, që zanafillën e kishin në procesin e decentralizimit të RSFJ-së, autonominë e krahinave, sidomos të Kosovës, si dhe frikës nga shpërbërja e Jugosllavisë dhe humbjes së qëllimit tradicional të nacionalizmit serb – vendosjes së hegjemonisë serbe në RSFJ. Në këto rrethana, vdekja e Titos dhe demonstratat studentore të shqiptarëve të Kosovës, më 1981, ndezën zjarrin e kamufluar të nacionalizmit serb.

Fjalët kyçe: Nacionalizmi, demonstratat, Shqipëria, Tito, autonomia, etj.

ABSTRACT

Thesis: “**The Reappearance of Serbian Nationalism after Tito’s death and strengthening of Anti-Albanian Policy in Kosovo and Macedonia during 1981-1989**” aims to elaborate the development of circumstances and elements that led to reappearance of Serbian nationalism in the Socialist Federative Republic of Yugoslavia, its expression and consequences it produced against other non-Serb people in Yugoslavia, with a particular emphasis on Kosovo and Macedonia. In addition, the thesis also elaborates the reaction, confrontation and attitude of Albanians opposing such a policy during the year 1981-1989.

The explanation of Serbian nationalism phenomenon is a wide topic that requires an in-depth and multidimensional study, therefore the thesis encompasses only the period 1981-1989. The selection of this period was not a random choice. In fact, the thesis embodies the development and final consequences deriving from Serbian nationalism, whose origin goes back to the process of disintegration of Yugoslavia, revocation of Kosovo’s autonomy, and implementation of last goal of Serbian nationalism – establishment of Serbian hegemony over the Yugoslavia. In such circumstances, Tito’s death and Kosovo Albanian student demonstrations in 1981 only ignited the covered fire of Serbian nationalism.

Key words: Nationalism, demonstrations, Albania, Tito, autonomy, etc.

PARATHËNIE

Teza: “Ridalja e nacionalizmit serb pas vdekjes së Titos dhe forcimi i politikës antishqiptare në Kosovë dhe Maqedoni në vitet 1981 - 1989”, ka për qëllim që përmes një objektiviteti shkencor të shtjellojë zhvillimin e rrethanave dhe të faktorëve, që çuan në rishfaqjen e nacionalizmit serb në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë, manifestimin e këtij nacionalizmi dhe pasojat, që ai prodhoi për popujt e tjerë jo serbë në Jugosllavi, me theks të veçantë në Kosovë e Maqedoni, si dhe reagimin, ballafaqimin dhe qëndrimin e shqiptarëve kundrejt një politike të tillë gjatë viteve 1981-1989.

Nacionalizmi serb është një fenomen shumë kompleks, që gërsheton në vete faktorë dhe rrethana të shumta që përfshijnë një periudhë të gjatë kohore e historike. Duke bërë një analizë të shkurtër të zhvillimit të tij historik, teza e hulumtimit fokusohet në vitet 1981-1989, atëherë kur ndihen pasojat e rënda të këtij nacionalizmi mbi kurrizin e popujve jo serbë, në veçanti të shqiptarëve. Prandaj, përzgjedhja e studimit të një teze të tillë lidhet me një varg argumentesh: (1) studimet e deritanishme, të bëra, kryesisht, nga studiues ndërkombëtarë, për rrënimin e RSFJ-së dhe pasojave që solli ky rrënim e trajtojnë sipërfaqësisht rolin e nacionalizmit serb, dhe këtë rol, kryesisht, e ndërlidhin me ngjarjet në Kroaci dhe në Bosnjë-Hercegovinë e fare pak përmendet faktori shqiptar te vitet në fjalë; (2) historiografia serbe e zbeh rolin e nacionalizmit serb dhe pasojat shkatërrimtare të këtij fenomeni ia atribuon faktorëve të tjerë, duke i nxjerrë kështu serbët si viktima të popujve të tjerë; (3) historiografia shqiptare, ndonëse, e ka trajtuar nacionalizmin serb në etapat më të hershme historike, nuk ka ndonjë studim të veçantë për këtë fenomen gjatë viteve në fjalë, ku edhe ato pak studime janë të fragmentuara. Në këtë mënyrë teza: “Ridalja e nacionalizmit serb pas vdekjes së Titos dhe forcimi i politikës antishqiptare në Kosovë dhe Maqedoni në vitet 1981 - 1989”, pretendon të ofrojë një studim të thelluar e gjithëpërfshirës, ku do të analizohen faktorët, që çuan në zgjimin e nacionalizmit serb, mënyrës, formës dhe rrethanave që ndikuan në zhvillimin e tij, si dhe pasojave që ai prodhoi për shqiptarët në veçanti, gjatë viteve në fjalë. Pra, këtu qëndron edhe risia e këtij punimi që të ofrojë një studim të bazuar e shumëdimensional, përmes interpretimit objektiv të fakteve dhe të argumenteve.

Metodologjia e përdorur në këtë studim është ajo e qasjes tematike. Nuk mungojnë as metodat e tjera të kërkimit shkencor, sikurse: përshkrimi, hulumtimi, analiza dhe krahasimi.

Përdorimi i këtyre metodave ka pasur për qëllim që të mos e cenojë kohezionin dhe të jetë në përputhje me kronologjinë kohore. Paanshmëria në interpretimin e dokumenteve, ballafaqimi, krahasimi i qëndrimeve dhe lidhjet logjike, që dalin nga sinteza e të dhënave dokumentare u shndërruan në boshtin kryesor të nxjerrjes së përfundimeve.

Në bazë të tematikës kryesore dhe rëndësisë së çështjeve, struktura e punimit fillon me hyrjen, vijon me katër pjesë, vazhdon me konkluzionet e përfundon me bibliografinë.

Koncepti i nacionalizmit që u manifestua, fillimisht, te francezët dhe gjermanët, në fillim të shekullit XIX u bart edhe te popujt ballkanikë, në veçanti te serbët, te grekët e te bullgarët, të cilët filluan të imagjinonin restaurimin e perandorive të tyre mesjetare. Në rastin e serbëve, nacionalizmi u manifestua me tendenca agresive ndaj popujve dhe religjioneve të tjera. Prandaj, Hyrja paraqet një ekspozitë të rrethanave për lindjen dhe zhvillimin e nacionalizmit serb, përgjatë dekadave dhe si u manifestua ai te shqiptarët, duke përfshirë kështu edhe shtjellimin e programeve dhe të projekteve të shumta antishqiptare.

Kreu I: *“Premisat e rishfaqjes së nacionalizmit serb” pretendon të shtjellojë rrethanat, ku u gjend RSFJ në fund të Luftës së Dytë Botërore. Pastaj, gjendjen dhe pozitën e popullsisë shqiptare, sistemin dhe zhvillimet politike, sidomos, ndryshimet politike të viteve 1966 e ato kushtetuese të viteve 1974, që si rezultat patën decentralizimin e RSFJ dhe akordimin e autonomisë së krahinave, që në fakt ishte edhe fillimi i heshtur i organizimit të nacionalizmit serb, që doli në skenë pas vdekjes së Titos dhe pas demonstratave studentore shqiptare në Kosovë, më 1981.*

*Vdekja e Titos, më 1980, paraqet një moment kthese në historinë e popujve, që atëherë jetonin në kuadër të RSFJ-së. Duke qenë se udhëheqja kolektive jugosllave, që pasoi Titon, nuk ishte në gjendje t'i ekuilibronte rrethanat dhe ta mbante gjendjen nën kontroll, u lind riaktualizimi i tendencave etnike. Gjatë pranverës së vitit 1981, studentët shqiptarë u ngritën në kërkim të të drejtave kombëtare dhe barazisë me popujt e tjerë në RSFJ. Një kërkesë e tillë hasi në reagimin e ashpër të strukturave shtetërore serbe e jugosllave, prapa së cilave fshihej nacionalizmi serb. Prandaj, **kreu II:** *“Ngjarjet në muajt mars-prill të vitit 1981 dhe situata e krijuar pas tyre” pretendon të ofrojë një vështrim të përgjithshëm rreth gjendjes në Kosovë e Maqedoni, pas vdekjes së Titos dhe demonstratave studentore në Kosovë, dhunën policore e ushtarake kundër shqiptarëve, diferencimin ideopolitik në institucionet universitare e shkencore. Pra, duke atakuar elitën akademike shqiptare, për t'i hapur rrugë, kështu, synimeve për heqjen e**

Kushtetutës së vitit 1974 dhe për krijimin e parakushteve për rivendosjen e centralizimit në RSFJ, që ishte një nga detyrat kryesore të nacionalizmit serb.

Kreu III: “Rishfaqja e nacionalizmit të heshtur serb 1981-1989” shtjellon ngjarje të rëndësishme që ndodhën pas pranverës shqiptare të vitit 1981. Nacionalizmi serb, i cili kishte qëndruar latent, që nga koha e Rankoviqit, tani doli në skenë dhe filloi mobilizimi i tij, që si një proces merr formë të organizuar tek në vitin 1986. Të dirigjuar nga instanca të larta shkencore e religjioze, si nga: Kisha Ortodokse Serbe (më tej: KOS), Lidhja e Shkrimtarëve të Serbisë (më tej: LSHS), Akademia Serbe e Shkencave dhe Artave (më tej: ASSHA), grupe të vogla serbësh, sidomos në Kosovë, filluan ta ndërtonin një kauzë të rrejshme, duke inskenuar incidente etnike dhe situata të paqena, të cilat do të thellonin ndarjet etnike në Kosovë e do ta bindin opinionin publik jugosllav për pozitën e tyre të rëndë në Kosovë, ku si rezultat kishte qëllimin për arsyetimin e veprimeve politike dhe policore kundër shqiptarëve në Kosovë. Po ashtu, një trajtim i veçantë e shumëdimensional në këtë kapitull i jepet edhe Memorandumit të ASSHA-së të vitit 1986, që ishte çelësi programor i të gjitha veprimeve shkatërrimtare e gjenocidale të serbëve në Jugosllavi.

Kreu IV: “Përgatitja dhe zbatimi i planit për heqjen e autonomisë së vitit 1974 dhe revolta e shqiptarëve” trajton ngjarje me rëndësi, të cilat fillojnë që nga ngritja e Slllobodan Millosheviqit në kreun e udhëheqjes komuniste në Serbi dhe realizimit të programit të përgatitur nga qarqet nacionaliste serbe (ASSHA, KOS, LSHS) për eliminimin e autonomisë së Kosovës dhe centralizimin e RSFJ-së apo të synimeve për krijimin e një hegjemonie serbe në RSFJ, që në fakt nënkuptonte një Serbi të madhe, si dhe rezistencën e shqiptarëve ndaj synimeve të tilla.

Në fund, kemi hartuar konkluzionet, të cilat provojnë të japin një dëshmi analizuese dhe krahasuese rreth zhvillimeve në fjalë, bazuar nga dokumentacioni në dispozicion.

Në punimin e një teze të tillë është shfrytëzuar një bibliografi e pasur, që, kryesisht, bazohet në materialet e pabotuara arkivore të hulumtuara në Arkivin Shtetëror të Kosovës, në Arkivin Qendror Shtetëror të Shqipërisë, pastaj një gamë e gjerë e literaturës në gjuhën shqipe, angleze e serbe. Po ashtu, janë shfrytëzuar revista, periodikë dhe gazeta ditore, të cilat kanë përcjellë kronologjinë e zhvillimit të ngjarjeve dhe, njëkohësisht, kanë ndjekur edhe metodologjinë e ballafaqimit të fakteve të ofruara nga dyja palët – shqiptarët dhe serbët. Një hapësirë të konsiderueshme zë edhe shfrytëzimi i burimeve elektronike – online.

HYRJE

Fenomenologjia e nacionalizmit serb nuk mund të shpjegohet nëse merret parasysh vetëm periudha e viteve të fundit të shekullit XX. Nacionalizmi serb, për t'u njohur, duhet të gjurmohet në gjenezën e tij, në zanafillën e tij, e që shkon tek në fillimet e shekullit XIX, kur idetë iluministe evropiane filluan të depërtojnë në arealin ballkanik, fillimisht, te serbët, te grekët e te bullgarët, duke zgjuar kështu ndjenjat e tyre për emancipim kombëtar, çlirim nga sundimi osman, por edhe restaurim të perandorive të tyre mesjetare. Kështu, serbët ëndërronin restaurimin e kufijve të shtetit mesjetar të Dushanit. Grekët ëndërronin restaurimin e Perandorisë Bizantine, kurse bullgarët shtetin mesjetar të Borisit.¹

Por, karakteristikë e veçantë është se këto përpjekje u shoqëruan edhe me elemente shoviniste. Serbët ishin të prirë në ndërtimin e një shteti etnik me religjion ortodoks të krishterë, duke mos duruar kështu elemente të tjera etnike apo fetare në truallin e tyre. Në vazhden e këtij qëndrimi, princi serb, Millosh Obrenoviçi, qysh gjatë sundimit të tij të parë (1815-1839) bëri përpjekje të mëdha që t'i shpërngulë shqiptarët dhe myslimanët nga territori i Serbisë autonome. Ai porosiste eksponentët e tij, që të ndërmermin të gjitha veprimet e mundshme, për t'i blerë tokat dhe shtëpitë e shqiptarëve. Kështu, përmes presionit dhe bashkëpunimit me autoritetet osmane, Milloshi arriti të realizonte shpërnguljen e një numri jo të vogël të shqiptarëve nga Quprija e Aleksinci.²

Një politikë e tillë krijoi premisat për përforcimin e elementeve dhe të ideve shoviniste te serbët. Inkurajimi për dëbimin e shqiptarëve dhe jotoleranca ndaj besimeve dhe gjuhëve të tjera demonstron nga i ashtuquajti: **“Kanuni Vasojeviçi”** i vitit 1829.³ Njëra nga dispozitat e këtij Kanuni inkurajon dhe legalizon rrënimin e të gjitha veprave të kulturës myslimane. Kjo tendencë barbare do të bartet, rrjedhimisht, në gjitha projektet dhe programet e organizatave nacionaliste serbe. Në këtë mënyrë, vepra me vlera të rralla të arkitekturës islame, janë shlyer nga faqja e

¹ Gazmend Rizaj, *Shqipëria e Sipërme 1800 – 1913*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2011, f. 97; Për më tepër shih edhe Sadulla Brestovci, *Marrëdhëniet shqiptare - serbo - malazeze (1830 - 1878)*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1983.

² S. Brestovci, “Mbi disa momente të marrëdhënieve shqiptaro-serbe gjatë kohës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit”, *Gjurmime Albanologjike*, Seria e Shkencave Historike, IX-1979, Prishtinë, 1980, f. 72.

³ Për më tepër shih: Vasojevički Zakon u 12 točaka, Google Internet https://www.rastko.rs/rastko-cg/povijest/vaszak_c.html, qasja 20 dhjetor 2018.

dheut si rezultat i politikës sistematike të kulturocidit serb gjatë historisë më shumë se njëqindvjeçare.⁴

Përprojekjet e serbëve për ndërtimin e një shteti etnik e të zgjeruar, në aspektin territorial, në dëm të popujve të tjerë do të marrin një kahje më të organizuar me fitimin e autonomisë së Serbisë nga Perandoria Osmane, më 1830.⁵ Rrethanat ndërkombëtare, në të cilën Serbia fitoi autonominë, sikurse ishte dekadencia e Perandorisë Osmane dhe ndikimi rus në të, si dhe ndërgjegjësimi për rolin e saj në politikën ballkanike, bëri që qarqet politike serbe të shtjellojnë strategji politike, për t'i shfrytëzuar këto rrethana në favor të restaurimit të perandorisë mesjetare serbe. Në këtë mënyrë projekti: *"Srbi - svi svuda"* (Serbë - të gjithë e gjithkund) të Vuk Karaxhiqit (1836), do të pasohet nga ndikimi i fuqishëm i lëvizjes pansllaviste të udhëhequr nga polaku, Adam Czartorisky, që synonte bashkimin e sllavëve të jugut në një shtet. Nën influencën e kësaj lëvizjeje, ministri i jashtëm i Serbisë, Ilija Garashanin, më 1843, hartoi programin e quajtur: "Naçertanije".⁶

Por, për dallim nga projekti polak që synonte bashkimin e sllavëve të jugut, duke vepruar në aspekt të kundërt në tendencë të vendosjes së hegjemonisë serbe mbi sllavët e tjerë të jugut, Garashanini do ta transformonte këtë ide në restaurim dhe zgjerim të shtetit serb, që sipas autorit të tij, ishte plotësim i detyrës së caktuar nga Car Stefan Dushani, e cila qe ndërprerë nga Beteja e Kosovës e vitit 1389. Në këtë mënyrë, rikrijimi i Perandorisë Serbe arsyetohej si një e drejtë historike. Prandaj, sunduesve të Serbisë të shekullit XIX u takonte që ta plotësonin atë se çfarë kishin lënë paraardhësit.⁷

Plani i Garashaninit ravijëzoi hapat e nevojshëm se si ta bënte unifikimin e sllavëve të jugut, ku drejtimi kryesor i ekspansionit të politikës se jashtme serbe do të shkonte në drejtim të Bosnjës e Hercegovinës, të Malit të Zi dhe të Shqipërisë Veriore. Kështu, Serbia e "fitonte të drejtën e daljes në det".⁸ Kjo nuk do mund të realizohej pa u larguar Perandoria Osmane nga Ballkani, ku pastaj në gërmadhat e saj të ngrihet Perandoria Serbe. Në njërin nga parimet themelore të këtij programi thuhej: "Serbia duhet ta shkallmojë, gurë pas guri, ngrehinën e shtetit

⁴ Sabri Bajgora, *Barbaria serbe ndaj monumenteve islame në Kosovë (Shkurt '98 – Qershor '99)*, Bashkësia Islame e Kosovës, Prishtinë, 2000, f. 5.

⁵ Barbara Jelavich, *Histori e Ballkanit – shekulli XVIII-XIX*, Tiranë, 1999, f. 217-228.

⁶ Georges Castellan, *Histori e Ballkanit*, Tiranë, 1997, f. 324.

⁷ Hakif Bajrami, "Ilija Garashanin dhe politika e tij shtetërore 1844-1874", *Vjetari-Godishnjak XXIV/88*, Prishtinë, 1988, f. 129.

⁸G. Rizaj, *Shqipëria e Sipërme 1800 – 1913...*, f. 99.

turk, duke marrë prej saj çfarëdo që mund të shpëtohet dhe mbi themelet e ngjeshura të shtetit të vjetër serb të ndërtojë një shtet të ri e të madh serb".⁹

Në kufijtë e kësaj perandorie të re, sipas "Naçertanies", do të hynin edhe viset e Shqipërisë së Veriut, së bashku me Kosovën, që sipas hartuesit të saj, u pagëzua me emrin Serbi e Vjetër.¹⁰

Ky emërtim jepte sinjale se programi i Garashaninit përveç të "drejtës historike" bazohej edhe në traditën e dikurshme të shtetit serb¹¹, dhe si i tillë do ta përbënte bazën për programet e tjera shoviniste serbe, në dëm të popujve jo sllavë, në veçanti, ndaj shqiptarëve. Përdorimi i kësaj shprehjeje: "Serbia e Vjetër", do të bëhej edhe më i shpeshtë dhe do të përgëzohej gjatë viteve 1870-1880, me synimin final për falsifikimin e historisë së trojeve shqiptare dhe sigurimit të argumenteve për një ekspansion drejt territoreve shqiptare të Kosovës.¹²

Pozita gjeografike e strategjike e territoreve shqiptare, në jug të Serbisë, ku kalonin rrugët kryesore tregtare që çonin drejt porteve detare, tokat pjellore dhe pamundësia për t'u shtrirë kah perëndimi për shkak të presionit austro-hungarez, bëri që qarqet politike serbe të orientonin ambiciet e tyre hegjemoniste drejt jugut. Në këtë mënyrë, programi i Garashaninit do të shndërrohet në një udhërrëfyes dhe themel për shumë programe të tjera antishqiptare, që u paraqitën përgjatë pjesës së mbetur të shekullit nëntëmbëdhjetë dhe të shekullit njëzet.

Në zbatim të "parimeve" të "Naçertanisë", në gjysmën e dytë të shekullit XIX (1876 - 1878), ushtria pushtuese serbe dëboi nga viset e pushtuara shqiptare të Toplicës, të Vranjës, të Kurshumlisë, të Leskovcit e të Prokuplës më se 300 mijë shqiptarë, u shkatërruan dhe u rrënuan rrafsh me tokë 80 fshatra.¹³ Për domosdoshmërinë e shpërnguljes së shqiptarëve fliste vetë akademiku serb, Vasa Çubrilloviqi në punimin e tij: "*Shkaqet politike të shpërnguljeve në Ballkan prej vitit 1860 deri në vitin 1880*". "Është me rëndësi të veçantë etnografike dhe politike shpërngulja e shqiptarëve nga Toplica dhe Kosenica. Prej shekullit XVII e këndeje, sidomos prej dyndjes së serbëve nën Arsenije Çarnojeviqin, lëshohen gradualisht malësorët shqiptarë nga

⁹ Branimir Anzulovic: *Serbia Hyjnore - Nga miti te gjenocidi*, "KOHA", Prishtinë, 2017, f. 142.

¹⁰ *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëllimi II, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Shqipërisë, Toena, Tiranë, 2002, f. 102-103.

¹¹ S. Brestovci, "Marrëdhëniet Shqiptaro-Serbo-Malazeze gjatë viteve 1839-1856", Google Internet, http://sadulla.brestovci.info/index.php?title=Marr%C3%ABdh%C3%ABnjet_Shqiptaro-Serbo-Malazeze_gjat%C3%AB_viteve_1839-1856, qasja 25 nëntor 2018.

¹² Zija Shkodra, *Qytetet Shqiptare të Rilindjes*, Tiranë, 1990, f. 14.

¹³ Vaso Çubrilloviq, *Problemi i pakicave kombëtare në Jugosllavinë e re*, (Parathënie) botoi Kolegjiumi i Redaksisë së "Zërit të Kosovës", Tetor 1987, f. 5.

*luginat e veta në fushat pjellore të Rrafshit të Dukagjinit dhe të Kosovës, duke depërtuar në veri, në drejtim të Moravës Perëndimore dhe asaj Jugore: nëpër malin e Sharrit zbresin në Polog, e prej aty në drejtim të Vardarit. Kështu deri në shekullin XIX është krijuar pyka shqiptare, e cila duke u mbështetur në prapavijënn e vet etnografike, është futur thellë në tokat tona, ka mbërritur në portat e vetë Nishit dhe i ka ndarë tokat tona veriore prej atyre jugore. Kjo pykë shqiptare ka qenë ajo transversalja, e cila gjatë tërë shekullit XIX e ka penguar Serbinë e Malin e Zi, që të zhvillonin aksione aq të gjera në Serbinë Jugore, siç kishin dëshiruar”.*¹⁴Pra, citimi në fjalë mohon autoktoninë shqiptare dhe i bën ata ardhacakë në viset e tyre, ku mohohet në bazë faktike nga studime të shumta, derisa paradoksi shkon deri në atë shkallë, sa t’i jap të drejtë vetes t’i dëboj popujt e tjerë nga vatrat e tyre.¹⁵

Programe të tilla u bënë udhërrëfyese për gjenocidin serb kundër shqiptarëve gjatë Luftës së Parë Ballkanike. Në Ferizaj, Kumanovë dhe në shumë lokalitete të tjera janë verifikuar masakra të mëdha mbi myslimanët (shqiptarët), si dhe plaçkitje pas okupimit ushtarak.¹⁶ Ky gjenocid dëshmohej edhe nga vetë serbët që si ushtarë kishin marrë pjesë në ekspeditat ushtarake kundër shqiptarëve. Në një memoar të një ushtari shkruhej: “...mund të them se Luma nuk ekziston në faqen e dheut. Kudo kufoma, hi, pluhur, nga fshatrat me rreth 100-120 shtëpi, ku nuk mbeti njeri i gjallë. I mblihdnin në grupe nga 40-50 vetë dhe i masakronin me thika”.¹⁷ Se një akt i tillë ishte i paramenduar dhe i projektuar nga shteti serb dëshmohej edhe nga roli i KOS-it. “Vesnik Srpske Crkve” – organi i KOS-it, i përkrahte dhe i frymëzonte çetnikët për luftë, e sidomos duhet cekur masakrën e “vullnetarëve” të ushtrisë serbe, nën udhëheqjen e priftërinjve ortodoksë, që masakruan 500 gra, fëmijë e pleq.¹⁸

Në një raport të shkruar nga Lav Trocki*, që ishte korrespondent lufte në Ballkan dhe kishte raportuar mbi Luftën e Parë Ballkanike, tregon bisedën që e kishte në tren me një oficer serb i cili udhëtonte nga Nishi në Shkup. Teksa përshkruante dhunën dhe terrorin që ushtronin forcat serbe mbi banorët shqiptarë, oficeri i lartë serb nuk harroi të përmendte politikën qeveritare

¹⁴*Serbia dhe Shqiptarë*, Pasqyrë e politikës së Serbisë ndaj shqiptarëve prej vitit 1878 deri në vitin 1914), Libri i parë, Instituti i Historisë, Prishtinë, 2011, f. 94.

¹⁵Po aty, f. 94.

¹⁶G. Rizaj, “Dokumente italiane mbi reprezaljet serbe në territoret e okupuara ballkanike 1912-1913”, *Buletini*, XXVII-XXVIII, 1997/98, f. 268.

¹⁷Zekeria Cana, *Shpalime Historike*, Vëll. II, Prishtinë, 1998, f. 165.

¹⁸Menduh Bamja, *Pozita kushtetuese juridike dhe faktike e bashkësive fetare në ish-Jugosllavi me vështrim të posaçëm të Bashkësisë Islame*, Prizren, 2011, f. 63-65.

* Lav Trocki, revolucionar rus. Gjatë Luftës së Parë Ballkanike ishte korrespondent nga Ballkani.

që qëndronin pas. Më tutje ai thekson, se: *"Dua të them që mizoritë, që kalimthi ishin përmendur në Beograd, nuk mund të ishin rastësi, raste të izoluara apo edhe përjashtime, po ato ishin pjesë e politikave qeveritare."*¹⁹

Këto fakte japin të kuptohet se tek institucionet politike dhe fetare të Mbretërisë Serbe ishte instaluar urrejtja antishqiptare. Një urrejtje e tillë do të vazhdojë edhe gjatë dekadave pasuese përmes ushtrimit të të gjitha formave të persekutimit. Në këtë mënyrë objektivat e "Naçertanies" dhe realizimi i tyre i plotë u bënë përsëri çështje themelore e aktivitetit integral, politik e shkencor të ASSHA, të Klubit Kulturor serb dhe të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Serbisë e të Jugosllavisë edhe pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore²⁰. Ndër programet e shumta do të përmendim: Programi sekret i vitit 1920 për likuidimin e shqiptarëve dhe kolonizimin e viseve jugore²¹, *"Iseljavanja Arnauta"* ("Shpërngulja e Arnautëve") të Vasa Çubriloviqit (1937), në bazë të së cilës u lidh marrëveshja turko-jugosllave (1938), e cila parashihte, që brenda gjashtë vitesh të shpërnguleshin për në Turqi mbi 40.000 familje.²²Në të njëjtën linjë ishte edhe: *"Elaborat o Albaniji" (1939)* (Elaborati për Shqipërinë) i laureatit të çmimit Nobel, Ivo Andriqit (1939), i cili ofronte një zgjidhje përfundimtare, duke ofruar ndarjen e Shqipërisë ndërmjet Italisë dhe Jugosllavisë. Në një rast të tillë, ai rikujtonte planet e hershme jugosllave për Shqipërinë e Veriut. Pushtimi i Shqipërisë Veriore, në aspektin ekonomik, ishte i leverdishëm, sidomos kur në të gjendej edhe Shkodra dhe liqeni i saj, tharja e të cilit do t'i jepte Malit të Zi një sipërfaqe të konsiderueshme të tokës pjellore, kurse në aspektin politik do të zhdukej qendra e mbështetjes për irredentizmin shqiptar në Kosovë, si dhe shpërngulja e shqiptarëve për në Turqi do të bëhej në rrethana të reja.²³ Përveç kësaj, Andriq mendonte se, duke aneksuar këtë pjesë të Shqipërisë, do të ndihmohej asimilimi i shqiptarëve të Kosovës. *"Vërtet do t'i kemi nja 200 deri në 300 mijë shqiptarë më shumë, thekson ai, por këta janë të katolikë, marrëdhëniet e të cilëve me shqiptarët myslimanë nuk kanë qenë kurrë të mira. Kështu që, kjo do ta lehtësonte dëbimin e shqiptarëve për në Turqi"*.²⁴

¹⁹ Robert Elsie & Bejtullah Destani, KOSOVA një histori dokumentare, Prishtinë 2019, fq.163.

²⁰ Esat Stavileci & Pajazit Nushi, *Të vërteta për Kosovën*, Prishtinë, 2000, f. 74 - 75.

²¹ H. Bajrami, *Politika e shfarosjes së shqiptarëve dhe kolonizimi serb i Kosovës (1844-1995)*, Prishtinë, 1995, f. 18.

²² Paskal Milo, *Politika e jashtme e Shqipërisë 1912-1939*, Vëllimi I, Toena, Tiranë, 2013, f. 863.

²³ Bogdan Krizman, "Elaborat Ive Andrica o Albaniji iz 1939 godine", *Casopis za Suvremenu Povijest*, Br. 9, Zagreb, 1977, f. 77-89.

²⁴ Flaka Surroi, *Politika serbomadhe prej Garashaninit deri te Akademia*, KOHA, Prishtinë 2019, f. 115.

Mendim të njëjtë shovinist për ndarjen e Shqipërisë kishte edhe **Stevan Moleviq**, përmes projektit: *"Homogena Srbija" (1941)* (Serbia homogjene), që fliste për ndarjen e Shqipërisë midis Jugosllavisë çetnike dhe Greqisë, për të dalë te programet jugosllave për shpërnguljen e shqiptarëve për në Turqi pas Luftës së Dytë Botërore e deri te: *"Memorandum"* i ASSHA (1986). Të gjitha këto në krijimin dhe zbatimin e idesë për Serbinë e Madhe.²⁵

Me sa u tha më lart, shohim se pretendimet dhe orvatjet e Serbisë ndaj tokave shqiptare datojnë qysh nga mesi i shekullit XIX, por që vazhduan pandërprerë deri në fund të shekullit XX, atëherë kur Millosheviqi, në përpjekje të implementimit të këtyre projekteve ekspansioniste e nacional – shoviniste, nxiti dhe shkaktoi luftëra gjenocidale mbi popujt jo serb. Këto luftëra të përgjakshme, që u shkaktuan në arealin e ish - Jugosllavisë u bënë në emër të asaj, që ata e quanin "e drejtë historike".

²⁵ Hajrullah Gorani "Është koha të shohim syhapur dhe mirëfilltë gjendjen tonë", BULETIN i Fakultetit Filozofik XXII/1992, Prishtinë 1994, f. 292 -293.

KREU I PARË

PREMISAT E RISHFAQJES SË NACIONALIZMIT SERB

1.1. Jugosllavia në përfundim të Luftës së Dytë Botërore – ndarja administrative dhe sistemi politik

Dekompozimi i Mbretërisë së Jugosllavisë në vitin 1941 ishte dramatik. Në qarqe të ndryshme politike, në hapësirat jugosllave, por, edhe në Evropë fare pak besohej në ringjalljen e Jugosllavisë. Por, një mision që llogaritej i pamundshëm u realizua nga Josip Broz Tito.²⁶

Ai dhe bashkëlufëtaret e tij arritën që më 29 nëntor 1943, në qytetin e vogël të Jajces, Bosnjë-Hercegovinë, t'i hidhnin themelet e një Jugosllavie të re e të organizuar në parime federative. Në një vendim që buroi nga mbledhja e dytë e Këshillit Antifashist Çlirimtar të Jugosllavisë, thuhej se: “*Jugosllavia ndërtohej mbi bazat e parimit federativ, përmes së cilës do të sigurohej barazia e plotë e serbëve, kroatëve, sllovenëve, maqedonasve dhe malazezëve, respektivisht të popujve të Serbisë, Kroacisë, Maqedonisë, Malit të Zi e Bosnjë-Hercegovinës, kurse pakicave do të siguroheshin të drejtat e plota kombëtare*”.²⁷

Nga ky formulim shihet qartë se shqiptarët e Kosovës nuk ishin kalkuluar si subjekt apo element konstituiv në federatën e ardhshme jugosllave. Me gjasë ata llogariteshin si një pakicë kombëtare. Në fakt, përfaqësuesit e Këshillit Nacionalçlirimtar të Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit as që ishin ftuar në mbledhjen e Jajces. Prandaj, për të mos mbetur jashtë kalkulimeve për rregullimin e ardhshëm politik në Jugosllavi apo Shqipëri, si dhe për të shprehur vullnetin e popullsisë së Kosovës, Këshilli në fjalë organizoi në Bujan (Malësia e Gjakovës), një mbledhje që u emërua si Konferenca e Parë e Këshillit Nacionalçlirimtar të Kosovës dhe e Rrafshit të Dukagjinit. Në punimet e kësaj Konference, që u mbajt në periudhën 31 dhjetor 1943 – 2 janar 1944, morën pjesë rreth 43 delegatë shqiptarë, 3 serbë e 3 malazezë. Aty u firmos një Rezolutë, e cila prononcohej për zgjidhjen e çështjes kombëtare të Kosovës, në bazë të parimit të vetëvendosjes, duke përcaktuar edhe rrugën që duhej ndjekur: “*Kosova e Rrafshi i Dukagjinit është një krahinë e banuar me shumicë nga populli shqiptar, i cili dëshiron që të bashkohet me*

²⁶Jasminka Udovički & James Ridgeway, *Makthi etnik i Jugosllavisë*, Albin, 1998, f. 57.

²⁷Branko Petranović, Momčilo Zečević, *Jugoslovenski federalizam ideje i stvarnost*, Tematska zbirka dokumenata, Prvi Tom 1914-1943, Prosveta, Beograd, 1987, f. 801.

*Shqipërinë. Rruga e vetme që populli shqiptar i Kosovës dhe i Rrafshit të Dukagjinit të bashkohet me Shqipërinë është lufta e përbashkët me popujt e tjerë të Jugosllavisë kundër okupatorit nazist. Kjo është e mënyra e vetme për ta fituar luftën të gjithë popujt. Pra, edhe populli shqiptar do të ketë mundësi të vendosë për fatin e tij me të drejtën e vetëvendosjes deri në shkëputje”.*²⁸

Rezoluta e Bujanit ishte pasqyrim i aspiratave të popullit shqiptar të Kosovës për bashkim kombëtar. Por, heshtja e çështjes së Kosovës në mbledhjen e Jajces, si duket kishte qenë një kalkulim i qarqeve nacionaliste serbe, të veshura me petkun komunist, që mos ta hapin këtë çështje deri në krijimin e rrethanave të përshtatshme për aneksimin e Kosovës. Ky supozim mund të vërtetohet me deklaratat, që udhëheqësit partiakë jugosllavë - serbë japin lidhur me këtë çështje, në kohën kur ende po zhvillohej lufta kundër forcave naziste, si dhe ndryshimin e qëndrimit pas konsolidimit të pushtetit të tyre. Në këtë vazhdë, qysh më 2 dhjetor të vitit 1943, Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Jugosllavisë (më tej: PKJ) përmes një letre i sqaron KQ të Partisë Komuniste të Shqipërisë (më tej: PKSH) se secili komb ka të drejtë për vetëvendosje, pra, edhe shqiptarët e Kosovës kanë të drejtë të përcaktohen se ku dhe si dëshirojnë të jetojnë.²⁹

Megjithatë, në gjirin e PKJ-së ekzistonin divergjenca lidhur me çështjen e Kosovës. Qarqet serbe ishin më të prira kundër çdo mekanizmi, që mund t'i ofronte kompetenca ekzekutive apo statut juridik Kosovës. Prandaj, në këtë vazhdë, Svetozar Vukmanoviq - Tempo kritikonte ashpër Pavle Joviqeviqin, në janar 1944, lidhur me Bujanin, derisa ky i fundit premtonte për përmirësimin e gabimit. Kurse në një letër të marsit 1944, Millovan Gjilas ia tërhoqi vërejtjen Komitetit Krahinor të Kosovës se Këshilli Nacionalçlirimtar i Kosovës nuk mund të kishte “karakter pushteti”, sikurse që këshilla të tilla kishin në: Serbi, Kroaci, Mal të Zi, etj.³⁰

Pavarësisht, këtyre qëndrimeve, një element tjetër që bie në sy lidhur me çështjen e Kosovës është qëndrimi partiak jugosllav për një federatë të mundshme me Shqipërinë. Për të gëlltitur Shqipërinë në federatën jugosllave, qarqet komuniste jugosllave shpreheshin se Kosova mund të bashkohej me Shqipërinë në një rregullim të ardhshëm federativ në Ballkan. Në një mbledhje të Këshillit Nacionalçlirimtar të Serbisë, të mbajtur në dhjetor të vitit 1944, zyrtari i

²⁸ Ana Lalaj, *Dosjet e luftës*, Botimet Toena, Tiranë, 2014, f. 187-189; *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëllimi IV, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Shqipërisë, Toena, Tiranë, 2008, f. 143.

²⁹ B. Petranović, M. Zečević, *Jugoslovenski federalizam ideje i stvarnost...*, f. 809.

³⁰ *Historia e Popullit Shqiptar...*, vëll. IV, f. 144.

lartë partiak serb, Zhujeviq, deklaroi: “Nuk ka asnjë diskutim lidhur me Kosovën. Ajo është jona. Nëse Shqipëria do të organizohej në parime të njëjta sikurse ne, atëherë ne nuk do të kishim gjë kundër, që shqiptarët të shkëputen dhe t’i bashkëngjiten asaj”.³¹

Nuk ka asnjë dyshim se këtu ishte në pyetje një federatë e mundshme midis dy vendeve. Kjo mund të argumentohet edhe nga një mbledhje e KQ Partisë Komuniste të Serbisë, në mars 1945, ku zyrtari i lartë partiak serb, Bllagoje Neshkoviq, deklaroi: “Çështjen se kujt duhet t’i takojë Kosova e Metohija, Shqipërisë apo Jugosllavisë, duhet vështruar në një mënyrë të tillë që, sot, Republika Federative e Demokratike e Jugosllavisë është një shtet i fuqishëm që mund të sigurojë një jetë më të mirë dhe plotësim të nevojave të popullsisë shqiptare dhe të popullsive të tjera. Kur në Shqipëri të arrihet fitorja e plotë e lëvizjes nacionalçlirimtare atëherë nuk do të ketë më çështje të kufijve midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë”.³²

Shprehje të tilla, me qëndrime neutrale rreth Kosovës ishin retorikë mashtruese e qarqeve serbe, sepse me konsolidimin e pushtetit komunist në Jugosllavi, filloi të ndryshojë edhe qëndrimi rreth çështjes së Kosovës. Në gjysmën e dytë të shkurtit 1945, kur ende nuk ishte shtypur revolta në Kosovë, në KQ PKJ në Beograd u mbajt një mbledhje me rëndësi, ku merrnin pjesë: Kardeli, Rankoviqi, Gjilasi, Tempo, Neshkoviqi, Zhujkoviqi, si dhe udhëheqësit kosovarë Fadil Hoxha e Miladin Popoviqi. U diskutua për çështjen e Kosovës. Kardeli tha se zgjidhja më e mirë do të ishte që Kosova t’i bashkëngjitej Shqipërisë, e që Shqipëria të hynte në federatë me Jugosllavinë. Por, pasi që Lëvizja Nacionalçlirimtare në Shqipëri nuk është forcuar ende, kurse situata ndërkombëtare është e pafavorshme pasi që aleatët ndërkombëtarë kishin ndërhyrë në Greqi, zgjidhja ballkanike nuk vjen në shprehje. Pasi u shqyrtuan të gjitha variantet, u arrit përfundimi se zgjidhja më e mirë do të ishte, sikur Kosova e Metohija të bashkohen në një qark dhe t’i bashkohen Republikës së Serbisë.³³

Në këto rrethana u hap rruga për aneksimin e Kosovës, qoftë edhe përmes forcës ushtarake. Pas mosnjohjes së vendimeve të Bujanit, hapi i parë drejt aneksimit të Kosovës ishte vendosja e Administratës Ushtarake në Kosovë, që mbeti në fuqi gjatë periudhës 8 shkurt - 5 korrik 1945. Kjo ishte një diktaturë e egër, që eliminoi pushtetin e këshillave antifashistë dhe nën pretekstin e “goditjes së reaksionit”, kreu masakra masive mbi popullatën shqiptare.³⁴

³¹ Branko Horvat, *Kosovsko pitanje*, Globus Zagreb, 1989, f. 86.

³² Po aty, f. 86.

³³ Po aty, f. 86.

³⁴ *Historia e Popullit Shqiptar...*, vëll. IV, f. 341.

Në këto kushte të presionit dhe të eliminimeve fizike, dhjetë ditë pas vendosjes së Administratës Ushtarake, më 18 shkurt 1945, në një mbledhje të udhëheqjes së lartë të Komitetit Qendror të PKJ në Beograd, nën diktatin e përfaqësuesve serbë mbi ata malazezë e maqedonas, u vendos që Kosova t'i bashkëngjitej Serbisë. Në këtë mënyrë, gjatë periudhës 8-10 korrik 1945 në Prizren u mbledh i ashtuquajtur i Kuvendi i Këshillit Popullor të Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit, i cili njihej si: "Kuvendi i Prizrenit". Nga 137 pjesëmarrës, vetëm 32 ishin shqiptarë, të cilët vëzhgoheshin nga njerëz të armatosur të UBD-së. U miratua me duartrokitje, pa votime e nënshkrime, një rezolutë e ardhur e gatshme nga Beogradi. Në Rezolutë shprehej dëshira e popullit të Kosovës, për t'iu bashkëngjitur Serbisë federale si pjesë përbërëse e saj.³⁵

Në këtë mënyrë, Kosova u bë pjesë e Serbisë, e cila në Kushtetutën Federative të vitit 1946 sanksionohej si Rajoni Autonom i Kosovës e Metohisë (më tej: RAMK). RAMK i nënshtrohej plotësisht Republikës Popullore të Serbisë. Shqiptarëve, shumicë në RAKM, iu mohua e drejta e përcaktimit të emrit dhe statusit etnik të njësisë federative. RAKM konsiderohej një rajon me popullsi të përzier, megjithëse, shqiptarët, sipas dokumenteve të kohës, përbënin mbi 75% të popullsisë së rajonit.³⁶

Pavarësisht se shqiptarët përbënin shumicën në krahinë, atyre iu mohuan të gjitha të drejtat kombëtare. Dispozitat ligjore në fuqi, nuk lejonin shprehjen e identitetit kombëtar të shqiptarëve. Nuk lejohej përdorimi i flamurit. Nuk lejohej mësimi në gjuhën shqipe, etj. Për më tepër, krahas diskriminimit etnik u zhvillua edhe diskriminimi administrativ e juridik. Ndonëse, quhej rajon autonom, Kosova nuk ishte e barabartë për kah statusi me krahinën autonome të Vojvodinës. Vojvodinës i njihej statusi krahinë, që ishte një akt më i lartë, në krahasim me statusin rajon. Prandaj, ajo kishte të drejta më të gjera juridike e administrative, sikurse Gjykatën e Lartë. Kosova e cilësuar si rajon autonom ishte e barabartë me rajonet e tjera në Serbi, prandaj Gjykata e Lartë e Serbisë e shtrinte autoritetin e saj edhe në Kosovë. Qarqet jugosllave këtë dallim e argumentonin me faktin se në Vojvodinë jetonte një numër i madh pakicash kombëtare, që dallonin për kah aspekti kulturor, prandaj ishte e nevojshme një gjykatë e tillë.³⁷ Me këtë,

³⁵ Sabile Keçmezi Basha, *Kosova 1945-1990*, Instituti i Historisë Prishtinë, Prishtinë, 2017, f. 50; *Historia e Popullit Shqiptar...*, vëll. IV, f. 341-342.

³⁶ Afërdita Sokolaj, *Çështja e Kosovës dhe media shqiptare (1981-2000)*, Tezë doktorate, Tiranë, 2014, f. 19-20.

³⁷ Miranda Vickers, *Midis serbëve dhe shqiptarëve*, Toena, Tiranë, 2004, f. 184.

pozita juridike e Kosovës në shtetin jugosllav, thënë në mënyrë paksa të ekzagjeruar, nuk ishte më e lartë se ajo e një "qarku administrativ serb me disa zbulime të pavarësisë".³⁸

Sidoqoftë, vitet pasuese do të karakterizohen me një degradim të statutit juridik të Kosovës. Në vitin 1953, hyn në fuqi Ligji kushtetues i vitit 1953, i cili zgjeronte kompetencat bashkiake dhe republikane, kundrejt Federatës. U reduktuan edhe më tej ato pak kompetenca të rajonit autonom. Lidhjet me Serbinë u forcuan, kurse ato me federatën u dobësuan. I njëjti delegim i pushtetit u aplikua edhe në Partinë Komuniste të Jugosllavisë, duke i dhënë fuqi autonome instancave të veta republikane.³⁹

Ishte kjo një politikë, e cila synonte t'i eliminonte kufijtë administrativë të RAMK, që Kosovën ta shkrijë plotësisht në Serbi. Ishte ky një synim, që origjinën e kishte në planet e hershme hegjemoniste serbe, por që gjenin zbatim edhe në Jugosllavinë socialiste. Nuk kishte si të ishte ndryshe, kur Vasa Çubrilloviq, i njohur për planin e shpërnguljes së shqiptarëve të vitit 1938, kishte post ministror në qeverinë jugosllave. Ende pa mbaruar lufta, më 3 nëntor 1944 ai i dorëzoi udhëheqjes më të lartë jugosllave elaboratin: "Problemet e pakicave në Jugosllavinë e re".⁴⁰ Ky elaborat, që parashihte të zgjidhte çështjen e pakicave kombëtare në Jugosllavi, konkretisht atyre jo sllave, ishte në fakt, një pamflet shovinist, sepse zgjidhja kërkohet jo në integrimin dhe zhvillimin e tyre kulturor, por në shpërnguljen dhe dëbimin e tyre, me theks të veçantë të shqiptarëve. Mbi parimet se Federata Demokratike e Jugosllavisë mund të ketë paqe dhe zhvillim të sigurt, vetëm atëherë, nëse bëhet e pastër etnikisht, duke zgjidhur problemin e pakicave njëherë e përgjithmonë⁴¹. Ai sugjeronte, që nga rajonet e Baçkës dhe të Kosovës të dëboheshin gjithë hungarezët, respektivisht shqiptarët. Nevojën e një veprimi të tillë, ai e argumentonte me faktin se: "Kosova e Metohia" është pikë strategjike në Ballkan, e cila paraqet një ndarje midis Serbisë, Malit të Zi e të Maqedonisë dhe se këto rajone nuk mund të jenë të lidhura njëra me tjetrën, derisa nuk sigurohet një kufi i drejtpërdrejtë etnik. Në rastin e Maqedonisë, ai argumentonte se rrjedha e sipërme e Vardarit mbahej nga shqiptarët, kurse ajo e poshtmjia nga grekët. Në rast të ndonjë lufte, Jugosllavia do të mbetej në udhëkryq dhe e hapur ndaj goditjeve.⁴²

³⁸ Arben Hajrullahu, *Paqja afatgjate në Ballkanin Perëndimor përmes integritit në BE*, Përkthyes nga gjermanishtja në shqip: Rexhep Bajrami, Botuar në Prishtinë, 2015, f. 60.

³⁹ Bernard Lory, *Evropa Ballkanike nga viti 1945 në ditët tona*, Dituria, Tiranë, 2007, f. 78.

⁴⁰ *Historia e Popullit Shqiptar...*, vëll. IV, f. 341.

⁴¹ V. Çubrilloviq, *Problemi i pakicave kombëtare në Jugosllavinë e re...*, f. 16.

⁴² M. Vickers, *Midis serbëve dhe shqiptarëve...*, f. 187-188.

Akademiku Çubrilloviq, si një korrektues dhe përpunues i hollësishëm i doktrinës së Garashaninit, kuptohet në kushtet e reja të Jugosllavisë, sugjeron edhe metodën, që duhej ndjekur, për të realizuar përzënien e shqiptarëve nga Kosova dhe Maqedonia Perëndimore dhe zëvendësimin e tyre me kolonë sllavë. Ai shkruan: "*E vetmja rrugë dhe mënyrë për të shpërngulur shqiptarët është forca brutale e shtetit të organizuar, të cilin e kemi pasur gjithnjë superior ndaj tyre*".⁴³ Duket se Çubrilloviqit nuk i kishte ikur asnjë detaj në referatin e tij. Ai propozonte për kohën e zbatimit të këtij plani që do të ishte më e volitshëm, e që është koha e luftërave. Lidhur më këtë ai thoshte se: "Luftërat janë më të volitshme për zgjidhjen e këtyre problemeve. Ato si ndonjë stuhi shkulin nga rrënjët dhe shfarosin popuj. Ajo që gjatë periudhave të paqes duhet të zgjidhet me dekada e shekuj, gjatë kohës së luftërave shtetërore zgjidhet për pak muaj dhe për pak vite."⁴⁴

Kërkesat e Çubrilloviqit do të gjejnë zbatim praktik gjatë periudhës së Administratës Ushtarake në Kosovë (shkurt-korrik 1945), ku u ndoq një politikë e ashpër persekutimi e masakrimi ndaj shqiptarëve, kurse më vonë edhe me Konventën Turko-Jugosllave të vitit 1953 për shpërnguljen e shqiptarëve për në Turqi. Në fakt, shpërngulja e shqiptarëve ishte një projekt për serbizimin e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi, program që zhvillohej sipas elaborateve të përpunuara në hollësi. Në realizimin e një programi të tillë u përdorën mekanizma, si: terrori, shfarosja, dëbimi i dhunshëm, etj. Fokusi i spastrimit nga elementi shqiptar ishin viset kompakte shqiptare dhe ato të pasura për nga aspekti bujqësor. Kështu shpërngulja bëhej nga Rrafshi i Kosovës drejt luginës së Vardarit, e prej andej në Kanalin e Bosforit. "Deri në fund të vitit 1954 nga Prelepi, Kumanova, Presheva u shpërngulën 3000 vetë; nga Tetova e Gostivari dhe nga katundet e Zhupës, afër Koxhaxhikut të Dibrës - 2000 vetë. Një e dhënë thekson se gjatë periudhës 1952 - 1962 u shpërngulën për në Turqi mbi 200.000 shqiptarë."⁴⁵

Autori, Shaban Braha, jep një pasqyrë të plotë nga viti në vit për shpërnguljen e shqiptarëve:

Në vitin 1953 janë dëbuar 13.000 frymë

Në vitin 1954 " " 17.000 "

⁴³Nijazi Halili, "Krizat e Kosovës në shek. XIX dhe Platformat serbe", *Global Challenge*, nr./5 2013, Akademia Diplomatike Shqiptare, f. 103.

⁴⁴V. Çubrilloviq, *Problemi i pakicave kombëtare në Jugosllavinë e re...*, f. 28.

⁴⁵Shaban Braha, *Gjenocidi serbomadh dhe Qendresa shqiptare 1844 - 1990*, Tiranë, 1992, f. 493.

Në vitin 1955	"	"	51.000	"
Në vitin 1956	"	"	54.000	"
Në vitin 1957	"	"	57.000	"
Në vitin 1958	"	"	41.000	"
Në vitin 1959	"	"	27.000	"
Në vitin 1960	"	"	23.000	" ⁴⁶ .

Shpërngulja e shqiptarëve siç po duket ka qenë mirë e organizuar, sistematike dhe e përvitshme. Numri i përgjithshëm, si pas kësaj pasqyre shkante në 283 mijë shqiptarë. Kështu po realizohej plani i serbizimit të Kosovës. Qarqet serbe e arsyeonin se po largohen ata që ishin "turq". Në të vërtetë, mbi gjysma e të shpërngulurve ishin nga trevat e Maqedonisë, ku numri i të deklaruarve si "turq" ishte rritur ndjeshëm. Në vitin 1948, jepeshin nga regjistrimi 95.940 turq, në vitin 1953 ngrihej artificialisht në 203.000, kurse në vitin 1971 zbrit në 108.552.⁴⁷ Mirëpo, siç dihet është bërë manipulim i madh me shifrat, por edhe forma të mëdha të presionit për t'u deklaruar si turq. Udhëheqjes serbe i konvenonte një ekzagjerim i qëllimshëm i shifrave, sepse në këtë mënyrë "justifikohej" shpërngulja.

Një fushatë tjetër antishqiptare e projektuar nga strukturat më të larta shtetërore, në krye me Rankoviçin e me bekimin e Titos, ishte aksioni për mbledhjen e armëve. Nën pretekstin se po përgatitej një kryengritje e armatosur dhe nën këtë akuzë false, organet e sigurimit shtetëror (Uprava Drzavne Bezbednosti – më tej UDB)* filluan një fushatë arrestimesh, persekutimesh, torturash apo burgosjes, pavarësisht, nëse atyre iu gjetën apo jo armët. Për shqiptarët, dimri i vitit 1955 /56 mbetet njëra nga periudhat më të rënda, ku organet e sigurimit torturuan rreth 30.000 shqiptarë, nga të cilat tortura, vdiqën 100 vetë.⁴⁸

Qëllimi i këtij aksioni, pa dyshim, ishte që të përshpejtohej shpërngulja dhe të nxitej kolonizimi i Kosovës me serbë nga viset e tjera të Jugosllavisë. Derisa shqiptarët po iknin në Turqi, në Kosovë filluan të vendoseshin serbët. Ata u sistemuan në punë, në zyrat e administratës

⁴⁶Sh. Braha, *Gjenocidi serbomadhi dhe Qendresa shqiptare 1844 – 1990...*, f. 493.

⁴⁷ Po aty, f. 490.

* UDB-a, Uprava Drzavne Bezbednosti (Drejtorja e sigurimit të shtetit), u krijua më 13 mars 1946 dhe funksionoi si e tillë deri në vitin 1991 kur u shpërbë Federata jugosllave.

⁴⁸*Kosova në vështrim enciklopedik*, Qendra e Enciklopedisë Shqiptare, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Toena, Tiranë 1999, f. 121.

shtetërore, institucionet shtetërore, shërbimet publike dhe institucionet mjekësore dhe kulturore. Këta kolonë të rinj ishin, kryesisht, nga Serbia e Jugut, Plava, Gucia dhe trevat e Podgoricës.⁴⁹

Por, krahas dhunës, shpërnguljeve, kolonizimeve, pabarazisë, etj., gjatë viteve në fjalë vërehet edhe një fenomen tjetër – restaurimi i objekteve të trashëgimisë kulturore, kryesisht, atyre me origjinë të krishtere, ortodokse dhe osmane. Një fenomen i tillë ishte në funksion të krijimit të parametrave, që do të dëshmonin se Kosova ishte një vend i origjinës së serbëve, se osmanët kishin qenë pushtues dhe tanimë ishin larguar, kurse nuk kishte asgjë që do ta dëshmonte përkatësinë shqiptare të këtyre viseve. Pra, ishte qartë një veprim i nacionalizmit latent serb, në përpjekje të serbizimit të Kosovës. Kjo detyrë u krye nga Enti Krahinor për ruajtjen e monumenteve, ku gjatë viteve 1950-1960, kuadrot ishin ekskluzivisht të kombësisë serbe. Në vazhden e këtij qëllimi, përmes fondeve federative u restauruan këto objekte: Patrikana e Pejës, Manastiri i Deçanit, Xhamia e Mbretit në Prishtinë, Kisha e Shën Spasit në Prizren, Kisha e Shën Gjorgjit në Zveçan, Hamami i Prizrenit, Kisha e Shën Nikollës në rrethinën e Prizrenit, Tyrbja e Muratit në Kosovë, Përmendorja e Gazimestanit*, Ndërtesa e Vilajetit të Kosovës, Shtëpia Eminçik në Prishtinë, Manastiri i Deviçit, Konaku i Tahir beut në Pejë, Konaku i Manastirit të Graçanicës, etj.⁵⁰

Një trend i tillë do të ndryshojë, gradualisht, pas viteve 1960, kur ekspertët shqiptarë të fushës muzeale fillojnë të punojnë në Entin për ruajtjen e përmendoreve, ku atëherë objektet e trashëgimisë kulturore shqiptare do të marrin trajtimin e merituar.

1.2 Ndryshimet politike të vitit 1966 dhe reflektimi i tyre në pozitën e shqiptarëve në Kosovë dhe në viset e tjera (Maqedoni e Preshevë)

Kthesë e rëndësishme, karshi shqiptarëve të Kosovës, Maqedonisë dhe në të gjitha viset, ku jetonin shqiptarët në Jugosllavi, ishte shkarkimi i ministrit të punëve të brendshme të RSFJ-së, Aleksandër Rankoviqi. Në mbledhjen IV të KQ të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë (më tej: LKJ), e njohur për publikun si Plenumi i Brioneve (ishull në Kroaci), që u mbajt me 1 korrik të vitit 1966, Rankoviq u akuzua për deformime të rënda, që kishin ndodhur në shërbimin e sigurisë

⁴⁹M. Vickers, *Midis serbëve dhe shqiptarëve...*, f. 196.

* Kompleksi memorial në Gazimestan u ndërtua më 1953, për të shënuar betejën e Fushë Kosovës të vitit 1389.

⁵⁰ Милош Ивановић, “Конзерваторски радови на споменицима култура Косова и Метохије, објављени 1959 и 1960 године”, *Antikitete të Kosovës e Metohisë, Vëllimi I*, Enti Krahinor për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore, Prishtinë, 1961, f. 341-345.

shtetërore, që ishte nën komandën e tij, madje, edhe për përgjimin e telefonave të udhëheqësve më të lartë jugosllavë, përfshirë Titon dhe Kardelin. Kjo vërtetohet nga deklarata, që Kardeli ia kishte dhënë Titos: *"Pata vënë re vite më parë se telefoni im përgjohej. Përse nuk ma ke thënë?"* - u nxeh Titoja. *"Kujtoja se mund ta kishe porositur ti"*, - iu përgjigj Kardeli me qetësi.⁵¹

Sipas dokumenteve të *Shërbimit të Kundërzbulimit Jugosllav* (KOS - Kontra Obavestajna Sluzba), e cila ishte pjesë përbërëse e Armatës Popullore Jugosllave (më tej: APJ) në ish RSFJ, ndikim të madh në mënjanimin e Rankoviçit nga pushteti, kishte bashkëshortja e Titos, Jovanka Broz, e cila u ankua për ndërhyrje në lidhjet e saj telefonike, që nga fillimi i viteve të 60-ta.⁵²

Përgjimi i telefonatave, kishte për qëllim diskreditimin dhe shantazhin mbi figurat e larta shtetërore në Jugosllavi, duke i detyruar ata në dorëheqje apo për t'i larguar nga funksionet politike⁵³, e për t'i zëvendësuar me njerëz besnikë të shërbimit.

Rënia e Rankoviçit u shoqërua me një diferencim politik brenda strukturës partiake dhe të zinxhirit komandues të UDB-së. Emra të udhëheqësve të lartë, si: Svetosllav Stefanoviç (ndihmësministër i Punëve të Brendshme), Vojin Lukiç, Slobodan Kostiq, si dhe gjeneralët: Millan Zhezhel, Milloje Millojeviç etj., u përjashtuan nga pozitat e larta shtetërore.⁵⁴

Është menduar se ka ekzistuar një komplot për rrëzimin e Titos nga pushteti, por një gjë e tillë nuk është provuar. Por, ishte indikativ se përqendrimi kaq i madh i pushtetit në duart e shefit të policisë sekrete, synonte të garantonte pozitën e tij, si pasardhës i padiskutueshëm i Titos. Kush do ta pasonte? Ishte një privilegj që Titoja e ruante me zili. Rankoviçi pagoi çmimin, që kishte guxuar ta cenonte këtë privilegj.⁵⁵

Por, duket se përgjimet apo komploti nuk ishin pjesë e vetme e motivit për rrëzimin e Rankoviçit. Titos përveç se i nevojitej një "kokë turku" për të mbuluar dështimet e veta politike, ai ishte i prirur të hiqte dorë nga krijimi i një "Jugosllavie homogjene", duke inkurajuar elemente të zhvillimit më të madh kombëtar⁵⁶. Prandaj, Plenumi në fjalë shënon edhe fundin e grupimit burokratik-centralist. Në këtë mënyrë u hap rruga drejt një faze të liberalizimit shoqëror, politik

⁵¹Misha Glenny, *Histori e Ballkanit 1804 - 1999, Nacionalizmi, luftërat dhe Fuqitë e Mëdha*, Tiranë, 2007, f. 582.

⁵²Svetko Kovač, Bojan B. Dimitrijević: "Slučaj Aleksandra Rankovića prema dokumentima KOS-a: Da li je bilo prisluškivanja?", *Istorija 20. veka*, Br.1/2015, f. 11.

⁵³Dušan Bilandžić, *Historija Socijalističke Federativne Republike Jugoslavija, Glavni procesi 1918 - 1985*, Zagreb, 1985, f. 321.

⁵⁴Jusuf Buxhovi, *Kosova nga Konferenca e Londrës e deri të protektorati ndërkombëtar*, Prishtinë, 2012, f. 329.

⁵⁵M. Glenny, *Histori e Ballkanit 1804 - 1999...*, f. 583.

⁵⁶Noel Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, Koha, Prishtinë, 2001, f. 338.

dhe ekonomik, nga i cili do të përfitojnë dukshëm edhe shqiptarët, pozita e të cilëve po shkonte kah barazimi me të tjerët në federatë.⁵⁷

Gjatë Plenumit, për herë të parë u paraqitën të dhëna për represionet dhe diskriminimin ndaj shqiptarëve, duke ardhur në përfundim se irredentizmi shqiptar buronte nga shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut të shqiptarëve, që jetonin në Kosovë.⁵⁸

Ky konkluzion u shoqërua me lëshime të kufizuara në favor të shqiptarëve. Ndryshoi edhe diskursi i krerëve më të lartë partiak, karshi shqiptarëve. Në këtë periudhë vjen edhe deri te ndalimi i përdorimit të fjalës “siptar”, që ishte me kuptim pezhorativ, derisa u referohej shqiptarëve dhe u zëvendësua me termin “albanac”. Në mars të vitit 1967, Tito vizitoi Kosovën dhe me këtë rast u tregua mjaft kritik me gjendjen e rëndë që mbizotëronte në Kosovë. Në një rast ai shprehet: *"Nuk mund të flitet për të drejta të barabarta, deklaroi ai, kurse serbët kanë përparësi kudo nëpër fabrika, kurse shqiptarët refuzohen edhe pse kanë kualifikime të njëjta apo edhe më të larta"*.⁵⁹

Në përpjekje për ta përmirësuar situatën në krahinë, udhëheqja e lartë jugosllave u angazhua për ndryshimin e Kushtetutës së vitit 1963. Pas disa diskutimesh, më 26 dhjetor 1968, u miratuan disa amendamente, ndër të cilat më i rëndësishmi ishte amendament VII, i cili theksonte se krahinat autonome i përkisnin sa Serbisë aq edhe strukturës federative të Jugosllavisë, kurse emërtimi “Kosovë e Metohi” ose “Kosmet”, që i zemëronte shqiptarët u thjeshtëzua në "Kosova". Me ndryshimet e reja kushtetuese, krahinat autonome u përcaktuan si "bashkësi politiko - shoqërore", duke fituar kështu të drejtën për miratimin e ligjeve të tyre kushtetuese.⁶⁰

Në këtë mënyrë, Kosova u shndërrua në një entitet legjitim i nivelit federativ. Mirëpo, dëshirat dhe ambiciet e shqiptarëve do të artikuloreshin në një kërkesë, e cila do të jetë edhe për vitet e ardhshme si kërkesë bazike - Kosova Republikë, kërkesë e cila për herë të parë do të proklamohet në demonstratat e vitit 1968, që shpërthyen në Kosovë. Heqja e Rankoviçit do të pritej me mirënjohje nga shqiptarët, doli e gabuar. Një brez i ri, i aftë për të formuluar qartë idetë

⁵⁷Po aty, f. 338.

⁵⁸ Stefan Karastojanov, *Kosova (një analizë gjeopolitike)*, Shkup, 2007, f.173.

⁵⁹Howard Clark, *Civil Resistance in Kosovo*, Pluto Press, London, 2000, f. 12.

⁶⁰Sonja Biserko, *Kovanje Antijugoslovenske zavere*, Knjiga 1, Helsinki odbor za ljudska prava u Srbiji, Beograd, 2006, f. 90.

e veta mbizotëronte në Universitetin e Prishtinës dhe ishte i etur për të kërkuar të drejtat kombëtare të shqiptarëve.⁶¹

Në këtë frymë, veterani komunist, Mehmet Hoxha, e kishte shtruar një pyetje para fillimit të demonstratave: "Pse 370.000 malazezë mund të kenë republikën e tyre, kurse 1.200.000 shqiptarë të mos kenë as edhe një autonomi të plotë?".⁶²

Manifestimet e shqiptarëve të shprehura gjatë muajve nëntor - dhjetor të vitit 1968 ekspozuan gjendjen, ku ishin shqiptarët e Kosovës, në kuadër të Jugosllavisë. Minoriteti josllav, më i madhi i vendit banon në një rajon më pak të zhvilluar. Duke u lënë mënjanë zhvillimi i madh të viteve të 50-ta, Kosova ka vuajtur nga një regjim policor, veçanërisht mizor.⁶³

Shqiptarët e Kosovës për herë të parë do ta konstruktin parullën: "Kosova Republikë", e cila do të bëhet fanar i tërë përpjekjeve edhe në dekadat e ardhshme, për ta sendërtuar atë synim.

Demonstratat filluan në Prizren, më 6 tetor, ku u kërkuar publikisht avancimi i statusit të Kosovës. Jehona e Prizrenit e bëri të vetën, duke ndikuar, që demonstratat të fillojnë në shumë qendra të tjera të Kosovës. Demonstratat vazhduan në: Podujevë, Gjilan, Ferizaj e në qytete të tjera, e që u kurorëzua me atë të Prishtinës - më 27 nëntor. Mijëra demonstruesve, që ishin mbledhur para Teatrit Kombëtar, iu drejtua njëri nga udhëheqësit e demonstratës, Osman Dumoshi, i cili paraqiti disa kërkesa në emër të komitetit të demonstruesve. Pra, më 27 nëntor 1968, në prag të përvjetorit të 56-të shpalljes së pavarësisë së shtetit shqiptar, në Prishtinë, filluan demonstratat e studentëve, me të cilat u bashkuan dhe shtresat e tjera të shoqërisë kosovare. Studentët kishin marrë përsipër të zgjidhnin me demonstrata atë, që nuk u realizuan në diskutimet e aktiveve partiake. Parullat dhe thirrjet: "Republikë", "Vetëvendosje", "Duam Universitetin" dhe "Kushtetutë, ja me hatër, ja me luftë", shoqëruan demonstratat edhe në qytetet kryesore të Kosovës, në: Prishtinë, Gjilan, Ferizaj dhe në Podujevë. Ishte hera e parë që në "jetën politike të krahinës së Kosovës së pasluftës, u afirmua me forcë kërkesa për republikë." Ndikimi i tyre u ndie edhe te shqiptarët e Maqedonisë. Demonstratat u zhvilluan në Tetovë, më 22 - 23 dhjetor 1968 dhe vijuan edhe në rajone të tjera të kësaj republike. Kërkesat e tyre ishin që shqiptarët në Maqedoni t'i bashkëngjiteshin Republikës së Kosovës, duke krijuar një njësi të vetme federative, t'u njihej e drejta e përdorimit të flamurit dhe e shkollimit në gjuhën shqipe.

⁶¹M. Glenny, *Histori e Ballkanit 1804 – 1999...*, f. 586.

⁶²Po aty, f. 338.

⁶³B. Lory, *Evropa Ballkanike nga viti 1945 në ditët tona...*, f. 116.

Demonstratat shqiptare kishin shkaktuar alarm te qarqet e larta politike jugosllave, të cilat në bashkëveprim me Titon miratuan marshimin e tankeve të APJ-së në rrugët e Prishtinës.⁶⁴ Pas qetësimit të situatës, qarqet politike jugosllave filluan me dënimin e këtyre demonstratave dhe si rrjedhojë edhe persekutimin juridik. Demonstratat u cilësuan armiqësore nga ana e LKJ-së. Të nesërmen filloi një valë e gjerë arrestimesh të shumë personave, që konsideroheshin si organizatorë të demonstratës. Organizatorët e demonstratave në Prishtinë u arrestuan dhe u gjykuan nga Gjyqi i Qarkut në Prishtinë, duke i shpallur "fajtor", si vijon: Hasan Demaku, Osman Dumoshi, Selatin Novosella me nga 5 vjet burg; Skender Kastrati e Xheladin Rekalii me nga 4 vjet burg; dhe Adil Pireva, Afrim Loxha, Ilaz Pireva dhe Skender Muçolli, me nga 3 vjet burg.⁶⁵

Përkundër dhunës së madhe që u ushtrua ndaj protestuesve, mesazhi i demonstratave të vitit 1968 u përçua. Ato ndikuan në fillimin e një procesi të vazhdueshëm të ndryshimeve politike, ekonomike, kulturore, etj. Demonstratat e vitit 1968 ishin produkt i bashkëpunimit të lëvizjes ilegale, e cila u riaktivizua në vitet e pasluftës dhe të strukturave të shoqërisë shqiptare, kryesisht, të rinisë dhe të intelektualëve të Kosovës.⁶⁶

Përkundër shtypjes së demonstratave dhe dënimeve drakonike, që i morën udhëheqësit e tyre, ato ndikuan në fillimin e një procesi të pandalshëm të ndryshimeve pozitive në Kosovë. Ajo ishte e vendosur që të shtypte çdo prirje, që do të synonte ta paraqiste problemin e barazisë së kombësive, si problem të konstituimit të tyre të veçantë shtetëror, d.m.th. të formimit të republikave të tyre. Pavarësisht, se kjo lëvizje e gjerë popullore u shtyp dhe, pavarësisht, etiketimit të saj nga pushteti jugosllav, ajo afirmoi me forcë, për herë të parë në jetën politike të Kosovës, kërkesën për republikë, e cila vijoi të mbetej objektiv shumë i rëndësishëm i shqiptarëve, për sa kohë do të ishin në përbërje të federatës jugosllave.⁶⁷

Roli i demonstratave ishte evident në avancimin e statusit të Kosovës në kuadër të Federatës jugosllave dhe hapjen e Universitetit të Prishtinës (më tej: UP) në gjuhën shqipe. Hapja e Universitetit ishte hapje e një kapitulli bashkëpunues me Universitetin e Tiranës. Qindra pedagogë erdhën nga Shqipëria dhe ligjëruan nëpër njësitë akademike të UP-së. Zhvillimi i UP-së ishte i vrullshëm. Numri i studentëve arrinte në 30.000, ndërsa numri i ligjëruesve në 1000.

⁶⁴UDBA U UDBI - Svedočenja Slavka Zečevića, Fejton elektronik, http://www.novosti.rs/dodatni_sadrzaj/clanci.119.html:276545-Vojska-obezbedila-mir-i-red, qasja 12 gusht 2018.

⁶⁵ J. Buxhovi, *Kosova nga Konferenca e Londrës e deri të protektorati ndërkombëtar...*, f. 352.

⁶⁶Ethem Çeku, *Demonstratat e vitit 1968 në Arkivin e Kosovës*, Prishtinë, 2009, f. 9.

⁶⁷ A. Sokolaj, *Çështja e Kosovës dhe media shqiptare (1981-2000)...*, f. 23.

Po ashtu, është me rëndësi se përpjesëtimi i shqiptarëve ndër popullatën studentore të Kosovës u shtua ndërmjet viteve: 1968 - 1978, prej 38% në 72%.⁶⁸

Por, e veçanta e gjithë kësaj ishte se këmbimi kulturor-shkencor e akademik midis Kosovës e Shqipërisë do të inkurajojë dhe forcojë ndjenjën kombëtare te popullsia e Kosovës. Si rezultat do të vijë deri tek artikulimi i kërkesave të reja në avancimin e statusit politik dhe juridik të Kosovës, në federatën jugosllave apo edhe të ideve për bashkim me shtetin amë.

Por, arritjet e shqiptarëve të Kosovës dhe rrjedhat e përgjithshme politike jugosllave që shkonin kundër ambicieve centraliste serbe, u shoqëruan edhe nga një faktor tjetër. Ishte ky nacionalizimi serb, i cili në rrethanat e krijuara, pas vitit 1968, kishte filluar të riorganizohet. Dobrica Qosiq, kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Serbisë, qysh kah fundi i vitit 1969, kishte filluar të krijojë një bashkësi intelektuale serbe, që do të ishte një qendër e “grumbullimit opozitar”, ku me sukses do t’i grumbullonte figurat e njohura politike e nacionaliste serbe, të përjashtuar nga partia komuniste, si: Milhajlo Markoviq, Ljubomir Tadiq, Borislav Mihajloviq, etj. Sipas Qosiqit, realiteti politik i kishte shkatërruar ndarjet ideologjike në mesin e këtyre intelektualëve.⁶⁹ Ky grupim do të vepronte në prapaskenë dhe do të ofronte një reagim latent ndaj zhvillimeve lidhur me Kosovën, kurse shenjat e para të reagimit të tij të hapur e agresiv do të shihen menjëherë pas demonstratave të vitit 1981.

1.3 Kushtetuta e vitit 1974 - nxitëse e rizgjimit të nacionalizmit serb

Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë, në vitet e 60-ta dhe të 70-ta po përfshihej nga një valë rivaliteti ndërmjet dy republikave më të mëdha, asaj të Serbisë dhe të Kroacisë. Ky konflikt u pasqyrua në përfaqësimin e kroatishes në gjuhën letrare serbo-kroate. Intelektualët kroatë ankoheshin se statusi i kroatishes ishte shumë i papërfillshëm, krahasuar me serbishten. Në fakt, prapa këtij konflikti fshihej ballafaqimi politik midis serbëve dhe kroatëve, respektivisht, ballafaqimi për centralizimin apo decentralizimin e Jugosllavisë. Qysh në fillim të viteve të 70-ta, në Kroaci kishte filluar një lëvizje, e emërtuar si “*Maspok*”, që luftonte për decentralizimin e Jugosllavisë dhe fuqizimin e rolit të republikave, kundrejt Federatës. Në krye të kësaj lëvizjeje, ishte Miko Tripalio dhe Savka Dapçeviq. Gjendja shkoj drejt acarimit, sepse brenda kësaj lëvizjeje u infiltruan edhe nacionalistë e ekstremistë, sa që rrezikonte trazirat në

⁶⁸ N. Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër...*, f. 340.

⁶⁹ S. Biserko, *Kovanje Antijugoslovenske zavere...*, f. 91.

Kroaci, por ndërhyrja e Titos ishte vendimtare. U eliminuan shumë nga kuadrot udhëheqëse të Maspokut, si: M. Tripallo, S. Dapçeviq, F. Tugjman, që ishte drejtor i Institutit të Historisë, pastaj S. Mesiç etj.

Me përfundimin e Lëvizjes kroate, gjatë vitit 1972, filloi një lëvizje në Republikën e Serbisë, e njohur si "Lëvizja liberale", që për udhëheqës kishte, Marko Nikeziqin dhe Latinka Peroviqin. Tito për t'i ruajtur ekuilibrat ndërmjet serbëve dhe kroatëve, ndërhyri, duke eliminuar nga skena politike figurat e lartcekura. Në këtë mënyrë, Tito, shtypi këto pikëpamje ndryshe, mirëpo shumë ide të promovuar nga këto lëvizje u integruan në Kushtetutën e viti 1974. Veprimtari, Mehmet Hajrizi, duke analizuar të arriturat e Kosovës përmes kësaj kushtetute deklaroi se: "Po të solidarizohej më shumë me kroatët dhe të shfrytëzonte më mirë koniunkturën e re politike, udhëheqja e Kosovës, mbase, do të bënte më shumë në avancimin e statusit të Krahinës."⁷⁰ Mirëpo, të arriturat dhe ngeçjet e Kushtetutës së vitit 1974, do t'i shohim në vazhdim të trajtimit.

Në qoftë se, viti 1963, përbënte nadirin e interesave kombëtare të shqiptarëve në Kosovën titiste, atëherë viti 1974 ishte zeniti i interesave kombëtare shqiptare, së paku, në çështjet e teorisë kushtetuese.⁷¹

Para se të plotësohej dhe aprovohej kushtetuta e vitit 1963, ajo u diskutua nëpër rrethe të ndryshme të Kosovës, për atë se çfarë pozite kushtetuese duhet të ketë Kosova. Gjatë këtyre konsultave dolën disa kërkesa mjaft të arsyeshme, të cilat po që se do të pranoheshin nga instancat federative, krahina e Kosovës do të avanconte kënaqshëm në pozitën juridiko - kushtetuese. Në të gjitha diskutimet u kërkua që Kosova të ishte njësi federale (nënkuptohej republika), që ligj themelor i republikës të ishte kushtetuta, ku në dhomën e kombeve, Kosova të kishte 20 deputetë, sikundër republikat e tjera. Përdorimi i simboleve kombëtarë të ishte zyrtare. Emri i krahinës të ndryshonte nga "Kosovë e Metohi" në "Kosova – Kosovo". Po ashtu, të kishte edhe Gjykatën e vet Supreme dhe Kushtetuese, të lidhura drejtpërdrejt me të njëjtat, në nivel federativ. Të sigurohej barazia e gjuhëve, në nivel federativ. Në Kushtetutën federative, në gjuhën serbokroate, populli shqiptar të mos emërtohej në mënyrë fyese "shiptari", por "albanci", Të saktësohej e drejta për riatdhesim, jo vetëm për pjesëtarët e kombeve, por edhe për pjesëtarët

⁷⁰ Mehmet Hajrizi, *Histori e një organizate politike dhe demonstratave të vitit 1981*, Toena, Tiranë, 2008, f. 45.

⁷¹ N. Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër...*, f. 341.

e kombësive, etj.⁷² Mirëpo, këto kërkesa të shqiptarëve, që buronin nga baza, nuk u morën për bazë dhe u kundërshtuan fuqishëm nga organet republikane dhe ato federative.

Me amendamentet e vitit 1968/69 dhe 71/72 u arrit një reformë e rëndësishme ndërmjet federatës, republikave e krahinave: U bë ndarja e pushteteve, funksioneve ndërmjet federatës dhe njësive që e përbënin atë. Mirëpo, vënia në jetë e këtyre amendamenteve, qysh në fillim, hasi në vështirësi, që nuk mund të kapërceheshin pa një përpunim të mëtejshëm, më të plotë e më preciz të disa çështjeve themelore, si në sistemin shoqëror - ekonomik, ashtu edhe në sistemin politik në tërësi.⁷³ Për këtë arsye u krijua Komisioni Koordinues i cili e pa të arsyeshme që të rinovohej tërësisht ose thënë më mirë të krijohet një kushtetutë e re. Kushtetuta e re që do të miratohet do mbetet në fuqi, deri kur u shkatërrua Jugosllavia. Kjo i siguronte dy krahinave barazi në shumë rrafshë me ato të republikave të tjera.

Në kohën, kur filluan diskutimet për renovimin e kushtetutës apo të hartimit të një kushtetutë të re, në Kosovë u përfshinë një numër i profesorëve të fushës së legjislacionit, të cilët sugjerorin për zgjerimin e kompetencave të Kosovës në rrafshë të ndryshme. E. Stavileci, S. Kurteshi, H. Hoxha, në publikimet e tyre shtroronin nevojën për autorizime më të gjera, të drejta burimore në fushën e mbrojtjes popullore, të sigurimit shtetëror, të planifikimit shoqëror, të politikës së jashtme, duke u formuluar juridikisht të drejtat, kompetencat dhe funksionet e federatës, ashtu, si edhe ato të republikave e të krahinave.⁷⁴

Pas një diskutimi të gjatë publik, që pati kushtetuta, Kuvendi federativ e miratoi kushtetutën e re të RSFJ. Pastaj, më 28 shkurt 1974, Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (më tej: KSA) e aprovoi Kushtetutën. Kosova për herë të parë e fitoi Kushtetutën, me të cilën i rregulloi në mënyrë të pavarur marrëdhëniet shoqërore - ekonomike dhe sistemin politik, kuptohet mbi bazat e sistemit unik shoqëror - ekonomik dhe politik të Jugosllavisë. Në këtë mënyrë, Kosova fitoi të drejtën, që në mënyrë plotësisht të pavarur t'i organizojë organet e Krahinës dhe të përcaktojë të drejtat dhe detyrat e tyre, bashkë me marrëdhëniet reciproke.⁷⁵

Sipas Kushtetutës së re të KSA të Kosovës, Kuvendi shfaqet si organi vetëqeverisës dhe më i lartë i pushtetit në Kosovë. Organ tjetër qendror i Kosovës shfaqet kryesia e KSA të Kosovës, e cila përbëhet nga 9 anëtarë. Organe tjera të Krahinës ishin: Këshilli Ekzekutiv i

⁷² A. Sokolaj, *Çështja e Kosovës dhe media shqiptare (1981-2000)*..., f. 22.

⁷³ A. Lalaj, *Kosova - rruga e gjatë drejt vetëvendosjes 1941 -48*, Tiranë, 2000, f. 222.

⁷⁴ Po aty, f. 211.

⁷⁵ J. Buxhovi, *Kosova nga Konferenca e Londrës e deri të protektorati ndërkombëtar*..., f. 366.

Kuvendit të KSA të Kosovës (qeveria) dhe organet krahinore të administratës: Gjykata Supreme dhe organet e tjera të judikaturës, të cilat në esencë kishin të njëjtin funksion, sikurse organet përkatëse republikane dhe federative.⁷⁶

Dekretimi i Kushtetutës së KSA të Kosovës në vend të ligjit kushtetues, nuk ishte thjesht një ndryshim emërtime. Ajo afirmonte në mënyrë më të plotë gjithçka që ishte arritur në pozitën juridiko - kushtetuese, politike, ekonomike e shoqërore të krahinës.⁷⁷ Në kushtetutën e re ishin plotësuar amendamentet e mëparshme të viteve 1967/72, duke sjellë zgjidhje të reja në sistemin politik, shoqëror e ekonomik të krahinës. Megjithëse, Kushtetuta e re e RSFJ - së nuk kishte ndonjë kapitull eksplicit për krahinat autonome, por ato gjenin veten në shumë prej neneve të saj, të cilat e përcaktonin Kosovën si pjesëmarrëse të drejtpërdrejtë në konstituimin e federatës. Në nenin 281 të pjesës së tretë, nënvizohej se për çështje të caktuara (të sistemit të përbashkët të marrëdhënieve shoqërore - ekonomike, të sistemit të financimit, të planit shoqëror të kreditimit, të politikës së brendshme, të mbrojtjes së vendit, të politikës së jashtme, të zhvillimit më të shpejtuar të të pazhvilluarve etj.) çdo akt normativ i federatës, çdo funksion ekzekutiv i organeve të saj, duhej të arrihej nëpërmjet harmonizimit paraprak (sipas një procedure) të qëndrimeve, jo vetëm të republikave, por edhe të krahinave.⁷⁸

Për dallim nga themeloret, ku spikasim për barazi, në disa nene vërehet se pjesëmarrja e krahinave dhe e republikave nuk ishte e barabartë. Ky diferencim shihej në organin më të lartë të pushtetit dhe të vetëqeverisjes shtetërore - në Kuvendin e RSFJ - së. Në këtë organ të lartë, republikat përfaqësoheshin me 30 delegatë, ndërsa krahinat me nga 20 delegatë.⁷⁹ Duke e ditur se në këtë organ vendimet merreshin me shumicë votash, atëherë në këtë përbërje e shohim se në çfarë përbërje të disfavorshme ishin krahinat.

Dhoma e republikave kishte, gjithashtu, një përbërje të favorshme për republikat, të cilat përfaqësoheshin me nga 12 anëtarë, karshi krahinave me nga 8 anëtarë. Dhoma e republikave dhe e krahinave kanë vendosur në bazë të parimit të paritetit, çka do të thotë që vota e një delegacioni kishte vlerë të barabartë me votën e secilit nga delegacionet e tjera pjesëmarrëse në votim. Delegacionet vendosnin në bazë të institucionit të marrëveshjes d.m.th. nëpërmjet pëlqimit paraprak të kuvendeve të republikave e të krahinave autonome. Në bazë të parimit të

⁷⁶Po aty, f. 369.

⁷⁷A. Lalaj, *Kosova - rruga e gjatë drejt vetëvendosjes 1941 -48...*, f. 224.

⁷⁸Po aty, f. 225.

⁷⁹Po aty, f. 226.

marrëveshjes, vendimi konsiderohet i marrë nëse për të jepnin pëlqimin të gjitha institucionet.⁸⁰ Mirëpo, ky nen mund të ndryshohej, thënë më mirë mund të anashkalohej parimi i paritetit, në rast se cenoheshin disa nga interesat vitale të vendit - Federatës jugosllave.

Ky përfaqësim i krahinave i kishte dritëhijet e veta. Në qoftë se dhoma e republikave dhe e krahinave merrte në shqyrtim çështje, që nuk duronin shtyrje (p.sh.: ato prej të cilave varej stabiliteti i ekonomisë dhe i tregut, marrëdhëniet e barabarta ekonomike midis republikave e krahinave, financimi i mbrojtjes popullore dhe buxheti i përgjithshëm, zbatimi i detyrimeve ndaj republikave jo mjaft të zhvilluara ose i detyrimeve ndërkombëtare të Jugosllavisë, si dhe raste tjera kur për shkak të mosmarrëveshjeve midis republikave dhe krahinave autonome të shkaktoheshin dëme të konsiderueshme për bashkësinë shoqërore si tërësi), atëherë braktisej mekanizmi i paritetit dhe zbatohet mekanizmi klasik i shumicës, vendimmarrjes me dy të tretat e votave.⁸¹

Në mënyrë të barabartë (me nga një anëtar) përfaqësoheshin republikat dhe KSA e Kosovës në kryesinë e RSFJ-së. Ndërsa, organet e tjera, si: Këshilli Ekzekutiv dhe Gjykata e Lartë Federative, Kosova përfaqësohej në mënyrë adekuate, që do të thotë, republikat nga dy anëtarë dhe krahinat nga një anëtar.

Në APJ, nenet e kushtetutës së vitit 1974, jepnin mundësi përfshirjeje, sipas parimit të përfaqësimit sa më proporcional të republikave dhe të krahinave autonome.

Vlen të përmendet edhe mundësia e pjesëmarrjes së shqiptarëve në ndryshimet kushtetuese. Në Kushtetutën e RS të Serbisë, të vitit 1963 parashihej që amandamentimet kushtetuese i takonin ekskluzivisht Kuvendit të Serbisë, ndërsa me Kushtetutën e vitit 1974, ndryshimet eventuale, që kishin të bënin me krahinat, duhet të merrnin miratimin e kuvendeve përkatëse të krahinave.⁸²

Për dallim nga sistemi kushtetues i vitit 1963, ky i vitit 1974 e sanksiononte barazinë e gjuhës shqipe me atë serbokroate, në të gjitha nivelet. Edhe në rrafshin financiar, Kosova nuk e arriti autonomitetin financiar.

Në politikën e jashtme, Kosova përfaqësohej në një masë të konsiderueshme, si autonome, por, kontrolli dhe diktati i RS të Serbisë ishte mjaft i ndjeshëm. Si dëshmi për këtë, mund të përmendim ecurinë e marrëdhënieve të KSA të Kosovës dhe të Republikës Popullore

⁸⁰Po aty, f. 227.

⁸¹Po aty, f. 227.

⁸²Po aty, f. 228.

Socialiste të Shqipërisë. Për çdo aktivitet kulturor apo shkencor të përbashkët me Republikën Popullore Socialiste (më tej: RPS) të Shqipërisë, në KSA të Kosovës do të lajmërohej, qysh në fillim e do të merrej pëlqimi i organeve kompetente të RS të Serbisë. Kështu ka ndodhur për aktivitetet që do të zhvillonin pedagogët e RPS të Shqipërisë, të ftuar nga institucionet homologe të shtetit shqiptar. Për çdo gjë duhej "leje nga Beogradi."⁸³ Esat Stavileci, në veprën: "Çështja e Kosovës e Gazmend Zajmit"* thekson: *"Me solucion të Kushtetutës së vitit 1974 dëshirohej të vihej njëfarë balance ndërmjet të një trajte politiko - institucionale të subjektivitetit të popullit shqiptar dhe Kosovës, në strukturën multinacionale të Federatës jugosllave dhe posesivizmit serb mbi Kosovën"*. Një balancim i tillë në shtigje më të gjata, sipas tij, "u tregua i pasuksesshëm dhe kundërrthënës, meqë vetë peshojat e tij centripetale dhe centrifugale, doemos ishin në kundërrthënie". Ishin këto "peshoja me karakter të ndryshëm të dominancës etnike në to", të cilat i ndihmuan atij që të nxjerrë konkluzionin se: "posesivizmi serb ndaj Kosovës, me çfarëdo trajte politiko - institucionale, qoftë të reduktuar, nuk përkonte me raportin interetnik shqiptaro - serb, të konceptuar mbi bazën e barazisë, nuk përkonte me esencën e mirëfilltë të barazisë në shtetin polinacional."⁸⁴

Duke e elaboruar më tej nga pozita e njohësit të thellë të çështjeve kushtetuese, autori i sipërpërmendur e konteston pozicionimin e Kosovës në raportet juridiko - kushtetuese me RS të Serbisë, duke e argumentuar fuqishëm këtë. "Paradoksi formal juridik, por edhe politik - kushtetues vërehet edhe në strukturimin pozicional - kushtetues të Kosovës, në kuadër të Republikës së Serbisë. Ai strukturim, siç është e njohur, nuk ishte në përputhje me vullnetin e popullit shumicë shqiptar të Kosovës, sikundër që ishte i panatyrshëm nga "aspekti i logjikës kushtetuese - juridike". Për më tepër Kosova, sipas tij, "njëkohësisht vihej në raport subordinimi ndaj një njësie tjetër federale, pa marrë parasysh se ai subordinim që, në fakt, i reduktuar në sfera të pakta të vendosjes".⁸⁵

Kushtetuta e vitit 1974 solli një realitet të ri në Kosovë, që ishte shumë më pozitiv, në krahasim me kushtetutën diskriminuese të vitit 1963. Pavarësisht, arritjeve që solli sistemi kushtetues i vitit 1974, gjithsesi i kishte edhe të metat dhe kufizimet e tij. Nenet dhe dispozitat e

⁸³Po aty, f. 238.

*Gazmend Zajmi dhe Esat Stavileci, jurist dhe profesor të shquar. Ekspert të çështjeve juridiko - kushtetuese.

⁸⁴Esat Stavileci, *Çështja e Kosovës në veprën e Gazmend Zajmit (Shoqata e pavarur e juristëve të Kosovës)*, Prishtinë, 1997, f. 50-51.

⁸⁵Po aty, f. 61.

saj përmes lidhjeve të dyfishta e krijonin një varësi të KSA të Kosovës, në raport me RS e Serbisë.

M. Hajrizi në librin e tij: "Histori e një organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981", theksonte se: "*Sanksionimi i statusit të ri të Kosovës në Kushtetutën e RSF të Jugosllavisë në vitin 1974, nuk e zgjidhte problemin madhor të Kosovës. Autonomia, jo vetëm nuk përmbushte kërkesat legjitime të demonstratave të 1968 për Republikë, por duke qenë një zgjidhje ekuivoke, kishte në vete edhe pasigurinë e së ardhmes. Pozita e re kushtetuese e Kosovës ishte, megjithatë, bazë e përpjekjeve për avancimin e saj, por edhe mundësi potenciale për nacional - shovinistët serbë, që në çastin e dhënë ta spastronin atë, sepse ky është fati historik i zgjidhjeve ambiguenë për popujt e vegjël e të pambrojtur*".⁸⁶

Kjo dykuptimësi kushtetuese, e cila Kosovën e definohte si pjesë të Serbisë, por njëherësh edhe si element konstituiv të federatës jugosllave, nuk do kënaqte mjaftueshëm aspiratën e popullit të Kosovës për vetëvendosje dhe bashkim kombëtar. Andaj, organizatat ilegale që vepronin në Kosovë dhe jashtë saj nuk do ta ndalin asnjëherë veprimtarinë e tyre, për ta realizuar këtë qëllim.⁸⁷

Dekretimi i kushtetutës së vitit 1974, për Serbinë, e në veçanti për qarqet nacionaliste serbe ishte një ogur i keq, por edhe një sensibilizim dhe njëkohësisht mobilizim për ta kundërshtuar atë. Sipas tyre duhej ndaluar menjëherë shkëputja paqësore e Kosovës nga RS e Serbisë. Universiteti i Beogradit, gjegjësisht, Fakulteti Juridik u bë çerdhja, nga ku rifilloi të ripërtërihej "hiri vullkanik", që ishte pashitur nën udhëheqjen e Titos. Tani në këtë kohë, kur udhëheqësi jugosllav ishte i shtyrë në moshë dhe njëkohësisht edhe i sëmurë, nacionalizmi serb sërish filloi të nxirrte kokën.

Miratimit të kushtetutës së vitit 1974 i parapriu një debat publik në gjithë Jugosllavinë. Qysh prej kësaj kohe, në Serbi, filluan të paraqiten pakënaqësi, për kursin që po merrnin këto ndryshime. Forcat konservative, si në strukturat partiake, ashtu edhe në qarqet nacionaliste, largimin e Rankoviqit dhe hapjen e rrugës për ndryshimin e kushtetutës në drejtim të një decentralizimi më të madh të Jugosllavisë, e përjetuan si rrezikim të interesave serbe.

[...] Konfederalizimi i Jugosllavisë u perceptua si tentim i dezintegritit të plotë të popullit serb, pasi që kufijtë e Serbisë “nuk ishin kufij kombëtar e as historik”, e në këtë kuptim edhe “kufijtë e

⁸⁶ M. Hajrizi, *Histori e një organizate politike...*, f. 51-52.

⁸⁷ Faruk Geci, *Tirana kryeqyteti i gjeopolitikës së shqiptarëve*, Qendra Kombëtare e Sigurisë dhe e Mbrojtjes, Tiranë, 2014, f. 16.

të gjitha republikave kishin më tepër karakter administrativ se sa politik”.⁸⁸ Mihajlo Djuric, profesor në Fakultetin Juridik të Beogradit, duke kundërshtuar amendamentet e Kushtetutës së vitit 1974 konstaton: “Jugosllavia ishte tanimë diçka si një “subjekt gjeografik”. Pashmangshëm, një decentralizim i tillë dhe radikal i pushtetit çoi serbët në hapjen e çështjes së tyre për herë të parë pas luftës, pasi që kufijtë e Republikës Socialiste të Serbisë “nuk ishin as historikë, e as kombëtar”. Në fakt, nëse ajo që shkruhet në kushtetutë do të bëhej realitet politik, shkruante Djurici, 40% e gjithë serbëve do ta gjenin veten jashtë juridiksionit të Republikës së Serbisë: “Kjo ishte pothuajse e barabartë me numrin e të gjithë kroatëve apo ndryshe me numrin e të gjithë sllovenëve, boshnjakëve myslimanë dhe maqedonasve.”⁸⁹

Për këto qëndrime nacionaliste, Djuric mbajti dy vite burg, por mendimet e tij qartazi gjetën pasqyrim në: “*Librin e kaltër*”, për të cilin do të flitet më poshtë.

Dekretimi i kushtetutës, sukseset dhe arritjet e tjera të KSA të Kosovës, po nxitnin shpërthime nacionaliste në RS të Serbisë. Në fakt, politikën unitariste të saj e shqetësonte çdo arritje e shqiptarëve, e në veçanti afrimi i Kosovës me Shqipërinë. Sidomos vënia e urave të bashkëpunimit në rrafshin kulturor ishte bërë i papranueshëm për Beogradin, siç ishte rasti me Kongresin e Drejtshkrimin, që u mbajt në Tiranë, më 1972. Qarqet nacionaliste në Beograd e fajësonin edhe udhëheqjen federale për këto “lëshime”, që i bënë në favor të shqiptarëve. Ç’është e vërteta, Serbia, asnjëherë nuk ishte pajtuar me ato që kishin ndodhur në Plenumin e katërt (të Brionëve), kur Rankoviçi dhe klika e tij ishin ngarkuar me deformime të rënda ndaj shqiptarëve, meqë kjo ua kishte hapur udhën proceseve shoqërore dhe politike, ku Kosova dhe faktorizimi i saj shfrytëzohej si një epiqendër e ndryshimeve të dyfishta [...].⁹⁰

Njeriu i cili u bë nxitës dhe bartës i nacionalizmit gjatë viteve të 60 - ta, në Serbi, ishte akademiku Dobrica Qosiqi*. Ai hodhi teza, me të cilat u mundua që të argumentojë se me

⁸⁸ S. Biserko, “Srpska elita i realizacija srpskog nacionalnog programa”, Čosićev Rat, Zbornik radova sa naučne i stručne rasprave o knjizi “Bosanski Rat” Dobrice Čosića, održane 3. Maja 2012 godine u Rektoratu Univerziteta u Sarajevu, Sarajevo 2013, f. 96

⁸⁹ Veljko Vujacic, “Serbian nationalism, Slobodan Milosevic and the origins of the Yugoslav War”, *The Harriman Review*, Vol.8, No. 4, December 1995, f. 3.

<http://studylib.net/doc/8550754/serbian-nationalism--slobodan-milosevic-and-the-origins-o>

⁹⁰ J. Buxhovi, *Kosova nga Konferenca e Londrës e deri të protektorati ndërkombëtar...*, f. 376.

*Dobrica Qosiqi, lindi më 29 dhjetor. Ishte një politikan e romancier serb. Ai ishte presidenti i parë i Republikës Federale të Jugosllavisë nga 1992-93. Admiruesit shpesh i referohen atij si "Ati i Kombit", për shkak të ndikimit të tij në politikën moderne të Serbisë dhe lëvizjes kombëtare të ringjalljes në fund të viteve 1980. Ishte kryesor në hartimin e Memorandumit të ASSHA, të vitit 1986. Kontribuoi dhe e miratoi udhëheqjen e Slobodan Millosheviçit dhe të Radovan Karaxhiçit në Bosnjë të cilët janë akuzuar nga Gjykata ndërkombëtare e Hagës për krime kundër njerëzimit dhe gjenocid. Vdes më 18 maj 2014.

avancimin e të drejtave të shqiptarëve vetëm sa do të rritet irredentizmi shqiptar. Ai më tutje konstaton se: “Barazia e mëtutjeshme nacionale e shqiptarëve çonte kah ngritja e vetëdijes irredentiste të tyre, e më këtë edhe të krijimit të kushteve, që Kosova të shkëputej nga Serbia dhe nga Jugosllavia.”⁹¹

Qosiqi, për të ndezur nacionalizmin, fliste me gjuhën e Çubriloviqit, pra, shërbehej me parullat e tij, gjoja se serbët kërcënohen nga ekspansioni biologjik i shqiptarëve. Ai i fyente nënat shqiptare duke i quajtur: "*Lavatriqe për fëmijë*". Dobrica Qosiqi ishte në mes të gjitha iniciativave, të cilat nxorën në skenën publike opozitën politike jashtinstitucionale e heterogjene, e cila ishte e bashkuar në mospranimin e ekonomisë së tregut dhe të formës konfederale të shtetit jugosllav. Duke iu kundërvënë konfederatës, së pari, në kuadër të partisë, e më pas në krye të opozitës jashtinstitucionale, Qosiqi, krijoi bazën ideologjike për aleancën e elitave serbe - aleancë që u arrit në mesin e viteve 1980.⁹²

Në Muni (Gjermani), më 1974, botohet libri pamflet: "*Srpsko - Arbanski odnosi kroz vekove* " (Marrëdhëniet shqiptaro - serbe nëpër shekuj), ku hartohen plane për rrënimin e kushtetutës së vitit 1974.⁹³ Libër, pamflet, i cili kishte për qëllim që të kontribuonte në zhbërjen e Kushtetutës së sapomiruar, të cilën qarqet nacionaliste të mobilizuara e konsideronin si burim i të këqijave për Serbinë, prandaj fushata vazhdoi edhe më tej.

Profesorë nga Universiteti i Beogradit, si: Najdan Pashiq, Ratko Markoviq dhe Lubomir Tadiq, do të ngarkohen nga kryesia e Serbisë, për të nxjerrë të dhëna dhe për të informuar për pasojat e dëmshme që kishte dekretimi i kushtetutës së re të vitit 1974. Në mbledhjen e 24 qershorit 1977, grupi punues njoftoi Kryesinë e Serbisë, ku paraqiti një përmbledhje për rendin kushtetues të Jugosllavisë dhe pozitën kushtetuese - juridike të Republikës së Serbisë dhe krahinave autonome. Pastaj paraqiti të "gjeturat", që ishin sistematizuar në: "*Librin e kaltër*"* (*Plava knjiga*).

Komisioni bëri të njohura argumentet kundërkushtetuese. Segmentet qenësorë, si: gjykatat e krahinës, policia (përfshirë edhe sigurimin e shtetit), mbrojtja territoriale dhe politikat

⁹¹Po aty, f. 376.

⁹² Latinka Perović, "Dobrica Ćosić o Josipu Brozu Titu – Skica za istraživanje političkog i intelektualnog odnosa", Ćosićev Rat, Zbornik radova sa naučne i stručne rasprave o knjizi "Bosanski Rat" Dobrice Ćosića, održane 3. Maja 2012 godine u Rektoratu Univerziteta u Sarajevu, Sarajevo 2013, f. 46-47.

⁹³ Nusret Pllana, *Terrori i Serbisë pushtuese mbi Shqiptarët 1844 - 1999*, Botimi i katërt, Arkivi Shtetëror i Kosovës, Prishtinë 2012, f. 18.

*Quhet Libri i kaltër për shkak të kopertinave të kaltërta që i kishte.

ekonomike, kërkonin që të rifuteshin nën kontrollin e Beogradit, por nga që pranimi i këtyre pretendimeve dukej se do të sillte një periudhë të re shtypjeje në Kosovë. Dokumenti pati një pritje armiqësore nga udhëheqja federale.⁹⁴ Pra, ky libër që do të ishte sipas tyre interno, pretendonte ricentralizimin e vendit dhe rikthimin e Kosovës dhe të Vojvodinës në kuadër të Republikës së Serbisë.⁹⁵

Dokumenti elaborues: "*Libri i kaltër*", shkaqet dhe arsyet e një veprimi të tillë i sheh te zvogëlimi i kompetencave të republikës së Serbisë, në raport me krahinat. Në fillim të tekstit thuhet se: "Kryesia e Republikës Socialiste të Serbisë, në mbledhjen e 16 janarit 1975, ka marrë iniciativën që në mbledhjen e Kryesisë të shqyrtohen çështjet e konstituimit kushtetues të Republikës, me një theks të veçantë në zbatimin e funksioneve me interes për Republikën si tërësi."⁹⁶

Udhëheqja serbe vazhdonte, duke u arsyetuar, pastaj duke përdorur alibi të ndryshme se gjoja këto ndryshime kushtetuese e pamundësonin dhe e shihnin si pengesë serioze në funksionimin e shtetit unik të Serbisë. Andaj, ajo ngriti çështje të caktuara, që ishin paraqitur brenda në: "*Librin e kaltër*", e që e kontestonin Kushtetutën e vitit 1974. Grupi punues pretendonte se funksionalitetin e shtetit të Serbisë e cenonin tri çështje themelore, e që janë: mbrojtja territoriale, punët e brendshme e siguria dhe marrëdhëniet me jashtë. Për këto tri çështje të mëdha, ka pasur mjaft diskutime në kuadër të komisioneve të ndryshme, lidhur me rregullimin në bazë ligjore të raporteve mes mbrojtjeve territoriale në tri nivele, ku edhe këtu, përmes: "*Librit të kaltër*" atakon kushtetutat, duke theksuar se nuk është marrë parasysh pozita kushtetuese e republikës dhe e krahinave në përbërjen saj.⁹⁷

Qëllimi kryesor i hartimit të: "*Librit të kaltër*" ishte përpjekja e politikës serbe për të penguar forcat patriotike të kohës, të realizojnë krijimin e Republikës së Kosovës. Pra, tezat e vendosura në këtë elaborat, kishin për qëllim që të atakonin autonominë, që e ofronte Kushtetuta e vitit 1974 dhe të parandalonin, që ky status mos të avancohet në republikë.

"*Libri i kaltër*" në njëfarë mënyre u shndërrua në platformë politike për rishikimin e pozitës juridike të Republikës së Serbisë dhe dy krahinave brenda saj. Ish- kryetari i Komitetit Qendror të LKJ - së, Stipe Shuvar, në një intervistë është shprehur: "*Pas shpalljes së Kushtetutës*

⁹⁴M. Vickers, *Midis serbëve dhe shqiptarëve...*, f. 225.

⁹⁵ Oliver Jens Schmit, *Kosova - Histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike*, KOHA, Prishtinë, 2012, f. 239.

⁹⁶E. Çeku, *Kosova në sfondin e diplomacisë së Jugosllavisë dhe të Shqipërisë 1945 - 1981, (Tezë doktore)* Prishtinë, 2008, f. 153.

⁹⁷Po aty, f. 156.

së vitit 1974, në Serbi ishin shfaqur pakënaqësitë. Dragosllav Markoviçiqi së bashku me Petar Stamboliçin, në vitin 1977 kishin kërkuar nga Eduard Kardeli, që të revidohen dispozita e të dy kushtetutave: federative dhe republikane, që krahinat të mos jenë shtet në shtet. Për këtë, Kardeli, kishte shprehur një mirëkuptim të veçantë.⁹⁸

Tito nuk ishte i gatshëm ta pranonte këtë shpërfaqje të nacionalizmit serb. U përpoq t'i ndalojë këto ripërtrirje të ndjenjave nacionaliste, si: në Kroaci më parë edhe tani në Serbi, megjithëse, ishte koshient se këto do marrin hov kurdoherë. Në një rast, derisa po kthehej me tren nga Rumania, ku ishte në vizitë, ai iu drejtua shokëve të tij: "Po ta shihnit edhe ju atë që shoh unë tek e ardhmja e Jugosllavisë do të tmerroheshit për vdekje".⁹⁹

Sido që të jetë, në kohën kur është hartuar: "Libri i kaltër", Tito ishte i sëmurë nga gangrena, por ai vendosi të veprojë, duke i thirrur në përgjegjësi krerët më të lartë të Serbisë. Udhëheqja serbe, në krye me: Drazha Markoviçin (Dragoslav, xhaxhai i Mira Markoviçiqit, gruas së Slobodan Millosheviçiqit – v.j. S. K) do t'i kërkojnë falje me arsyetimin se: "Libri i kaltër" ishte vetëm një "përmbledhje e vërejtjeve që kishin ardhur nga baza" dhe kurrsesi një qëndrim politik i udhëheqjes serbe. Me këtë rast ishte shprehur gatishmëria që të tejkaloheshin "të gjitha moskuptimet" dhe "keqinterpretimet" që ishin bërë nga qarqe të caktuara serbe.¹⁰⁰

Në një intervistë të tij, i pyetur se a kishte njohuri Tito për këtë dokument, Fadil Hoxha tregon: "Po, mund të them me kompetencë se Tito ka pasur informata për pretendimet e Serbisë kundër Kosovës, pra, edhe për qëllimet serbe që përmes: "Librit të kaltër" të suprimojë autonominë e Kosovës dhe të vërë një mbikëqyrje edhe më të rreptë ndaj zhvillimeve në Kosovë".¹⁰¹

Pra, siç po vërehet, intelektualët serbë ishin mobilizuar në përgatitjen e literaturës nacionaliste, përmes së cilës po ripërtrinin etnonacionalizmin serb. "Libri i kaltër" shërbeu si brumë i mirë për Memorandumin famoz të Akademisë Serbe të Shkencës dhe të Arteve, i cili u publikua në vitin 1986 e për të cilin do të flasim më gjerësisht në kreun e tretë.

Me këto veprime, Serbia po dëshmonte se asnjëherë nuk ka qenë e gatshme që të pranojë shqiptarët si realitet e aq më pak si partnerë. Vitet e 70-ta të shekullit XX, kur Kosova avancoi në

⁹⁸Po aty, f. 157.

⁹⁹J. Udoviçki & J.Ridgeway, *Makthi etnik i Jugosllavisë...*, f. 67.

¹⁰⁰J. Buxhovi, *Kosova nga Konferenca e Londrës e deri të protektorati ndërkombëtar...*, f. 380.

¹⁰¹Agim Zogaj, Bisedë me Fadil Hoxhën, <https://telegrafi.com/fadil-hoxha-prill-1994-tito-dhe-kardeli-thane-cka-ju-duhet-republika-kujdes-prej-serbise/>, qasja 20 tetor 2018.

statusin e saj (subjekt federal) ishin imponim nga lart (Titoja dhe rrethi i tij) e jo vetëdije e klasës politike serbe.¹⁰²

KREU I DYTË

NGJARJET NË MUAJT MARS - PRILL 1981 DHE SITUATA E KRIJUAR PAS TYRE

2.1. Vështrim i përgjithshëm i gjendjes në Kosovë dhe në Maqedoni, pas vdekjes së Titos

Në mbrëmjen e 4 majit 1980 media qendrore jugosllave transmetuan komunikatën që KQ i LKJ dhe Kryesia e RSFJ ia adresuan klasës punëtore, popullit punonjës dhe qytetarëve të Jugosllavisë, lidhur me vdekjen e kryetarit të RSFJ, Josip Broz Tito.¹⁰³

Që në ditët e para pas vdekjes së tij, krerët politikë jugosllavë u zotuan për besnikëri ndaj parimeve dhe politikës që kishte ndjekur Tito. Në këtë mënyrë artikuluan frazën e njohur: “Pas Titos - Tito”. Duke qenë se kohëve të fundit, shëndeti i Titos ishte rënduar, ai kishte lënë me testament zëvendësimin e funksioneve të tij politike në formën e një udhëheqjeje kolektive me rotacion: një presidencë e shtetit me përbërjen e tetë anëtarëve që qarkullonin, ku të gjithë zyrtarët zgjidheshin mbi bazën e përfaqësimit të barabartë nga gjashtë republikat (Sllovenia Kroacia, Bosnjë-Hercegovina, Serbia, Mali i Zi, dhe Maqedonia) dhe dy krahinat autonome (Kosova dhe Vojvodina).¹⁰⁴

Vdekja e Titos kishte shkaktuar një brengosje të përgjithshme në skenën politike botërore. Shtypi i proveniencës perëndimore paralajmëronte fundin e shpejtë të Jugosllavisë. Madje, ata flisnin për një luftë civile ndërmjet popujve, që e përbënin Jugosllavinë, sepse sipas tyre Titoja ishte shtylla e vetme që mbante unitetin multi-etnik të Jugosllavisë.¹⁰⁵

¹⁰² Emine Bakalli - Arifi: Çështje nga historia moderne dhe bashkëkohore shqiptare, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2011, f. 239.

¹⁰³ Miodrag Zdravkovic, Umro drug Tito, <https://www.youtube.com/watch?v=92NR7S2YhsU>, qasja 20 gusht 2019.

¹⁰⁴ M. Vickers, *Midis serbëve dhe shqiptarëve...*, f. 238.

¹⁰⁵ M. Glenny, *Histori e Ballkanit 1804 – 1999...*, f. 623.

Duket se shtypi perëndimor kishte pasur të drejtë. Strategjia kryesore e Titos, në ruajtjen e qetësisë ndërnacionale, bazohej në frenimin e fuqisë së republikës më të madhe në federatë (Serbisë), si dhe në parandalimin e largimit të njësive të tjera nga Federata. Pas vdekjes së tij, një strategji e tillë kishte pak gjasa që të ekzistonte për shkak të mungesës së një arbitri suprem. Në Jugosllavi nuk ekzistonin institucione legjitime politike, për t'i zgjidhur problemet midis grupeve të ndryshme nacionale dhe për ta përkrahur idealin e një shteti të unifikuar kombëtar, një rrethanë e zakonshme edhe për shtetet e tjera multinacionale të bllokut komunist. Kjo rrethanë, në veçanti ishte e përshtatshme për rritjen e nacionalizmit etnik në këto vende.¹⁰⁶

Në këtë mënyrë, me kalimin e kohës, Jugosllavia po mbytej gjithnjë e më shumë nga egoizmi nationalist. Ideologjia komuniste po zëvendësohej nga nacionalizmi serbomad, gjë që kjo ishte paralajmërim i fortë se kultura shumëkombëshe e Jugosllavisë po shkonte drejt fundit të saj.¹⁰⁷

Në rrafshin ekonomik, Jugosllavia në prag të vdekjes së Titos u gjend para një varg problemesh të shumta të kësaj sfere, që ishin akumuluar për një kohë të gjatë. Ndër shkaqet kryesore të kësaj krize renditen: deficitit tregtar dhe përkeqësimi i borxhit të jashtëm. Deficiti i bilancit të prodhimit në vitin 1979, duke i hequr të ardhurat nga turizmi dhe ato nga emigracioni arrinte në 3.6 miliardë dollarë amerikanë. Në vitin 1980, borxhi i jashtëm tanimë kishte kapur vlerën prej 16 miliardë dollarë, kurse niveli i inflacionit arriti në masën prej 20%.¹⁰⁸ Kriza ekonomike u rëndua edhe më tej. Sipas të dhënave të publikuara nga Banka Botërore, borxhi i jashtëm i Jugosllavisë, në vitin 1986, kishte arritur vlerën prej më tepër se 21 miliardë dollarë. Paaftësia për t'u ballafaquar me borxhin e jashtëm, bëri që ky borxh të pësojë një rritje enorme deri në shkallën 2000%.¹⁰⁹

Mbyllja e shumë ndërmarrjeve bëri që numri i të papunëve të arrijë shifrën prej një milion. Shtrirja e papunësisë ishte e pabarabartë nëpër republika dhe krahina, ndërsa ky problem ishte më i theksuar në Kosovë. Të gjithë treguesit, parametrat ekonomikë tregojnë se KSA e Kosovës ishte treva më e prapambetur në Jugosllavi, edhe pse nëntoka e Kosovës konsiderohej nga më të begatat, për sa i përket resurseve natyrore.

¹⁰⁶Vesna Pestic, "Serbian Nationalism and the Origins of the Yugoslav Crisis", *United States Institute of Peace*, Peaceworks No. 8. First published April 1996, f. 14.

¹⁰⁷ Joschka Fischer, *Vitet kuq - gjelbër - politika e jashtme gjermane nga Kosova e deri më 11 shtator*, Prishtinë, Koha, f. 98.

¹⁰⁸ Viktor Meier, *Fundi i Jugosllavisë*, Liria, Lubjanë, 2007, f. 25.

¹⁰⁹ Uolter Lakër, *Evropa në kohën tonë - Histori e viteve 1945 - 1992*, Dituria, Tiranë, 1996, f. 436 – 437.

Në vitin 1979, kapaciteti prodhues për banorë, në Kosovë ishte 7,2 herë nën nivelin federativ dhe 16 herë nën atë të Sllovenisë. Në vitin 1980, të ardhurat kombëtare për banorë në krahinë përbënin 28.1% të mesatares jugosllave. Sipas të dhënave të Entit Federativ të Statistikës për vitin 1980, të gjithë treguesit e standardit jetësor në Kosovë ishin nën nivelin e mesatares jugosllave.¹¹⁰ Sipas llogaritjeve krahasuese të disa ekonomistëve të Kosovës dhe të huaj , në vitin 1981, në KSA e Kosovës kishte 450 mijë të papunë ose 53% të popullsisë së saj në moshë të punës.¹¹¹

Kosova, edhe pse kishte kapacitete zhvillimore, mbeti më e pazhvilluara brenda Federatës jugosllave. Në kushtet e pabarazisë e të diferencimit të përgjithshëm në Jugosllavi, aspirata e tyre për të jetuar të pavarur bëhej gjithnjë e më imponuese. E trashëguar brez pas brezi dhe e kultivuar në kushtet e vështira të pushtimit e të diskriminimit serb, kjo aspiratë zuri vend në themele të ndërgjegjes politike, psikologjisë shoqërore e kulturës së tyre. Është kjo arsyeja që pakënaqësia ndaj pushtetit nacionalist serb përfshiu të gjitha shtresat e popullsisë së Kosovës, që nga punëtorët e fshatarët e deri te studentët e intelektualët.¹¹²

Në rrafshin kulturor e arsimor, kjo periudhë karakterizohet me zhvillim të hovshëm dhe arritje te kënaqshme. Kjo vie pasi që u hap një kapitull i ri bashkëpunimi ndërmjet RP të Shqipërisë dhe RSFJ - së.

Në faktë, marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave filluan të normalizohen nga viti 1970, pas fjalimit të Enver Hoxhës në Tropojë ku theksoi nevojën e afrimit të Shqipërisë me Jugosllavinë duke i dhënë përparësi fqinjësisë së mirë. Të njëjtin vit, Tito në Ulqin dha një deklaratë ku potenconte qartë pikat e afrimit ndërmjet dy vendeve.¹¹³

Kosova që ishte pjesë e RSFJ - së asokohe, do kishte përfitimet më të mëdha në aspektin e shkencës e të kulturës nga ky përafrim mes dy vendeve. Në Prishtinë u hap Universitetit i Prishtinës (më tej - UP), tashmë i pavarur nga ai i Beogradit, ku mësimi zhvillohej në të dyja gjuhët: në shqip e në serbokroatisht. Katedrat e fakulteteve u pasuruan me laboratorë, ambiente për punë praktike e me biblioteka. Si i ri, Universiteti i Prishtinës kishte nevojë për të vënë ura bashkëpunimi me Universitetin e Tiranës (më tej - USHT), nga i cili do të merrte përvoja, por

¹¹⁰ A. Lalaj, *Kosova - rruga e gjatë drejt vetëvendosjes 1941 -48...*, f. 372; Për këtë shih: M. Hajrizi, *Histori e një organizate politike...*, f. 206.

¹¹¹Po aty, f. 373.

¹¹²Po aty, f. 380.

¹¹³Rilindja, 06 shkurt, 1971, f.8.

edhe ti shkëmbejnë ato. Andaj, ndërmjet këtyre dy institucioneve arsimore, filloi një bashkëpunim i ngushtë.

Gjatë muajve korrik - tetor të vitit 1970, delegacione të larta bënë vizita reciproke, të cilat rezultuan me nënshkrimin e një protokollit. Ky Protokoll u nënshkrua më 27 tetor 1970, me propozimin e delegacionit nga Kosova.

Përmbajtja e Protokollit është e orientuar në ndihmat e USHT për UP në disa drejtime si vijon: në ngritjen e nivelit të kuadrove të rinj në UP duke ardhur për specializim dhe eksperiencë pranë katedrave të USHT dhe së dyti duke dërguar USHT 50 kuadro të saj për punë mësimore-shkencore pranë UP që të zhvilloj ligjërata, leksione etj. Protokollit përmbante gjithashtu zotimin e USHT që të dërgoj tekste të cilat i boton etj.¹¹⁴ Nënshkrimi i protokollit ndërmjet dy Universiteteve, pati jehonë të madhe në Jugosllavi sidomos në vendet ku ishin me shumicë shqiptare. Pedagogët e dy Universiteteve pos ligjëratave, këto udhëtime i kanë shfrytëzuar edhe për takime të shumta në Rektorat, si dhe me kolegë të ndryshëm të Kosovës respektivisht Shqipërisë. Vitet 1970-1971, bëjnë kthesë të rënjësishme në çështjen e sensibilizimit të Kosovës në Shqipëri. Pikërisht sfera arsimore i parapriu këtij hapi të rëndësishëm e që u bë vatër dhe djepit të nacionalizmit në dy anët e kufirit.¹¹⁵

Ky bashkëpunim ndikoi në krijimin e kuadrove, të reja në të gjitha fushat e nevojshme. Shumë pedagogë të Universitetit të Prishtinës pëfunduan specializime në USHT. Në pak vite u hapën shumë shkolla të reja dhe u rrit numri i nxënësve i studentëve e për rrjedhojë i mësuesve shqiptarë. Simpoziumet e konferencat shkencore u bënë të shpeshta në përvjetorë ngjarjesh e figurash historike me rëndësi kombëtare, si: 500-vjetori i vdekjes së Skënderbeut, 100 - vjetori i krijimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, konsulta për drejtshkrimin e gjuhës letrare shqipe, mbledhje përkujtimore për 43-vjetorin e Konferencës së Bujanit, për 70-vjetorin e vdekjes së Naim Frashërit, etj.

Për më tepër u forcuan lidhjet me institucionet analoge arsimore, kulturore e shkencore të Republikës Popullore të Shqipërisë. Të gjithë këta hapa ndikuan në rigjallërimin e në forcimin e ndërgjegjes kombëtare të shqiptarëve të Kosovës.¹¹⁶ Bashkëpunimi ndërmjet KSAK dhe RP të Shqipërisë u intensifikua me vizitat bilaterale të homologëve në fushën e arsimit, respektivisht të

¹¹⁴ Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë (më tej AMPJ), viti 1971, dosja.661, f.76.

¹¹⁵ AMPJ , viti 1971, dosja.661, f.77.

¹¹⁶ Po aty, f. 368.

sekretarit krahinor për Arsim, Shkencë e Kulturë, Ymer Jaka që i bëri Shqipërisë nga data 25 -30 shtator 1979 dhe të ministres së arsimit të RP e Shqipërisë, Tefta Cami, vizitë që e realizoi nga data 6 -10 tetor 1980. Dakordimi ishte për shkëmbimin e librave shkollorë, për hartimin e një atlasit dialektologjik, si dhe për hartimin e një enciklopedie shqiptare.¹¹⁷

Këto vizita te nivelit të lartë u pasuan edhe nga vizita tjera të niveleve të ndryshme. Një delegacion i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës i përbërë nga kryetari i këtij institucioni të lartë, Idriz Ajeti dhe sekretari i përgjithshëm, Syrja Pupovci vizituan Shqipërinë me 27.01.1981.

Delegacioni u prit nga kryetari i Akademisë në Shqipëri, Aleks Buda. Dy palët biseduan për nënshkrimin e një Protokolli, që për dallim nga ai i mëparshëmi për të cilin kemi folur më lartë, ky i tanishmi parashihte shtimin e aktiviteteve të cilat ishin me interes të dyanshëm.

Pavarësisht se në dukje shihej sikurse shqiptarët e Kosovës kishin terren të lirë bashkëpunimi me Shqipërinë, megjithatë, çdo gjë ishte e kontrolluar dhe e mbikëqyrur. Këtë fakt, përveç pjesëmarrësve të ngjarjeve të kohës, e kishte vërejtur edhe diplomati austriak, W. Petritsch. Në librin e tij: “Rruga e gjatë në luftë”, ai shkruante: “... *Por liritë kishin kufij. Nëse bëhej fjalë për të kritikuar sistemin jugosllav, unitetin e popujve të Jugosllavisë, Qeverinë ose Lidhjen e Komunistëve, ose kur shfaqjet e veçorive të veta kulturore shndërroheshin në kërkesa secesioniste dhe revezioniste , organet shtetërore bllokuan gjithçka. Edhe dyshimi më i vogël mjaftonte për t'u akuzuar për "veprimtari irredentiste" dhe për të përfunduar pas hekurave të burgut. Numri i madh i të arrestuarve ndër shqiptarët tregon se në Kosovë ka pasur një veprimtari të tillë. Sipas Amnesty International midis viteve 1971 – 1981, shqiptarët përbënin grupin më të madh në numër ndër të burgosurit politikë në Jugosllavi.*¹¹⁸

Mostoleranca ndërmjet popujve të Jugosllavisë, po shënonte rritje dhe po thellonte antagonizmat etnik, kjo si pasojë e prirjeve nacionaliste, të cilat Tito i ndëshkonte ashpër dhe i cilësonte si krim. Në kohën e Titos nuk lejohej asnjë formë e hapur e shprehjes së nacionalizmit. Mirëpo pas vdekjes së tij, nacionalizmi mori hov. U thellua mosbesimi ndërmjet popujve të Jugosllavisë. Kushtetuta e vitit 1974, i kishte dhënë kompetenca të gjëra njësive federale, republikave dhe krahinave. Gjashtë republikave dhe dy krahinave iu dha e drejta e vetos në asamblenë federale, gjë që në mënyrë të heshtur e shndërronte Jugosllavin federale në

¹¹⁷ Peter Bartl, *Shqipëria nga mesjeta deri sot*, Drita, Prizren 1999, f. 239.

¹¹⁸ Wolfgang Petritsch & Robert Pichler, *Rruga e gjatë në luftë (Kosova dhe Bashkësia ndërkombëtare 1989 -1999*, Koha, Prishtinë, f. 32.

konfederatë.¹¹⁹ Ky sistem kushtetues krijoi favore për njësitë federale, por jo për federatën, sepse secila mendonte për shtëpinë e vet dhe asnjëra nuk mendonte për shtëpinë e përbashkët.

Në kuadër të Federatës jugosllave, Kosova vazhdonte të mbetej njësi federale më e pazhvilluar. Prapambetja ishte burim tensionesh midis popullsisë etnike të Kosovës: shqiptarëve, në njërin anë dhe, serbëve e malazezëve, në anën tjetër.¹²⁰

Në kushtet e këtij zhvillimi të pabarabartë, rinia shqiptare përballej me mundësi të pakta punësimi. Mospërputhja mes atyre që diplomoheshin në Universitetin e Prishtinës dhe atyre që punësoheshin ishte e madhe. Si rrjedhojë e këtij diskriminimi politik e ekonomik që i bëhej Kosovës, filluan demonstratat e vitit 1981, së pari, në mesin e studentëve, ku pastaj eskaluan, duke marrë hov edhe në mesin e qytetarëve të Kosovës.

2.2. Shpërthimi i demonstratave të vitit 1981 dhe dhuna policore serbe

Demonstratat masive, që shpërthyen në pranverën e vitit 1981, gjegjësisht, në mbrëmjen e 11 marsit, konsiderohen si ngjarjet kryesore në Jugosllavi pas vdekjes së Titos. Fillimisht, revoltat studentore filluan në mjediset universitare, me arsyetimin e cilësisë së dobët në ushqim dhe kushteve jo të mira në konvikte, e që ato brenda një kohe të shkurtër u përshkallëzuan në protesta gjithëpopullore anekënd Kosovës. Policia ndërhyri, duke përdorur shkopinj gome e gaz lotsjellës. Protesta që, fillimisht, kishte karakter social u shpërnda. Mirëpo, kjo vetëm përkohësisht, sepse ato do të rifillojnë edhe më fuqishëm dhe me kërkesa politike, sidomos, me kërkesën kulmore, e cila artikulonte aspiratën kryesore, e që ishte avancimi e pozitës juridiko - kushtetuese të Kosovës, pra: Kosova Republikë!

Azem Vllasi, njëri nga udhëheqësit e lartë politik të asaj kohe në Kosovë, tregon që së bashku me Pajazit Nushin përpiqeshin t'i bindnin studentët për t'u larguar nga rruga dhe për të shkuar në Qendrën e studentëve, ku do bisedonin lidhur me kërkesat e tyre. "*Erdhi nënkryetari i Qeverisë së Kosovës, prof. dr. Pajazit Nushi dhe, sipas detyrës që kishte marrë nga udhëheqësit e Kosovës iu drejtua turmës. E mbajtën dhe e ndihmuan të hipte mbi po të njëjtën arkë, mbi të cilën ishte folësi paraparak*". Shkurtimisht ai tha: "*Në udhëheqjen e Kosovës tashmë e kemi informatën që shkak i protestës ishte ushqimi i dobët dhe organizimi i keq i të ushqyerit në*

¹¹⁹J. Udovički & J.Ridgeway, *Makthi etnik i Jugosllavisë*..., f. 75.

¹²⁰Po aty, fq.76.

mensë. Shoqëria jonë ka investuar shumë që të përmirësohet standardi i studentëve, por është evidente që nevojat janë më të mëdha. Kam ardhur këtu që t'ju them se jemi njoftuar me pakënaqësinë tuaj dhe do t'i ndërmarrim të gjitha masat e mundshme që situata të përmirësohet".¹²¹

Vllasi, vazhdon më tutje, duke rrëfyer për ngjarjet, të cilat ndodhën në vazhdim: *"Gjithnjë e më vështirë po bëhej të komunikohesh me turmën, sepse nervozizmi dhe zhurma po shtoheshin. Ftesat që të shkonim në mensë për të biseduar, definitivisht u injoruan. Dëshën të ktheheshin përsëri në qendër, përsëri në rrugën e njëjtë, ku ishin para tri orësh. Por, poshtë nja 200 metra, tashmë ishte vendosur kordoni i policisë. Dikush nga udhëheqja kishte urdhëruar të mos i lejonin më të shkonin drejt qendrës. Mesnata po afrohej. Asgjë më shumë nuk mund të bënim. Dikush tha se duhej të largoheshim. Shpresoja që edhe ata më këmbëngulësit do të shpërndaheshin, kur ta kuptonin se nuk mund të shkonin në qytet dhe se shkuarja atje nuk kishte kurrfarë kuptimi. Për fat të keq nuk u shpërndanë".¹²²* Pasi që janë larguar funksionarët e lartë të shtetit, atëherë ka pasuar ndërhyrja e policisë me shkopinj gome dhe me gaz lotsjellës. Bëhet me dije se kishte të plagosur nga të dyja palët, pra, nga ana e protestuesve dhe nga policia.

Qetësia pas ngjarjeve të 11 marsit kishte qenë e përkohshme. Një valë e re protestash studentore rifilloi më 26 mars 1981. Për kohëzgjatje, po në këtë datë, në Prishtinë, duhej të parakalonte "Stafeta e Rinisë", një ngjarje tradicionale në Jugosllavi. Ishte kjo hera e parë që pas vdekjes së Titos stafeta në fjalë parakalonte nëpër qytetet e Jugosllavisë me destinacion final Beogradin. Demonstrimet që ndodhën në ditën kritike u interpretuan nga Azem Vllasi, si skenarë të përgatitura e të planifikuara mirë, pikërisht në ditën kur bëheshin aktivitete tradicionale për Titon, të trumbetoheshin, si manifestime kundër Titos. Konstatimet e Vllasit shkonin edhe më thellë, duke e implikuar edhe Shqipërinë në këto demonstrata, duke u bazuar te propaganda që bënte Shqipëria zyrtare në edukimin e të rinjve nga Kosova. Mirëpo, më vonë doli se Tirana nuk qëndronte drejtpërdrejt prapa këtij skenari. E gjithë kjo kishte prapavijë më të thellë politike.¹²³ Ky prononcim ishte sinjali i parë rreth qëndrimit të udhëheqjes politike krahinore lidhur me këto demonstrata.

Qytetarët e shumtë, të cilët kishin dalë në rrugë dhe ata që kishin ardhur nga qytete të tjera të Kosovës u përballën me ndërhyrjen e policisë sonë, por edhe efektive të policisë, që

¹²¹ Azem Vllasi, *Kosova: Fillimi që nuk harrohet*, KOHA, Prishtinë, 2017, f. 257.

¹²² Po aty, f. 257.

¹²³ Po aty, f. 264.

kishin ardhur nga republikat e tjera të Jugosllavisë. Në demonstratat e 26 marsit, studentëve dhe nxënësve iu bashkuan dhe punonjës të arsimit, të kulturës e të artit, punëtorë dhe nëpunës shqiptarë.¹²⁴

Udhëheqësit e Kosovës dhe Rektorati i Universitetit të Prishtinës, duke e parë që situata po dilte jashtë kontrollit e ftuan një takim me përfaqësuesit e studentëve. Në këtë delegacion pos rektorit Gazmend Zajmi, Pajazit Nushit (nënkryetar i Këshillit Ekzekutiv të Kosovës, pra qeverisë) ndodheshin edhe: Azem Vllasi dhe Sanie Hyseni. (Vllasi dhe Hyseni kishin qenë kryetarë të Lidhjes së Rinisë së Jugosllavisë dhe vlerësoheshin si pjesë e "garniturës së re titiste). Nga ana e studentëve kishin qenë disa nga organizatorët e demonstratave, si: Riza Demaj, Ali Lajçi dhe Teuta Hadri.¹²⁵ Autoritetet universitare bënë përpjekje për ta qetësuar situatën, duke premtuar se do të ndërtohen konvikte të reja për studentë dhe se do të përmirësoheshin kushtet në mensë; sakaq, protestat tashmë kishin marrë një ton serioz politikë.¹²⁶ Sipas Vllasit, udhëheqësit e Kosovës: Xhavit Nimani dhe Mahmut Bakalli ishin në kontakt të vazhdueshëm me instancat më të larta në Beograd, duke premtuar se do ta menaxhojnë krizën. Presidenca e Jugosllavisë nuk kishte besuar më në vlerësimin e udhëheqësve të Kosovës. Sigurisht edhe nëpërmjet kanaleve të tjera nga Prishtina, nëpërmjet kuadrove serbe dhe oficerëve të armatës, në Beograd shkonin informata dramatike, madje, me theks se veçanërisht serbët në Kosovë ishin shumë të frikësuar nga zhvillime të tilla. Prandaj, kryesia e RSFJ kishte urdhëruar sekretarin federativ, gjeneralin, Franjo Herleviq që në Prishtinë të dërgonte Njësinë speciale për intervenime të shpejta të policisë federative, që t'i ndihmonte Policisë së Kosovës për të rivendosur rendin publik. Bashkë me këtë Njësi speciale dhe komandantin e saj nga Beogradi, në Prishtinë ishte dërguar edhe Rrahman Morina, i cili asokohe, si përfaqësues i Kosovës ishte njëri nga shtatë ndihmësit e ministrit, Franjo Herleviq.¹²⁷

Ndërhyrja e policisë speciale ishte brutale. Dhuna e përdorur ndaj protestuesve dhe ndaj studentëve paqësorë në konvikte e tejkaloi çdo rregull të ushtrimit të detyrës së tyre. Për brutalitetin e policisë speciale rrëfen Vllasi, si njëri nga protagonistët e asaj kohe: *"Njësia speciale arriti nga Beogradi me avion në orën 14 pasdite. Nga aeroporti u transportuan me automjete të policisë drejtpërdrejt te konviktet e studentëve, pra, drejt e në aksion. Pa kurrfarë*

¹²⁴ Sabit Syla, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës 1939-1981*, Instituti i Historisë-Prishtinë, 2012, f. 260.

¹²⁵ J. Buxhovi, *Kosova nga Konferenca e Londrës e deri të protektorati ndërkombëtar...*, f. 389.

¹²⁶ N. Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër...*, f. 349.

¹²⁷ A. Vllasi, *Kosova.....*, f. 270.

bashkëveprimi me policinë vendore, intervenuan në mënyrë të pavarur, ndonëse, edhe policët tanë ishin te konviktet e studentëve. Dëshmitarët okularë, pra edhe policët tanë, pastaj tregonin se ndërhyrja kishte qenë brutale, përtej çdo mase. Ishte shfryrje mllëfi. Policët specialë kishin hyrë në konvikte pa kurrfarë nevojë. Ishin futur nëpër dhoma dhe kishin rrahur këdo që kishin gjetur brenda, jo vetëm djemtë, por edhe vajzat. Kishin hedhur gaz lotsjellës. Studentët që kishin mundur kishin ikur. Shumica kishin shkuar nëpër shtëpitë e tyre, jashtë Prishtinës, anembanë Kosovës. Kishin treguar krejt çka kishin parë dhe kishin përjetuar. Kështu të njëjtën ditë e gjithë Kosova mori vesh për brutalitetin e Policisë Federative, së cilës sa herë përmendej i shtohesh "policia serbe", edhe pse, me sa dukej njësia ishte shumetnike, jugosllave, madje e komanduar prej një slloveni me emrin, Marko Kos. Rrëfimet për ngjarjet të tilla, viktimat shpeshherë mund t'i ekzagjerojnë. Por, në këtë rast nuk pati nevojë të ekzagjerohet asgjë, sepse veçanërisht të tmerrshme ishin rrëfimet për vajzat, të cilat ishin fyer, tërhequr zvarrë për flokësh...me zhargonin e ri në demokraci do të quhej përdorim i tepruar i forcës". Por, me sa duket pati shumë më keq se kaq. Ky ishte përdorimi jo vetëm i tepruar, por brutal i dhunës.¹²⁸

Ditët që e pasuan 26 marsin ishin të rënda. Reprezaljet policore vazhduan pandërprerë edhe gjatë ditëve të ardhshme. Në anën tjetër, demonstrata po përfshinte edhe kategori të tjera të shoqërisë, si punëtorët e ndërmarrjeve të mëdha asokohe dhe të nxënësve. Ja si e përshkruan Vllasi gjendjen e këtyre ditëve. "Në ditët në vijim, pra nga 26 marsi e deri më 31 mars, gjendja në Prishtinë ishte kaotike dhe konfuze. Me 30 dhe 31 mars, drejt Prishtinës ishin nisur edhe punëtorët e Elektroekonomisë nga Obiliqi, por u rebeluan edhe punonjësit e ndërmarrjeve të tjera. Ata nuk kishin asnjë kërkesë. Madje, punëtorët e Elektroekonomisë kishin bartur edhe një fotografi të Titos, që të mos kishte keqkuptime. Në protesta dolën edhe nxënësit e shkollave të mesme në Prishtinë, por edhe të qyteteve të tjera. Me ta ishte edhe një numër jo i vogël i profesorëve të tyre. Kështu, më 31 mars dhe 1 prill në Prishtinë ishte gjendje shtetrrethimi. Nga Beogradi erdhën forca shtesë të policisë federative. Në përbërje kishte shumë policë nga Serbia. Ata pritnin përtej kufirit të sotëm në Merdarë, ngase pa lejen e pushtetit të Kosovës nuk mund të hynin. Edhe ushtria ishte vënë në gjendje gatishmërie. Tanket e Garnizonit të APJ-së në Prishtinë dolën nga kazermat që ishin nja dy kilometra larg nga qendra dhe kaluan nëpër rrugën kryesore. Disa u pozicionuan para institucioneve qeveritare dhe para shërbimeve të rëndësishme publike. Nuk gjuajtën me armë, por ishin aty për të tërhequr vërejtjen për frikësim. Policia kudo

¹²⁸Po aty, f. 270.

ishite në aksion. Në vendet, ku pati konflikte të ashpra fizike me demonstrues, u shkrepën edhe armë. Tani aty ishte çdo herë e më shumë e pranishme Policia Federative. Policët tanë, jo vetëm që ishin në plan të dytë, por diku - diku u detyruan t'i mbronin demonstruesit nga çmenduria e policëve federativë.¹²⁹

Për implikimin e ushtrisë kishte pranuar edhe vetë Nikolla Ljubiçiç gjatë bisedës me historianin serb, Venceslav Glisliqin, e që në atë kohë Ljubiçiç ishte ministër i mbrojtjes në RSFJ. Ai gjatë trazirave në Prishtinë, kishte intervenuar në mënyrë energjike me ushtri kundër demonstratave shqiptare, si në vitin 1968, po ashtu edhe më 1981: “*Pas vete e kam pasur Titon, i cili mori vendimin, kurse unë e ekzekutova (fjala për demonstratat e vitit 1968). Në kohën e demonstratave shqiptare të vitit 1981 unë mora vendimin që të intervenohet me ushtri. I kam nisur katër divizione për në Kosovë e Metohi dhe kam kërcënuar se do të djeg gjithçka. Shqiptarët hoqën dorë nga demonstratat*”.¹³⁰

Pavarësisht ndërhyrjes së forcave ushtarake e policore, demonstratat shqiptare në Kosovë u bënë edhe më masive në ditët e para të prillit, respektivisht më 1, 2 dhe 3 prill. Me studentët, nxënësit dhe qytetarët u bashkuan edhe punëtorët. Punëtorë nga ndërmarrjet gjigante kosovare të kohës, si: “Ramiz Sadiku”, “Trepça”, Fabrika e Akumulatorëve në Obiliq, etj., iu bashkuan demonstratave, sikurse edhe shumë fshatarë në të gjitha komunat, ku u zhvilluan demonstratat. Në demonstrata morën pjesë gra dhe të reja shqiptare nga Kosova. Ministria e Punëve të Jashtme e Shqipërisë i referohej një shifre mbi 100 mijë vetëve, si pjesëmarrës në demonstrata, por sidoqoftë kjo shifër nuk ishte verifikuar.¹³¹

Gjatë këtyre tre ditëve të para të prillit vazhdoi po e njëjta dhunë policore. Për më tepër situata u rëndua pas brutalitetit policor, që u shoqërua me përdorimin e armëve të zjarrit, ku mbetën të vrarë disa protestues në disa qendra të Kosovës. Në tri qytete pati të vrarë 9 persona dhe shumë të plagosur.* Mbi qiellin e Kosovës fluturonin avionë të forcës ajrore jugosllave "Mig", me qëllim të demonstrimit të forcës, si dhe frikësimin e qytetarëve të Kosovës.

¹²⁹Po aty, f. 274.

¹³⁰Venceslav Glislić, “Politički osinjak u Predsedništvu”, Fejton elektronik, http://www.novosti.rs/dodatni_sadrzaj/clanci.119.html:689674-Politicki-osinjak-u-Predsednistvu, qasja 10 shtator 2018.

¹³¹ Sabit Syla, *Shteti shqiptar ...*, f. 260.

*Në Prishtinë u vranë: Naser Hajrizi, Asllan Pireva dhe Xhelal Maliqi, në Ferizaj me 3 prill ishin vrarë Riza Matoshi dhe Sherif Frangu, në Vushtrri, Sali Zeka, Sali Abazi dhe Ruzhdi Hyseni, ndërsa në Mitrovicë ishte vrarë Sokol Bajrami. (S. Syla, *Shteti shqiptar...*, f.260)

Zhvillimet e ditëve të para të prillit 1981 në Kosovë mund të pasqyrohen nga një dokument sekret i përpiluar nga rrëfimet e njerëzve, që kishin parë personalisht ngjarjet e ditëve në fjalë. Sipas këtij dokumenti: *“Me 1.4.1981, nga ora 9:00 dëgjuam disa të shtëna armësh nga mesi i qytetit. Në orën 13:00 pamë një grup të madh studentësh që po vinin në drejtimin tonë. Ishin afër 700 vetë, por nga na tjetër e rrugës kryesore, që hyn për në Prishtinë, erdhi milicia jugosllave me një numër të madh autobлиндash. Ajo ishte e armatosur dhe hapi zjarr me armë, gaz - lotsjellës kundër studentëve. Aty në afërsi kishte punëtorë të ndërtimit të banesave, të cilët filluan të vërshellenin e të bërtisnin kundër milicisë. Në thellësi të qytetit u dëgjuan edhe demonstrues të tjerë. Kërkesat e demonstruesve ishin: " duam republikë", "të lirohen shokët", "të zhduket diferencimi i pagave". Nata e 1 prillit ka qenë gjithë demonstrata e përleshje me milicinë.”*¹³²

Po ashtu i njëjti dokument e përshkruante gjendjen në ditën vijuese, respektivisht më 2 prill të vitit 1981. *"Më 2 prill, demonstruesit vazhdonin demonstratat për kërkesat e tyre. Numri i tyre u shtua shumë, studentë, nxënës dhe punëtorë. Filloi përleshja e madhe. Demonstruesit gjuanin me gurë e shkopinj kundër milicisë, si dhe kundër dyqaneve. Një veturë e pamë duke u djegur dhe një tjetër të përmbysur. Numri i demonstruesve u rrit në rreth 30.000 vetë. Mbi qytet filluan të fluturojnë aeroplanë në një lartësi shumë të ulët dhe me zhurmë të madhe, si dhe helikopterë. Në pasditen e 2 prillit zbarkoi ushtria me tanke e autobлиндa, duke ardhur mbi 250 tanke e autobлиндa nga rruga Shkup - Prishtinë. Bashkë me to ishin edhe shumë kamionë me ushtarë, që këndonin serbisht. Ushtri me tanke e autobлиндa kanë ardhur edhe nga rruga Mitrovicë - Prishtinë.”*¹³³

Udhëheqja jugosllave shpalli gjendjen e jashtëzakonshme në Kosovë. Vendosja e gjendjes së jashtëzakonshme u shoqërua me fillimin e një fushate të gjerë arrestimesh nga policia jugosllave, në bashkëpunim me rrjetin e spiunazhit të tyre. Shumë qytetarë u arrestuan edhe ata që konsideroheshin si organizator të demonstratave. Përndjekjet policore dhe arrestimet vazhduan gjatë tërë vitit.

Tirana zyrtare po i përcillte me shqetësim ngjarjet që ndodhën gjatë demonstratave, por edhe fushatën e arrestimeve të shumta dhe dënimeve drakonike të shqiptarëve. Në gazetën: "Zëri

¹³²Arkivi Qendror Shqiptar (më tej: AQSH), Fondi: Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë (sektori i jashtëm), nr.14, Dosja, nr.28, PPSH - Komiteti i Partisë së Rrethit Durrës/nr.583, dërguar sekretarit të KQ të PPSH, shokut Simon Stefani, datë, 10.04.198, f. 1.

¹³³AQSH, Fondi: Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë (sektori i jashtëm), nr.14, Dosja, nr.28, PPSH - Komiteti e Partisë së Rrethit Durrës/nr.583, datë, 10.04.198. f. 1- 2.

i Popullit", që ishte organ i Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë u botuan një varg artikujsh që i kushtoheshin demonstratave dhe përgjithësisht çështjes së Kosovës. Në njërin nga artikujt e lartpërmendur theksohej se, Qeveria e Shqipërisë, në mënyrë miqësore dhe në kuadrin e politikës së marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë ka kërkuar nga Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë që të ndalohen: terrori, vrasjet, masakrat, torturat dhe burgimet në masë të kosovarëve nga ana e policisë serbe. Po ashtu i bëhej thirrje jugosllavëve, që të ulnin gjakrat, të ruanin gjakftohtësinë e të mos armiqësoheshin me shqiptarët.¹³⁴

Në një analizë të gjatë, udhëheqja zyrtare e Tiranës, jep shkaqet e demonstratave të shqiptarëve në Kosovë, ku fajtor e nxjerrë pushtetin jugosllav për trajtimin jo të barabartë dhe diskriminimin politik dhe ekonomik, që u kishte bërë shqiptarëve. "Udhëheqja e Tiranës i vlerësonte demonstratat e zhvilluara në Kosovë, së pari, si dështim të politikës jugosllave në Kosovë, si rrjedhojë e politikës së ndjekur ndaj territoreve shqiptare nën Jugosllavi, duke i trajtuar ato si ngastra të Serbisë, të Maqedonisë dhe të Malit të Zi. Këto ngjarje, sipas udhëheqjes shqiptare përgënjeshtroan edhe një herë me forcë shumë të madhe "suksesin" e politikës titiste për "zgjidhjen e drejtë të çështjes kombëtare" në Jugosllavi, e cila ishte bërë sipas modelit të "këshilluar" nga Çubrilloviçi, përmes demagogjisë dhe synimit për ta mbajtur nën kontroll emancipimin kombëtar të shqiptarëve. Kjo taktikë "e hollë", e projektuar prej tij, si treguan ngjarjet, dështoi. Në zbatimin të saj u përdor pa sukses një arsenal i tërë mjeteve jo humane dhe shoviniste nga shteti jugosllav dhe, në veçanti, nga ai serb kundër të gjitha vlerave kombëtare shqiptare për t'i shpallur ato si armiqësore dhe kundërrevolucionare. Së dyti, udhëheqja shqiptare vlerësonte traditën dhe vendosmërinë që ishte krijuar te shqiptarët nën Jugosllavi, gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, e cila vinte duke u konsoliduar, duke qenë zot i fateve të veta. Ajo ishte e aftë të përdorte të gjitha mjetet e luftës politike dhe shoqërore, si për të sfiduar politikën dhe demagogjinë e Jugosllavisë për realizimin e aspiratave të veta shekullore. Ajo shihej si një lëvizje, që do të vazhdonte edhe në të ardhmen, e cila do të ishte e aftë që t'i imponohej Jugosllavisë dhe do të arrinte, së paku, që ta detyronte atë të ndiqte një politikë më të drejtë ndaj çështjes shqiptare. Së treti, vlerësohej pjesëmarrja masive e shqiptarëve në demonstrata, e cila arrinte në 100 mijë vetë, të cilët u përkisnin të gjitha shtresave të popullsisë, duke vënë në pah, sidomos, moshat e reja dhe rininë shkollërore e studentore."¹³⁵

¹³⁴S. Syla, *Shteti shqiptar ...* vepër e cituar, f. 260.

Burimet shqiptare japin dëshmi të detajuara edhe për proceset gjyqësore që zhvilloheshin ndaj shqiptarëve. “*Sipas Drejtorisë IV të MPJ-së, më 14 gusht 1981, lidhur me 7 gjyqet e zhvilluara në Kosovë gjatë periudhës 22 korrik deri më 12 gusht 1981 ishin dënuar 67 vetë. Nga këta: 15 punëtorë, 13 arsimtarë, 14 studentë, 15 nxënës, 5 bujq dhe 5 të tjerë. Ndër të dënuarit, 4 janë vajza, përkatësisht 2 punëtore, 1 arsimtare dhe 1 nxënës. moshë mesatare e të dënuarave - 23 vjeç. Dënimi mesatar 7 vjet bile edhe për femrat. Në pikëpamje të shtrirjes gjeografike të dënuarit u përkasin 10 komunave. Akuza kryesore e të dënuarve është: "Veprimtari armiqësore, organizim e pjesëmarrje në demonstrata. Lista e shumë të dënuarve në gjyqet e zhvilluara jugosllave, na paraqitet me emër dhe mbiemër, komuna, profesioni, moshë dhe afati i dënimit, në të cilën janë të evidentuar emrat e 103 personave të dënuar, me gjithsej 778 vjet burg. Ndërkaq, sipas Ambasadës Shqiptare në Beograd, evidentohen emrat e 111 personave të dënuar gjatë muajit korrik dhe gusht të vitit 1981.*”¹³⁶

Kualifikimet për demonstratat e shqiptarëve ishin nga më të ndryshmet. Nga forumet më të larta krahinore, republikane e federative u cilësuan si demonstrata armiqësore e kundërrevolucionare. Në fillim, demonstrata e 11 marsit u cilësua si demonstratë me karakter social, pasi që edhe kërkesat ishin të asaj natyre. Mirëpo, nëpër forumet e tjera, gradualisht erdhi duke u ashpërsuar gjuha. Konkludimet që nxirreshin për organizimin, qëllimin dhe ecurinë e demonstratave ishin ekstreme.

Me një diskurs të ashpër dhe aspak mirëkuptues u kualifikuan demonstratat si armiqësore gjatë mbledhjes së zgjeruar të Kryesisë së KK të Lidhja Socialiste e Popullit Punonjës (më tej: LSPP) e Prishtinës, e cila i zhvilloi punimet më 28 mars 1981. Në vazhden e takimeve ishin edhe ato të nivelit republikan, që u mbajtën me 2 prill 1981. Kjo ishte mbledhje e përbashkët e Kryesisë së KQ të LK të Serbisë e të Kryesisë së RS të Serbisë. Demonstratat u dënuan si "destruktive" që, "me parullat nacionaliste e irredentiste, kanë për qëllim destabilizimin e sistemit kushtetues të bashkësisë socialiste vetëqeverisëse, minimin e "vëllazërim bashkimit" të kombeve e kombësive të Kosovës, të Serbisë e të Jugosllavisë, si dhe përmbysjen e sistemit politik. Të nesërmen, pra më 3 prill 1981, mbajtën takim të përbashkët: Kryesia e Këshillit Ekzekutiv Federativ dhe Kryesia e KQ të LKJ, prej nga dolën kualifikime të rënda për

¹³⁵Po aty, f. 257-258.

¹³⁶ Po aty, f. 260- 261.

demonstratat shqiptare, si: kundërrevolucionare, nacionaliste, irredentiste, etj.¹³⁷U shtua intensiteti i takimeve nëpër forumet udhëheqëse prej nga dilnin edhe vlerësime të ashpra për ngjarjet e fundit. Më poshtë do t'i japim deklaratat e tre udhëheqësve kryesorë të KSAK të Kosovës, të cilat u dhanë brenda disa ditësh.

Më 3 prill, para aktivitet politik të Prishtinës foli Fadil Hoxha, duke i cilësuar ngjarjet e fundit si kundërrevolucion. *"Një varg ngjarjesh që ndodhën ditëve të fundit në Prishtinë dhe në disa vende të tjera të Kosovës janë vepër e kurdisur mjeshhtërisht me karakter armiqësor. Kjo është vepër e kundërrevolucionit"*.

[...] *Ja këtu i shohim gishtat e kundërrevolucionit, që në këtë situatë të ndërlikuar e plot rreziqe të manipulojë edhe me RSFJ-në, edhe me Kosovën, madje, edhe më gjerë me qëllim që të krijohet një shqetësim i masave dhe një vatër e re për interesat e huaja. Elementet armiqësorë po tentojnë me parulla të rrejshme dhe demagogjike, në esencë me kërkesa nacionaliste dhe shoviniste të mashtrorë dhe të çojnë në rrugë të gabueshme një numër të rinjve e madje edhe disa të tjerë. Për ne nuk është i panjohur fakti se armiqët tanë me parullën: "Kosova Republikë" përherë manipulojnë, kur tentojnë ta sulmojnë sistemin tonë socialist dhe kur i vërsulën bashkësisë sonë federative. Është e qartë se këta janë parulla nga arsenali armiqësorë"*.¹³⁸Ndërkaq, në mbledhjen e Komitetit Krahinor të LK të Kosovës, që u mbajt më 7 prill 1981, Mahmut Bakalli, bëri me dije se i njohin se kush janë forcat reaksionare, që nxitën demonstrata, si nga brenda, ashtu edhe ato nga jashtë. *"Në esencë ne i njohim forcat reaksionare, të cilat i organizojnë këto demonstrata. I njohim edhe ato forca reaksionare nga jashtë, të cilat i kanë nxitur këto aksione armiqësore. Hetimet e mëtejshme dhe të gjithanshme do të ndihmojnë që t'i nxjerrim konkretisht, plotësisht dhe publikisht të gjitha këto në dritë dhe t'i demantojmë"*.¹³⁹

Disa ditë më vonë, më 13.4.1981 u prononcua edhe Azem Vllasi, anëtar i Kryesisë së LSPP të Kosovës, me ç'rast theksoi: *"Organizatorët dhe nxitësit e veprimtarisë armiqësore edhe kësaj here nxorën në shesh shumë teza dhe parulla nga arsenali dogmatik informbyroist, irredentist, antijugosllav dhe botëkuptimet e tyre ideologjike, duke dashur, në radhë të parë, të hedhin farën e urrejtjes në radhën e kombeve dhe të kombësive tona"*.¹⁴⁰

¹³⁷A. Lalaj, *Kosova - rruga e gjatë drejt vetëvendosjes 1941 -48...*, f. 386-387.

¹³⁸S. Sylja & Hamit Kaba, *Demonstratat e Kosovës në arkivin kombëtar të Londrës*, Instituti i Historisë "Ali Hadri"-Prishtinë, 2017, f. 56.

¹³⁹*Rilindja*, Prishtinë, 7 prill 1981.

¹⁴⁰*Rilindja*, Prishtinë, 14 prill 1981.

Pra, sa u tha më lart, të gjitha instancat më të larta shtetërore, unanimisht i akuzuan shqiptarët, si: nacionalistë, irredentistë, si kundërrevolucionarë, që për qëllim kishin prishjen e rendi kushtetues të Jugosllavisë. Autoritetet në Beograd filluan të ngrehin pikëpyetje për atë se, a ishte e njoftuar udhëheqja e partisë në Kosovë, për demonstratat paraprakisht, por kishte të tillë që akuzonin se segmente të caktuara të partisë dhe aparati i sigurimit janë infiltruar nga kundërrevolucionarët dhe irredentistët.¹⁴¹

Duke kërkuar kurbanin, dy pyetje filluan të ngriheshin nga autoritetet e Beogradit: Pse popullsia (jugosllave) ishte kaq keq e informuar për atë se çfarë ndodhi në Kosovë, dhe çfarë bënin anëtarët e partisë gjatë ngjarjeve? Të dyja këto pyetje kishin të bënin drejtpërdrejt me përgjegjësinë e Mahmut Bakallit* , si kreu i Lidhjes së Komunistëve të Kosovës: Si është e mundur që ne mësuam për krejt çështjen vetëm pas konferencës për shtyp të shokut Dolanci, më 6 prill?¹⁴²

Disa ditë, para fillimit të demonstratave, Bakalli vuri në pah domosdoshmërinë e shtimit të përpjekjeve për ta ngritur nivelin e jetesës së punëtorëve me të ardhura të ulëta, por edhe të kategorive të tjera shoqërore. Nga kjo deklaratë është pretenduar të nxirret edhe shkak i shpërthimit të demonstratave, gjoja se shkaqet ekonomike ishin ato, të cilat i shtynë shqiptarët në trazirat e rënda të pranverës së vitit 1981. Kështu, si shkaqe merreshin faktorët ekonomikë dhe shoqërorë dhe mënjanoheshin faktorët politikë. Por, domosdo, që faktorët janë të pleksur dhe që ekzistonte një kompleksitet i gjerë i rrethanave që nxitën trazirat. Kërkesat e artikuluar, si: "*Kushte për studentët*", "*Kushte për punëtorët*", "*Çmimeve, stop*", "*Duam punë*", "*Kosova Republikë*", "*Poshtë robëria, rroftë liria*", "*Lironi të burgosurit*", "*Kosova është jona*", "*Trepça është jona*", "*Duam vetëvendosje*", "*Të gjithë shqiptarët jemi një*", "*Jemi shqiptarë, s'jemi jugosllavë*", "*Trepça punon, Beogradi ndërton*" etj., e demantonin Bakallin dhe njëherësh dëftonin për kompleksitetin e faktorëve, që determinuan demonstratat e shqiptarëve.

Republika e Popullore e Shqipërisë, atëkohë përcillte me vëmendje ngjarjet që po zhvilloheshin në Kosovë dhe hapësirat e tjera, ku jetonin shqiptarët. Një informacion i sektorit të

¹⁴¹M. Vickers, *Midis serbëve dhe shqiptarëve...*, f. 246.

* Mahmut Bakalli, ish kryetar i Komitetit krahinor të LK së KSAK, ish anëtar i Kryesisë së KQ të LKJ (1971-1981). Dha dorëheqjen nga funksionet politike –partiake pas shpërthimit të demonstratave studentore në Kosovë në vitin 1981 dhe kontradiktave me qëndrimet e Kryesisë së KQ të LKJ për Kosovën. Si politolog u angazhua në jetën politike dhe publike brenda e jashtë Kosovës në mbështetje të çështjes së saj. Pas luftës u zgjodh deputet (2001-2004) dhe shërbeu si këshilltar politik pranë dy kryeministrave

¹⁴²Po aty, f. 246.

jashtëm të KQ të PPSH për gazetën: *"Zëri i Popullit"*, për reagimet e vendeve të ndryshme, përmendeshin faktorët, që nxitën trazirat e pranverës së vitit 1981. *"...amerikanët, anglezët dhe sidomos gjermano-perëndimorët, ashtu si në ditët e para, edhe me vonë, theksin e kanë vënë në faktin se shkaku i vërtetë i ngjarjeve, i revoltës popullore në Kosovë, është gjendja e rëndë ekonomike, disniveli i madh i zhvillimit të kësaj krahine, në krahasim me republikat dhe krahinën e Vojvodinës, kontradiktat e papajtueshme nacionale midis kombësisë shqiptare dhe asaj serbe dhe politiken diskriminuese, në përgjithësi, ndaj popullsisë shqiptare të Kosovës nga ana e udhëheqjes jugosllave qysh prej periudhës pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore."*¹⁴³

Me një qasje dualiste (pra, të gërshetimit të faktorëve politikë dhe ekonomikë) profesori universitar, A Hajrullahu e trajton arsyen e trazirave të vitit 1981. Ai vlerëson se situata e mjerueshme ekonomike, që mbretëronte në KSA të Kosovës, si dhe në kontekstin e përpjekjeve të shqiptarëve për njohjen si komb, në njërin anë, dhe në anën tjetër, të politikës represive e diskriminuese të Serbisë kundër shqiptarëve të Kosovës, që zgjati deri më 1999, caku i së cilës ishte: "eliminimi përfundimtar" i shqiptarëve, si "faktor i më i madh pengues" i idesë serbomadhe.¹⁴⁴

Edhe Jakup Krasniqi, pushtimin e gjatë të Serbisë në Kosovë dhe mosgatishmërinë e saj për zgjidhjen e problemit shqiptar e sheh si arsye të revoltës së shqiptarëve. Asnjë politikë serbe, asnjë sistem politik monarki, borgjezi a socialist, nuk patën vesh t'i dëgjojnë kërkesat e shqiptarëve e as të bëjnë përpjekje serioze për integrimin e tyre. Ata synim kishin dëbimin dhe shfarosjen e kombit tonë.¹⁴⁵ Ai më tutje përmend një aspekt, që ka ndikuar në edukimin dhe formësimin e bindjes së shqiptarëve, në veçanti, të rinisë për ta ngritur zërin e mospajtimit me gjendjen ekzistuese. Ngritja e vetëdijes kombëtare kishte ardhur si rezultat i ngritjes arsimore të shqiptarëve të Kosovës. Ky nivel i vetëdijes ishte rritur si pasojë e impaktit arsimor e kulturor që vinte nga Shqipëria. Pastaj rol të madh ka luajtur literatura historike, politike, letërsia etj. Gjithashtu, edhe media shqiptare, si ato vizuale, por edhe ato të shkruara, patën një ndikim të madh në ngritjen e kësaj vetëdijeje.¹⁴⁶

Për një mendësi të re, për një botëkuptim të ri, që ishte krijuar nga rinia studentore flet edhe, E. Çeku, i cili e parashtron kështu çështjen." [...] Kjo botë e re e këtyre njerëzve të rinj

¹⁴³AQSH, Fondi: KQ i PPSH (sektori i jashtëm), nr.14, Dosja, nr.28. Informacion - Mbi reagimin në vendet të ndryshme për artikullin e "Zërit të Popullit", botuar me 8 prill 1981, f. 6.

¹⁴⁴A. Hajrullahu, *vepër e cituar*, fq.65.

¹⁴⁵Jakup Krasniqi, *"Shtypi shqiptar për zhvillimet në Kosovë 1981-1991"*, Tezë Doktorate, Prishtinë 2008, f. 27.

¹⁴⁶Po aty, f. 27.

dëshironin të jetonin të lirë e të barabartë, dëshironin të bëheshin pjesë e zhvillimit dhe të progresit, që kishte kapluar dhe kishte arritur në një shkallë të lartë zhvillimi të të gjitha vendet e Evropës".¹⁴⁷

Shqiptarët e Kosovës kishin arsye që të ngriheshin kundër pushtetit komunist të asaj kohe. Kishte një mori arsyes, që e determinuan pranverën shqiptare të viti 1981. Rinia shqiptare ishte koshiente me gjendjen që mbretëronte në Kosovë. Ishte e vetëdijshme për eksploatimin galopant që i bëhej resurseve të Kosovës, ndërkaq shqiptarët vazhdonin të jetonin nën çdo mesatare, në krahasim me vendet e tjera të ish - Jugosllavisë. Krahas diskriminimit ekonomik, shqiptarët e Kosovës shtypeshin e persekutoheshin edhe në aspektin politik. Proklamimi i vazhdueshëm për barazinë e popujve në Jugosllavi, për shqiptarët nuk vlente. Rinia shqiptare e jetonte çdo ditë këtë pabarazi. Kjo ndikoi në akumulimin e gjithë këtij mllef, i cili në pranverën e vitit 1981 do shpërthejë si një uragan. Bartës i kësaj lëvizjeje, do të bëhet rinia shqiptare, gjegjësisht studentët e Universitetit të Prishtinës.

Pranvera shqiptare e vitit 1981, arriti ta sensibilizojë dhe ta ndërkombëtarizojë problemin e Kosovës që kërkonte zgjidhje. Ndikimi i kësaj lëvizjeje pranverore bëri që faktori ndërkombëtar ta kuptojë gjendjen politike e socio – ekonomike, që mbretëronte në Kosovë.¹⁴⁸ Demonstrata e vitit 1981, mbetet një lëvizje autentike e rinisë studentore, por që u shndërrua në një përpjekje popullore çlirimtare, me një masivitet të madh dhe me një program të qartë për lirinë e Kosovës. Këto ngjarje të mëdha dhe efektive vunë në lëvizje, jo vetëm botën shqiptare, por "shkundën" edhe bashkësinë ndërkombëtare. Çështja e Kosovës, "shteteve të botës do t'u trokas në ndërgjegje, si një vonesë historike", ndërkaq themelet e Jugosllavisë po lëkundeshin për herë të parë që nga krijimi i saj.¹⁴⁹

¹⁴⁷ E. Çeku, *vepër e cituar*, fq. 228.

¹⁴⁸ Eqrem Zenelaj, *Shtypi i Austrisë për demonstratat e shqiptarëve të Kosovës më 1968, 1981 dhe 1989*, Faik Konica, Prishtinë, f. 132.

¹⁴⁹ M. Hajrizi, *Histori e një organizate politike....*, f. 227.

2.3. Fillimi i diferencimeve ideopolitike në Kosovë dhe forcimi i nacionalizmit serb

Instancat më të larta të pushtetit jugosllav kishin përgatitur dhe kishin filluar së zbatuari një varg masash për të persekutuar e dënuar demonstratat e vitit 1981. Kjo udhëheqje e gjeti një metodë të re, të cilën e emërtoi si: "diferencim ideopolitik", e që ishte presion për t'i detyruar shqiptarët ta denoncojnë njëri - tjetrin. Kjo metodë e luftës së shqiptarit kundër shqiptarit, e lansuar përmes zuzarëve të UDB-së, fillimisht, u aplikua në Universitetin e Prishtinës, për ta zgjeruar më pastaj rrjetin e saj edhe nëpër të gjitha institucionet shoqërore, deri në bashkësi lokale dhe në familje. Ekzekutor i kryesor i kësaj politike të vjetër me metoda të reja u bë: Lidhja Komuniste e Jugosllavisë, aktivi i saj politik tok me shqiptarët lojalë të pushtetit.¹⁵⁰

Diferencimet prekën të gjitha grupet shoqërore, që konsideroheshin se i kishin përkrahur demonstratat në një formë ose tjetër, duke filluar nga politikanët, të cilët i takonin linjës së "butë", karshi demonstratave dhe që përpiqeshin për një fuqizim dhe avancim të mëtutjeshëm të autonomitetit të Kosovës. Fushata e diferencimeve ideologjike e politike do të zgjasë vite me radhë, ku do të përfshiheshin një numër i madh shqiptarësh, nga të gjitha grupet shoqërore, si: politikanë, intelektualë, profesorë e studiues eminent të Kosovës, pastaj studentë etj. Armiku imagjinar u kërkua kudo midis anëtarëve të organizatave të LKJ, të rinisë, të LSPP e të luftëtarëve, punëtorëve të ndërmarrjeve ekonomike e fshatarëve, studentëve e pedagogëve të universitetit e të shkollave të tjera të larta, midis arsimtarëve e nxënësve të shkollave të mesme e filllore të qyteteve e të fshatrave.¹⁵¹

Udhëheqja jugosllave, "diferencimin ideo - politik" parashihte që ta realizonte në dy faza. Fillimisht, nga mbledhjet e shumta, që organizoheshin, tentonin të evidentonin publikisht pjesëmarrësit dhe përkrahësit e demonstratave, si dhe organizatorët e tyre. Ndërkaq në fazën e dytë, që do pasonte, parashihej të bëhej diferencimi politik në një proces afatgjatë.¹⁵²

Goditje e madhe iu bë Universitetit të Prishtinës, që konsiderohej si: "*Çerdhe e nacionalizmit*", pasi, aty edhe kishin filluar demonstratat. Gazeta austriake: "*Kleine Zeitung*", e 9 prillit 1981, duke folur për diferencimet, me theks të veçantë për profesoratin e universitetit,

¹⁵⁰ Dario Malnar, *SHBA-ja dhe Kosova*, Koha, Prishtinë, 2013, f. 70.

¹⁵¹ Lefter Nasi, *Aspekte të shtypjes kombëtare e politike të shqiptarëve në Kosovë (1981 - 1986)*, Tiranë 2011, f. 94 - 95

¹⁵² Po aty, f. 92.

shkruan se tani në Kosovë nga Jugosllavia po bëhet heqja (diferencimi) e kokave (d.m.th intelektualëve). “Janë bërë spastrime të mëdha politike. Një spastrim i tillë u zbatua, sidomos, në Universitetin e Prishtinës, me anë të "procesit të diferencimit", nga i cili vend edhe kishin filluar demonstratat e para studentore”.¹⁵³

Një numër i profesorëve u përjashtuan nga puna. Nën akuza fiktive, si ato të nacionalizmit e irredentizmit u dërguan në izolim. Me një fjalë u shpall luftë e hapur ndaj ndërgjegjes kombëtare shqiptare.¹⁵⁴ Kësaj kampanje të diferencimeve nuk i shpëtuan as studentët, të cilët u përjashtuan nga Universiteti. U burgosën me dënime të rënda deri në 15 vjet burg. Njëri nga protagonistët kryesorë të establishmentit politik të asaj kohe në KSA të Kosovës, Azem Vllasi, më 12 mars do të deklaroj: [...] *nuk mund të flitet për një masë të mashtruar, por kemi të*

*bëjmë me një kundërrevolucion, që i ka shtrirë rrënjët thellë. Prandaj, thellimi i diferencimit ideo-politik në të gjitha sferat e jetës në Kosovë është si parakusht për normalizimin e gjendjes.*¹⁵⁵

Udhëheqësit politikë shqiptarë u goditën të parët. U shkarkuan nga pozitat e larta shtetërore ato kuadro, të cilat akuzoheshin se nuk kishin përfillur rritjen e nacionalizmit dhe indoktrinimin e shqiptarëve me nacionalizëm. U mënjantuan ata që kishin si qëllim fuqizimin e autonomisë së Kosovës. Kishte edhe personalitete që tani konsideroheshin se ishin të shpenzuar dhe nuk ishin të dobishëm për pushtetin serb. U shkarkuan ose u detyruan të japin dorëheqje, duke filluar nga majat më larta të pushtetit, si: kryetari i KK të Kosovës, Mahmut Bakalli; kryetari i Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të Kosovës, B. Oruçi; zëvendëskryetari i Këshillit Ekzekutiv të KSA të Kosovës, Pajazit Nushi; sekretari krahinor për Arsim, Kulturë e Shkencë, Ymer Jaka etj.¹⁵⁶ Fushata e diferencimeve i preku edhe institucionet e tjera, sikur që ishte shkarkimi i drejtorit të Televizionit e të Radio Prishtinës, kryeredaktorët përkatës, po ashtu edhe drejtori i Shtëpisë Botuese "Rilindja", si dhe kryeredaktori i kësaj gazete.¹⁵⁷

¹⁵³ E. Zenelaj, *Shtypi i Austrisë për demonstratat...*, f. 110.

¹⁵⁴ Akademia e Shkencave të Shqipërisë - Qendra e Enciklopedisë Shqiptare, *KOSOVA në vështrim enciklopedik*, Toena, Tiranë 1999, fq.126.

¹⁵⁵ Isak Sherifi, *Zhvillimet politiko-diplomatike në ish-Jugosllavi me theks të veçantë Kosova dhe Maqedonia 1981-2008*, Tezë doktrate, Tiranë 2013, f. 20

¹⁵⁶ A. Lalaj, *Kosova - rruga e gjatë drejt vetëvendosjes 1941 -48...*, f. 393.

¹⁵⁷ L. Nasi, *Aspekte të shtypjes kombëtare...*, f. 98.

Fushata e diferencimeve ideopolitike kishte vazhduar vite me radhë dhe synonte të sulmonte çdo gjë shqiptare, në radhë të parë, të arriturat politike, kulturore e arsimore të shqiptarëve të Kosovës dhe figurave politike, që kishin ndikuar në këto arritje. Pra, konkretisht ishte fjala për Fadil Hoxhën, ndaj të cilit qarqet nacionaliste serbe, në shtator 1987, do ta fillonin një fushatë të egër e denigruese, duke keqpërdorur në deklaratë të tij dhënë kohë më parë, që lidhej me çështjet gjinore në Kosovë.¹⁵⁸

Rreth përjashtimit të Fadil Hoxhës, flet Remzi Kolgeci, në një intervistë të dhënë për "Zërin e Rinisë", me ç'rast thekson: *"Sa i përket Fadil Hoxhës, ne si kryesi e partisë nuk kemi pasur kurrfarë bisede për përjashtimin e tij nga partia. Zatën, vendimin për këtë e mori grupi punues në kuadër të KQ të LKJ, në krye me Millan Pançevskin. Prej neve në grupin punues ka qenë, Ekrem Arifi, i cili me sa di unë, ka qenë kundër përjashtimit të Fadil Hoxhës nga partia. Në KQ, atëherë, nga Kosova ishin përveç, Azemit, edhe: Rrahman Morina, Dolasheviqi, Kolë Shiroka, Ali Shukriu, Sanije Veseli, etj. Asnjëri nga këta nuk reagoi në mbrojtje të Fadil Hoxhës, e dihet fare mirë se nuk ka qenë vështirë të mbrohet ky, kur dihet se çfarë kontributi ka dhënë në LNÇ e më pastaj. Për mua personalisht, çështja lidhej me atë proverbin popullor: që prej kopësë së dhenve kur hiqet dashi, shumë lehtë është të asgjësohen qengjat."*¹⁵⁹

Si duket me degradimin e Fadil Hoxhës tentohej të rrënohej gjithë ajo çfarë ishte arritur deri tash – pra, autonomia e Kosovës, pasi që dihej se ishte Fadili dhe garnitura e tij, që i shtynë proceset autonomiste në Kosovë gjatë periudhës së Titos. Qarqet nacionaliste serbe nuk e kishin harruar as rolin e Fadilit në Konferencën e Bujanit, ku ishte kërkuar vetëvendosja për Kosovën. Pra, ata tentonin të fshinin çdo gjë nga faqja historike lidhur me tendencat shtetndërtuese shqiptare, e me këtë të hidhnin hapin e parë drejt synimeve për anulimin e autonomisë së Kosovës.

Përqendrimi më i madh i diferencimeve ishte tek Universiteti i Prishtinës, sepse aty konsiderohej se ishte çerdhja e nacionalizmit shqiptar. Edhe Kolishevski, në mbledhjen e KQ të Lidhjes Komuniste të Beogradit, që u mbajt më 5 prill, i drejtoi shtizat e shumta kundër sistemit arsimor (veçmas atij universitar), që ishte ngarkuar me fajësinë e "frymëzuesit të irredentizmit shqiptar".¹⁶⁰

¹⁵⁸ *Rilindja*, Prishtinë, 17 tetor 1987, f. 8.

¹⁵⁹ *Zëri i Rinisë*, nr. 1341, 12-19 maj 1990, Intervistë me Remzi Kolgecin, anëtar i Kryesisë së KK LKK, f. 27.

¹⁶⁰ J. Buxhovi, *Kosova nga Konferenca e Londrës e deri të protektorati ndërkombëtar...*, f. 393.

E kuptueshme është se pse u atakua Universiteti i Prishtinës dhe në përgjithësi arsimit shqip, sepse donin ta ndalnin zhvillimin e mëtutjeshëm të shkollës shqipe. Dëshironin ta pengonin zhvillimin e kulturës kombëtare, e cila kishte marrë hovë në vitet e fundit. Nën petkun e diferencimeve ideologjike e politike, në Universitetin e Prishtinës u formua Grupi punues*, i cili në bashkëpunim me OTH të LK* do të merret me shqyrtimin e rasteve dhe përcaktimin e masave për profesorët e ndryshëm nëpër njësi akademike. Diferencimet ishin sistematike dhe prekën çdo nivel të shoqërisë sonë. Ato filluan me shkarkimin e rektorit të Universitetit të Prishtinës - akademikut Gazmend Zajmit dhe prorektorëve. Në gazetën ditore të asaj kohe, “Rilindjes”, pasqyroheshin në detaje masat për një mori profesorësh, punonjësish shkencorë, punëtorë të administratës, studentë e të tjerë. Ja një përmbledhje e një varg masash të ndryshme, që u morën ndaj personelit të Universitetit të Prishtinës: *“Në mbledhjen parmbledhëse u propozua të merren masa partiake deri përjashtim ndaj këtyre profesorëve: Hamdi Gashit, dr. Riza Binishit, mr. Murat Blakajt, dr. Ali Hadrit, dr. Ali Aliu, mr. Agim Vincës, dr. Rexhep Ismajlit, dr. Fehmi Aganit, dr. Rexhep Qosjes, dr. Millorad Qoracit, mr. Idriz Beranit, dr. Hivzi Islamit, dr. Mustaf Bacajt, si dhe ndaj disa udhëheqësve të organizatave të LK e të organeve vetëqeverisëse. Nga procesi mësimor propozohet të largohet, dr. Ali Hadri, ndërsa rekomandohet shqyrtimi i përshtatshmërisë së dr. Mark Krasniqit për punë të mëtejshme në fakultet, pastaj të dr. Mujë Rugovës, të dr. Nexhat Dacit, si dhe të dr. Rashit Alidemës, ndërkaq në Akademinë e Arteve propozohet të shkarkohet sekretari i saj”*.¹⁶¹

Për shkak të lëshimeve dhe qëndrimeve të tyre të papranueshme nga procesi mësimor janë larguar ose do të largohen: Ymer Jaka, profesor në Fakultetin Filozofik, Nexhmi Rexhepi, lektor i gjuhës angleze në Fakultetin Filozofik, Ali Hadri, profesor në Fakultetin Filozofik dhe Rashit Alidema, profesor në fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore.

Për shkak të veprimtarisë së hapët armiqësore dhe të përkrahjes së demonstratave dhe përpjekjeve kundërrevolucionare, nga radha e arsimtarëve dhe e bashkëpunëtorëve të Universitetit janë dënuar nga gjykata kompetente këta persona: Ukshin Hoti, mësimdhënës në Fakultetin Filozofik, Muhamet Tërnavë, mësimdhënës në Fakultetin Filozofik, Shaqir Shaqiri, mësimdhënës në Fakultetin Filozofik, Shemsi Reçica, asistent në Fakultetin Filozofik, Ruzhdi

*Ggrupi punues përbëhej nga: Azem Vllasi, Dervish Rozhaja, Hajredin Hoxha, Ragip Halili, Rexhep Gashi, Minir Dushi, Syrja Pupovci, Millan Sheshlia, Budislav Sheshlia, "Rilindja", 19.IX.1982, Prishtinë

*Organizata themelore të Lidhjes Komuniste

¹⁶¹Rilindja, Prishtinë, 19 shtator 1982, f. 3.

Sefa, asistent në Fakultetin Teknik dhe Halil Alidemaj, referent në Fakultetin Filozofik. Të gjithë këta persona qysh herët janë përjashtuar nga Lidhja Komuniste.¹⁶²

Masat diferencuese u shtrinë edhe te studentet, duke përjashtuar - mohuar regjistrimin, pastaj largim nga konviktet e masa të tjera. Për shkak të papërshtatshmërisë moralo -politike dhe qëndrimeve jo të drejta, në fakultete e shkolla të larta nuk janë regjistruar 157 kandidatë të paraqitur për regjistrim. Për të njëjtat arsye nuk u është dhënë leja për strehim në konvikte 113 studentëve, ndërsa pas përcjelljes së sjelljes së studentëve të strehuar në konvikte, që u bë gjatë pushimeve të vjetme dimërore, nga konvikti u përjashtuan 64 studentë.

Për arsye të sjelljeve jo të mira dhe pjesëmarrjes në aktivitete armiqësore janë ndërmarrë edhe këto masa administrative: janë përjashtuar pa të drejtë regjistrimi deri në 5 vjet - 38 studentë; janë përjashtuar pa të drejtë regjistrimi deri në një vit 78 studentë; u është shqiptuar vërejtja me shkrim 82 studentëve, ndërsa janë qortuar 34 studentë. Duhet theksuar se LRS nëpër fakultete është duke shqyrtuar edhe sjelljet e një numri të caktuar të studentëve, ndaj të cilëve do të merren masa konkrete, varësisht prej përgjegjësisë së tyre.¹⁶³

Diferencimet ideopolitike nuk u kufizuan vetëm në KSA të Kosovës. Gjatë kësaj periudhe ato u shtrinë edhe në Maqedoni, në Mal të Zi e në Serbi, me një fjalë, gjithandej, ku jetonin shqiptarët. Në një informacion të Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Beograd për KQ të PPSH bëhej me dije se ngjarjet në Maqedoni zhvilloheshin nën ndikimin e ngjarjeve në Kosovë. Aty flitej për gjendjen e rëndë, por sugjerohej edhe për marrjen e masave nga shteti shqiptar. Ja çka thuhej në atë dokument: *"Përkundrazi në Maqedoni dhe në Mal të Zi, por veçanërisht në të parën shikojmë sot të zhvillohet një situatë, që pritej, nën influencën e ngjarjeve në Kosovë, në të dy drejtimet: të rritjes së luftës së shqiptarëve për të drejta kombëtare dhe të masave të shovinistëve maqedonas, për të përfituar nga rryma për të shtypur shqiptarët, duke marrë masa asimiluese kundër popullsisë shqiptare në fushën e arsimit dhe të të drejtave kulturore etj. Problemi në Maqedoni është delikat, por në një situatë të tillë edhe ne duhet të veprojmë, të bëjmë diçka, pa shkuar larg, duke botuar ndonjë "intervistë" në gazetën tonë "mësuese" etj.*¹⁶⁴

¹⁶²Rilindja, Prishtinë, 9 shtator 1982, f.1

¹⁶³Rilindja, Prishtinë, 9 shtator 1982, f.1

¹⁶⁴AQSH, Informacion nga Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Beograd për KQ të PPSH (sektorit të jashtëm), nr.115/1, Beograd, 16.07.1981, fq.4

Gjurmimi i "organizatorëve" vazhdoi me intensitet të shtuar nëpër qytete e fshatra të Maqedonisë. Vetëm në qytetin e Dibrës, organet e rendit "zbuluan" se në demonstratat e Kosovës kishin marrë pjesë 30 studentë dhe kundër tyre u morën masa përkatëse. Po kështu, pas ngjarjeve në Kosovë nga shkolla e mesme në Strugë u përjashtuan 20 nxënës dhe 5 profesorë, ndërsa nga shkolla fillore - 2 arsimtarë. Gjykatat dënuan 20 vetë me burgim, pesë studentë u dënuan deri në 5 vjet burgim.¹⁶⁵

Një skanim i plot iu bë planprogrameve mësimore, por edhe teksteve që përdorshin nëpër shkolla. Këshilli Pedagogjik Republikan ndaloi përdorimin e atyre teksteve, që ishin përdorur deri në atë kohë, si dhe një rishikim të planprogrameve të letërsisë e të historisë nga cikli fillor deri në atë universitar. Po ashtu, në RS të Maqedonisë u ndalua përdorimi i teksteve të botuara në KSA të Kosovës. Ato u trajtuan si vepra të papërshtatshme nga pikëpamja.¹⁶⁶

Ky akt ishte pasqyrim i qartë i tendencave antishqiptare të pushtetit maqedonas, që përfitoi nga rasti për t'i hequr qafe tekstet shqiptare, e me këtë edhe ta parandalonin emancipimin arsimor e kulturor të popullsisë shqiptare, që jetonte në Republikën e Maqedonisë.

Përveç të tjerash, dhuna sistematike e policisë vazhdoi edhe nëpër qytetet e tjera të Maqedonisë. Komunën e Kërçovës u bë cak i organeve e hetuesisë, të cilat arrestuan 11 punonjës të arsimit, 5 prej të cilëve i përjashtuan nga Lidhja Komuniste. Disa prej profesorëve morën kritika të ashpra dhe vazhdimisht ishin të përcjellë nga "spiunë", sepse kishin heshtur lidhur me dënimin e ngjarjeve në Kosovë. Po ashtu, edhe fshati Shipkovicë i Tetovës, që konsiderohej si një nga vatrat më aktive pjesëmarrëse në demonstratat e Kosovës, organet maqedonase të pushtetit bënë hetime të vazhdueshme dhe persekutime ndaj popullatës. Në këtë fushatë nuk mbeti pa u përfshirë asnjë fshat e qytet shqiptar në Maqedoni.¹⁶⁷

Persekutimi ndaj shqiptarëve vazhdoi, jo vetëm në Kosovë e Maqedoni, por edhe në vendet e tjera të banuara me shqiptarë, siç ishte rasti me vendet e Kosovës Lindore. Gjykata e Vrajës ishte bërë vendi, ku shqiptoheshin dënime të rënda kundër shqiptarëve të rajoneve të Preshevës, të Bujanovcit dhe të Tërnovcit. Në mars të vitit 1982, aty u ngrit padia kundër 11 personave (prej të cilëve 9 ishin nxënës të shkollës së mesme "Skënderbeu" të Preshevës dhe një shok i tyre 21 - vjeçar). Ata u dënuan me burgime të rënda nën akuzën se kishin qenë anëtarë të grupit ilegal "Bajram Curri". Në maj të atij viti, gjykata e Vrajës dënoi 4 studentë dhe nxënës

¹⁶⁵ S. K. Basha, *Të burgosurit politikë shqiptarë në Kosovë 1945-1990*, Logos-A, 2009, f. 96-97.

¹⁶⁶ L. Nasi, *Aspekte të shtypjes kombëtare...*, f. 122.

¹⁶⁷ S. K. Basha, *Të burgosurit politikë...*, f. 97.

nga Presheva dhe Bujanovci, nën akuzën se ishin anëtarë të organizatës ilegale: "Zëri i Kosovës". Po ajo gjykatë, në qershor të vitit 1983 dënoi edhe 7 shqiptar të tjerë - të gjithë nga Bujanovci. Midis tyre 2 ishin arsimtarë, 2 punëtorë, 1 student, 1 nxënës dhe 1 i papunë.¹⁶⁸

Krahas dhunës dhe terrorit që ushtronin organet policore, pushteti serb ndoqi edhe linjën e likuidimeve fizike të figurave të shquara të Lëvizjes kombëtare. Për realizimin e këtyre detyrave, rolin kryesor e luajtën organet e UDB - së, e cila përdorte metodën e njohur që këto vrasje të organizuara jashtë Jugosllavisë, u munduan t'i paraqesin si "larje të hesapeve midis elementeve e grupeve të ndryshme reaksionare", siç ishte rasti i likuidimit fizik të Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe të Kadri Zekës. Vrasje e organizuar nga UDB - ja, që ndodhi më 17 janar të vitit 1982 në Untergruppenbah pranë Shtutgardit.¹⁶⁹

Megjithëse qëllimi i diferencimeve ideopolitike ishte për t'i zbuluar organizatorët, pjesëmarrësit e përkrahësit e demonstratave të vitit 1981, kishin edhe një qëllim tjetër latent, që duke spiunuar njëri - tjetrin të fusnin përçarje ndërmjet shqiptarëve. Mirëpo, në të shumtën e rasteve, ky proces dështoi, sepse po haste në qëndresën e vendosur të popullit shqiptar dhe në sabotim nga ana e tyre. Prandaj, organet federative dhe ato republikane ushtronin presion tek ato krahinore, që procesi i diferencimeve të vazhdonte edhe më tutje dhe më me vendosmëri.¹⁷⁰

KREU I TRETË

RISHFAQJA E NACIONALIZMIT TË HESHTUR SERB (1981-1989)

3.1 Fillimet e mobilizimit të serbëve në Kosovë dhe përshkallëzimi i nacionalizmit

Pas demonstratave shqiptare të marsit të vitit 1981, zjarri që përfshiu një aneks të kompleksit të Patrikanës Serbe në Pejë, në natën e 15 marsit 1981, ngriti edhe më shumë tensionet në Beograd. Ndonëse, objekti gjendej larg nga Patrikana dhe nuk kishte ndonjë vlerë arkitektonike. Opinioni publik në Serbi këtë ngjarje e cilësoi si një akt të "irredentistëve"

¹⁶⁸ L. Nasi, *Aspekte të shtypjes kombëtare...*, f. 101.

¹⁶⁹ Po aty, f. 86.

¹⁷⁰ Po aty, f. 83.

shqiptarë, edhe pse të gjeturat e hetuesisë vërtetimin se zjarri ishte shkaktuar nga instalimi i rrymës elektrike.¹⁷¹

Këto dy ngjarje të cekura më lart shënojnë fillimin e mobilizimit të hapur të nacionalizmit serb, i cili gjatë gjithë dekadës së shtatë të shekullit XX, në një formë latente i kishte rezistuar udhëheqjes federative dhe asaj republikane, sidomos kur çështjet kishin të bënin me Kosovën. Në të vërtetë, këto ngjarje aktivizuan ripërtëritjen e politikës së identitetit e bazuar në riciklimin e mitit mbi Kosovën, që kishte filluar në Serbi, menjëherë pas vdekjes së Titos (1980). Fillimisht, kishte qenë vetëm projekt i nacionalistëve mbi kulturën dhe Kishën Ortodokse Serbe, i cili tërhoqi një pjesë të shquar të opozitës joformale ndaj regjimit komunist.¹⁷²

Shenjat e para të mobilizimit të nacionalizmit serb shfaqen, së pari, te qarqet kulturore e letrare të Serbisë. Nëse sipas akademikut të njohur serb, Millorad Ekmexhiq, se në fillim të shekullit XIX selia e lëvizjes kombëtare çeke kishte qenë një kafene në qytetin e Pragës, atëherë në rastin e Serbisë, një seli e tillë do të ishte me siguri Lidhja e Shkrimtarëve, në rrugën “Francuska 7”. Gjatë vitit 1980, përmes timit të duhanit dhe avujve të rakisë, para syve të mendjes së tyre paraqitej - Serbia e Madhe. Në tavanin e kësaj selie u përpunuan plane të shumta për arritjen e një aspirote të tillë.¹⁷³

Pakënaqësia e tyre me pozitën juridike të Serbisë dhe çështjeve të tjera të karakterit nacional, që ishin akumuluar, kryesisht, gjatë vitit 1970, gjetën shprehje në rrethanat e reja që ishin krijuar pas vdekjes së Titos. Kështu që, ende pa u bërë një vit nga vdekja e Titos, pra, më 1981, shkrimtari, Gojko Gjogo shkroi një përmbledhje poezish me titull: “*Kohë të leshta*”, e cila për shkak të përmbajtjes fyese ndaj revolucionit socialist dhe figurës së Titos ishte tërhequr nga botimi e më pas edhe është asgjësuar.¹⁷⁴

Letrarët u pasuan nga akademikët. Po të njëjtën periudhë, akademiku, Dobrica Qosiqi dhe grupimi rreth tij dalin me projektin e revistës: “Javnost”, e cila duhej të shërbente për formulimin e një platforme të re politike, me synimin e arritjes në pushtet. Redaksia e kësaj revista përbëhej nga njerëz eminentë të shkencës serbe, të njohur për nacionalizmin dhe kundërvënien ndaj sistemit komunist në rastin e ndryshimeve kushtetuese të viteve 1968-1974, sikurse: Ljuba

¹⁷¹M. Vickers, *Midis serbëve dhe shqiptarëve...*, f. 242-243; Атанасије Јевтић, *Страдања Срба на Косову и Метохији од 1941. до 1990. Године*, Интернет издање "Јединство" - Приштина 1990.

¹⁷²Ivan Čolović, Tako je govorio Milošević, publikuar më 27.06.2012, <https://pecanik.net/tako-je-govorilo-milosevic/>, qasja 20 shtator 2018.

¹⁷³ Millorad Tomaniq, *Kisha serbe në luftë dhe luftërat brenda saj*, Camaj-Pipa, Shkodër, 2006, f. 14.

¹⁷⁴ Po aty, f. 14-15.

Tadiqi (redaktor kryesor), Dobrica Qosiq, Dushan Boshkoviç (filozof), Nebojsa Popov, Zoran Gjingjiç, etj., por që nuk doli kurrë në publik për shkak të ndalesës.¹⁷⁵

Përveç Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Serbisë, edhe Kisha Ortodokse Serbe, me vdekjen e Titos pa fundin e një epoke dhe fillimin e një epoke të re, ku ajo duhej të zinte vendin e vet në shoqëri e të rimerrte “rolin që i kishin rrëmbyer padrejtësisht e me dhunë”. Gjatë viteve të 80-ta me aktivitetet e tyre u dalluan në mënyrë të veçantë tre teologë, murgj të rinj, por me reputacion, profesorë të Fakultetit Teologjik, të cilët i quanin justinianë*. Këta ishin: Amfilofije Radoviç, Irinej Bullatoviç dhe Atanasije Jeftiç, të cilët, në saje të qëndrimit të tyre të hapur antikomunist e nationalist, si dhe aktivitetit të tyre të jashtëzakonshëm në fushën e shkrimeve, në janar të vitit 1985 u pranuan në Shoqatën e Shkrimtarëve të Serbisë.¹⁷⁶

Ky ishte një rast unik në skenën shkencore jugosllave, kur teologët bëhen pjesë e një shoqate të shkrimtarëve. Por, sigurisht që një veprim i tillë konsistonte në pajtimin e mendimeve për çështjet me interes nacional dhe vënies në shërbim apo bashkëveprimet të koordinuar, në arritjen e synimeve të përbashkëta të karakterit nationalist.

Në këtë mënyrë, godina në rrugën “Francuska 7” u shndërrua në një adresë, ku u ndodhën së bashku aktorët kryesorë të ndodhivë përgjatë viteve të 80-ta. Ishte kjo, pra, ajo lulja serbe me tre fletë (LSHS-ASSHA-KOS), era dehëse e së cilës shumë serbëve do t’ua merrte mendjen.¹⁷⁷

Për t’i shprehur lirshëm mendimet e tyre nacionaliste, këto forca duhej, fillimisht, të ballafaqoheshin me barrierën e kufizimit të lirisë së shprehjes, që ishte instaluar nga regjimi komunist jugosllav. Kështu, filluan protestat e reagimet kundër politikës komuniste ndaj shkrimtarëve e disidentëve politikë. Universiteti i Beogradit (në veçanti Fakulteti Juridik dhe Filozofik), Akademia Serbe e Shkencave dhe e Arteve, institutet e shkencave shoqërore, klubet dhe shoqatat e shkrimtarëve, etj., u shndërruan në epiqendra të mendimit të lirë dhe të rezistencës. Në publik gjithnjë e më tepër theksohej kërkesa për rehabilitimin e të dënuarve politikë.¹⁷⁸ Si rezultat i gjithë këtyre përpjekjeve u formua edhe Këshilli për mbrojtjen e

¹⁷⁵S. Biserko, *Kovanje Antijugoslovenske zavere...*, f. 106.

* Quheshin justinianë sepse ishin nxënës të teologut serb Justin Popoviç, të cilin e patën dëbuar nga Universiteti i Beogradit dhe e patën dërguar në manastirin Qelija afër Valevës, ku u mbajt në një lloj gjysmë internimi, shih: M. Tomaniç, *Kisha serbe në luftë dhe luftërat...*, f. 16.

¹⁷⁶Po aty, f. 16.

¹⁷⁷Po aty, f. 16.

¹⁷⁸Srdan Cvetković, “Traže ujedinjenje albanskih zemalja”, Fejton elektronik,

mendimit dhe shprehjes së lirë, i cili përbëhej nga 23 intelektualë, 12 prej të cilëve ishin akademikë. Kjo solli edhe ndryshimin e Kodit penal, respektivisht, heqjen e nenit 133 që sanksiononte konfliktin verbal.¹⁷⁹

Heqja e këtij neni, ndonëse, promovonte lirinë e shprehjes së të menduarit, në fakt vetëm sa e lehtësoi shprehjen e tendencave nacionaliste serbe. Qarqe të ndryshme shkencore, akademike e gazetareske filluan me publikimin e shkrimeve, që kishin për qëllim ringjalljen serbe, e cila më vonë do të shoqërohet edhe nga propaganda antishqiptare. “*Libri mbi Millutinin*” (Knjiga od Millutina) i Danko Popoviqit, që pasqyrore gjendjen e vështirë të fshatarësisë serbe, në pjesën e parë të shekullit dhe nënkuptimi për braktisjen e “Iluzioneve jugosllave”, mund të cilësohen si deklarata të fuqishme drejt një izolimi të ri serb. Në disa novela, që ia përkushtoi Luftës së Dytë Botërore në vendlindjen e tij - në Hercegovinë, Vuk Drashkoviç (më vonë njëri nga liderët kryesorë opozitarë) shtjelloi trashëgiminë tragjike të gjenocidit kundër serbëve nga Shteti i Pavarur Kroat. Përfundimisht, “Greshnik” dhe “Otpadnik”, vepra të Dobrica Qosiqit, politikisht më ndikues nga këta tre autorë, talleshin me iluzionet internacionaliste të komunistëve serbë të para luftës, të cilët duke u bazuar në udhëzimet e Kominternit, ndihmuan në fakt instalimin e një regjimi “kundër serb” në Jugosllavinë e pas luftës.¹⁸⁰

Këto ishin paralajmërime të qarta për konceptin, që ndiqnin këto forca, që bazoheshin në të drejtën historike të një shteti të serbëve, derisa Jugosllavia shihej si një gabim strategjik i serbëve.

Për ndryshim nga mobilizimi i nacionalizmit serb në Serbi, mobilizimi i serbëve të Kosovës u zhvillua, kryesisht, si reaksion ndaj ndryshimeve në kontekstin politik dhe në kuadër të ambientit politik, që nuk ishte plotësisht i pafavorshëm për veprime nga grupet lokale të këtij komuniteti.¹⁸¹

Serbët e Kosovës, kryesisht, u mobilizuan përmes organizatave: “*Otpor*” (Rezistenca) dhe “*Bozhur*”.¹⁸² Këto dy emërtime nuk janë të rastësishme, derisa e para pretendon rezistencën

http://www.novosti.rs/dodatni_sadrzaj/clanci.119.html:652457-Traze-ujedinjenje-albanskih-zemalja, qasja 20 gusht 2018.

¹⁷⁹ S. Biserko, “Srpska elita i realizacija srpskog nacionalnog programa...”, f. 105-106.

¹⁸⁰ V. Vujacic, “Serbian nationalism, Slobodan Milosevic and...”, f. 4, <http://studylib.net/doc/8550754/serbian-nationalism--slobodan-milosevic-and-the-origins-o...>

¹⁸¹ Momčilo Pavlović, “Kosovo under autonomy 1974-1990”, *Research Team 1*, <https://www.cla.purdue.edu/si/Team1Reporte.pdf>, f. 31.

*Kjo organizatë para-politike e para-institucionale kishte një impakt të jashtëzakonshëm, për shkak të përkrahjes së madhe që kishin nga instancat më të larta në Beograd. Këta u bënë faktor të rëndësishëm në realizimin e skenarëve që përgatiteshin nga Millosheviqi. Pra, në një formë edhe vetë Millosheviqi ishte i varur nga ata.

kundër shpërnguljes dhe mbrojtjes së identitetit kombëtar, ndërkaq e dyta simbolizon gjakun e derdhur të serbëve gjatë Betejës së Kosovës 1389. Sipas besimit të serbëve, lulet e bozhurit kanë qenë ekskluzivisht të bardha deri në betejën e Kosovës, kur në tokën e lagur nga gjaku i heronjve serbë mbinë bozhuret e kuqe.¹⁸³ Ky ishte një mesazh i qartë për “gjakun që serbët derdhën për Kosovën”, në mbrojtje të civilizimit të krishterë nga civilizimi islam, e që njëkohësisht pretendonte të drejtën historike e juridike mbi tokën e Kosovës.

Fillimet e organizimit konkret të serbëve kosovarë i hasim tek në vitin 1982, kur një grup serbësh filluan të ngritën kundër “presioneve perfide nga pozicionet shtetërore”, kurse qendra e këtij grupi ishte në Fushë Kosovë. Bërthama e hershme e këtij grupi përbëhej nga: Miroslav Sholeviq, Kosta Bullatoviq e Boshko Budimiroviq. Këta dhe përkrahës të tjerë të tyre mbanin mbledhje e takime të rregullta, kryesisht, me LSPP, për t’i paraqitur brengat e veta. Konkluzionet e takimeve të tyre ia dërgonin niveleve politike krahinore, republikane e federale. Gjatë vitit 1985, ky grup arriti të konsolidohet dhe të shndërrohet në një lëvizje, duke inkorporuar në radhët e veta edhe këshilltarin jozyrtar: Zoran Grujiq, profesor universitar dhe Dushan Ristiçin, ish-

"Bozhuri", edhe pse e ruante karakterin mbipartiak mbeti si forcë politike kohezive e serbëve të Kosovës. Ata mbanin kuvende zgjedhore, ku në njërin nga ta u zgjodhe kryetar Bogdan Kecman, me mandat katërvjeçar. Miratuan programin dhe statutin e organizatës, që përmbante 35 pika. Esenca e tij lidhet me domosdoshmërinë e ndryshimit të strukturës nacionale të Kosovës. Ne do t’i vëmë në spikamë disa nga pikat, ku vërehen planet e këtyre bozhuristëve për spastrimin etnik të popullsisë shqiptare nga Kosova dhe kolonizimit me serbë e malazezë. Nga pika e pestë e deri tek e dhjeta, memorandumit fliste me hollësi për këtë gjë: "Me masa politike, juridike, ekonomike dhe me masa të tjera është e domosdoshme që të ndryshohet struktura e prishur kombëtare në Kosovë dhe Metohi. Në frymën e këtij orientimi, deri në vitin 2000, në Kosovë duhet kolonizuar 200.000 serbë! Natyrisht, për ardhjen e tyre duhet siguruar tokë dhe troje - gjë që parashihet në pikën gjashtë të programit. Pas këtyre masave (me politikë agrare - si thuhet, gjegjësisht me një reformë të re agrare që do të nënkuptonte shpronësimin e shqiptarëve), do të pasonte ndërtimi i 30 vendbanimeve krejtësisht të reja (vendbanime etnike serbe), me nga 200 shtëpi apo ndërtesa. Në pikën shtatë parashihet ardhja në Kosovë, madje, edhe e serbëve e malazezve që jetojnë në Shqipëri. Mirëpo, për popullzimin e tillë, së pari, duhet siguruar hapësirë, gjë që - sipas pikës tetë do të bëhej me dëbimin e të gjithë atyre shqiptarëve që kanë ardhur në Kosovë pas vitit 1941. Kjo shifër varion prej 300.000 deri në 720.000! Përveç dëbimit do të duhej ndërmarrë diç për zvogëlimin e natalitetit të shqiptarëve, gjë që parashihet në pikën dhjetë të këtij programi.¹⁸² Për të shtuar dinamikën e kolonizimit parashihej rritja e numrit të studentëve serbë në Universitetin e Prishtinës. Në pikën 15 te memorandumit parashihej: " Vitin i ardhshëm akademik, në Kosovë të vijnë të studiojnë edhe dhjetë mijë të rinj nga Serbia e "brendshme unike". Për ta bërë të domosdoshëm këtë ardhje, këta propozojnë që të mbyllën shumë fakultete të panevojshme në Beograd, Nish, Novi - Sad, Kragujevc etj. Po ashtu, në njërin nga pikat e programit parashihet ndalimi i përdorimit të flamurit shqiptar. Në pikën e 32-të deri në 35-të, udhëheqësit e bozhurit u morën me planifikimin dhe rregullimin hapësinor, si dhe me riemërtimin e rrugëve. Ata propozonin: "Që vijat Prishtinë - Podujevë, Prishtinë - Mitrovicë, Prishtinë - Shkup dhe vijat e tjera strategjike të shpallen si territore të posaçme, ku në një hapësirë prej 80 metrash (majtas dhe djathtas) nuk guxon të ketë kurrfarë ndërtesash, gjë që do të thotë se duhet rrënuar me qindra e mija shtëpi, të cilat sot zënë vend në këtë hapësirë strategjike.

Në pikën e fundit (të 35-tën me radhë), "Bozhuri" parasheh ndërrimin e emrave të rrugëve, njëmendësimin në të gjitha nivelet të parimit të paritetit dhe më në fund ndalimin e të gjitha partive alternative të shqiptarëve në Kosovë si dhe ndjekjen penale të udhëheqësve të këtyre partive!" (**Revista " KOHA", 27 shkurt 1991, f. 23**)

¹⁸³ Božur u tradiciji srba, <https://www.bastabalkana.com/2016/03/bozur-u-tradiciji-srba-crveno-evece-natopljeno-junackom-krvlju/>, qasja 10 maj 2018

funksionarin e lartë kosovar. Një organizim i tillë i serbëve u bë edhe në viset e tjera të Kosovës ku ata banonin.¹⁸⁴

Qëllimi primar i organizimit të serbëve nga Kosova ishte ndalja e shpërnguljes së serbeve dhe kthimi i atyre që janë shpërngulur. Prandaj, edhe mbështetnin politikën partiake të vitit 1981 për ndaljen e shpërnguljes së serbëve. Në fakt, këto ishin vetëm pretendime zyrtare të kërkesave të tyre, derisa qëllimi i vërtetë ishte mosdurimi i çdo gjëje shqiptare dhe, mundësisht, ndryshimi i strukturës demografike të Kosovës. Miroslav Šoleviqi theksonte se në Kosovë popullata shqiptare ndahej në: “Albanci” dhe “Shiptari”. Me të parin, pretendonte se ishin emigrantët nga Shqipëria që u vendosën në Kosovë më 1941, e të cilët duhej të dëboheshin, kurse me të dytët, edhe pse emërtim ofendues, cilësoheshin shqiptarët autoktonë. Ai shkonte edhe më tej, duke bërë ndarje në baza religjioze, duke i ndarë: “Albanci” dhe “Shiptari” në myslimanë e katolikë, dhe se nga këto grupe vetëm “Shiptari” katolikë mund të jenë të besueshëm.¹⁸⁵ Në këtë mënyrë, dëbimi i masave jo besnike do ta zgjidhte apo lehtësonte zgjidhjen e çështjes së Kosovës. Ky ishte një indikacion i mjaftueshëm për synimet e vërteta të këtij grupimi politik.

Në këtë periudhë, pra, në fazën e organizimit të grupimeve serbe në Kosovë, manifestimi i nacionalizmit serb dhe malazez bëhet edhe përmes shkrimit së parullave, letrave dhe pamfleteve, që më shpesh janë anonime dhe nga bota e nga organizatat çetnike dërgohen letra të cilat i bëjnë “thirrje popullit serb të ngrihet në luftë për çlirim...”.¹⁸⁶

Por, ky grupim ishte relativisht i vogël dhe i pafuqishëm në Kosovë, prandaj kërkesat e tyre nuk mund të realizoheshin pa mbështetjen politike nga Serbia. Duke pretenduar se qarqet republikane e federale nuk ishin të njoftuar me të vërtetën e gjendjes në Kosovë, ky grupim, duke shfrytëzuar ndërmjetësimin e serbëve që ishin shpërngulur më herët në Serbi, arriti të vendosë kontakte me qarqe politike serbe, duke arritur që, më 1983, privatisht të takoheshin edhe me kryetarin e atëhershëm të Serbisë, Nikolla Ljubiçin.¹⁸⁷

Përprjekjet e këtij grupimi filluan të marrin një kah tjetër, kur ata arritën të vendosin kontakte me qarqet nacionaliste në Serbi, të cilët u dhanë atyre udhëzime se si të punojnë dhe të paraqiten¹⁸⁸. I rëndësishëm ishte në veçanti kontakti me Dobrica Qosiqin, një disident i njohur

¹⁸⁴M. Pavlović, “Kosovo under autonomy 1974-1990”, f. 31-33.

¹⁸⁵Zorica Zarić, “Ko je ovaj čovek? Miroslav Šolević”, <http://arhiva.glas-javnosti.rs/arhiva/2002/06/30/srpski/T02062902.shtml>, qasja 4 korrik 2018.

¹⁸⁶Политика, Београд, 20 март 1986, f. 7.

¹⁸⁷M. Pavlović, “Kosovo under autonomy 1974-1990”, f. 31-33.

¹⁸⁸Политика, Београд, 20 март 1986, Interv. e Rrahman Morinës, Sekretar Krahinor i Punëve të Brendshme, f. 7.

politik i përjashtuar nga partia, më 1968, mu për shkak të kundërshtimit të politikës ndaj Kosovës. Qosiqi përkrahu kauzën e tyre dhe sugjeroi përdorimin e të gjitha mjeteve ligjore për ankesa. Një ndër aktet kryesore të këtij grupimi të serbëve nga Kosova ishte: Peticioni i tetorit të vitit 1985. Ky petition kishte nisur, fillimisht, me 76 nënshkrime dhe ishte shoqëruar me tone nacionaliste: “*Kjo është toka jonë. Nëse Kosova dhe Metohia nuk janë serbe, atëherë ne nuk kemi ndonjë tokë tonën*”. Në vjeshtën e vonë 1985, ky petition u nënshkrua nga 2.016 serbë e malazezë të Kosovës.¹⁸⁹

Ky petition ishte hartuar nga gazetarët e revistës: “Duga”, Rajko dhe Danica Gjurgjeviq, kurse vërejtjet u plotësuan nga Dobrica Qosiqi dhe murgu, Atanasije Jeftiq, edhe pse Kosta Bullatoviqi pretendonte se ai e kishte shkruar tekstin. Ky petition u dërgua në adresë të Kuvendit Republikan dhe Federativ, kryesisht së RSFJ-së, si dhe në adresë të organeve të ndryshme federale e republikane. Në këtë petition prej 15 pikash përshkruhej gjendja e rëndë e serbëve dhe mënyra se si mund të përmirësohet kjo gjendje. Titulli: “Peticioni 2016”, buron nga numri i personave që e nënshkruan petitionin origjinal, kurse pas daljes nëpër gazeta, petitioni u nënshkrua nga më tepër se 40.000 njerëz.¹⁹⁰

Përveç përshkrimit të gjendjes së serbëve në Kosovë, sikurse ishin frazat e zakonshme mbi presionet, rrahjet, dhunimet, etj., petitioni në fjalë përfshinte edhe 15 pika apo kërkesa, ndër më kryesoret veçojmë:

- (1) Garancinë për realizimin e të drejtave tona themelore njerëzore, sipas kushtetutës së RSFJ dhe konventave ndërkombëtare, të drejta që “na janë marrë”;
- (2) Që Republika e Serbisë të fitojë statusin e njëjtë shtetëror, sikurse republikat e tjera në Jugosllavi;
- (3) Që nga organet krahinore dhe republikane të shkarkohen dhe vihen para përgjegjësisë shovinistët shqiptaro mëdhenj, të cilët po kryejnë kryengritje në Kosovë...;
- (4) Që të zbulohen emrat e hartuesve të projektit të gjenocidit kundër serbëve në Kosovë...;
- (5) Që t’u ndërpritet qëndrimi i emigrantëve nga Shqipëria që erdhën në Kosovë, që nga viti 1941 e tutje;

¹⁸⁹H. Clark, *Civil Resistancein Kosovo...*, f. 17.

¹⁹⁰Andrej Stefanović, *Antibirokratska Revolucija*, Univerzitet u Beogradu, Fakultet političkih nauka, Beograd, 2011, f. 10; Dobrica Ćosić, *Piščevi Zapisi (1981-1991)*, Fejton elektronik, http://www.novosti.rs/dodatni_sadrzaj/clanci.119.html:275783-Haranga-protiv-SANU, qasja 10 korrik 2018.

(6) Të anulohen marrëveshjet e shitblerjes së pronave të serbëve.¹⁹¹

Megjithatë, esenca e këtij peticioni, qëndronte në paragrafin vijues: “Gjatë njëzet viteve të kaluara nga Kosova dhe Metohija u shpërngulën rreth 200.000 njerëz, kurse më tepër se 700 vendbanime u “spastruan” etnikisht, kurse shpërngulja po vazhdon me ritëm të njëjtë. Kosova e Metohija po bëhet “etnikisht e pastër”, kurse agresioni i tejkalon kufijtë e krahinës”¹⁹². Prandaj, edhe u bëhej thirrja organeve përkatëse federale e republikane, që të marrin masa efikase ndaj një dukurie të tillë. Po ndaj këtyre organeve u bë edhe një kërcënimin, ku thuhej: “Nëse udhëheqjet jugosllave dhe republikane nuk janë të përgatitura për të përmbushur detyrat e tyre qeveritare ose të partisë, ne kërkojmë, të paktën, që ju mos të na pengoni që të organizojmë vetëmbrojtjen tonë për lirinë, nderin dhe dinjitetin tonë”.¹⁹³

Paragrafi në fjalë paraqet pikën më të ndjeshme serbe, qoftë zyrtare partiake apo jozyrtare opozitare, sepse shpërngulja e serbëve dhe ndryshimi i strukturës demografike në Kosovë nënkuptonte edhe humbjen e saj, kurse “masat efikase” do ta parandalonin një gjë të tillë, sipas tyre.

Sipas Bullatoviqit, i cili në prononcimet e tij gjithmonë gjente arsye për t’i sulmuar udhëheqësit komunistë shqiptarë për mostrajtim të drejtë të serbëve dhe kërkesave të tyre, kryesia partiake në Prishtinë kishte theksuar se peticioni është një pamflet politik i llojit të vet me përmbajtje armiqësore i drejtuar kundër politikës së LKJ.¹⁹⁴

Mbështetja që grupimi serb gjeti në Beograd dhe efekti mediatik i kërkesave të tyre bëri që ky grup të përafrohej edhe më tej me qarqet nacionaliste në Serbi. Peticioni u botua në “Knjizevne Novine”, më 15 janar 1986¹⁹⁵. Në janar të vitit 1986, rreth 200 intelektualë nga Beogradi nënshkruan një peticion në mbështetje të serbëve nga Kosova, kurse shoqata e shkrimtarëve mbajti disa takime lidhur me këtë çështje.¹⁹⁶ Roli i Qosiqit në hartimin e këtij peticioni ishte i padiskutueshëm. Intelektualet më të njohur që e nënshkruan këtë akt ishin: Antonije Isakoviq, Kosta Çavoski, Vojislav Koshtunica, Nebojsa Popov, Mihajlo Gjuriq, Zagorka Goluboviq, etj.¹⁹⁷

¹⁹¹Илустрована Политика, Београд, 4 март 1986, Intervistë me Kosta Bullatoviqin, f. 12.

¹⁹² S. Biserko, *Kovanje Antijugoslovenske zavere...*, f. 113.

¹⁹³ V. Meier, *Yugoslavia a history of its demise*, Routledge London and New York, 1999, f. 70.

¹⁹⁴Илустрована Политика, Београд, 4 март 1986, Intervistë me Kosta Bullatoviqin, f. 12.

¹⁹⁵ M. Vickers, *Midis serbëve dhe shqiptarëve...*, f. 270

¹⁹⁶M. Pavlović, “Kosovo under autonomy 1974-1990”, f. 36.

¹⁹⁷ S. Biserko, “Srpska elita i realizacija srpskog nacionalnog programa...”, f. 106.

Në mars të vitit 1986, pas një debati treditor në Beograd, lidhur me librat për Kosovën dhe situatën atje, ku morën pjesë edhe përfaqësuesit e KOS-it, u formua një koalicion i ri midis inteligjencës, rrymave radikale në Lidhjen Komuniste të Serbisë (më tej: LKS) dhe disa politikanëve që ndiqnin këto protesta. Këto grupe e cilësonin veten si “opozitë kundër regjimit”, duke kritikuar për moszbatimin e masave të ashpra për mbrojtjen e serbëve në Kosovë.¹⁹⁸

Duke filluar nga pjesa e parë e vitit 1986, koalicioni në fjalë do ta instrumentalizojë lëvizjen e serbëve nga Kosova me synim të realizimit të aspiratave të përbashkëta. Hapi i parë në këtë aspekt, erdhi nga Kosta Bullatoviqi, i cili e promovoi zyrtarisht lëvizjen serbe në tribunën e Shoqatës së Shkrimtarëve të Serbisë, më 2 mars 1986.¹⁹⁹ Vetë vendi i promovimit është një argument i mjaftueshëm se lëvizja e serbëve nga Kosova kishte kaluar nën kontrollin e forcave nacionaliste në Serbi, kurse në anën tjetër, Dobrica Qosiqi, i këshillonte ata për hapat që duhej t’i ndiqnin. “*U thashë që nesër, ashtu siç munden, të shkojnë te Dushan Çkrebiqi, kryetar i kryesisë së RS të Serbisë. Ai patjetër duhet që t’ju pranojë. Shtrihuni te pragu i derës së tij*”.²⁰⁰

Për më tepër, gjatë gjithë vitit 1986, grupi i Fushë Kosovës, përfshirë edhe Bogdan Kecman, që ishte inkuadruar rishtazi, punoi në bashkimin e grupeve lokale serbe që po paraqiteshin në një forcë politike. Secila prej tyre mori përgjegjësi për rajone të caktuara në Kosovë dhe u punua në forcimin e lidhjeve midis aktivistëve ekzistues në rajon, rekrutimit të aktivistëve të rinj, si dhe në informimin e mbështetësve potencialë, lidhur me iniciativat e tyre. Jo një kohë të gjatë më parë, grupi i Fushë Kosovës arriti të mobilizonte grupe të vogla të aktivistëve për protesta disa orësh brenda dhe jashtë Kosovës. Kërkesat e aktivistëve, fillimisht, ishin mungesa e mbrojtjes nga organet për sundimin e ligjit, pabarazia në sektorin e publik, duke evoluuar gradualisht drejt çështjes kushtetuese. Protestuesit theksonin se nëse zyrtarët krahinorë nuk ishin në gjendje t’i mbronin serbët, atëherë Kosova duhet të rivendoset nën autoritetin e organeve republikane.²⁰¹ Mobilizimi i grupeve të ndryshme brenda këtij komuniteti ishte frymëzuar, organizuar dhe koordinuar nga zyrtarët e regjimit të Millosheviqit ose nga intelektualë nacionalistë serbë ose të dyja. Në fakt, ky ishte një mobilizim bazë.²⁰²

¹⁹⁸ Vesna Pešić, *Ethnic Mobilization in Serbia*, MIRICO: Human and Minority Rights in the Life Cycle of Ethnic Conflicts, 2007, f. 10.

<http://www.eurac.edu/en/research/autonomies/minrig/Documents/Mirico/Serbia%20Report%20WEB.pdf>

¹⁹⁹ Rade Dragović, *Osmi sednica CK KP Srbije*, Fejton elektronik,

http://www.novosti.rs/dodatni_sadrzaj/clanci.119.html:686773-Teror-nad-Srbima-na-Kosovu, 10 korrik 2018.

²⁰⁰ S. Biserko, *Kovanje Antijugoslovenske zavere...*, f. 111.

²⁰¹ M. Pavlović, “Kosovo under autonomy 1974-1990”, f. 34.

²⁰² Po aty, f. 34.

Për t'i imponuar kërkesat e tij, ky grup përveç protestave organizoi edhe shkuarjen e delegacioneve të tyre në Beograd, për t'u takuar me zyrtarët federativë e republikanë. Përmes shkuarjes dhe presionit fizik ata dëshironin që t'ia tërhiqnin vëmendjen organeve federale apo republikane mbi gjendjen në Kosovë, sidomos kur në fund të shkurtit, Këshilli Ekzekutiv Federativ do të shqyrtonte çështjen e shpërnguljes së serbëve nga Kosova.²⁰³ Në bazë të kësaj strategjie, më 26 shkurt 1986, rreth njëqind serbë nga Kosova arritën në Beograd. Kjo ishte hera e parë që serbët nga Kosova po protestonin në Beograd, për shkak të “presionit nga shqiptarët”. Këta serbë u futën dhunshëm në Kuvendin Federativ²⁰⁴, e me ta vonë iu bashkuan edhe punëtorët e ndërmarrjeve: “Uljanik” dhe “Borovo”. Sipas pohimeve të Miroslav Sholeviqit, regjia për hyrjen e serbëve në Kuvend ishte arritur në pajtim me Miodrag Trifunoviçin, atëherë kryetar i Këshillit Federativ.²⁰⁵

Sigurisht që aranzhimi i këtij akti kishte qenë i natyrës sekrete, kurse qëllimi ishte të bëhej presion në organet federale, sidomos, para mbledhjes së Këshillit Ekzekutiv Federativ, si dhe të njoftohej opinioni jugosllav me pozitën e vështirë të serbëve në Kosovë. Njëkohësisht, kështu shtrohej rruga drejt konvertimit të çështjes së Kosovës nga problemi jugosllav në një problem të Serbisë.

Sipas medieve serbe, që shikonin me simpati aktivitetet e grupimit serb të Kosovës, në këtë mbledhje serbët e Kosovës kishin kërcënuar me shpërngulje kolektive nëse organet federative nuk do të ndërmerrnin asgjë lidhur me kërkesat serbe të shprehura në Peticion. Po ashtu, u përsëritën temat apo ankesat serbe rreth shpërnguljeve, shitjes së pronave, dhunës nga shqiptarët, rrahjeve e dhunimeve, mosefikasitetit të organeve të sigurimit, por edhe theksime se u pengon flamuri shqiptar gjatë dasmave apo ndërtimit të shtëpive.²⁰⁶

Përveç konsolidimit si lëvizje, në çerekun e dytë të vitit 1986 del në pah edhe agresiviteti i kësaj lëvizjeje. Më 2 prill 1986, Kosta Bullatoviçi u arrestua dhe akuzua për veprë penale të “propagandës armiqësore”. Para shtëpisë së tij, në Fushë Kosovë, u mbledhën rreth 20.000 serbë. Atmosfera ishte para shpërthimit.²⁰⁷ Arrestimi i Bullatoviçit u konsiderua si një provokim për serbët, sepse po atë ditë ishte përvjetori i Lidhjes së Prizrenit, prandaj edhe erdhi deri te protestat

²⁰³ *НИИ*, 2 mars 1986, f. 29.

²⁰⁴ Po aty, f. 29.

²⁰⁵ Slobodanka Ast, Miroslav Šolević: Režim nas je iskoristio, *Vreme* broj 454, 18. septembar 1999. https://www.vreme.com/arhiva_html/454/11.html, qasja 10 maj 2018.

²⁰⁶ *Илустрована Политика*, Београд, 4 март 1986.

²⁰⁷ R. Dragović, *Osmo sednica CK KP Srbije*, Fejton elektronik, http://www.novosti.rs/dodatni_sadrzaj/clanci.119.html:686773-Terror-nad-Srbima-na-Kosovu, 10 korrik 2018.

në gjithë Kosovën. Sidoqoftë, ky ishte vetëm një mashtrim, sepse në historiografinë shqiptare Lidhja e Prizrenit nuk është mbajtur në prill, por në qershor. Sidoqoftë, Bullatoviç u lirua, kurse për ta qetësuar situatën, Ivan Stamboliç (atëherë kryetar i KQ LKS dhe më pas edhe kryetar i kryesisë së RS të Serbisë), vizitoi Fushë Kosovën. Ai tentoi të qetësojë situatën te serbët, duke përdorur retorikën e zakonshme komuniste, e cila i kundërvijet nacionalizmit serb. Kjo vizitë nuk kishte sjellë atë çfarë kërkonin serbët e Kosovës. Sipas tyre: “incidentet vazhduan. Vazhdoi edhe shpërngulja e serbëve, ndoshta, me intensitet më të lartë”.²⁰⁸

Ajo çfarë kërkonte lëvizja serbe ishte gjetja e një lideri që do ta shtyjë përpara kauzën serbe. Sipas Sholeviçit, “...*Stamboliçi e kishte rastin të bëhej mbret i gjithë serbëve, por ai nuk e shfrytëzoi rastin. Ne, edhe për një vit tjetër u revoltuam, bërtitëm, u shtymë, për shkak të presioneve, padrejtësive, majorizimeve, dhe asgjë nuk arritëm ...*”.²⁰⁹

Në korrik dhe nëntor të vitit 1986, kjo lëvizje e serbëve dhe e malazezëve përsëri bëri një presion të veçantë mbi organet federale përmes shkuarjes së tyre në Beograd dhe organizimit të tubimeve të ndryshme politike.²¹⁰

Presioni i serbëve të Kosovës ishte i vazhdueshëm dhe konstant. U intensifikua gjatë gjysmës së parë të vitit 1987, respektivisht në qershor, atëherë kur po planifikohej të mbahej mbledhja e IX e KQ të LKJ- së. Kjo mbledhje, do t'i kushtohet shqyrtimit të çështjeve aktuale ideopolitike, në KSA të Kosovës. Në përgatitje të saj, Sekretariati Federativ, gjatë muajit maj dhe qershor kishte pranuar disa informacione nga Sekretariati Krahinor i Punëve të Brendshme të KSA Kosovës dhe nga Sekretariati Republikan i Punëve të Brendshme i RS të Serbisë, lidhur me ardhjen e mundshme në Beograd të një grupi serbësh e malazezësh nga KSA e Kosovës, apo për tubimin e tyre në disa lokacione në Kosovë, me rastin e mbledhjes së cekur më lart. Një tjetër raport ditor i Sekretariatit Krahinor i Punëve të Brendshme të KSAK të 8 qershorit flet për agjitacionin që bëhej te banorët vendas, për një shkuarje sa më masive në Beograd. Në të njëjtën informatë thuhet se, Kosta Bullatoviç, po i viziton fshatrat e rrethit të Gjilanit me qëllimin e realizimit të idesë së mësipërme.²¹¹ Përfaqësuesit e parë të serbëve erdhën më 22 qershor, ku edhe vendoset që, më 26 qershor, të mbahet tubimi qendror, sepse kjo datë korrespondon me

²⁰⁸A. Stefanović, *Antibirokratska Revolucija...*, f. 10-11.

²⁰⁹S. Ast, Miroslav Šolević: Režim nas je iskoristio, Vreme broj 454, 18. septembar 1999. https://www.vreme.com/arhiva_html/454/11.html, qasja 10 maj 2018.

²¹⁰R. Dragović, *Osmo sednica CK KP Srbije*, Fejton elektronik, http://www.novosti.rs/dodatni_sadrzaj/clanci.119.html:686773-Teror-nad-Srbima-na-Kosovu, 10 korrik 2018.

²¹¹ Arhiv Republike Slovenije, Fondi: Централни Комитет Комунистички Лиге, Škatla 872-KOSOVO, f. 1, 2.

mbajtjen e KQ të LKJ. Sipas raportimeve të 26 qershorit të vitit 1987 një numër i madh i qytetarëve serbë e malazezë arritën me trenin që vinte nga Prizreni. Gjatë qëndrimit në stacion, ata u incizuan nga gazetarët e RTV Beogradit, të “Politikës”, nga gazetari: Ranko Milosavljeviqi, gazetari i Reuterit, etj. Disa të intervistuar i kishin deklaruar gazetarëve se kishin ardhur në Beograd, që ta mbështesin KQ LKJ-së që “çështjen e Kosovës” ta zgjidhin në mënyrë të duhur. Ata u shprehën të vendosur të qëndrojnë në Beograd, deri në përfundimin e mbledhjes së KQ LKJ.²¹²

Më 26 qershor, qytetarët e shumtë serbë e malazezë të ardhur nga Kosova dhe vendas u grumbulluan në parkun: “Pionir”. Ata u vizituan nga Vojislav Sheshel dhe shkrintarët: Milan Komneniq e Miodrag Bullatoviq. Rreth orës 14.00, në park u kthye delegacioni nga Kuvendi i RSFJ. Qytetarëve të grumbulluar iu drejtua: Miroslav Sholeviqi, i cili tha se është i kënaqur me bisedimet dhe se mjeteve të informacionit së shpejti do t’u jepej një komunikatë zyrtare. Sërish në orët e mbrëmjes u formua një delegacion që shkoi për të biseduar me organet federative. Nga atje u kthye para mesnatës. Siç njofton raporti, njëri nga anëtarët e delegacionit e mori fjalën për t’i informuar ata 1000 persona, që ishin aty, lidhur me bisedimet që kishin zhvilluar. Në raport thuhej: “Rreth orës 22.10, në park u kthye grupi që kishte shkuar për bisedime”. Kosta Bullatoviq dhe Miroslav Sholeviqit bisedonin mes vete se cili t’i drejtohej qytetarëve të grumbulluar. Pasi që asnjëri nuk dëshoi të flasë, fjalën e mori Jovica Vučkoviq nga Beogradi, që kishte qenë anëtar i delegacionit. Ai, përveç të tjerash, në mënyrë ironike theksoi se gjatë bisedimeve ishte thënë se në mesin e qytetarëve nga Kosova ishin futur elemente destruktive dhe se ishin lutur që të shpërndaheni. “Ata nuk kanë fuqi që të na dëgjojnë dhe na thanë të shpërndahemi që mos të vijë deri tek incidentet më të mëdha”.²¹³

Përshkrimi kronologjik i ngjarjeve dhe qëndrimi në park jep të kuptohet se grupi i serbëve ishte i instrumentalizuar nga Sholeviqi e Bullatoviqi. Pra, këta eksponentë të lartcekur dhe disa të tjerë ishin aktivisht të angazhuar për mobilizimin e serbëve të Kosovës, që të shkonin në Beograd, me qëllim që t’u bënin presion organeve federative.

²¹² ARS, Fondi: Централни Комитет Комунистички Лиге, Škatla 872-KOSOVO, f.10.

²¹³ ARS, Fondi: Централни Комитет Комунистички Лиге, Škatla 872-KOSOVO, f.11, 12, 16

3.2 Propaganda në shërbim të nacionalizmit serb, si dhe inskenimi i disa incidenteve në Kosovë dhe në Maqedoni, me të cilat Beogradi manipuloi skajshmërisht

Mobilizimi i nacionalizmit serb në Serbi dhe te serbët e Kosovës u shoqërua dhe u ndikua edhe nga veprimtaria propagandistike e qarqeve të ndryshme serbe, në veçanti, nga Kisha Ortodokse Serbe. Për ta dëshmuar “dhunën shqiptare” kundër pronës së kishës dhe personelit kishtarë, Sinodi i Shenjtë i peshkopëve të Kishës Ortodokse Serbe, qysh më 1969, kishte kërkuar nga Pavle (peshkop i dioqezës Rashkë-Prizren), që ta mbajë të informuar Sinodin për çdo rast dhune kundër kishës dhe klerikëve. Por, ajo që bie në sy ishte se kërkesa tejkalonte kornizat kishtarë, pasi që, njëkohësisht, kërkoheshin edhe informacione lidhur me popullatën serbe në Kosovë, sikurse: sa familje dhe individë dhe nga cilat fshatra u detyruan që t’i braktisin shtëpitë e tyre për shkak të dhunës, që nga viti 1945? Sa njerëz u vranë? Sa njerëz u rrahën? sa shtëpi e kisha u demoluan? Sa bagëti u dëmtuan? Cilat janë dëmet materiale të shkaktuara?²¹⁴

Duke respektuar një urdhër të tillë, qarqet kishtarë serbe anekënd Kosovës regjistruan raste të ndryshme të cenimit të pronës apo reputacionit të klerit kishtar serb, duke i zgjeruar ato, madje, edhe duke i shndërruar në incidente të karakterit ndëretnik.

Pas vdekjes së Titos, brenda KOS-it filloi një luftë midis rrymave të ndryshme, ku shquhet ajo e justinianëve. “Nuk pranoj që patriarku të na presë kostumet sipas shtatit të vet!”, ishte deklarata e justinianit të famshëm, Atanasije Jevtiq, që qartas pretendonte se nuk do të ndiqej politika e patriarkut të atëhershëm serb, Germanit, i cili me shumicën e peshkopëve të tjerë, deri në fillim të vitit 1980 e mbajtën Kishën Serbe larg zhvillimeve shoqërore dhe përpiqeshin të mos jepnin shkas për mosmarrëveshje apo konflikte me pushtetin.²¹⁵

Rrymat e reja që erdhën në pozita drejtuese të Kishës Ortodokse Serbe kërkonin hapësirën e nevojshme mediatike, kurse ngjarjet e vitit 1981 ishin shkas i mjaftueshëm për të ngritur zërin në “mbrojtje të serbëve të Kosovës”. Si rezultat i deklarimit të saj dhe të peticioneve, që denonconin situatën si një “gjenocid kulturor dhe shpirtëror” kundër serbëve dhe trashëgimisë së tyre të krishtere (përdhosja e kishave, manastireve dhe varrezave, ngacmimet dhe sulmet kundër murgjve dhe murgeshave, etj.), të shpërndara gjerësisht përmes shtypit kishtar,

²¹⁴ Шинтарски геноцид над србима у 20. Веку, Документа Архиве Епархије рашко-призренске и косовско-метохијске, Уредник: Мирјана Литричин, Београд, 2011, f. 339.

²¹⁵ М. Томиќ, *Кisha serbe në luftë dhe luftërat...*, f. 17-18.

Kisha Serbe nuk shihej më tutje si një organizatë konservative dhe e kufizuar, por në opinionin publik ajo rimori rolin që e kishte pasur gjatë periudhës së sundimit osman - atë të mbrojtësit natyral të interesave kombëtare në kohëra krize.²¹⁶

Këtij misioni iu bashkëngjitën edhe intelijenca nacionaliste serbe, si dhe lidërshipi politik, i cili e kishte kontrollin mbi mediet. Ringjallja e ndërgjegjes kombëtare serbe u pasua nga metodat klasike për “ndërtimin e kombit”, përfshirë përshkrimet mbi “thesaret kombëtare” dhe veçantinë kulturore. Ata inkurajuan komunitetin nacional serb ta imagjinojë veten si një “specie e rrezikuar”, së cilës, urgjentisht i duhej një shtet, për ta mbrojtur atë nga “speciet e tjera”. Një emocion bazik, për të cilin u ndërtua identiteti kombëtar serb në kurriz të armiqësisë me popujt e tjerë jugosllavë. Kjo më së miri ilustron nga fjalët e shkrimtarit dhe “babait të kombit serb”, Dobrica Qosiq: “*Armiqtë e serbëve, i bënë serbët - serbë*”.²¹⁷

Nacionalistët serbë, duke filluar nga qëndrimi tanimë i ndërtuar rreth pamundësisë së durimit të problemit demografik të Kosovës, demonstratat shqiptare i shfrytëzuan për hapjen e çështjes serbe, e jo për zgjidhjen e çështjes së Kosovës. Filloi një propagandë për gjenocidin ndaj serbëve në Kosovë, shpërnguljet e serbëve, përdhunimet e serbeve, etj.²¹⁸

Në rrethana të tilla, çështja e problemit demografik dhe shpërngulja e popullsisë serbe nga Kosova mori një trajtim të veçantë nga qarqet nacionaliste serbe, edhe pse serbët qysh më herët kishin filluar ta braktisnin Kosovën për shkak se gjenin punë më atraktive në Nish, në Beograd, në Kralevë, etj. Serbët lëvizën, sikurse lëvizën edhe banorët nga rajonet e varfra të Malit të Zi apo Bosnjë-Hercegovinës, apo sikurse kroatët e Bosnjës, që lëvizën kah Kroacia.²¹⁹

Arsyet e migrimit ishin të shumëfishta, por opinionin publik besonte se ato ishin rezultat i frikës, presionit, pabarazisë dhe dështimit të sistemit gjyqësor, për t’i mbrojtur njerëzit dhe pronat e tyre. Ky opinion publik u përpunua nga qarqet nacionaliste e akademike serbe, si dhe nga raportet e shtypit jugosllav, më konkretisht atij serb, për ngacmimet, dhunën (në veçanti dhunimet seksuale) dhe keqtrajtimin të përgjithshëm të serbëve në Kosovë.

Në aspekt të trajtimit të problemit demografik, qarqet nacionaliste serbe, të prira nga ASSHA, me theks të veçantë nga akademikët: Dimitrije Bogdanoviq, Millutin Garashanin, Sima

²¹⁶Dušan T. Bataković, “Kosovo and Metohija: Serbia’s Troublesome Province”, *Balkanica XXXIX* (2008), Belgrade 2009, f. 260.

²¹⁷V. Pesic, “Serbian Nationalism and the Origins of ...”, f. 18.

²¹⁸S. Biserko, “Srpska elita i realizacija srpskog nacionalnog programa...”, f. 106.

²¹⁹Tim Judah, *Kosovo: What everyone needs to know*, Oxford University Press, New York, 2008, f. 59; M. Vickers, *Midis serbëve dhe shqiptarëve...*, f. 269-270.

Qirkoviç, paraqitën mendimet e tyre në vepra shkencore të veçanta, sikurse: “Libri mbi Kosovën”, trajtesat shkencore në librin: “Ilirët dhe shqiptarët”, nxitën ndryshimin e qëndrimeve politike ndaj shqiptarëve dhe institucioneve të tyre, bashkë me to, edhe nxitjen e akteve të dhunës e të krimit ndaj shqiptarëve. Në krahasim me akademikët e cekur më lart, akademiku tjetër, Millosh Macura, pati një ndikim më të fuqishëm në marrjen e qëndrimeve për politikën demografike në Serbi dhe në formimin e masave të veçanta shtetërore për pengimin e riprodhimit biologjik të shqiptarëve. Ky mendim i akademikut, M. Macura përputhet me qëndrimin e ASSHA, ku “ekspansioni i shqiptarëve” është cilësuar si “kërcënim real për të gjithë popujt në Jugosllavi”.²²⁰

Të gjitha institucionet serbe e jugosllave, nga ato politike e shtetërore e deri tek ato shkencore, kulturore, publicistike, informative, kishtarë etj., nisën të shpifin teza të ndryshme, ndër të cilat më transparente ishin: se shqiptarët në mënyrë të organizuar, po ua blejnë serbëve tokën dhe po lindin shumë fëmijë, për shkaqe nacionaliste, me qëllim që t'i ndjekin serbët nga Kosova dhe të krijojnë "Kosovën etnikisht të pastër" dhe "Shqipërinë e Madhe. Ndërkaq, një udhëheqës i lartë partiak - shtetëror i ish-Jugosllavisë nuk ngurroi të deklaronte: “Ne e njohim shumë mirë njëri nga parullat kryesore të irredentës: “Blej tokë dhe lind fëmijë”.²²¹

Indoktrinimi kundër natalitetit dhe, në esencë, antishqiptar kishte marrë tashmë përmasa të gjera në të gjitha shtresat e shoqërisë serbo-jugosllave, duke e fyer rëndë femrën shqiptare, të cilën në çdo forum politik, në medime, në rrugë e cilësonin si "makinë për prodhimin e fëmijëve".²²²

Një frikë e tillë bazohej në ndryshimin e strukturës demografike të popullsisë. Të dhënat përkatëse dëshmojnë rritjen e numrit të pakicës kombëtare shqiptare në RSF të Jugosllavisë, në periudhën pas LDB: 1948 – 750.431 banorë; 1953 – 754.245 banorë (rritja 0.5%); 1961 – 914.733 (rritje 21.3%); 1971 – 1.309.523 (rritje 43.2%), dhe 1981 – 1.730.878 (rritje 32.2%). Përmes të dhënave të Byrosë Federale të Statistikave të RSFJ-së, të vitit 1982, rritja e numrit të

²²⁰ Pajazit Nushi, *Etiologjia e krimit të pushtetit serb ndaj shqiptarëve në Kosovën e viteve '90 të shekullit XX, Gjenocidi i pushtetit serb ndaj shqiptarëve në Kosovë gjatë viteve '90*, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, Seksioni i Shkencave Shoqërore, Prishtinë, 2001, f. 19-21.

²²¹ Hivzi Islami, *Studime demografike, 100 vjet të zhvillimit demografik të Kosovës*, Botimi i dytë i plotësuar, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Prishtinë, 2008, fq. 258

²²² Po aty, f. 259.

popullatës shqiptare sillej: 1948 – 498.242; 1953 – 524.559; 1961 – 646.605; 1971 – 916.168 dhe 1981 – 1.226.736.²²³

Nga këto të dhëna shihet se gjatë viteve: 1948, 1953, 1961, 1971, dhe 1981 vjen deri te rritja e përgjithshme e popullsisë shqiptare në Kosovë dhe te zvogëlimi i numrit të popullsisë serbe e malazeze në këtë krahinë.

Për t'i vërtetuar pretendimet e tyre për shpërnguljen e detyruar të serbëve nga Kosova, në vitin 1984, ASSHA inicioi hulumtimin për çështjen e shpërnguljes së serbëve. Sipas të gjeturave të saj, në radhë të parë regjistrimi i vitit 1981 kishte treguar se gjatë periudhës: 1961-1981 kishte ndodhur një shpërngulje në masë e popullsisë serbe, e cila kishte ndryshuar dukshëm strukturën etnike të Kosovës. Së dyti, kah mesi i vitit 1980 kishte një vetëdije dhe shqetësim në rritje në mesin e serbëve, lidhur me eksodin e tyre nga Kosova. Regjimi komunist, në veçanti lidhësi serb i kohës, tentoi që ta mbulonte problemin, por kjo vetëm sa i shtoi ndjenjat e solidaritetit me serbët që mbetën në krahinë. Së treti, disa media filluan të raportojnë, lidhur me shitjet masive të shtëpive dhe pronave serbe, me një çmim tepër të lirë. Për më tepër, sipas kësaj ankete, në 75-85% të rasteve motivi kryesor për shpërngulje kishte qenë diskriminimi etnik, e më pak faktorët e tjerë.²²⁴

Të dhënat autentike nuk vërtetonin asnjë tezë serbo-jugosllave të shpërnguljes së serbo-malazezëve nën presion të shqiptarëve. Evidencat autentike për të shpërngulurit, sikurse edhe për të ardhurit, flisnin për motive krejt të tjera, nga ato që i theksonte politika e ditës dhe mjetet e komunikimit. Të shtyrë nga pushteti serbo-jugosllav, Qeveria e atëhershme e Kosovës, që njëjhej si: Këshill Ekzekutiv i Kuvendit të KSA të Kosovës mori vendim që, përmes Sekretariatit të Punëve të Brendshme dhe Entit të Statistikës të Kosovës, si dhe shërbimeve të lajmërimit e të çlajmërimit të sekretariateve komunale të punëve të brendshme, prej 1.6.1983 në Kosovë, në mënyrë të organizuar të përcilleshin shkuarjet e njerëzve nga Kosova në viset e tjera të ish-Jugosllavisë dhe ardhjet e tyre në Kosovë. Evidencat ishin autentike dhe të dhënat mbledheshin sipas shumë karakteristikave: kombësisë, gjinisë, moshës, aktivitetit, profesionit dhe marrëdhënies së punës, përgatitjes shkollore dhe shkallës së arsimit profesional, shkaqeve të shpërnguljes dhe shkaqeve të ardhjes, sipas komunave dhe rajoneve të vendosjes etj. Vlera e të

²²³ Đorđe Borozan, "Jugoslavija i Albanija u XX vijeku", *Istorija 20. Veka*, Časopis Instituta za Savremenu Istoriju, br. 1-2, 1999, Beograd, f. 15.

²²⁴ Marina Blagojević, "The other side of the truth: Migrations of Serbs from Kosovo", *Kosovo-Kosova, Confrontation or Coexistence*, edited by Greg Duijzing, Peace Research Centre, University of Nijmegen, 1996, f. 71-72.

dhënave ishte shumë e madhe, sepse çdo emigrant vetë i jepte shënimet në formularë të posaçëm. Sipas kësaj evidence, prej 1. 6. 1983 deri më 31. 12.1988 nga Kosova emigruan 39.605 vetë (16.958 serbë, 10.858 shqiptarë, 3.552 myslimanë, 2.613 malazezë dhe 5.624 të tjerë), ndërsa në Kosovë u kthyen 14.001 vetë (6.757 shqiptarë, 3.463 serbë, 1.425 myslimanë, 596 malazezë dhe 1.760 të tjerë).²²⁵

Për më tepër, Libri Vjetor i Statistikave të Serbisë (1981) tregonte qartë se më tepër serbë po largoheshin nga Vojvodina (140.000) se sa nga Kosova (110.000) gjatë periudhës 1941-1981. Ky fakt krahasues ofron dyshime të bazuara për “eksodin e serbëve për shkak të terrorit shqiptar”. Si mund të ndodhë që numri më i madh i shpërnguljeve ishte nga Vojvodina, një rajon jo aq i populluar dhe me një nivel më të lartë të zhvillimit ekonomik, se sa nga Kosova – një rajon me popullsi të dendur, e pazhvilluar ekonomikisht e me kushte jete shumë më të këqija se sa në Vojvodinë?²²⁶

Një fakt tjetër demografik që rrëzon tezën serbe të eksodit të serbëve, si rezultat i presionit të shqiptarëve është se rreth çdo i treti fshat në Serbinë jugore apo Kosovën Veriore është braktisur nga serbët, e në këto rajone nuk banonin shqiptarët për ta shkaktuar “eksodin”. Këto fakte u paraqitën nga qarqet e moderuara intelektuale, por zëri i tyre ishte i dobët para propagandës së dhunshme, që nuk lejonte asnjë vërtetim të fakteve.²²⁷

Një tjetër element i politikës propagandistike antishqiptare, që linte përshtypje negative në psikologjinë njerëzore dhe në opinionin jugosllav ishin përdhunimet e grave serbe nga shqiptarët. Kjo ishte njëra nga strategjitë për ta dëshmuar “gjenocidin” e shqiptarëve. Kjo propagandë përshkruante përdhunimin e femrës serbe, si një fenomen i përditshëm, që ndodhte në shkallë të lartë, duke e bërë këtë si një ndodhi normale në Kosovë. Një psikolog serb citonte në një zhurnal psikologjik se “shqiptarët kryejnë përdhunime çdo ditë dhe në çdo vend: në rrugë, në fushë, në autobus, spitale, fabrika, etj.”. U krijuan poezi, piktura, madje, edhe një skulpturë se si mashkulli shqiptar e përdhunonte femrën serbe.²²⁸

Një propagandë e tillë nxitej nga qarqet intelektuale e nacionaliste serbe. Duke pretenduar se përdhunimet ishin një “vërtetësi”, akademiku, Dobrica Qosiqi, në shtator të vitit 1986, e këshillonte veprimtaren serbe, Liljana Bullatoviqin për nxitjen e propagandës për një

²²⁵ H. Islami, *Studime demografike...*, f. 263-264.

²²⁶ Muhamedin Kullashi, “The production of hatred in Kosova (1981-1991)”, *Kosovo-Kosova, Confrontation or Coexistence*, edited by Greg Duijzing, Peace Research Centre, University of Nijmegen, 1996, f. 63.

²²⁷ Po aty, f. 63.

²²⁸ H. Clark, *Civil Resistance in Kosovo...*, f. 50.

fenomen të tillë. “...ju mund të bëni një akt të shkëlqyeshëm për historinë e këtij vendi: që të bisedoni me gratë nga Kosova. Që ato t’ju flasin se si i përjetojnë dhe i jetojnë këto ditë të vështira... kjo është një edukatë amësore, sepse nënave iu desh t’i fshinin dhunimet e shumta në mënyrë që t’ua ruanin fytyrën bijave të tyre në publik. Ndoshta, ato nuk do të dëshirojnë të flasin për këtë temë. Por, ju duhet t’i bëni që të flasin...”- këshillonte Qosiqi.²²⁹

Megjithatë, raportet nga MPB – që kërkoheshin nga deputetët e parlamentit federal apo të atyre nga Serbia e Kosova – demonstroi qartë se shkalla e përdhunimeve në Kosovë ishte më e vogla në vend. Për më tepër, në shumicën e rasteve fajtori dhe viktimat ishin të komunitetit të njëjtë, që do të thotë se përdhunimet etnike ishin shumë të rralla. Për të gjitha këto burime listojnë vetëm shtatë raste në periudhën 1981-1988, ku shqiptarët ishin të akuzuarit, kurse serbët viktimat. Ky proporcion prej shtatë vetëve brenda shtatë viteve, në një territor të banuar prej 2 milionë njerëzish, normalisht se hedh poshtë tezën se përdhunimet ishin sistematike dhe të përditshme. Por, kjo nuk kishte ndodhur. Si rezultat i propagandës së vazhdueshme, të “vërtetën” e saj e pranoi pjesa më e madhe e opinionit publik.²³⁰

Më vonë, përmes një analize të intelektualëve (“Kosovski cvor”) u dokumentua se në Kosovë nuk kishte përdhunime masive, në veçanti ndëretnike, dhe se shpërngulja e serbëve dhe e malazezëve lidhej me arsyet ekonomike.²³¹

Një mospërputhje kaq e madhe midis propagandës dhe fakteve nuk u kundërshtua nga organet zyrtare për dy arsye: në fuqi ishte programi jugosllav për Kosovën dhe mungesa e rezistencës brenda aparatit shtetëror, në tre nivelet kundër fushatës, natyra irracionale, e cila shkaktoi heshtjen dhe brengën midis zyrtarëve partiakë, të cilët arritën ta ruajnë minimumin e arsyes dhe të cilët menduan se do të ishte në dëm të interesave të Jugosllavisë dhe të Serbisë.²³²

Një rol të veçantë në politikën propaganduese serbe kishte edhe Kisha Ortodokse Serbe. Në ndjekje të një politike të tillë, qysh më 15 maj 1982, një grup prej 21 klerikësh serbë i dërguan një apel kryesisë së RSFJ, kryesisë së RS të Serbisë, Kuvendit të Serbisë dhe Sinodit të Shenjtë, për “mbrojtjen e qenies biologjike dhe shpirtërore të popullit serb dhe vendeve të shenjta të saj në Kosovë”.²³³

²²⁹S. Biserko, *Kovanje Antijugoslovenske zavere...*, f. 112.

²³⁰M. Kullashi, “The production of hatred in Kosova (1981-1991)...”, f. 61.

²³¹S. Biserko, “Srpska elita i realizacija srpskog nacionalnog programa...”, f. 107.

²³²M. Kullashi, “The production of hatred in Kosova (1981-1991)...”, f. 61.

²³³S. Biserko, *Kovanje Antijugoslovenske zavere...*, f. 104.

Në mesin e këtyre 21 klerikëve ishte edhe Atanasije Jevtiqi, i cili në vitin 1982 botoi shkrimin: “*Sa Kosova i oko Kosova*” (Nga Kosova dhe rreth Kosovës), ku flitej për shfarosjen e popullit serb në hapësirat e krahinës jugore, kurse më 1983 në revistën kishtare: “*Pravoslavlje*” ai filloi me botimin e fejttonit me titull: “*Od Kosova do Jedovna*” (Nga Kosova në Jedovna). Në këtë fejton përshkruheshin në detaje sulmet kundër serbëve në Kosovë, përdhunimet, keqtrajtimet e murgjve, murgeshave, etj. Por, propaganda në viktimizimin e serbëve tani tejkalonte Kosovën dhe përfshinte edhe serbët në pjesë të tjera të Jugosllavisë. Në vazhdim të fejttonit, Atanasije Jevtiq, kaloi nga gjendja e tashme në Kosovë, në përshkrimin e së kaluarës së afërme dhe vuajtjet e serbëve në Shtetin e Pavarur të Kroacisë Ustashe.²³⁴

Në këtë mënyrë, propaganda kishtare serbe, që filloi të intensifikohet nga viti 1983, duke viktimizuar serbët në gjithë hapësirën jugosllave, vinte themelet e tendencave nacionaliste e shoviniste për një Serbi të Madhe.

Gjatë gjithë periudhës në fjalë, në mënyrë të rregullt u paraqitën dokumente arkivore, të shoqëruara me fotografi mbi krimet kundër serbëve. Në kumtesën zyrtare të mbledhjes së kuvendit episkopal botëror më 1987, për herë të parë përmendet fjala “gjenocid”, për të emërtuar atë se çfarë po ndodh me popullin serb në Kosovë dhe në viset juglindore të Serbisë.²³⁵

Urdhri i vitit 1969 për regjistrimin e incidenteve kundër serbëve e kishës u zbatua me një intensitet tepër të lartë, që nga viti 1981 e tutje, madje, duke regjistruar edhe incidentet apo pretendimet nga më të thjeshtat e më banalet, e duke i shndërruar ato në incidente që kishin për qëllim presionin ndaj serbëve e malazezëve, për t’u larguar nga Kosova. Të tilla raste ishin: dëmtimi i varrit të priftit të ndjerë Sava Iliq, në shkurt të vitit 1982 në Kamenicë, uzurpimi i një pjese të kishës dhe rrënimi i rrethojave të kishës në fshatin Reti të Rahovecit, në tetor 1982, dëmtimi i varrezave serbe në Oplotushë, në Krushë të Vogël e në Rahovec.²³⁶ Tjera incidente të raportuara ishin edhe: plaçkitja e kishës Shën Premte në Dobërçan afër Gjilanit, më 1983, hedhja e gurëve kundër peshkopit Pavle, në shtator 1983, maltretimi i murgeshave në fshatin Mushtisht, etj.²³⁷

²³⁴ M. Tomaniq, *Kisha serbe në luftë dhe luftërat...*, f. 19-20.

²³⁵ Srđan Barišić, *Srpska pravoslavna crkva i Jugoslavija*,

http://www.yuhistorija.com/serbian/kultura_religija_txt00c5.html, qasja 15 qershor 2018.

²³⁶ *Шинтарски геноцид над србима у 20. Веку...*, f. 563-599.

²³⁷ *Od Kosova do Jadovna, putni zapisi jeromonaha Atanasija Jevtića*, Preštampato iz lista "Pravoslavlje" (broj 400, 15. XI 1983; 404, 15. I 1984, i 405, 1. II 1984). <http://www.kosovo.net/sk/rastko-kosovo/istorija/kosovo-jadovno.html>, qasja 29 prill 2018.

Një ngjarje tjetër që pati jehonë në opinionin publik jugosllav ishte, pa dyshim, edhe raportimi nga organet kishtare serbe në tentimin për ta përdhunuar një murgeshë në Manastirin e Goriqit. Rasti mori një ngjyrim politik, duke u trajtuar nga Komisioni për Marrëdhënie me Komunitetet Fetare të KSA të Kosovës në Prishtinë²³⁸

Po ashtu, u regjistruan edhe incidente të tjera, të cilat iu atribuuan shqiptarëve edhe pse ato mund të kenë ndodhur për shkaqe të tjera, si: zjarri në hambarin e bujikut, Radoje Shmigiq nga Dresniku i Klinës, në gusht të vitit 1984, pastaj dëmtimin e 29 gurëve të varrezave të serbëve në fshatin Dvorane afër Suharekës, në qershor të vitit 1984, djegien e nëntë mullarëve me bar në Manastirin e Deviçit, në gusht të vitit 1984, etj.²³⁹

Lloje të tilla të incidenteve të pretenduara apo të zmadhuara ishin të përditshme. Ato kishin për qëllim që ta bindin opinionin jugosllav për gjendjen e vështirë të popullatës serbe në Kosovë. Por, vetëm disa raste specifike tërhoqën vëmendjen e medieve serbe, me të cilat Beogradi zyrtar manipuloi skajshëm me to. Ato ishin: rasti Danilo Milinçiq, si dhe rasti i Gjorgje Martinoviçit.

Në vllugun e ndjekjeve dhe të diferencimeve ideopolitike, kur zhvillohej një fushatë e egër e shpifjeve dhe e inskenimeve, në shkallë jugosllave kundër “nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar” e kur sulmohej çdo gjë shqiptare në Kosovë, më 2 qershor 1982 në Samadraxhë të Vushtrrisë ndodhi një incident, ku mbeti i vrarë, Danilo Milinçiq. Kjo vrasje u përcoll nga një propagandë e ashpër serbe. Në përshkrimin e kësaj ngjarjeje, propaganda e medieve serbe shkon deri në atë pikë sa që, sipas tyre, tre fqinjë shqiptarë, jo vetëm se kishin hyrë në pronën e Milinçiqit, por edhe e kishin djegur atë, kurse gjatë ballafaqimit fizik me Milinçiqin, tre fqinjët e kishin kapur atë derisa i katërti, M.F (Muhamet Ferati - Muja) e kishte vrarë me revole në zemër. Po ashtu, sipas burimeve serbe, fqinjët e tjerë shqiptarë nuk i kishin ardhur në ndihmë Milinçiqit, por se vetëm nëna e tij kishte tentuar ta mbulonte djalin nga revolja dhe ishte plagosur në duar dhe se i gjithë ky akt u shoqërua me ofendime, sharje dhe kërcënime nga M. F. Ai kishte thënë: “se kjo pronë nuk është Serbi (RSFJ), por është toka e kryetarit shqiptar, Enver Hoxha.”²⁴⁰

²³⁸Шиптарски геноцид над србима у 20. Веку..., f. 659-663.

²³⁹По ату, f. 691-731.

²⁴⁰Данило

Милинчић, http://www.zlocininadsrbima.com/Zrtva.aspx?ImeZrtve=%D0%94%D0%B0%D0%BD%D0%B8%D0%BB%D0%BE_%D0%9C%D0%B8%D0%BB%D0%B8%D0%BD%D1%87%D0%B8%D1%9B, qasja 10 shtator 2018.

Theksimi i frazës së mësipërme nuk kishte qenë i rastësishëm, sepse përmes saj tentohej të manipulohej dhe të tmerrohej opinioni jugosllav se kjo vrasje ishte vetëm një hallkë në zinxhirin e irredentizmit dhe separatizmit shqiptar, për dëbimin e serbëve nga Kosova, uzurpimin e pronës së tyre, si dhe bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Një skenar i tillë ishte përgatitur nga qarqet nacionaliste serbe, ku emisarë të caktuar kishin përgatitur tregimin se Milinqiqi ishte sulmuar në shtëpinë e tij, kurse nënën e tij e zvarritnin nëpër TV-kanalet e Beogradit, me duar të lidhura me fashë, kinse kishte luftuar për ta shpëtuar djalin, të cilin vrasësi ia paska vrarë në oborr të shtëpisë.²⁴¹

Por, ndryshe nga propaganda serbe burimet zyrtare nga autoritetet krahinore theksojnë një version krejt tjetër të kësaj ngjarjeje. Sipas Azem Vllasit, njëri nga funksionarët më të lartë krahinor të vitit 1980, i cili i referohej edhe dokumentacionit gjyqësor, ngjarja kishte ndodhur kështu: “... *Danica, e nxiti djalin Milinqiqin që t’i dilte Feratit me revole përpara, i cili po kalonte kah ara e tij, sepse ishte turp që shqiptari t’ia shkelte arën. Ky doli dhe gjatë një kacafytjeje e rrëzoi Feratin për tokë. Ferati, po ashtu, i armatosur, në pozicion me shpinë për toke, nxjerr revolen dhe shkrep një predhë vdekjeprurëse*”.²⁴²

Po sipas Vllasit, për t’u qetësuar opinioni i krijuar me version të rrejshëm, u bë presion në tri instanca gjyqësore dhe Ferat Muja u dënua me vdekje. Versioni i vërtetë gjendet në shkresat e lëndës gjyqësore. Ishte një rast klasik i mbrojtjes së detyrueshme, eventualisht i tejkalimit të kufijve të mbrojtjes së detyrueshme. Por, e vërteta më nuk i interesonte askujt. Ferati u ekzekutua në kundërshtim me ligjin në fuqi, dispozitat e të cilit nuk lejonin që një i sëmurë apo invalid të ekzekutohej.²⁴³

Familja Milinqiq njihej për aktivitete propaganduese antishqiptare. Ajo ishte çerdhe e shovinistit serb, Rankoviq, ku ai në kohën e tij kishte kaluar shumë ditë dhe net. Në shenjë të kësaj afrie, fëmijën më të ri të Danicës, Danillon, bashkëfshatarët e quanin edhe Rankoviqi i vogël.²⁴⁴ Për më tepër, Danica Milinqiqi, 15 vjet para kësaj ndodhie, me ndihmën e djalit Danillo, kishte vrarë burrin e saj dhe për këtë akt kishte fajësuar “ballistët”, edhe pse historia e

²⁴¹ Ahmet Qeriqi, *Djallëzia dhe hipokrizia e titistit, Azem Vllasi*, publikuar më 21/10/2012 në <https://www.radiokosovaelire.com/ahmet-qeriqi-djallezia-dhe-hipokrizia-e-titistit-azem-vllasi/>

²⁴²Po aty,

²⁴³Po aty,

²⁴⁴ Nezir Myrtaj, *Ende nuk dihet ku ndodhet varri i Ferat Mujës*, <https://www.radiokosovaelire.com/nezir-myrtaj-ende-nuk-dihet-ku-ndodhet-varri-i-ferat-mujes/>, qasja 20 korrik 2018.

vërtetë e vrasjes kishte të bënte me një skandal amoraliteti, ku ishte përfshirë një zyrtar i lartë i UDB-së.²⁴⁵

Qarqet kishtarë serbe incidentin Miliniq e pasqyruan në kontekstin e arsyeve për “martirizimin” dhe shpërnguljen e detyruar të serbëve nga Kosova. Kisha Serbe i dha asaj një konotacion të paraqitjes simbolike të fatit të gjithë serbëve në Kosovë.²⁴⁶

Gazetat serbe kishin shkruar në mënyrë të përsëritshme për këtë ngjarje, por fryma e kësaj ngjarjeje do të ndihej tek pesë vite më vonë, në mbledhjen e tetë të KQ LKS, që u cilësua si fillimi i ngritjes së Millosheviqit. Gjatë “natës më të gjatë” në Shtëpinë e Kulturës në Fushë Kosovë, më 1987, Millosheviç kishte dëgjuar përvojat e serbëve të pakënaqur, në mesin e të cilëve ishte edhe Danica Miliniq.²⁴⁷

Përveç rastit Miliniq, një tjetër rast me të cilin Beogradi manipuloi skajshëm, ishte ai i Gjorgje Martinoviçit. Martinoviçi, një serb kosovar, arriti më 1 maj 1981 në qendrën mjekësore të Gjilanit me një shishe të thyer birre në anus. Vetëm tre ditë më vonë, në gazetën beogradase “Politika”, të 4 majit të vitit 1985, publikohet informacioni me titullin: “Zyrtari i shtëpisë së APJ në Gjilan, Gjorgje Martinoviç, u vu në një piring, më 1 maj, në fushën e tij, në rajonin e quajtur “Jaruga” - 2 km larg Gjilanit. Këtë akt e kryen terroristët shqiptarë”.²⁴⁸

Ky lajm shkrepri si vetëtimë në ambientin e nxehtë kosovar dhe jugosllav. Rasti filloi të cilësohet si simbol i dhunës ndaj serbëve në Kosovë, simbol i pakënaqësisë dhe i ndjenjës së viktimizimit. Po ashtu, rasti u interpretua edhe si një shkas që përshpejtoi shpërnguljen e serbëve nga Kosova. Mediet beogradase filluan menjëherë me konstruktimin e ngjarjes. Shtypi i Beogradit dhe e tërë makineria e saj nëpër botë kanë tentuar që këtë rast ta sensibilizojnë, duke i paraqitur shqiptarët popull mizor dhe johuman ndaj serbeve dhe jetës së tyre.

Në fakt, qysh në fillim, sapo ishte transportuar në spitalin e Prishtinës, Gjorgje Martinoviçi, i kishte deklaruar kirurgut shqiptar se “... më kapën dy agjentë, njëri më mbante, kurse tjetri më shtiu shishen”.²⁴⁹ Por, kjo deklaratë ishte demantuar nga vetë Martinoviçi, i cili

²⁴⁵По ату,

²⁴⁶А. Јевтић, *Страдања Срба на Косову и Метохији од 1941. до 1990. Године*, Интернет издање "Јединство" - Приштина 1990.

https://www.rastko.rs/kosovo/istorija/stradanje_srba/index_c.html

²⁴⁷ R. Dragović, *Osmi sednica CK KP Srbije*, Fejton elektronik,

http://www.novosti.rs/dodatni_sadrzaj/clanci.119.html:686773-Teror-nad-Srbima-na-Kosovu, 10 korrik 2018.

²⁴⁸ Dragan Vlahović, *Na vest o smrti Đorđa Martinovića*, publikuar më 8 shtator 2000, <http://arhiva.glas-javnosti.rs/arhiva/2000/09/10/srpski/R00090803.shtm>

²⁴⁹*Koha*, Viti II, nr. 7, 20 mars 1991, f. 23.

para gjykatësit shqiptar dhe kolonelit, Novak Ivanoviq, komandant i kazermës së APJ në Gjilan, derisa ende ishte në spital, kishte pranuar se vetë e kishte futur shishen në anus, por një fakt të tillë e kishte fshehur në mënyrë, që mos ta zbulojë bashkëshortja e tij.²⁵⁰

Në bazë të asaj çfarë vetë kishte dëgjuar nga Martinoviqi, koloneli ishte bindur në versionin e vetëlëndimit, kurse mediet serbe bindjen e tij e interpretuan si presion ndaj Martinoviqit, që ta pranojë vetëkryerjen e veprës, madje, duke aluduar se për një hap të tillë koloneli kishte qenë urdhëruar nga një gjeneral në hierarkinë e lartë jugosllave.²⁵¹

Një element tjetër, që hedh dyshime në aktin e inskenimit, është edhe mosprezenca e familjes së tij në spital, sigurisht nëse ata kishin pasur indikacione për orientimin e tij seksual. Personeli mjekësorë serb ishte i bindur në fajësinë e shqiptarëve, prandaj edhe hodhi ofendime në drejtim të kirurgut shqiptar, që kreu operimin e Martinoviqit.²⁵²

Sidoqoftë, në ditët e para pas incidentit, përkundër propagandës serbe, rasti po shkonte drejt vërtetimit të inskenimit të ngjarjes nga Martinoviqi. Kirurgu i cekur më lart, së bashku me prof. Markoviqin, ekspert i mjekësisë ligjore dhe dr. Moraqiqin, kishin konstatuar se Martinoviq ishte vetëlënduar me shishe, ngase pos rreth anusit, në asnjë pjesë të trupit nuk kishte shenja të përdorimit të forcës (gërvishtje apo lëndime të tjera). Aq më tepër, mjekët kishin vërejtur një prerje në gishtin e madh, e cila pastaj nga organet e SPB do të dokumentohej si lëndim i bërë gjatë prerjes së shkopit të drurit, ku kishte qenë e vendosur shishja.²⁵³

Konstatimi i ekipit mjekësor u vërtetua edhe nga një gjykatës kujdestar, i cili pas ftesës së policisë kishte dalë në vendin e ngjarjes dhe së bashku me ekipin policor, përveç pjesëve të thyera të shishes nuk kishin vërejtur gjurmë të këmbëve të tjera, përpos gjurmëve të këmbëve të vetë personit që kishte kryer këtë vepër. Në bazë të gjetjeve të tij, gjykatësi në fjalë, hartoi procesverbalin nga vendi i ngjarjes pa lënë asnjë dyshim për aktin e vetëlëndimit të Gjorgje Martinoviqit.²⁵⁴

²⁵⁰Bajram Kadriu: *Si e trajtova rastin e Gjorgje Martinoviqit*, publikuar më 2 maj 2015, <http://zeri.info/aktuale/30983/bajram-kadriu-si-e-trajtova-rastin-e-gjorgje-martinoviqit/>, qasja 2 maj 2015.

²⁵¹D. Vlahović, *Na vest o smrti Đorđa Martinovića*, publikuar më 8 shtator 2000, <http://arhiva.glas-javnosti.rs/arhiva/2000/09/10/srpski/R00090803.shtm>; Dosije Kosovo: Flaša kao simbol početka stradanja i egzodusa Srba sa Kosova <https://embargo.rs/dosije-kosovo-flasa-kao-simbol-pocetka-stradanja-i-egzodusa-srba-sa-kosova/>, qasja 30 shtator 2018.

²⁵²*Koha*, Viti II, nr. 7, 20 mars 1991, f. 24.

²⁵³Po aty

²⁵⁴B. Kadriu: *Si e trajtova rastin e Gjorgje Martinoviqit*, publikuar më 2 maj 2015, <http://zeri.info/aktuale/30983/bajram-kadriu-si-e-trajtova-rastin-e-gjorgje-martinoviqit/>.

Duke dashur që me çdo kusht të akuzoheshin shqiptarët, qarqet nacionaliste serbe Martinoviqin e dërguan për një ekzaminim special në Institutin Mjekësor të Akademisë Ushtarake në Beograd, ku pesë mjekë nënshkruajnë diagnozën se një lloj i tillë i vetëlëndimit është i pamundshëm. Më pas kërkohet një superekspertizë nga akademiku sloven, Janez Malčinski, nga Lubjana, i cili zyrtarisht ka shkruar se vetëlëndimi është i mundur, por edhe i pamundur! Në këtë mënyrë, dalin tre versione: në ekzaminimin e parë që iu bë Martinoviqit në Prishtinë thuhej se deri te vetëlëndimi kishte ardhur aksidentalisht. Në ekzaminimin e dytë në Beograd ishte përjashtuar mundësia e vetëlëndimit. Kurse në ekzaminimin e tretë në Lubjanë, nuk përjashtohet mundësia e përdorimit të forcës nga persona e tjerë, por se edhe vetëlëndimi ishte i mundur.²⁵⁵

Në fund, Martinoviqi dërgohet në Londër te dr. Piter Holy, i cili dy herë e operoi dhe publikisht deklaroi se vetëlëndimi është i pamundur.²⁵⁶

Deklarimet e kirurgut anglez i dhanë gjallëri propagandës serbe, e cila tani bazohej në konstatimet nga faktori ndërkombëtar e i “paanshëm”. Në këtë mënyrë, procesi i vërtetimit të aktit të Martinoviqit, përveç propagandës, ishte shoqëruar edhe me një presion politik. Ky presion ishte i qartë në rastin e mjekëve, derisa në fillim edhe vetë Moraçiqi e pranonte se Martinoviqi ishte lënduar vetë, pas shkuarjes së tij në Beograd, ai ndërroi mendje dhe propagandonte tezën tjetër se Martinoviqin e kishin lënduar shqiptarët. Ndërkaq, prof. Markoviqi, prej ditës së parë nuk e ndryshoi konstatimin profesional, si ekspert i mjekësisë ligjore, se Martinoviq ishte lënduar vetë.²⁵⁷

Në vazhden e aktiviteteve për shtrembërimin e fakteve, në favor të tezës se krimin e kishin bërë shqiptarët, hetues specialë serbë nga Beogradi e Nishi, kishin kërkuar nga gjykatësi shqiptar, Bajram Kadriu, riekzaminimin e vendit të ngjarjes, por ai kishte refuzuar një kërkesë të tillë me faktin se vendi i ngjarjes ishte ekzaminuar dhe tanimë ekziston mundësia e manipulimit me të. Një presion i tillë ndaj gjykatësit shqiptar kishte vazhduar edhe më tej. Tani në Gjilan

²⁵⁵Илустрована Политика, Београд, 29 јул 1986.

²⁵⁶ D. Vlahović, *Na vest o smrti Đorđa Martinovića*, publikuar më 8 shtator 2000, <http://arhiva.glas-javnosti.rs/arhiva/2000/09/10/srpski/R00090803.shtm>; Dosije Kosovo: Flaša kao simbol početka stradanja i egzodusa Srba sa Kosova <https://embargo.rs/dosije-kosovo-flasa-kao-simbol-pocetka-stradanja-i-egzodusa-srba-sa-kosova/>, qasja 30 shtator 2018.

²⁵⁷*Koha*, Viti II, nr. 7, 20 mars 1991, f. 24.

kishte arritur Prokurori Federativ, i cili kishte bërë presion që të ndryshohet qëndrimi me qëllim që “të qetësohet “Çarshia e Beogradit”, mirëpo pa sukses. Procesverbali mbeti i njëjtë.²⁵⁸

Lidhur me rastin e Gjorgje Martinoviçin u diskutua tetë herë edhe në Kuvendin e Jugosllavisë, por pa rezultate. Kuvendi i Serbisë gjashtë herë e shtyu këtë diskutim, pasi që udhëheqja serbe konsideronte se ajo nuk ishte kompetente, sipas Kushtetutës së Krahinës së Kosovës. Zgjidhjes së rastit nuk i kontribuoi as letra e shkrimtarit të njohur, Dobrica Qosiqit, që haptas i ishte adresuar Branko Mamullës dhe Dushan Çkrebiqit, atëherë kryetar i Serbisë.²⁵⁹

Qarqet nacionaliste serbe fajin për pamundësinë për t'i ndryshuar faktet ia hedhin Stane Dolancit, atëherë Ministër i Brendshëm Federativ, që edhe e drejtonte rastin. Sidomos, prekëse për opinionin serb ishte deklarata e tij në televizionin e Lubjanës më 1987 se “... *Policia ka vërtetuar se ai është vetëlënduar dhe nuk do të ketë ndonjë proces gjyqësor. Gjorgje është samuraji i parë serb që ka kryer harakiri*”, thoshte Dolanci me një buzëqeshje të dukshme.²⁶⁰

Gjenerali, Petar Graçanin, që e pasoi Dolancin në postin e sekretarit të brendshëm federativ, kërkoi që dosja e rastit Martinoviç të mbyllet.²⁶¹ Një kërkesë e tillë shkon në favor të tezës së inskenimit, sidomos, kur dihen qartë tiparet nacionaliste të Graçaninit dhe qëndrimit të tij antishqiptar.

Martinoviçi u bë simbol i “sakrificës dhe i viktimizimit të serbëve në Kosovë”. Përveç tjerash, e fuqishme ishte, sidomos, propaganda artistike. U incizuan dy filma dokumentarë mbi Martinoviçin nga regjisori Millorad Bajiç.²⁶²

Martinoviçi u reflektua edhe në fushën e arteve të bukura. Piktori, Miça Popoviç pikturoi viktimizimin e Gjorgje Martinoviçit, që paraqitet përmes një paraleleje të qartë me kryqëzimin e

²⁵⁸B. Kadriu: *Si e trajtova rastin e Gjorgje Martinoviçit*, publikuar më 2 maj 2015, <http://zeri.info/aktuale/30983/bajram-kadriu-si-e-trajtova-rastin-e-gjorgje-martinoviçit/>.

²⁵⁹Srpski političari ubijali istinu o Đorđu Martinoviću <http://arhiva.glas-javnosti.rs/arhiva/2005/08/22/srpski/D05082101.shtml>., qasja 10 gusht 2018.

²⁶⁰Dosije Kosovo: Flaša kao simbol početka stradanja i egzodusa Srba sa Kosova <https://embargo.rs/dosije-kosovo-flasa-ka-simbol-pocetka-stradanja-i-egzodusa-srba-sa-kosova/>., qasja 30 shtator 2018.

²⁶¹Dosije Kosovo: Flaša kao simbol početka stradanja i egzodusa Srba sa Kosova <https://embargo.rs/dosije-kosovo-flasa-ka-simbol-pocetka-stradanja-i-egzodusa-srba-sa-kosova/>., qasja 30 shtator 2018.

²⁶²D. Vlahović, *Na vest o smrti Đorđa Martinovića*, publikuar më 8 shtator 2000, <http://arhiva.glas-javnosti.rs/arhiva/2000/09/10/srpski/R00090803.shtml>;

Jezusit, nën syrin e hapur të policisë komuniste, nga shqiptarët me plisa në kokë. Për këtë punim, piktori Miqa Popoviq ka fituar titullin piktor akademik.²⁶³

Mund të thuhet se kjo ngjarje ishte pika fillestare e shumë zhvillimeve të mëvonshme në Kosovë e Jugosllavi, e në një mënyrë edhe e mbledhjes së tetë të LKS, që u mbajt një vit e gjysmë më pas. Propaganda nacionaliste serbe e cilësoi këtë, si një akt, që përshpejtoi shpërnguljen e serbëve dhe të malazezëve nga Kosova.

3.3. "Memorandumi" i Akademisë së Shkencave dhe e Arteve të Serbisë (SANU) i vitit 1986 dhe impakti i tij në ringjalljen e ideologjisë nacionaliste serbe

Qysh në vitin 1984, te qarqet akademike serbe u theksua edhe më tej brenga rreth krizës ekonomike në vend dhe statusit të Serbisë në Federatë. Akademiku, Dobrica Qosiq, në vitin 1984, fliste për “ngarkesat e së kaluarës dhe sfidat e së ardhmes” dhe kërkonte që edhe ASSHA të deklarohej për nevojën e angazhimit “rreth problemeve gjithëshoqërore e kombëtare”. Propozimi i akademikut, Ivan Maksimoviq se” “...problemet më akute shoqërore, politike, ekonomike, të mirëqenies sociale, shkencore dhe kulturore duhet të adresohen në formë të një memorandum. Ky memorandum duhet të qarkullojë në të gjitha instancat, që kanë të bëjnë me çështjet publike në Serbi dhe në Jugosllavi”, ku gjeti përkrahjen e kolegëve të tij në ASSHA. Prandaj, kryesia e këtij institucioni në mbledhjen e mbajtur, më 13 qershor 1985, emëroi një “komision për të përgatitur një memorandum për çështjet aktuale shoqërore”. Mbledhja e parë e këtij komisioni u mbajt, më 28 qershor. Dushan Kanazir dhe Antonije Isakoviq, që të dy me pozita të larta në Akademi, u zgjodhën kryetar dhe zv. kryetar të Këshillit. Po ashtu, u zgjodh grupi punues që kryesohej nga Antonije Isakoviqi.²⁶⁴ Përveç këtyre dy kryesuesve, anëtarë të komitetit ishin: Pavle Iviq, Mihajlo Markoviq, Milosh Macura, Dejan Medakoviq, Miroslav Pantiq, Nikolla Pantiq, Ljubisha Rakiq, Radovan Samarxhiq, Miomir Vukobratoviq, Vasilije Krstiq, Ivan Maksimoviq, Kosta Mihajloviq, Stojan Çeliq dhe Nikolla Çobeljiq.²⁶⁵

²⁶³B. Kadriu: *Si e trajtova rastin e Gjorgje Martinoviqit*, publikuar më 2 maj 2015,

<http://zeri.info/aktuale/30983/bajram-kadriu-si-e-trajtova-rastin-e-gjorgje-martinoviqit/>.

²⁶⁴ Kosta Mihailovic, Vasilije Krstic, *Memorandum of the Serbian Academy of Sciences and Arts – Answers to Criticisms*, Serbian Academy of Sciences and Arts, Belgrade, 1995, f. 13.

²⁶⁵ Enver Hoxhaj, *Politika etnike dhe shtetndërtimi i Kosovës*, Pejë 2008, f. 93.

Zgjedhja e 28 qershorit nuk është e rastësishme. Një ditë e tillë në historinë serbe simbolizon Betejën e Kosovës të vitit 1389, ku serbët pretendonin ta kenë mbrojtur civilizimin e krishterë dhe se humbja përballë Perandorisë Osmane ishte shoqëruar me dyndjen e shqiptarëve në Kosovë. Për më tepër, puna në këtë projekt u shoqërua me përgatitjet për manifestimin e njëqindvjetorit të ASSHA, kur vetëm një muaj para manifestimit, gjithçka u ndal përmes publikimit të materialit, të quajtur atëherë “Memorandumi i ASSHA”.²⁶⁶

Gazeta beogradase: “Veçernje Novosti” arriti të shtie në dorë tekstin e papërfunduar të Memorandumit dhe ta botojë atë. Ky botim, përbën faktikisht edhe fundin e punës për këtë material. Teksti kryesor në faqen e dytë të gazetës: “Veçernje Novosti”, të 24 shtatorit të vitit 1986, titullohej: “Çka përmban Draftmemorandumi i Komisionit të Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve”. Nën të ishte vendosur titulli sugjestiv: “Oferta e pashpresë”. Nën këto fjali të zgjedhura me kujdes nga redaksia fshihej teksti, që për herë të parë do të nxirrte në dritë pjesë nga Memorandumi i papërfunduar i ASSHA. Të nesërmen, në faqen e njëjtë, po të njëjtës gazetë qëndronte titulli: “Edhe AVNOJ paska qenë i rrejshëm”. Që të dy tekstet, i nënshkroi gazetari dhe redaktori i atëhershëm i gazetës: “Novosti”, Aleksandar Gjukanović. Këta dy artikuj nxitën një debat të ashpër në publikun jugosllav, si dhe polemika të ndryshme në faqet e kësaj gazete.²⁶⁷

Çështja e parë që e preokupoi opinionin publik jugosllav ishte se nga e mori gazetari tekstin? Ishte kjo një pyetje, përgjigja e vërtetë e së cilës do të hidhte në dritë shumë gjëra, ndër të cilat më e rëndësishmja ishte se çfarë fshihej pas këtij botimi. Qarkullonin versione të shumta, që nga vjedhja e këtij materiali e deri te lëshimi i qëllimshëm. Njohësit e rrethanave shoqërore të viteve të 80-ta, tregojnë se ekzemplarët e parë të Memorandumit filluan të qarkullonin në Beograd, dhjetë ditë më herët, se sa që ishte botuar në gazetën: “Novosti”. Rrethi i ngushtë i “njerëzve të duhur”, përmes lidhjes së duhur, mund të siguronte një kopje edhe tek adresa “Francuska 7”, më saktë, në restorantin e Klubit të Shkrimtarëve.²⁶⁸

²⁶⁶ Vreme, br. 247, 17 jul 1995, <https://www.vreme.com/cms/view.php?id=1377420>, tërhequr më 30 tetor 2018.

²⁶⁷Rade Dragović, Memoradum SANU - tri decenije posle, *Fejton elektronik*http://www.novosti.rs/dodatni_sadrzaj/clanci.119.html:625479-Pocetak-medijsko-politickog-trilera, qasja 10 shtator 2018.

²⁶⁸R. Dragović, Memoradum SANU - tri decenije posle, *Fejton elektronik*http://www.novosti.rs/dodatni_sadrzaj/clanci.119.html:625479-Pocetak-medijsko-politickog-trilera, qasja 10 shtator 2018.

Sipas Dobrica Qosiqit, ishte policia e Stane Dolancit, që e kishte vjedhur Memorandumin dhe që e kishte filluar makinerinë e saj propagandistike kundër ASSHA.²⁶⁹

Versioni zyrtar thotë se Memorandumi ishte vjedhur. Në mesin e kontradiktave për “vjedhje” në ASSHA atyre ditëve të vitit 1986 u gjend gazetari, Aleksandar Gjukanoviq. Tek ai ra dyshimi se personalisht e kishte vjedhur këtë dokument, dhe atë nga askush tjetër përveç se nga vjehri i tij, profesori dhe autori i njohur i shkrimit të kushtetues, profesori i Fakultetit Juridik, akademiku, Jovan Gjorgjeviqi. Por, Gjukanoviqi kishte mohuar ta ketë vjedhur tekstin nga tavolina e punës së vjehrit të tij. Në një shkrim në “Novosti”, ai thotë se tekstin ia kishin dhënë vetë akademikët. Pas leximit ky kishte vendosur ta botonte në gazeta.²⁷⁰

Duket se një veprim i tillë kishte qenë i parapërgatitur, me qëllim që të testohet reagimi i opinionit publik dhe, njëkohësisht, të shërbente si mekanizëm për mobilizimin e masave serbe. Ndonëse, Memorandumi mbeti i papërfunduar, sipas mendimit të anëtarëve të kryesisë së ASSHA puna e bërë: *“ka pasur pasoja domethënëse për zhvillimin shoqëror gjatë viteve të fundit. Ai është kuptuar edhe si një lloj programi kombëtar për marshimin e popullit serb drejt së ardhmes”*.²⁷¹

Teksti i Memorandumit përbëhej prej 73 faqesh, prej të cilave, ashtu sikurse vërteton sot ASSHA, vetëm 30 faqe e kishin kaluar procedurën e redaktimit zyrtar. Teksti i saj ishte i ndarë në dy pjesë: pjesa e parë, kishte të bënte me krizën e shoqërisë dhe ekonomisë jugosllave, kurse i dyti ishte emërtuar: “Pozita e Serbisë dhe e popullit serb”. Nëntë pika të këtij dokumenti paraqesin kritika të shumta për gjendjen e atëhershme. Po ashtu, paraqiteshin edhe një numër faktesh e dëshmish për pretendimet kryesore të autorëve të tekstit: *“Jugosllavia ka nevojë për rirregullim. Në të kundërtën, nuk do të ekzistojë. Populli serb, sikurse thanë akademikët, duhet të jetë i përgatitur edhe për këtë përfundim”*.²⁷²

Memorandumi bëri jehonë të madhe në gjithë Jugosllavinë, sidomos duke zgjuar frikë dhe pasiguri te komunitetet jo serbe. Duke u konsideruar si një platformë nacionaliste, Memorandumi u kritikua nga mediet e kontrolluara nga regjimi komunist gjatë vjeshtës së vitit 1986 dhe pranverës së vitit 1987, si në Serbi, ashtu edhe në njësitë e tjera federale.

²⁶⁹D. Čosić, Piščevići Zapisi (1981-1991), Fejton elektronik, http://www.novosti.rs/dodatni_sadrzaj/clanci.119.html:275783-Haranga-protiv-SANU, qasja 10 korrik 2018.

²⁷⁰R. Dragović, *Osmo sednica CK KP Srbije*, Fejton elektronik, http://www.novosti.rs/dodatni_sadrzaj/clanci.119.html:686773-Terror-nad-Srbima-na-Kosovu, 10 korrik 2018.

²⁷¹M. Tomaniq, *Kisha serbe në luftë dhe luftërat...*, f. 15-16.

²⁷²R. Dragović, *Osmo sednica CK KP Srbije*, Fejton elektronik, http://www.novosti.rs/dodatni_sadrzaj/clanci.119.html:686773-Terror-nad-Srbima-na-Kosovu, 10 korrik 2018.

Memorandumi u kritikua edhe nga instancat politike të Serbisë. Komiteti Qendror i LK të Serbisë, atëherë i udhëhequr nga Ivan Stamboliçi kishte kërkuar tërheqjen e këtij Memorandumi. Pavarësisht, kritikave dhe presioneve nga regjimi i Stamboliçit, për t'u tërhequr nga ky akt, sikurse mbledhja e aktivitetit të LK në Akademi, më 14 tetor 1986, mbledhja e mbyllur e Kryesisë së Serbisë, më 21 tetor, vizita e Ivan Stamboliçit në ASSHA, më 29 tetor, Kuvendi i jashtëzakonshëm i ASSHA, më 18 dhjetor 1986, etj., akademikët mbrojtën Memorandumin dhe ishin konsekuent në qëndrimin e tyre. Duke e cilësuar memorandumin si “një tekst që, juridikisht, nuk ekziston”, ASSHA e liroi veten që ta shprehë qëndrimin e saj për përmbajtjen e tekstit, duke e zhvendosur fokusin në mënyrën problematike të daljes së tekstit në publik.²⁷³ Po aty, në Kuvendin e jashtëzakonshëm të ASSHA, pavarësisht, presioneve të shumta, akademikët me shumicë votash, 114 nga gjithsej 137, u deklaruan për besimin ndaj anëtarëve të Këshillit Ekzekutiv të Kryesisë së ASSHA.²⁷⁴

Në vazhdën e këtyre kritikave, ajo që tërheq vëmendje ishte qëndrimi i Sllobodan Millosheviqit ndaj Memorandumit. Ai kishte qëndruar i heshtur, por me ndryshimin e rrethanave ai kishte kritikuar Ivan Stamboliçin dhe ithtarët e tij, lidhur me qëndrimin e tyre ndaj Memorandumit.²⁷⁵

Në pjesën e parë të Memorandumit, ku flitej për krizën ekonomike, qysh në fillim konstatohet se: “kriza ekonomike zgjat që pesë vite, kurse dalja nga ajo as që duket në horizont”. Por, edhe theksohet se dalja nga kriza është e mundur vetëm përmes “ndryshimeve themelore në sistemin ekonomik dhe politik”. Problemi kryesor ekonomik i Jugosllavisë së viteve të 80-ta, sipas hartuesve të Memorandumit, ishte dezintegrimi, si një tendencë bazë në ekonomi dhe në shoqëri. Doktrina e vetëqeverisjes nuk kishte, as që mund të kishte, ndonjë përgjigje të vendosur në mbylljen gjithnjë në rritje të ekonomive republikane, të cilat gjithnjë e më tepër u fokusuan kah tregu kombëtar.²⁷⁶

Kjo pjesë vazhdon të ofrojë të dhëna nga një studim i hollësishëm i gjendjes dhe shkaqeve që e sollën atë. U studiuan aspekte shumëdimensionale ekonomike, duke filluar që nga viti 1960, duke i përshkruar trendët dhe politikat ekonomike, të cilat Memorandumi i cilëson të gabuara, por theksi kryesor vihet te decentralizimi. Këtu vërehet brenga e akademikëve serbë,

²⁷³ *Vreme*, br. 247, 17 jul 1995, <https://www.vreme.com/cms/view.php?id=1377420>, qasja 30 tetor 2018.

²⁷⁴ *Политика*, Београд, 19 децембар 1986, f. 7.

²⁷⁵ V. Meier, *Yugoslavia...*, f. 38.

²⁷⁶ K. Mihailovic, V. Krstic, *Memorandum of the Serbian Academy of Sciences and Arts—Answers...*, f. 96-97.

sepse njësitë e veçanta ekonomike ishin shoqëruar me krijimin e njësisive përkatëse politike. Kjo do të çonte në krijimin e një ekonomie të veçantë për secilën republikë dhe krahinë, gjë që jepte tipare shtetërore dhe mundësonte një secesion të mëvonshëm të cilësdo prej tyre, ku shqetësimi qëndronte sidomos te Kosova.

Memorandumi i jepte rëndësi të theksuar edhe rregullimit kushtetues të Jugosllavisë, sidomos, raportit të krahinave me Serbinë, duke potencuar se një kushtetutë e tillë promovonte elemente të konfederatës, pasi që kushtetutat republikane dhe krahinore mund të mos jenë në harmoni me Kushtetutën Federale. I vetmi obligim ishte që këto kushtetuta republikane apo krahinore të mos binin në konflikt me Kushtetutën Federative. Nuk parashiheshin zgjidhje ligjore në rast të ndonjë konflikti të mundshëm. Në anën tjetër, në rast të një konflikti midis statusit republikan apo krahinor me atë federal, prioritet kishte statusi republikan apo krahinor, dispozitat e të cilave mbeteshin në fuqi, deri në kohën, kur Gjykata Kushtetuese ta lëshonte vendimin e saj.²⁷⁷

Në pjesën e parë të Memorandumit, trajtohen edhe probleme të tjera nga fusha ekonomike e shoqërore, çështjet sociale, etj. Por, pjesa më e diskutueshme e Memorandumit, dhe ajo çfarë bëri jehonë të madhe në opinionin publik jugosllav të asaj kohe, por edhe të opinionit ndërkombëtar më vonë, ishte pjesa e dytë e Memorandumit, që trajtonte çështjen e statusit të Serbisë dhe të popullit serb.

Reagimin më të ashpër të qeverisë e nxiti pjesa e Memorandumit, që kishte të bënte me pozitën e popullit serb. Akademikët shkruan ato për çfarë flitej me të madhe pas miratimit të Kushtetutës së vitit 1974, ku në këtë mënyrë ranë në konflikt me elitën udhëheqëse, e cila ishte e shurdhër mbi pozitën e serbëve në federatë. *“Shumë pakënaqësi që e mendojnë popullin serb dolën në rastet që janë të përbashkëta me gjithë popujt jugosllavë. Por, serbët janë nën presion të argumenteve të tjera. Prapambetja afatgjate në zhvillimin e ekonomisë së Serbisë, raportet e parregulluara juridike me Jugosllavinë dhe krahinat, si dhe gjenocidi në Kosovë, u paraqitën në skenën politike me një fuqi të bashkuar, që e acaroi situatën edhe më shumë. Këto tre çështje të mundimshme, që burojnë nga politika afatgjate ndaj Serbisë, me kompleksitetin e vet*

²⁷⁷ Po aty, f. 105.

“rrezikojnë jo vetëm popullin serb, por edhe stabilitetin e gjithë Jugosllavisë”, ishte njëra nga qëndrimet kryesore të draftmemorandumit.²⁷⁸

Përmes parashikimit se: “brenda dhjetë vitesh, nëse nuk ndryshon diçka, në Kosovë nuk do të ketë më serbë” dhe se do të arrihej: “Kosova e pastër etnikisht”, të definuar me programin e Lidhjes së Prizrenit (1978-1881) - autorët e Memorandumit të ASSHA të vitit 1986 iu rrekën edhe gjendjes së popullit serb në krahinën e atëhershme autonome të Kosovës. Në kohën e revoltave dhe shprehjes së parullës: “Kosova Republikë!”, akademikët nxorën edhe parashikimin e errët të shpërnguljes së serbeve dhe të malazezëve nga Kosova. Duke cituar Jovan Cvijiqin, akademikët nxorën të dhëna mbi të gjitha shpërnguljet, përfshirë edhe atë të Arsenije Cernojeviqit, ku u dëbuan rreth 500.000 serbë, përfshirë edhe 150.000, që shtëpitë e tyre i braktisën gjatë viteve 1876-1912. Gjatë katër viteve të Luftës së Dytë Botërore nga Kosova u dëbuan 60.000 serbë. Gjatë njëzet viteve, sipas tyre, Kosovën e braktisën rreth 200.000 serbë.²⁷⁹

Sigurisht, që këto të dhëna janë të falsifikuara, sidomos, kur është çështje e diskutueshme shpërngulja e serbëve nën Cernojeviqin, apo edhe gjatë viteve 1876-1912, kur dihet mirë se trevat e banuara me shqiptarë, në pjesën verilindore të Kosovës u pushtuan nga ushtria serbe, e cila përveç aneksimit bëri edhe spastrimin etnik të atyre viseve.*

“Përmes vlerësimeve nga forumet e ndryshme politike, popullit serb në Kosovë kursesi nuk mund t’i mohohet e drejta, që përmes gjitha mjeteve ligjore të mbrohet nga dhuna. Nëse këtë mbrojtje ata nuk mund ta realizojnë në krahinë, populli duhet ta kërkojë realizimin e saj në republikë dhe federatë”²⁸⁰, ishte pjesa ku u trajtua Peticioni 2016* dhe veprimtaria politike e serbëve nga Kosova, ku haptazi paralajmëroheshin veprimet e tyre në të ardhmen.

Shtjellimi i pozitës së serbëve jashtë Serbisë, paraqiste një çështje komplekse, sepse sipas vlerësimeve dilte se jashtë kufijve të Serbisë së ngushtë jeton një numër mjaft i madh i serbëve, më i madh se numri i përbashkët i të gjithë kombësive të tjera. Sipas regjistrimit të vitit 1981

²⁷⁸R. Dragović, Memorandum SANU - tri decenije posle, Fejton elektronik http://www.novosti.rs/dodatni_sadrzaj/clanci.119.html:625479-Pocetak-medijsko-politickog-trilera, qasja 10 shtator 2018.

²⁷⁹ K. Mihailovic, V. Krstic, *Memorandum of the Serbian Academy of Sciences and Arts—Answers...*, f. 129-130.

*Gjatë vitit 1877/78 ushtria serbe largoi me dhunë nga Sanxhaku i Nishit mbi 200.000 shqiptarë...për më tepër shih: Sabit Uka, “Planet antishqiptare të shteteve fqinje në shekullin XIX”, *Shqiptarët në rrjedhat ballkanike*, Instituti Albanologjik Prishtinë, 1996, f. 162.

²⁸⁰ K. Mihailovic, V. Krstic, *Memorandum of the Serbian Academy of Sciences and Arts—Answers...*, f. 129-130.

* Në tetor 1985 rreth 2016 serbë në Kosovë e nënshkruajnë një petition me frymë nacionaliste: “Kjo është toka jonë. Nëse Kosova dhe Metohia nuk janë serbe, atëherë ne nuk kemi ndonjë tokë tonën”...për më tepër shih: H. Clark, *Civil Resistancein Kosovo...*, f. 17.

jashtë territorit të Serbisë jetonin 24% apo 1,958.000 serbë, që është një numër më i madh se sa i sllovenëve, shqiptarëve apo maqedonasve në Jugosllavi veç e veç, e njëjtë edhe sikur myslimanët. Jashtë territorit të ngushtë të Serbisë jetonin 3,285.000 serbë apo 40,3% i numrit të tyre të përgjithshëm. Një theks i veçantë iu kushtua serbëve të Kroacisë, të cilët i ishin nënshtruar “diskriminimit dhe asimilimit”.²⁸¹ Memorandumi theksonte edhe pozitën e serbëve në Bosnjë-Hercegovinë. Edhe këtu serbët u përshkruan si viktimë. *“Të mësuar nga përvoja e gjenocidit gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe të vetëdijshëm se gjenocidi mund të përsëritej në çdo kohë, sikurse ishte rasti për fat të keq, serbët filluan të largohen nga Bosnja-Hercegovina pasi që në këtë republikë aktet diskriminuese ndaj serbëve po bëheshin gjithnjë e më të shpeshta.”*²⁸² Me fjalë të tjera, Memorandumi jepte mesazhin se: “Rivendosja e integritetit të plotë nacional dhe kulturor të popullit serb, pavarësisht, se në cilën republikë apo rajon serbët banonin, është e drejtë e tyre historike dhe kushtetuese”.²⁸³ Për të arritur këtë të “drejtë”, ndryshimi i Kushtetutës së vitit 1974 ishte i domosdoshëm. Trajtimi i çështjes së serbëve jashtë Serbisë jepte indikacione drejt arritjes së një zgjidhjeje, ku populli serb duhej të jetonte i bashkuar në rast të dezintegritimit të Jugosllavisë, që u vërtetua si një projekt, që solli luftëra, vdekje e shkatërrime të shumta.

Memorandumi përmbyllet me “gatishmërinë për të qenë në shërbim të realizimit të detyrave të përcaktuara në të dhe për hir të diktateve të historisë dhe gjeneratave të ardhshme”. Kjo dëshmon se si ASSHA shtroi rrugën për një politikë të caktuar të zgjerimit territorial, me marrëveshje apo manu *militari*, sikurse, përcaktoi, Dobrica Qosiqi, duke i dhënë diskursit serb një argument shtesë në luftën e ardhshme për Serbinë e Madhe.²⁸⁴

Argumentet për shkrimin e Memorandumit dhe pasojat që dolën nga ky tekst janë studiuar thellësisht nga studiues të ndryshëm nga rajoni. Në këtë aspekt, në studimin e saj të detajuar, studiuesja, Vesna Peshiq, vë në pah se nacionalizmi serb përbëhej prej dy komponentëve. Derisa komponenti i parë ishte për konsum të brendshëm, duke i ofruar lidërsipit konservativ serb një taksonomi reale dhe të fabrikuar të ankesave serbe ndaj popujve të tjerë të Jugosllavisë, komponenti i dytë, i jashtëm, përmbante një rishikim të marrëdhënieve midis Serbisë me kombet e tjera dhe me Jugosllavinë, si tërësi. Këto komponentë u gërshetuan

²⁸¹ Po aty, 131-133.

²⁸² Po aty, 10-11.

²⁸³ V. Meier, Yugoslavia ..., f. 46-47.

²⁸⁴ Enver Hasani, “Reflections on Serbian nationalism and the policy of ethnic cleansing” <http://sam.gov.tr/wp-content/uploads/2015/06/REFLECTIONS-ON-SERBIAN-NATIONALISM-AND-THE-POLICY-OF-ETHNIC-CLEANSING-ENVER-HASANI.pdf>, qasja 20 tetor 2018.

në Memorandumin e vitit 1986. Prandaj, bazuar në këtë dokument dhe në pozicionime të shkrimtarëve të njohur dhe anëtarëve serbë të ASSHA, të cilat shpreheshin në gazetat ditore serbe, ajo identifikoi shtatë elemente kryesore të “zemërimit” serb:

- (1) **Jugosllavia është një iluzion serb:** Sipas këtij përkufizimi, serbët në mënyrë naive u viktimizuan, duke pranuar jugosllavizmin dhe lidhjet vëllazërore me popujt e tjerë, derisa këta “vëllezër” në mënyrë të vazhdueshme po i ndërtonin shtetet e tyre etnike-nacionale mbi eshtrat e serbëve të vdekur, që luftuan në luftën për liri. Vetëm serbët e duan Jugosllavinë. Ata ishin të vetmit për të abdikuar nga shteti serb për hir të unitetit jugosllav. Ata humbën një kohë të konsiderueshme historike, derisa e kuptuan se Jugosllavia ishte një iluzion serb.²⁸⁵
- (2) **Konspiracioni kundër serbëve:** Gjatë gjithë historisë jugosllave serbët iu ekspozuan konspiracionit të Kominternit, LKJ-së, Titos (kroat) dhe Kardelit (slloven), që luajtën role kryesore në vendimmarrjet jugosllave dhe të cilët zbatuan politikën kundër serbe. Si pjesë e revolucionit të saj social dhe të luftës kundër hegjemonizmit serb, LKJ veprroi në zvogëlimin e Serbisë, në një pashallëk turk të Beogradit dhe promovoi dezintegrimin dhe asimilimin e popullit serb: “Ideologjia austro-hungareze dhe ajo e Kominternit u shkrinë në Titizëm. Duke përcaktuar kufijtë politikë të republikave, duke zhvilluar etatizmin republikan...dhe duke hartuar Kushtetutën e vitit 1974, Titizmi bënte gjithçka për ta dezintegruar popullin serb dhe e arriti një gjë të tillë”.²⁸⁶
- (3) **Serbia është shfrytëzuar:** Serbia është shfrytëzuar ekonomikisht nga Sllovenia dhe Kroacia, ku kjo sqaron prapambeturinë ekonomike të saj. Pjesa më e madhe e Memorandumit të ASHAS i përkushtohet kësaj teme, të formuluar në këtë mënyrë: “Gjatë gjithë periudhës së pasluftës, ekonomia e Serbisë i ishte ekspozuar një shkëmbimi jo ekuivalent...”. Situata e Serbisë duhet të vështrohet brenda kornizave të dominimit politik dhe ekonomik të Sllovenisë dhe të Kroacisë, të cilët ishin nismëtare të ndryshimeve në gjitha sistemet e mëparshme.²⁸⁷

²⁸⁵V. Pesic, “Serbian Nationalism and the Origins of ...”, f. 18-19.

²⁸⁶Po aty, fq.19

²⁸⁷ Po aty

- (4) **Serbët janë humbës:** Sepse ata janë të vetmit që nuk kanë një shtet të mirëfilltë. Ata fituan në luftë, por humbën në paqe. Serbët dhe malazezët sakrifikuan shtetet e tyre për formimin e Jugosllavisë.²⁸⁸
- (5) **Serbët u ekspozohen urrejtjes nga popujt e tjerë jugosllavë:** Urrejtja kundër serbëve është një temë mbizotëruese në shkrimet e intelektualëve serbë, të shprehur në mënyra të ndryshme. Secili nga popujt jugosllavë ka një urrejtje të veçantë ndaj serbëve. Për shembull: “Komunistët maqedonas i kanë maqedonizuar serbët (p.sh. kanë kryer etnocid kundër serbëve në republikën e tyre)”. Dhe, kjo vlen për të gjithë popujt e tjerë. (f. 19-20)
- (6) **Serbët i janë nënshtruar gjenocidit:** Përsëri armiqte dhe politika e tyre kundër serbëve. Motivi i liderëve serbë në provokimin e frikës dhe të përplasjeve etnike, kishte për qëllim t’ua përkujtojë serbëve mundësinë e përhershme të gjenocidit kundër tyre dhe për të parandaluar një fushatë gjenocidi ndaj serbëve. Kjo temë u interpretua në mënyra të ndryshme, por më së shumti duke paraqitur fotografi dhe të dhëna mbi krimet e ustashëve ndaj serbëve, në gjitha gazetat kryesore të republikës dhe në televizion. Priftërinjtë ortodoksë serbë kërkonin, që të lejoheshin t’i nxirrnin eshtrat e viktimave serbe nga varret masive të Luftës së Dytë Botërore dhe t’i rivarrosnin ata me dinjitet. Zhvarrosja dhe rivarrosja kishte një rol simbolik në përcaktimin e kufijve shtetërorë të Serbisë: ku ka varre serbe, aty janë edhe kufijtë serbë. Gjatë fushatave serbe në vazhdimësi rritej numri i viktimave serbe.²⁸⁹
- (7) **Një shtet kombëtar për gjithë serbët:** “Ne serbët duhet të mësohemi të mendojmë se ne mund të jetojmë të vetëm”. Në këtë mënyrë, shteti kombëtar serb shihej si një: “çështje e lirisë dhe e drejtës për të ekzistuar për etnosin serb, si një tërësi e identitetit të tij historik, kulturor dhe shpirtëror, pavarësisht kufijve aktualë republikanë dhe të kushtetutës jugosllave. Nëse kjo liri dhe këto të drejta nuk respektohen, atëherë nuk është përmbushur qëllimi historik i popullit serb – unifikimi i të gjithë serbëve në një shtet.”²⁹⁰

Këto shprehje nacionaliste, të cilët u përhapën nga inteligjenca serbe, përmes mjeteve të informimit, nuk do të ishin plotësisht të suksesshme nëse nuk do të përqafoheshin nga elita politike dhe ushtarake e Serbisë, si një pjesë e aktivitetit të tyre ditor, ndonëse, ata publikisht nuk i paraqitën qëndrimet e tilla të tyre.

²⁸⁸Po aty

²⁸⁹Po aty, f. 20

²⁹⁰Po aty

Një analizë të mirëfilltë mbi efektet e Memorandumit e paraqiti edhe ish - kryetari i fundit i Jugosllavisë, Stipe Mesiq*. “Në rastin e Kroacisë, ky akt nënkuptonte gjunjëzimin para Millosheviqit, i cili te vetja e tij bashkoi planin hegjemonist të shekullit të kaluar të Garashaninit, planin Pashiq-Karagjorgjeviq për Ballkanin, sipas Marrëveshjes së Londrës të vitit 1915 dhe të Memorandumit të Qosiqit në ASSHA – Serbët duhet ta përmbushin misionin e tyre historik, e ky mision mund të përmbushet vetëm nëse bashkohen në Serbinë homogjene dhe brenda kornizës të Jugosllavisë, të cilën do ta mbizotërojnë me frymën e tyre, duke ia dhënë edhe vulën e tyre. Serbët duhet ta kenë hegjemoninë e tyre në Ballkan dhe në Jugosllavi. Prandaj, atyre iu imponua detyra e parë: që ta krijojnë dhe ta organizojnë Serbinë homogjene, e cila duhet të përfshijë të gjitha rajonet etnike, ku jetojnë serbët” – shkruan në librin e tij: “Kako smo razbili Jugoslaviju”, kryetari i fundit i RSFJ, Stipe Mesiqi. Perceptimi i tij për dokumentin e ASSHA nënkupton në plotësi bashkërendimin e planit për krijimin e Serbisë së Madhe e të hegjemonisë absolute të Serbisë.²⁹¹

Sipas studiuesit kosovar, Enver Hasani, kombi serb, i ushqyer nga besimi se ai ishte një komb mbizotërues dhe se Serbia ishte një qendër e sllavëve të jugut, gjatë gjithë ekzistencës së Jugosllavisë u përpoq që ta ruante strukturën centraliste të shtetit. Në kohën kur gjithë shtetet e tjera komuniste ishin duke ecur drejt demokracisë, shoqëria dhe klasa politike serbe luftonin për një legjitimitet të ri për ta ruajtur pushtetin. Klasa politike serbe kërkonte që t’i integrojnë serbët e rëndomtë në projektin e Serbisë së Madhe, jo për t’ua mbrojtur pronën e tyre private, por vetëm “tokat e shenjta serbe”. Ky memorandum shënoi fillimin e këtij diskursi dhe përgatitjet emocionale të shoqërisë serbe për kryerjen e spastrimeve etnike dhe të shkatërrimit të kulturave tjera. Ishte ky programi i parë kombëtar në Jugosllavi, që bazohej në standardizimin e retorikës nacionaliste me këndvështrimin e eliminimit të kulturave të tjera.²⁹²

***Stipe Mesiq**, i lindur me 24 dhjetor 1934 në Orahovicë. Diplomoi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Zagrebit. Ishte i burgosur me një vit burg në Stara Gradishka për shkak të pjesëmarrjes në të ashtuquajturën "pranvera kroate". Në fillim të viteve të '90 merr pjesë në lëvizjen e më vonë në partinë e HDZ. Me vendim të Kuvendit të Republikës së Kroacisë bëhet anëtar i Kryesisë së RSFJ-së. Me 01.07.1991 u bë kryetar i RSFJ -së. Largohet nga HDZ - ja për shkak të qëndrimeve të saja ndaj B-H dhe formon një parti të re të quajtur, HND (Hrvatski Nezavisni Demokrati - Demokratët e Pavarur Kroatë). Ishte kryetar i Kuvendit të Republikës së Kroacisë gjatë viteve 1992 - 1994. Në vitin 2005 zgjidhet president i Republikës së Kroacisë.

²⁹¹R. Dragović, Memoradum SANU - tri decenije posle, Fejton elektronikhttp://www.novosti.rs/dodatni_sadrzaj/clanci.119.html:625479-Pocetak-medijsko-politickog-trilera, qasja 10 shtator 2018.

²⁹² E. Hasani, “Reflections on Serbian nationalism and the policy of ethnic cleansing” <http://sam.gov.tr/wp-content/uploads/2015/06/REFLECTIONS-ON-SERBIAN-NATIONALISM-AND-THE-POLICY-OF-ETHNIC-CLEANSING-ENVER-HASANI.pdf>, qasja 20 tetor 2018.

Azem Vllasi, kryetar i KQ Lidhjes Komuniste të Kosovës (më tej: LKK) lidhur me memorandumun deklaroi: “*Në nxitjen e shpërnguljes së serbëve dhe të malazezëve në Kosovë ndikon edhe nacionalizmi serb përmes përhapjes së mosbesimit në procesin e stabilizimit të gjendjes në Kosovë. Kjo bëhet përmes përhapjes së propagandës se nuk mund të jetohet me shqiptarët dhe se i vetmi shpëtim për serbët është në bashkimin kombëtar*”.²⁹³

Profesori, Enver Hoxhaj, flet edhe për ndikimin e madh që e kishte “*Memorandumi*” te Millosheviqi, dhe që zhbërja me dhunë e shtetit nuk mund të merret vetëm vepër e Millosheviqit, sepse si në çdo konflikt, veprimi i aktorëve të veçantë është i lidhur ngushtë me faktorë e struktura të tjera. Roli i veçantë i tij duhet kuptuar në lidhje të ngushtë me ndikimin e Akademisë Serbe dhe Memorandumi dëshmohej këtu për bazë ideologjike e veprimtarisë së tij politike. Është gjë e njohur se Millosheviqi e instrumentalizoi në mënyrë të vazhdueshme dhe të vetëdijshme nacionalizmin serb dhe racizmin antishqiptar, ashtu siç ishte propaganduar çdo ditë, duke filluar nga viti 1981, nga faktorë me ndikim si: shkrimtarë, klerikë, shkencëtarë, si dhe nga mediat. Dhe, ky nacionalizëm e ky racizëm nuk është aktualizuar gati askund më efektivisht se sa në memorandum dhe, njëkohësisht, i shkruar në një dokument, prapa përmbajtjes së të cilit qëndronte instanca më e lartë shkencore e vendit.²⁹⁴

Se sa kishte përgjegjësi politike Memorandumi vërehet edhe te hapat politikë që i propozonte, e që ushtruan ndikim të padiskutueshëm në formësimin e politikës Millosheviqiane, siç ishin: Revidimi i Kushtetutës së vitit 1974, “Ribashkimi” i Serbisë dhe luftimi i “agresionit shqiptar” përmes “shpalljes së luftës”, përmes “luftës revolucionare” dhe të “konfrontimit të hapur”. Që nga vitet 1989 /90 të gjithë këta hapa u bënë vërtetësi. Në verën e vitit 1988, shqipja u hoq nga përdorimi zyrtar dhe në vend të saj si gjuhë zyrtare në Kosovë u bë serbishtja. Më 24 mars 1989 u hoq autonomia e Kosovës përmes grushtshtetit. Më 5 korrik 1990 me dhunën e policisë e të ushtrisë serbe u shuan Parlamenti dhe Qeveria e Kosovës.²⁹⁵

Pasojat më të tmerrshme të Memorandumit u ndjen në Bosnjë-Hercegovinë. Prandaj, edhe studiuesit boshnjakë e trajtuan këtë tekst nga kënde të ndryshme, përfshirë edhe atë psiko-social. Studiuesi boshnjak, Ismet Dizdareviq, sjell konstatime dhe analiza nga dy sociologë dhe psikologë kroatë rreth Memorandumit. Sipas tij, Dr. Ivan Shiber, në bazë të analizës psiko-

²⁹³R. Dragović, Memoradum SANU - tri decenije posle, Fejton elektronikhttp://www.novosti.rs/dodatni_sadrzaj/clanci.119.html:625479-Pocetak-medijsko-politickog-trilera, qasja 10 shtator 2018.

²⁹⁴ E. Hoxhaj, *Politika Etnike dhe shtetndërtimi i Kosovës...*, f. 130.

²⁹⁵ Po aty, f. 133.

sociale të Memorandumit konstaton porositë etnocentrike që gjenden në të. Në interpretimin psiko-social të memorandumit, ai paraqet ngjashmërinë e qëndrimeve të Memorandumit me qëndrimin e ideologëve dhe të realizuesve të doktrinës fashiste. Sa çfarë është afërsia midis memorandumit dhe hartuesve e zbatuesve të ideologjisë fashiste më së miri paraqiten nga dr. Rudi Supeka. Psikologu social, Supek, në librin e tij: “Drustvene predrasude. Socialno-psiholoska razmatranja”, tregon për shtatë tema mbizotëruese, të cilat karakterizojnë sindromën nacionaliste. Këto tema janë: “(1) Dëmtimi (po na mashtrojnë, po na vjedhin, po na plaçkitin, kurse ne durojmë); (2) Komploti (në shoqërinë tonë ekzistojnë forca të errëta, të cilat qëllimisht punojnë kundër nesh. Ata kanë agjentë të huaj e të vendit, të cilët janë infiltruar në organet drejtuese të shoqërisë dhe të popullit dhe po e helmojnë atë); (3) Rrezikimi biologjik (përmes teorive dhe perceptimeve të ndryshme morale e ideologjike, që po e dobësojnë fuqinë e popullit tonë nga brenda, që po e shkatërrojnë dhe po e rrënojnë...); (4) Alarmi ideologjik (populli ynë është tepër i ndershëm, i sinqertë dhe naiv. Duhet t’ia hapim sytë e t’i tregojmë të vërtetën. Ta organizojmë si falangë kundër armiqve të ndryshëm. Është detyrë jona që ta sigurojmë prosperitetin e tij); (5) Superioriteti etnocentrik (ndërgjegjja jonë tregon se populli ynë është trim, i ndershëm e punëtor, që mund të shërbejë si shembull për popujt e tjerë, të mbizotërojë mbi popujt e tjerë...); (6) Autoritarizmi apo sado-mahoizmi (masat respektojnë vetëm forcën, atyre u duhen njerëz të forcës, që dinë të qeverisin si liderë të fuqishëm, e që me ta mund të identifikohen në rrjedhat shoqërore...); (7) Hakmarrja (atyre që shkatërrojnë qenien tonë kombëtare, do t’i përgjigjemi, duke i likuiduar pa menduar dy herë, do t’i shkatërrojmë dhe do t’i fshijmë nga faqja e tokës. Në këtë mënyrë ata edhe njëherë nuk do të vinë në kontakt me popullin tonë, e as që do ta kërcënojnë atë në ndonjë lloj mënyre...)”²⁹⁶

²⁹⁶ Ismet Dizdarević, “Etnocentrički stavovi akademika Dobrice Ćosića”, Ćosićev Rat, Zbornik radova sa naučne i stručne rasprave o knjizi “Bosanski Rat” Dobrice Ćosića, održane 3. Maja 2012 godine u Rektoratu Univerziteta u Sarajevu, Sarajevo 2013, f. 278-279.

Memorandumi ishte kritikuar edhe nga qarqet akademike jo nacionaliste në Serbi. Olivera Milosavljeviq, historiane, autore e disa artikujve dhe studimeve të këtij dokumenti dhe përfshirjes së tij në zhvillimet e mëvonshme tragjike, duke u bazuar në një intervistë të Dushan Kanazirit të bërë më 1991, në mënyrë të rezervë konstaton se Memorandumi ishte një ide e planit nacional serb. Arkitekti, Bogdan Bogdanoviç, i cili për shkak të mospajtit me mënyrën e punës së Akademisë e kishte braktisur atë, qysh më 1981. U rreshtua, pa dyshim, në anën e kritikuesve të ashpër të këtij dokumenti. Sipas mendimit të tij, publikimi i këtij dokumenti ishte “shprehje e bashkërendimit midis qarqeve të caktuara politike dhe intelektualëve të Beogradit”. Ai vazhdonte: “*Memorandumi ishte trimërim dhe mbulesë shkencore për nacionalizmin serb. Një dokument i tillë nuk mund të publikohet pa bashkëpunimin midis akademikëve, liderëve kombëtarë dhe disa anëtarëve të caktuar partiakë. Gjithsesi, jo të rrymës së Stamboliçit. Memorandumi në Beograd u prit si një shenjë për fillimin e vrapimit. Intelektualët tanë na thanë të nisemi. Kah? Kah Serbia e Madhe, kuptohet. Në luftë për realizimin e idealeve tona të larta*”.²⁹⁷

Akademiku, Pavle Saviq, duke cekur se kishte në dispozicion 70 faqe tekst pa titull e nënshkrimesh, e cilësoi atë si një material që paraqet një konglomerat qëndrimesh heterogjene dhe të njëanshme, e që përmban karakteristika të pamfletit dhe të materialit propagandistik, prandaj nuk mund t’i përshkruhen atributet shkencore.²⁹⁸

Akademiku, Vasa Çubriloviç, u shpreh kundër që ASSHA të përzihet në politikën ditore, pasi që detyrë e saj janë hulumtimet shkencore e jo politika. Ai ishte konkret në kërkimin e përgjegjësisë, duke propozuar edhe shkarkimin e Këshillit të Akademisë.²⁹⁹

Gjykimi i krimeve të luftës në hapësirat jugosllave, bëri që pasojat e Memorandumit të studioheshin nga ekspertë dhe gjykatës së Tribunalit të Hagës. Prokurorët në Hagë dhe hetuesit e tyre vendosën tezën e njëanshme dhe të njëkahshme – Memorandumi i ASSHA është platformë ideore për “Serbinë e Madhe”, kurse dëshira për ta realizuar këtë qëllim është çelësi kryesor për rënien e Jugosllavisë. Kjo solli deri te gjenocidi dhe spastrimi etnik. Ky qëndrim është i paramenduar në mënyrë që të nxirret përgjegjësia individuale e Serbisë dhe e udhëheqjes së saj,

²⁹⁷R. Dragović, Memorandum SANU - tri decenije posle, Fejton elektronikhttp://www.novosti.rs/dodatni_sadrzaj/clanci.119.html:625479-Pocetak-medijsko-politickog-trilera, qasja 10 shtator 2018.

²⁹⁸ Политика, Београд, 19 Децембар 1986, ф. 7.

²⁹⁹ По ату, ф. 7.

në radhë të parë të Slllobodan Millosheviqit*, për shpërthimin e luftës. Lidhja politike, historike e juridike është bërë me tezën se Memorandumi gjatë kohës së hartimit të tij është lëshuar qëllimisht në publik në mënyrë që ta provokonte mobilizimin e masave.³⁰⁰

Një konstatim të tillë e mbron edhe gjykatësi i njohur hetues dhe avokati nga Serbia, Dragoljub Todoroviq, i cili shkruan se: “kur prej një periudhe pas 25 vitesh analizohet teksti i Memorandumit të ASSHA, vjen deri te konkluzioni i bazuar se ky dokument përmban platformën kombëtare dhe serbomadhe, për gjitha luftërat, që i filloi në dekadën e fundit Slllobodan Milosheviq”.³⁰¹

Kur Slllobodan Millosheviq erdhi në pushtet, më 1987, ai mori përsipër programin politik alternativ të paraqitur në draftin e Akademisë. Ai, jo vetëm që vërtetoi diagnozën e draftit për zgjidhjen e problemit serb, por edhe i rekrutoi disa ish- disidentë akademikë, që kishin qenë në komisionin e botimit. Kështu, filozofi neomarksist, Mihailo Markoviq dhe novelisti Antonije Isakoviq iu bashkuan (apo ribashkuan) Partisë Socialiste (ish- komuniste) të Millosheviqit, më 1990. Kurse, më 1992 novelisti, Dobrica Qosiq, pranoi postin e kryetarit të Jugosllavisë që sa po ishte shpallur nga parlamenti i dominuar nga ithtarët e Millosheviqit.³⁰²

Pavarësisht, kritikave dhe presioneve nga regjimi i Stamboliçit, për t’u tërhequr nga ky akt (sikurse mbledhja e aktivitetit të LK në Akademi, më 14 tetor 1986, mbledhja e mbyllur e Kryesisë së Serbisë, më 21 tetor, vizita e Ivan Stamboliçit në ASSHA, më 29 tetor, kuvendi i jashtëzakonshëm i ASSHA më 18 dhjetor 1986, etj.), akademikët mbrojtën Memorandumin dhe ishin konsekuent në qëndrimin e tyre. Duke e cilësuar memorandumin si “një tekst, që juridikisht

*Slllobodan Millosheviq ka lindur në Pozharevc të Serbisë më 20 gusht të vitit 1941. U gjetë i vdekur në qelin e tij në burgun e Hagës, me 11 mars 2006. Prindërit e Slllobodan Millosheviqit, Svetozar Millosheviq dhe Stanislava Millosheviq u divorcuan pak vite pas lindjes së Slllobodanit. Babai i tij, që shërbente si prift kreu vetëvrasje, poashtu edhe nëna e tij Stanislava, mësuese shkolle, do të kryejë vetëvrasje (varje). Gjatë viteve të gjimnazit, Millosheviq e takon gruan e tij të ardhshme Mira Markoviq figurë kryesore e politikës Serbe në vitet 90 dhe inspiruese e rilindjes së nacionalizmit serb. Diplomohet jurist më 1964 në Beograd dhe i bashkohet Lidhjes Komuniste të Serbisë. Millosheviq filloi të punojë si funksionar në firmat shtetërore të Serbisë: së pari në kompaninë e gazit e pastaj në "Beogradska Banka". Gjatë karrierës së tij politike, Millosheviq mbajti postin e Presidentit të Republikës së Serbisë për periudhën 1989-1997, dhe postin e presidentit të Republikës Federale të Jugosllavisë për periudhën 1997-2000, kryetar i Partisë Socialiste të Serbisë nga krijimi i saj më 1992 deri në vitin 2001, dhe i akuzuar për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

³⁰⁰R. Dragović, Memorandum SANU - tri decenije posle, Fejton elektronikhttp://www.novosti.rs/dodatni_sadrzaj/clanci.119.html:625479-Pocetak-medijsko-politickog-trilera, qasja 10 shtator 2018.

³⁰¹I. Dizdarević, “Etnocentrički stavovi akademika Dobrice Ćosića...”, f. 277.

³⁰²Aleksandar Pavković, “The Serb National Idea: A Revoival 1986-1992”, *The Slavonic and East European Review*, Vol. 72, No. 3 (Jul. 1994), f. 446-447.

nuk ekziston”, ASSHA e liroi veten që ta shprehë qëndrimin e saj për përmbajtjen e tekstit, duke e zhvendosur fokusin në mënyrën problematike të daljes së tekstit në publik.³⁰³

Në Kuvendin e Jashtëzakonshëm të ASSHA, që u mbajt më 18 dhjetor 1986, ku morën pjesë edhe përfaqësues të pushtetit, u shqyrtuan pasojat dhe situata që u pasua nga ky tekst. Pavarësisht, presioneve të shumta, akademikët me shumicë votash, 114 nga gjithsej 137, u deklaruan për besimin ndaj anëtarëve të Këshillit Ekzekutiv të Kryesisë së ASSHA.³⁰⁴

KREU I KATËRT

PËRGATITJA DHE ZBATIMI I PLANIT PËR HEQJEN E AUTONOMISË SË VITIT 1974 DHE REVOLTA E SHQIPTARËVE

4.1. Rrethanat që çuan në ngritjen e Millosheviqit në krye të KQ të LKS

Tentativat e klasës politike të Serbisë për reduktimin e kompetencave të krahinave autonome, respektivisht, kthimin gradual nën varësinë republikane, vazhduan edhe gjatë vitit 1980, për t’u intensifikuar, sidomos, pas demonstratave shqiptare të vitit 1981. Te qarqet nacionaliste serbe ekzistonte bindja e nuk mund të tolerohej asnjë lloj vonese në zgjidhjen e krizës. Por, problemi kryesor qëndronte në faktin se, për ta ripërcaktuar pozitën e Serbisë si shtet, patjetër duhej pajtimi i gjitha elementeve federativë, midis tyre dhe ajo e Kosovës. Udhëheqja e kësaj krahine, ai dhe ajo e krahinës tjetër – Vojvodinës, tanimë ishin pavarësuar plotësisht në sjelljen e vendimeve, kështu që për këtë kthesë politike nevojitej edhe bashkëpunimi i tyre. Ky bashkëpunim nënkuptonte që me vetiniciativë t’i bartnin atributet e pushtetit tek organet republikane, kurse nuk ekzistonte asnjë instancë politike që do t’i detyronte në diçka të tillë.³⁰⁵

Vendosmëria e krahinave për ta mbrojtur autonominë e tyre, u dëshmuar në kundërshtimin që ato ia bënë pakos gjithëpërfshirëse të “reformave” të propozuara nga subjektet republikane, që

³⁰³ Vreme, br. 247, 17 jul 1995, <https://www.vreme.com/cms/view.php?id=1377420>, tërhequr më 30 tetor 2018.

³⁰⁴ Политика, Београд, 19 Децембар 1986, fq. 7

³⁰⁵ Dragan Bogetić, “Nacionalno pitanje i Jugoslavija 1945-1989”, *Istorija 20. Veka*, Časopis Instituta za Savremenu Istoriju, br. 1-2, 1999, Beograd, f. 71.

doli në pah në tetor të vitit 1984, kur organizata partiake e Serbisë paraqiti projektin prej katër pikash, që bënte thirrje për forcimin e rolit dhe të iniciativave ekonomike, forcimin e qeverisë federale, demokratizimin e sistemit elektoral dhe reduktimin e të drejtave të veçanta dhe të autonomisë së përgjithshme të të dyja krahinave autonome.³⁰⁶

Një kundërshtim i tillë nxiti reagimin e ashpër të udhëheqjes serbe. Kështu në mbledhjen e KQ LKS, nëntor të vitit 1984, Dushan Çkrebiq, foli haptazi kundër autonomisë së krahinave, me pretekstin se ato po e pengonin planifikimin e zhvillimit të brendshëm të Serbisë.³⁰⁷ Në përfundim të kësaj mbledhjeje u konfirmua iniciativa e KQ LKS, që të marrë përsipër iniciativën për zgjidhjen e kësaj krize në Serbi.³⁰⁸

Në këtë mënyrë, Ivan Stamboliçi, shef i Lidhjes Komuniste të Serbisë mori iniciativën që t'i pajtojë subjektet e tjera federative rreth nevojës së ndryshimeve kushtetuese, që do të çonin në rregullimin e raporteve midis Serbisë dhe krahinave autonome. Por, iniciativa e Stamboliçit kërkonte kohë dhe durim në bindjen e subjekteve të tjera, kështu që ai vazhdimisht ishte nën presionin e strukturave nacionaliste serbe në Kosovë. Duke mos dashur të ballafaqohet me këto struktura, ai, në prill të vitit 1987 e delegoi kolegun e tij partiak, Slobodan Millosheviqin, që të shkonte në Fushë Kosovë dhe t'i dëgjonte brengat e serbëve. Në fakt, në Fushë Kosovë operonte vorbulla e nacional-shovinizmit serb. Serbët e Kosovës e kishin formuar të ashtuquajturin: “*Këshilli për mbrojtje dhe vetekzistencë i serbëve dhe i malazezëve nga Kosova*”, i njohur edhe si: “Shtabi” i Fushë Kosovës me protagonistët e njohur, si: Sholeviq, Kecman, Budimiroviq, etj. Në këtë shtab funksiononte një makineri e fuqishme propagandistike, që sajonte akuza e trillime të ndryshme ndaj shqiptarëve, që përfshinin, madje, edhe gjoja përdhunimet kundër plakave e të miturave serbe, shëmtimi i varrezave serbe, etj.³⁰⁹

Paralajmërimi për ardhjen e Millosheviqit, bëri që një propagandë e tillë të intensifikohej. Ishte ky një interes i ndërsjellë midis Millosheviqit dhe serbëve të Kosovës. I pari, ishte i interesuar ta shfrytëzonte këtë mundësi për ngjitje në shkallët e pushtetit, kurse të dytët, ishin të interesuar të realizonin kauzën e tyre antishqiptare.

Në këto rrethana, qysh më 20 prill, Millosheviqi vjen për herë të parë në Fushë Kosovë. Masës së tubuar serbe në oborrin e shkollës fillore “Aca Maroviq”, Millosheviqi iu drejtua me

³⁰⁶ Sabrina P. Ramet. *The Disintegration of Yugoslavia from the Death of Tito to the War for Kosovo*, Westview Press, 1999, f. 14.

³⁰⁷ Po aty, f. 14.

³⁰⁸ D. Bogetić, “Nacionalno pitanje i Jugoslavija 1945-1989...”, f. 74.

³⁰⁹ Z. Cana, *Apeli 215 i intelektualëve shqiptar*, Rilindja, Prishtinë 2001, f. 9.

një fjalim, ku ndër të tjera tha se: “*Nuk do të realizohet teza e separatizmit shqiptar mbi Kosovën e pastër etnike*”. Dikush nga masa bërtiti se ky qëllim tanimë ishte realizuar. Millosheviqi reagoi: “...*ju këtu, jeni fakti më i qartë se nuk është realizuar...*”, duke vazhduar me përdorimin e retorikës së vëllazërim-bashkimit, etj.³¹⁰

Por, në fund të këtij tubimi u arrit marrëveshja që Millosheviç përsëri të vijë në Fushë Kosovë, më 24 prill, dhe të formohet një delegacion nga serbët, që në takim me krerët e Kosovës dhe të Serbisë të paraqesin vërejtjet e tyre për funksionimin e pushtetit në këtë krahinë.

Më 24 prill, mijëra serb e malazezë u dyndën nga të katër anët e Kosovës, për në Fushë Kosovë, aty ku ishte paralajmëruar mitingu. Gjatë këtyre ditëve u bë një skenar se si duhet të zhvillohen ngjarjet. Bulatoviq, Kecman, Budimiroviq, Sholeviq, Sekuliq...,që të gjithë ishin të përfshirë në organizimin e “shfaqjes”, e cila i shërbeu Millosheviqit, që të hidhet në krahë të pakënaqësisë së (pa) arsyeshme serbe dhe që në mënyrë të pakompromis të fillojë punën në rrënimin e autonomisë së Kosovës e Vojvodinës.³¹¹

Po kështu, thotë edhe historiani i njohur, Zekerija Cana, se këto organizime nuk ishin as spontane, as të rastësishme. Ky grumbullim popullate ishte organizuar sipas një planifikimi të sajuar mirë e mirë deri në detaje, sigurisht jo vetëm me dijen dhe miratimin e Beogradit, por edhe ndërsimin nga andej. Prandaj, Millosheviqi u gjend shpejt atje, ku “e lypte vendi”.³¹²

Gazetari i njohur, Slavko Çuruvija*, e kishte përcjellë nga afër dhe kështu e përshkruan ditën e 24 prillit: “*Ishte një ditë e nxehtë, gjithë pluhur. Rreth orës pesë pasdite u duk në horizont një kolonë makinash zyrtare. Ndonëse, ishte paralajmëruar se do mbahej një mbledhje, ku do të merrnin pjesë përfaqësues të serbëve të Kosovës, përpara disa minutash rruga dhe sheshi përpara Qendrës Kulturore të qytetit kishin qenë thuajse të zbrazëta; shumë - shumë me nja dy grupe njerëzish, që silleshin vërdallë me dembelizmin tipik ballkanas. Papritmas, si me urdhrin e peshkut, në shesh u derdhën 15.000 serbë. Kolona e makinave u rrethua nga të katër anët. Në kohën kur Millosheviqi dilte nga makina, ajri dridhej nga thirrjet buçitëse: Duam liri! Duam liri!*”³¹³ Millosheviqi erdhi në Fushë - Kosovë i shoqëruar nga Azem Vllasi (kryetar i kryesisë së

³¹⁰ Илустрована Политика, Београд, 28 април 1987, ф. 11.

³¹¹ Bahri Cani, Čovek koji je "polozio ispit", Naša Borba, 24 april 1997, http://www.yuorpe.com/nasa-borba/arhiva/Apr97/2404/2404_26.HTM, qasja 18 maj 2018.

³¹² Z. Cana, *Apeli 215 i intelektualëve shqiptar...*, f. 10.

* Slavko Curuvija - Gazetar dhe botues i njohur në Serbi. Për shkak të kritikave që i bënte regjimit të Millosheviqit iu be atentat me 11 prill 1999. Për vrasjen e tij është arrestuar shefi i shërbimit sekret në Serbi.

³¹³ J. Udovički & J. Ridgeway, *Makthi etnik i Jugosllavisë...*, f. 82.

KK të LK të Kosovës), Kolë Shiroka (anëtar i Kryesisë së KQ të LKJ), Bajram Selimi (kryetar i Kryesisë së KK të LSPP), Ragip Halili (kryetar i KK të Prishtinës) dhe Bozhidar Llaziq (kryetar i komunës së Prishtinës). Policia e Kosovës, duke pasur njoftimin për organizimet e serbëve në Fushë Kosovë dhe qëllimet e tyre, shkuan atje, me ç'rast u pritën me breshëri gurësh e fyerjesh të ndryshme. U hodhën parullat, si: "*Duam liri!*", "*Jetën e japim, Kosovën s'e japim!*", "*Vrasës!*" etj. Millosheviqi doli nga Shtëpia e Kulturës dhe para masës së frustruar e të ekzaltuar nga nacionalizmi iu drejtua me frazën e famshme, që u bë prelud i tragjedive në Kosovë: "*Askush nuk duhet të guxojë të ngrejë dorën mbi ju*", (*Ovaj narod vise nikad niko sme da bija*), e që më vonë njëri nga udhëheqësit kryesor të serbëve të Kosovës, Miroslav Sholeviq deklaronte: "*Kjo fjalë e ngriti atë në fron si një mbret*".³¹⁴

Pastaj Millosheviqi u kthye brenda dhe para përfaqësuesve serbë e malazezë, mbajti një fjalim më të gjatë, ku ndër të tjera theksoi: "... *Kjo është toka juaj, këtu janë shtëpitë tuaja, këtu janë kopshtet tuaja, memoriet tuaja. Me siguri nuk do ta braktisni tokën tuaj, sepse këtu jetohet vështirë, për shkak të presionit, padrejtësive dhe nënçmimeve. Nuk ka qenë kurrë në shpirtin e popullit serb e malazez, që pas ballafaqimit me problemet të tërhiqen...nuk ju them se qëndroni këtu dhe duroni, përkundrazi, së bashku me të gjithë duhet ta ndryshoni gjendjen...mos më thoni se nuk mundeni vetëm, sigurisht që nuk mundeni vetëm, do ta ndryshojmë gjendjen së bashku. Jugosllavia nuk ekziston pa Kosovën! Jugosllavia do të shpërbëhej pa Kosovën! Jugosllavia dhe Serbia nuk do ta dorëzojnë Kosovën*".³¹⁵

Ky fjalim e bëri Millosheviqin të parin udhëheqës komunist në Jugosllavi, që përqafoi një retorik nacionaliste dhe një pikë të fuqishme kondensimi të nacionalizmit serb.³¹⁶

Tubimi me përfaqësuesit e komunitetit serbë dhe malazezë zgjati deri në orët e hershme të mëngjesit. Pjesëmarrësit ngriheshin një nga një në podium dhe lëshonin fyerje të llojllojshme në baza etnike ndaj shqiptarëve dhe udhëheqjes politike kosovare. Sipas skenarit të parapërgatitur mirë, serbët duhet ta "dëshmonin" se në Kosovë situata ishte dramatike. Kjo do ta "përligjte" ndërhyrjen e Serbisë për ta suprimuar autonominë dhe për ta shtuar mbikëqyrjen e Beogradit në Kosovë, me qëllim mbrojtjen e serbëve dhe të malazezëve.

³¹⁴ T. Judah, *Kosovo: What everyone needs to know...*, f. 78.

³¹⁵ Политика, Специално Издање, Београд, 19 Новембар 1988, f. 3.

³¹⁶ Geert - Hinrich AHRENS, *Diplomaci mbi tehun e thikës-Pengimi i Konfliktit etnik dhe Grupi i Punës për minoritetet i Konferencës për Jugosllavinë*, TOENA, Tiranë, 2010, f. 310.

Kështu, njëri nga organizatorët e tubimit në Fushë Kosovë, Miroslav Sholeviq, gjatë fjalës së tij u fokusua tek "eksodi" i serbëve nga Kosova. Ai shprehej: "*Ne duhet ta ndalojmë këtë eksod. Duhet ta frenojmë këtë përmytje, ose nuk do të ketë serbë të mbetur*"³¹⁷. Ata hidhnin akuza mbi zyrtarët e Prishtinës, gjoja për miratimin e heshtur të këtij "eksodi". Një gjë që është hedhur poshtë, si e pabazë, nga shumë historianë të huaj, që njihen për kredibilitetin shkencor.

Gazetari dhe publicisti i njohur britanik, njohës i rrethanave në Ballkan, Misha Glenny, lidhur me këtë rast shkruan: "*Vërtet pati një eksod të serbëve në fillim të viteve të 80-ta, por ata qenë emigrantë ekonomikë, e jo refugjatë. Çka thuheshin për përdhunime, vrasje e për frikësime qenë të pabaza*".³¹⁸ Edhe një analizë e intelektualëve ("Kosovski cvor") u dokumentua se në Kosovë nuk kishte përdhunime masive, në veçanti ndëretnike, dhe se shpërngulja e serbëve dhe malazezëve lidhej me arsyet ekonomike.³¹⁹

Me tone të ashpra foli edhe Sreten Martinoviqi, një eksponent i njohur i serbëve të Kosovës. Ai konsideronte se: "Serbia nuk ishte as republikë, as shtet, sepse Kushtetuta e vitit 1974 qëndronte jashtë bazave të AVNOJ-it, kurse fati i serbëve në Kosovë ishte i njëjtë me atë të serbëve në Shqipëri. Në Ferizaj nuk nevojitej më gjenocid, ngase irredentizmi e kishte arritur edhe ashtu qëllimin: çdo vit i mungonte nga një paralele me mësimin në gjuhën serbokroate. Në Universitetin e Prishtinës kishte marrë turr nacionalizmi dhe irredentizmi shqiptar", - përfundonte Martinoviq.³²⁰ Ndërsa, Vujadin Millanoviq (profesor në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës), parashtrroi kërkesë për formimin e komisioneve në shkallë të Serbisë dhe të Jugosllavisë për kolonizimin e Kosovës, në mënyrë që të arrihej struktura nacionale e vitit 1941, të merrej vendim për ndalimin e flamurit shqiptar, si dhe të bëheshin ndryshime esenciale në Kushtetutë.³²¹ Dufin nacional - shovinist e zbrazën edhe pjesëmarrës të tjerë, si njëri nga udhëheqësit kryesor të serbëve dhe malazezëve, Bogdan Kecman, i cili kërkonte dënime për ish-krerët e Kosovës, që ishin në pushtet gjatë demonstratave të vitit 1981. Ndërsa, pjesëmarrja e shqiptarëve në këtë tubim ishte minimale, edhe kur e merrte fjalën ndonjëri nga ta, ndërpritej me fishkëllima dhe fyerje.

³¹⁷The Death Of Yugoslavia 1/6 Enter Nationalism - BBC Documentary, <https://www.youtube.com/watch?v=vDADy9b2IBM>, qasja 20.04.2018.

³¹⁸M. Glenny, *Histori e Ballkanit 1804 – 1999...*, f. 625.

³¹⁹S. Biserko, "Srpska elita i realizacija srpskog nacionalnog programa...", f. 107.

³²⁰Z. Cana, *Apeli 215 i intelektualëve shqiptar...*, f. 12.

³²¹Po aty, f. 12.

Kjo ngjarje që ndodhi në Fushë - Kosovë nuk ishte diçka e rastësishme. Ky ishte një skenar mirë i përgatitur nga vetë Millosheviqi, sepse përmes çështjes së Kosovës, që fillimi është te kjo ngjarje, atij do t'i hapej rruga për të arritur në majat e pushtetit në Serbi. E tërë makineria propagandistike u vu në shërbim të tij. Kur u kthye në kryeqytet, Dushan Miteviqi, zëvendës drejtor i Televizionit të Beogradit, shfaqti pambarimisht në televizion pjesën, ku Millosheviqi thoshte: "*Askush nuk duhet të marrë guximin t'ju rrahë*".³²²

Katër ditë më parë ai kishte ardhur në Kosovë për të bërë organizimin e këtij udhëtimit. Për skenar të përgatitur flet edhe Miranda Vickers, ku e përmend se vetëm katër ditë më parë, më 20 prill ai (S. Millosheviqi- S.K) kishte qenë atje për të takuar zyrtarët e Partisë Komuniste, ku iu kërkua nga serbët vendorë të bënte një vizitë tjetër, që do të ishte krejtësisht e përqendruar në ankesat e tyre. Gjatë atyre katër ditëve, ndihmësit e Millosheviqit punuan në ethe për të organizuar demonstrata masive, që me aq efektivitet nisen kryqëzatën e tij mbi Kosovë.³²³

Edhe Vllasi, i cili kishte qenë prezent në atë që njihet si "*nata e fjalëve të ashpra*"³²⁴, i referohet njërit prej protagonistëve kryesor të atyre trazirave, flet për inskenime dhe provokime ndaj policisë me qëllim të nxitej ndërhyrja e tyre, në sytë e përfaqësuesve të lartë të RS e Serbisë: "*... Diku 7- 8 vjet më vonë, kur pushoi dashuria dhe bashkëpunimi luftarak i Millosheviqit me grupet e banditëve dhe ekstremistëve të Fushë - Kosovës, ai i njëjti, Miroslav Sholeviqi, i cili më pas u kthye për të jetuar në Nish, në një intervistë, duke shpjeguar hollësi të asaj ngjarjeje e pranoi se dy ditë para ardhjes së Millosheviqit ata kishin sjellë dy traktorë gurë para Shtëpisë së Kulturës, gjoja për të kryer disa punime afër rrugës. Por, qëllimi i vërtetë ishte të gjuanin policinë dhe të krijonin rrëmujë. Kur policia të nisej drejt tyre, ata shtireshin si viktimat, të cilët i rrihte policia, madje, edhe në prezencën e kryetarit të KQ të LKJ të Serbisë. Në këtë mënyrë duhej të nxirrnin një reagim më të fuqishëm të Beogradit kundër nesh*".³²⁵

Por, një fakt interesant është se serbët e Kosovës ishin zhgënjyer nga Millosheviqi. Në një intervistë për media lidhur me ngjarjet e Fushë Kosovës, Sholeviq kishte deklaruar: "*Këtu u mashtrua më së shumti. Menduam se me të vërtetë do të ndryshojë diçka. Në mënyrë deklarative gjithçka, por në zbatim asgjë. Nuk ia shoh për të madhe atij se mbeti një komunist, por se e shkatërroi shtetin, e shkatërroi një energji të madhe popullore. Duhet decenie për ta*

³²² T. Judah, *Kosovo: What everyone needs to know...*, f. 79.

³²³ M. Vickers, *Midis serbëve dhe shqiptarëve...*, f. 278.

³²⁴ J. Udovički & J. Ridgeway, *Makthi etnik i Jugosllavisë...*, f. 83.

³²⁵ A. Vllasi, *Kosova...*, f. 405.

akumuluar energjinë e harxhuar. Energjinë tonë ai nuk e shfrytëzoi për përmirësimin e gjendjes në Kosovë, për çështjen serbe, por për përvetësimin dhe ruajtjen e sundimit të tij. Ai ka mundur të qëndrojë në pushtet si një reformator, por ai nuk e pranoi një gjë të tillë".³²⁶

Kryesia e Komitetit Krahinor të LKK -së u mbledh për të diskutuar rreth çështjeve që dolën nga tubimi i Fushë - Kosovës, sepse efektet te popullata shumicë shqiptare ishin të mëdha. Azem Vllasi tregon për masat që i morën, konform, situatës së krijuar pas ngjarjeve të fundit që ndodhën, e që i tensionuan marrëdhëniet ndëretnike. *"Isha i autorizuar nga Kryesia që së bashku me anëtarin e Kryesisë së KQ të LKJ-së nga Kosova, Kolë Shirokën, të kërkonim nga kryetari i Kryesisë së KQ të LKJ-së, Boshko Kruniq që informatën tonë ta shtronte në rend të ditës dhe të hapnim debat për këtë. E vlerësuam këtë si të nevojshme, meqë, fjalimi i Sllobodan Millosheviqit pati jehonë të madhe në tërë opinionin jugosllav fal medieeve të Beogradit. Megjithatë kjo kërkesë nuk u realizua sepse nuk u mbajt seanca e Kryesisë së Komitetit Qendror dhe kërkesa mbeti në pritje".³²⁷*

Si duket një veprim i tillë ishte parandaluar nga presioni politik dhe mediatik i Beogradit. Kjo mund të dëshmohej edhe me qëndrimin e Komitetit Komunal të LK të Prishtinës, që ishte i ngarkuar ta analizonte stenogramin e asaj mbrëmjeje dhe të dalë me një analizë të hollësishme, por që nuk veprroi me detyrat e ngarkuara për shkak të ruajtjes së balancës politike.³²⁸

Pra, reagimet e organeve të Prishtinës dhe vetë heshtja e përfaqësuesve shqiptarë në Fushë Kosovë tregon se këta u stepën dhe u dorëzuan para atij shpërthimi nacionalist dhe "kalorësit" që i printe këtij kaluari. Mirëpo, populli i Kosovës sërish do të ngrihet dhe do të ndeshët me këto politika ultranacionaliste, të cilat po nxitnin dhe do të shkaktonin gjakderdhje në tërë arealin e Jugosllavisë.

Pas ngjarjeve në Fushë Kosovë, nacionalizmi dhe shovinizmi serb doli sheshazi. Politika zyrtare e Beogradit u njësuua me qëndrimet ultranacionaliste të Kishës Ortodokse, Akademisë Serbe të Shkencës (SANU) dhe Lidhjes së Shkrimtarëve. Këtyre institucioneve, shpirtërore, shkencore e letrare, iu dha kurajë Millosheviqi, i cili tani po konsiderohej shpëtimtari i serbëve, jo vetëm të Kosovës, por edhe të mbarë RSFJ-së. Ky diskurs nacionalist, ekstrem që filloi të ndiqet nga Millosheviqi, do ta çojë Jugosllavinë drejt luftërave të përgjakshme dhe shkatërrimit

³²⁶S. Ast, Miroslav Šolević: Režim nas je iskoristio, Vreme broj 454, 18. septembar 1999. https://www.vreme.com/arhiva_html/454/11.html, qasja 10 maj 2018.

³²⁷ A. Vllasi, *Kosova...*, f. 412.

³²⁸ Z. Cana, *Apeli 215 i intelektualëve shqiptar...*, f. 13.

të saj. Ky diskurs i tij nuk do pranohet nga politikanë të ndryshëm në Serbi, e veçmas nga tutori i tij politik, i deriatëhershëm, Ivan Stamboliç, si dhe nga kundërshtimet e Dragosllav Markoviçit, njërit nga figurat qendrore të asaj kohe në Serbi. Këto rivalitete të thekshme rridhnin nga logjika e "luftës" së grupeve për t'i zaptuar pozicionet më të rëndësishme të pushtetit. Ngjarje, për të cilën publiku kishte shumë pak informata se çfarë po ndodhte.*

Stamboliçi ndiqte një kurs relativisht më të moderuar, në krahasim me Millosheviqin, që po ndiqte vijën e ashpër nacionaliste dhe centraliste. Stamboliçi ia kishte frikën rritjes së vrullshme të pakënaqësisë serbe dhe, sidomos, shprehjes gjithmonë e më publike të saj. Ai u përpoq që ta zgjidhte problemin me rrugë institucionale, duke ndryshuar kushtetutën dhe duke vënë nën kontroll fondet që i shkonin Kosovës. Stamboliçi e respektonte autonominë e Kosovës, ndonëse, përkrahte lidhje më të forta të saj me Serbinë dhe autoritet më të madh të pushtetit serb mbi autoritetet vendase të Kosovës. Ai ushtroi presion mbi udhëheqjen e shqiptarëve të Kosovës, që të punonte për të gjetur rrugëzgjdhje. Por, metoda e tij nuk doli e pranueshme as për serbët, as për shqiptarët.³²⁹ Pra, ai kërkonte riintegrim administrativ të Republikës Serbe me provincën, por pa i ngritur serbët kundër shqiptarëve.³³⁰ Ndërkaq, Millosheviqi i ndërsente serbët ndaj shqiptarëve. Përmes ngritjes së kauzave fiktive, inekzistente, si: dhuna sistematike, pasiguria e madhe për të jetuar, qe si pasojë kishte shpërnguljen e serbëve dhe të malazezëve nga Kosova, ky e paraqiste vetën si protektor i këtyre kauzave. Loja me këtë kartë, për serbët e dehur nga nacionalizmi ekstrem, Millosheviqi, me të vërtetë konsiderohej si shpëtimtar i tyre. Pra, pikëpamjet e tyre ishin të njëjta sa i përket Kosovës, mirëpo ajo për çka nuk pajtoheshin ishte dinamika e zgjidhjes së çështjeve.

[...] *“Edhe nga kjo distancë kohore e edhe atëherë kam menduar që kurrfarë dallimi për sa i përket Kosovës nuk ka pasur midis këtyre dy opsioneve në Serbi. Dallimi i vetëm ka qenë metoda dhe shpejtësia kohore. Ana e Stamboliçit ishte për një veprim më të ngadalshëm, ndërsa e Millosheviqit për një veprim më të shpejtë, por qëllimi ishte i njëjtë, qëllim i papranueshëm për ne, edhe atëherë edhe tash”*³³¹, kujton Remzi Kolgeci në intervistën e dhënë për "Zërin e Rinisë", të vitit 1990.

*Për këtë shih: Kosta Nikolić, “Kako je Slobodan Milošević izabran za vođu srpskih komunista”, *Istorija 20. VEKA*, Godina XXIV 2006, Beograd. Broj 1.

³²⁹ J. Udovički & J. Ridgeway, *Makthi etnik i Jugosllavisë...*, f. 84.

³³⁰ Po aty, f. 86.

³³¹ *Zëri i Rinisë*, nr. 1341, 12-19 maj 1990, Intervistë me Remzi Kolgecin, anëtar i Kryesisë së KK LKK, f. 27.

Stamboliç kujton më vonë kur e pyet Millosheviqin pas takimit në Fushë Kosovë: "Sllobodan, çfarë po luanin në Kosovë? Përgjigjja e tij ishte: "Ne duhet të veprojmë tani. Shqiptarët kanë marrë përsipër, serbët janë larguar nga punët kyçe. Shqiptarët mund ta bënin këtë, sepse provinca e Kosovës ishte praktikisht një republikë. Këshilli lokal kishte fuqinë për të zbatuar atë që unë do ta quaja, një politikë vërtetë naziste, thekson Millosheviç".³³²

Stamboliç i bëri me dije se: "Nëse vazhdoni ... çfarë do të ndodhë me vendin tonë? Unë them që jemi krejtësisht kundër metodave tuaja. Kemi dy politika të ndryshme për Kosovën. Distanca jonë u rrit".³³³Këtu filluan të ndahen rrugët, dhe njëkohësisht realizimi i skenarit për eliminimin e Satamboliqit nga pushtetit. Divergjencat po thelloheshin ndërmjet këtyre dy grupeve në kuadër të LKJ - së. Grupi i parë drejtohej nga Sllobodan Millosheviqi. Ky grup deklaroi se ishte titist, denoncoi nacionalizmin serb, por paradoksisht kërkoi mbështetjen e kërkesave të serbëve të Kosovës. Grupi i dytë drejtohej nga Ivan Stamboliçi. Ai synonte të vendoste unitetin e Serbisë, duke respektuar provincat autonome dhe strukturat federale të Jugosllavisë.³³⁴

Millosheviç deklaroi se: "Nuk mund të ketë kompromis. Çdo ditë, kriza në Kosovë bëhet më e keqe. Ne nuk duhet të vonojmë. Ne prisnim probleme nga separatistët kosovarë. Por, ne nuk e prisnim atë nga anëtarët e partisë këtu. Ata që pengojnë reformat tona shkelin disiplinën partiake. Ata nuk mund ta mohojnë atë".³³⁵

Një ngjarje që ndikoi në ballafaqimet politike në Serbi ishte ajo e 3 shtatorit të vitit 1987, në kazermën e Paraqinit, kur katër ushtarë jugosllavë të nacionaliteteve të ndryshme u vranë dhe pesë të tjerë u plagosën*, sikur thuhej nga i riu shqiptar, Aziz Kelmendi, që vinte nga rrethi i Prizrenit. Ndonëse, dhjetë vite më vonë aktorët e kësaj ngjarjeje pranuan se rasti ishte i montuar³³⁶. Qarqet nacionaliste serbe të kohës e shfrytëzuan atë për shpërthimin e një histerie antishqiptare në ballë të së cilave u vunë mediet serbe, me synimin final për ta përçuar tek opinionin publik domosdoshmërinë e unitarizimit të Serbisë.

³³²The Death Of Yugoslavia 1/6 Enter Nationalism - BBC Documentary, <https://www.youtube.com/watch?v=vDADy9b2IBM>, qasja 20.04.2018.

³³³Po aty.

³³⁴Gjon Boriçi, *Lufta për paqen në ish - Jugosllavi 1987-1990*, f. 39.

³³⁵The Death Of Yugoslavia 1/6 Enter Nationalism - BBC Documentary, <https://www.youtube.com/watch?v=vDADy9b2IBM>, qasja 20.04.2018.

* Emrat e ushtarëve të vrarë janë: Sergjan Simiq nga Beogradi, Hazim Xhananoviq nga fshati Koçicë, komuna e Vitezit, Safet Budakoviq nga fshati Orahova, komuna e B. Gradishkës dhe Goran Begiqin nga Zagrebi.

³³⁶Mikel Ndreca, *Terror dhe gjenocid shtetëror (1912 - 1999)*, Prishtinë 2001, f. 240.

“Kelmendi shtiu mbi Jugosllavinë” ishte titulli kryesor në gazetën "Politika" të 4 shtatori. Edhe mediet e tjera beogradase komentuan ngjashëm. U interpretua se Kelmendi vetëm se e kishte ngrehur këmbëzën” dhe se “kishte shtënë drejt njëres nga shtyllat e sigurisë jugosllave – APJ-së”, dhe se motivet e këtij akti ishin politike.³³⁷ Korit medial serb iu bashkangjiten edhe ato nga Novi Sadi, siç ishte: "Nedeljni Dnevnik" e veçanërisht "Pobjeda" e Titogradit, e cila solli një artikull të titulluar: "Mësimi i urrejtjes". Ky ishte një editorial nga redaktori i saj, Shqepan Vukoviq, ku ndër të tjera thekson se: "Aziz Kelmendi u bë "kriminel mizor" në moshën e vet njëzetvjeçare. Vukoviq thekson se ai edhe vetë është "viktimë e krimit të llojit të vet të farës së zezë, të cilën tani vite më radhë e mbjellin nacionalistët shqiptarë, të veshur me rroba të arsimtarëve, nëpër mësonjëtoret e shkollave!"³³⁸

Në fakt, deri sa këto media përpiqeshin ta paraqisnin urrejtjen si veçori të shqiptarëve, ata me shkrimet e tyre helmuan popullin serb me urrejtje ndaj shqiptarëve dhe udhëheqësve të tyre politikë. Kjo u vërejt, posaçërisht. gjatë varrimit të ushtarit, Srdan Simiç, më 5 shtator 1987 në Beograd, ku sipas këtyre gazetave morën pjesë rreth dhjetë mijë njerëz. Gjatë ceremonisë së varrimit u hodhën brohoritje si: "Vareni Fadilin", "Azem Vllasi – jashtë nga Jugosllavia"...e fjalë e mallkime të tjera, në llogari të krerëve shqiptarë të Kosovës. Sipas gazetarit të revistës "NIN", i atij i ushtarit të vrarë, Petar Simiq, edhe pse në pikëllim të thellë, iu desh të prononcohej. Ai mori mikrofonin dhe masës së grumbulluar i sugjeroi që të ndërpresin brohoritjen e parullave nacionaliste mbi varrin e të birit të tij.³³⁹

Motivet e kësaj vrasjeje janë ende të panjohura, por të njohura janë reagimet e shtetit. Nga autoritetet lokale në Prizren, familjes Kelmendi iu kërkua të largoheshin nga vendlindja e tyre: prindër, dy vëllezër e motra. Motra e mitur përjashtohet nga rinia. Filluan procedurat për përjashtimin e saj nga shkolla. Shteti jugosllav duket se është në nivelin e shoqërisë fisnore, ku kryen hakmarrje kolektive.³⁴⁰

Për ngjarjen e Paraqinit, Gjykata Ushtarake e Nishit filloi një gjueti kundër ushtarëve shqiptarë, duke i dënuar tetë nga ta, nën akuzat e pjesëmarrjes dhe ndihmës për kryerjen e veprës

³³⁷ Keljmendijev pucanj u Jugoslaviju - Rade Dragović | 17. septembar 2017
http://www.novosti.rs/dodatni_sadrzaj/clanci.119.html:686273-Keljmendijev-pucanj-u-Jugoslaviju

³³⁸ Mikel Ndreca, Terror dhe gjenocid shtetëror (1912 - 1999), Prishtinë, 2001, fq. 239.

³³⁹ Keljmendijev pucanj u Jugoslaviju - Rade Dragović | 17. septembar 2017
http://www.novosti.rs/dodatni_sadrzaj/clanci.119.html:686273-Keljmendijev-pucanj-u-Jugoslaviju

³⁴⁰ Branko Horvat; Kosovsko Pitanja, GLOBUS, Zagreb, 1987, fq.173

penale. Ata u dënuan me 20 vjet heqje lirie. Sipas fjalëve të mbrojtjes, vepra penale nuk ishte argumentuar. Ky proces më vonë u quajt i montuar. Një dekadë më vonë, gazeta e njohur: "Nasha Borba", e 9 majit të vitit 1997 botoi një artikull me titull: "Procesi është i montuar". Në artikull thuhet: "Ish prokurori ushtarak në Sarajevë ka deklaruar se procesi i lëndës së Paraqinit ishte i montuar, kurse avokati, dr. Jovan Buturoviq (në atë kohë ishte gjyqtar referues në shkallën e dytë - v.j S.K) i është drejtuar prokurorit ushtarak suprem, që të paraqesë kërkesën për përsëritjen e procedurës penale".³⁴¹

Ish -prokurori ushtarak në Sarajevë, tani kolonel në pension (i cili dëshiron të mbetet anonim tani për tani), ka deklaruar se procesi i ashtuquajtur i Paraqinit ka qenë i montuar. Organet e Sigurimit Ushtarak në Nish e kanë nxjerrë me dhunë pranimin e rrejshëm nga të dënuarit. Deponimet e rrejshme për fajin e të dënuarve janë nxjerrë me dhunë nga dëshmitarët.³⁴²

Disponimi antishqiptar i nxitur nga këto media rezultoi me veprime vandale të grupeve ekstremiste serbe. Ditëve në vijim, shumë nga ëmbëltoret, furrat e bukës dhe kioskat në gjithë Serbinë, pronarë të së cilave ishin shqiptarët, u demoluan. Ky vandalizëm të kujton "Kristalnacht" (nata e qelqtë), kur nazistët gjermanë organizuan demolimën e dyqaneve të hebrenjve, më 1938. Megjithatë, kjo ngjarje që ndodhi ishte një adut i fuqishëm në duart e nacionalistëve, që t'i mënjanonin nga pushteti ata që njiheshin si krerët burokratikë të Serbisë. Slavko Çuruvija shkruan se: "Atë verë pati një vrasje të ushtarëve në Paraqin, e cila më vonë u konstruktua dhe u shfrytëzua në përballjen përfundimtare për pushtetin në Serbi."³⁴³

Duke e parë këtë gjuhë nacionaliste që po përshkallëzohej, udhëheqja e Serbisë përmes Dragisha Pavlloviçit* i mbledhi redaktorët e gazetave të Beogradit dhe i paralajmëroi për rolin e madh të medias në këto eskalimet nacionaliste. Në këtë mbledhje që u transmetua publikisht, më 11 shtator, Pavlloviçi paralajmëroi: "Situata në Kosovë, e cila nuk po përmirësohet sipas shpejtësisë së dëshiruar e të premtuar është duke shkaktuar një ambient të rrezikshëm, ku çdo fjalë e theksuar kundër nacionalizmit serb është trajtuar si nacionalizëm. Fjalitë e zjarra mund ta sjellin vetëm zjarrin (...). Çfarë do të duhej të ndodhte, që të kuptojmë se shkrepësi i armës tërheq

³⁴¹ M. Ndreca, vepër e cituar, fq. 240.

³⁴² Po aty

³⁴³ Vladimir Petrović, ULOGA MEDIJA U UČVRŠĆENJU VLASTI SLOBODANA MILOŠEVIĆA, Istorija 20.Veka, 2/2013, fq. 193 - 94.

* Dragan Pavlloviçi, parardhës i Millosheviçit në krye të LKJ-së për Beograd. U shkarkua në sesionin e VIII - të që u mbajt në shtator të vitit 1987. Njeri i afërm i Stamboliçiçit

edhe fjalë të pamatura në skenën publike?”³⁴⁴ Qortimi i tij ishte adresuar ndaj përfaqësuesve të medias, si: “Politika”, “Politika Ekspres” dhe “Intervju”, por ato mund jenë të drejtuara kah politikanët, të cilët qëndronin prapa këtyre medieve.

Në Plenumin VIII të Lidhjes Komuniste, që u mbajt në shtator të po të njëjtit vit, Millosheviqi vendosi t’i eliminojë kundërshtarët e tij. Së pari, në mënyrë të planifikuar u sulmua Dragan Pavloviqi, e që nënkuptohej, sulmet ndaj tij ishin sulme ndaj vetë Stamboliçit. Sulmi ndaj Pavloviqit për mënjanimin e tij politik u orkestrua nga gruaja e Millosheviqit, Mira Markoviç. Në fakt, targeti ndaj Pavloviqit ishte planifikuar, më 13 shtator të vitit 1987, “në shtëpinë e gjyshit të bashkëshortes së Millosheviqit, ku ky i kalonte ditët e lira. Aty takohen: Slobodan Millosheviç, Mira Markovic, Dushan Miteviç dhe kryeredaktorët e “Politika” dhe “Express”: Zhivorad Minoviç dhe Slobodan Jovanoviç. U ra dakord që shtypi të niste një fushatë kundër Dragisha Pavloviçit. Teksti u shkrua nga Mira Markovic dhe u ndihmua nga Zivorad Minoviç, kryeredaktori i gazetës “Politika”, i cili gjithashtu luajti rolin e tipografit”.³⁴⁵ Ajo, në këtë artikull e akuzoi si një përçarës të unitetit jugosllav dhe përkrahës të irredentizmit shqiptar.

*“Veprimet e Dragisha Pavloviqit shprehin përçarje në realizimin e detyrave më të rëndësishme për problemet e shoqërisë dhe në veçanti me aplikimin e politikës, që duhet ndjekur në Kosovë”*³⁴⁶, thuhet në komunikatën e kryesisë së KQ të LKS. Pas njëzet orë diskutimesh, Pavloviqi dha dorëheqje, ndërkaq Slobodani i tha Stamboliçit, “Me vjen keq, por pozita jote është bërë e paqëndrueshme.”³⁴⁷ Heqja e Pavloviqit i hapi rrugë eliminimit të Stamboliçit. Më 14 dhjetor të vitit 1987, gjashtë anëtarët e presidencës kolegjiale të Serbisë votuan për shkarkimin e Ivan Stamboliçit nga posti i Presidentit të Republikës së Serbisë. Vetëm një në kolegjiun votoi pro tij, një tjetër abstenoj dhe katër votuan kundër. “Kjo ishte vrasja ime politike. Ata hodhën gjithçka që mundën në mua, ishin të vendosur për të më detyruar të largohem”³⁴⁸, - kujton Stamboliç në një intervistë të mëvonshme.

³⁴⁴ Vladimir Petrović, ULOGA MEDIJA U UČVRŠĆENJU VLASTI SLOBODANA MILOŠEVIĆA, Istorija 20.Veka, 2/2013, fq. 194.

³⁴⁵ Vladimir Petrović, ULOGA MEDIJA U UČVRŠĆENJU VLASTI SLOBODANA MILOŠEVIĆA, Istorija 20.Veka, 2/2013, fq. 194

³⁴⁶Po aty, f.47.

³⁴⁷ T. Judah, Kosovo: What everyone needs to know..., f. 79.

³⁴⁸The Death Of Yugoslavia 1/6 Enter Nationalism - BBC Documentary, <https://www.youtube.com/watch?v=vDADy9b2IBM>, qasja 20.04.2018.

Pas triumfit në Kongresin e Partisë, Slobodan Millosheviqi, vazhdoi ecejaket e konsolidimit të pushtetit të tij. Organizimi i pandërprerë i mitingjeve anëmbanë Serbisë u bë mjet i fuqishëm në dorën e tij, për të realizuar programin e tij dhe partisë së tij, që tashmë e kishte futur në dorë. Është e vërtetë se kjo programatikë nacionaliste kishte ende një pamje mbarë jugosllave, por në të dukeshin qartë aspiratat e hegjemonisë serbomadhe. Nacionalizmi serb, i gërshetuar me populizmin social dhe i mbështetur nga mediet, shkrimtarët dhe kisha ortodokse, u kthye në një potencial të madh mobilizues³⁴⁹

4.2 Mitingjet serbe, si shprehje e rritjes së nacionalizmit serb dhe presioni ndaj udhëheqjes legjitime të KSA të Kosovës

Vizionin e tij për rolin e popullit serb në Jugosllavi, Millosheviqi filloi që ta zbatojë menjëherë pas mbledhjes së tetë të KQ të LK të Serbisë, që u mbajt më 23-24 shtator 1987, i cili shënon momentin kryesor të ngritjes së tij në një lider kombëtar, por edhe të fillimit të një periudhe të re të shtetit jugosllav dhe të shoqërisë serbe. Në mënyrë energjike, duke shfrytëzuar pakënaqësinë e popullit dhe atmosferën nacionaliste, lideri i ri nisi rrugëtimin për renovimin e shtetit.³⁵⁰

Kriza ekonomike që kishte përfshirë vendin ishte një pretekst i mjaftueshëm për Millosheviqin, që nën maskën e ndryshimeve kadrovike ta bazonte programin e tij për dalje nga kriza. Duke e akuzuar sistemin për burokraci të dendur, që ishte pengesë në zbatimin e masave të duhura, hapi i parë i Millosheviqit ishte spastrimi i radhëve të LK të Serbisë, e më pas edhe të krahinave dhe zëvendësimi i tyre me njerëz besnikë, në mënyrë që të realizoheshin ambiciet politike të tij, të bazuara pjesërisht në pretendimet që buronin nga Memorandumi i vitit 1986, që cak kryesor kishin anulimin e autonomive krahinore dhe forcimin e pozitës së Serbisë në Federatën jugosllave.

Në këtë mënyrë u paraqit termi: “*Revolucioni antiburokratik*”, i cili në Serbi u zhvillua në dy faza. Faza e parë, që filloi me paraqitjen e Slobodan Millosheviqit në tubimin masiv të serbëve në Fushë Kosovë, në prill 1987 dhe përfundoi me ballafaqimin përfundimtar midis

³⁴⁹ W. Petritsch & R. Pichler, *Rruga e gjatë në luftë...*, f. 46-47.

³⁵⁰ R. Dragović, *Osmo sednica CK KP Srbije*, Fejton elektronik, http://www.novosti.rs/dodatni_sadrzaj/clanci.119.html:686773-Terror-nad-Srbima-na-Kosovu, 10 korrik 2018.

fraksionit të Millosheviqit e Stamboliçit në mbledhjen e tetë të KQ LKS, në shtatorin e po të njëjtit vit, karakterizohet nga mobilizimi zyrtar politik që e kreu Slllobodan Millosheviqi brenda LK të Serbisë, si dhe në aleancë me elementet e mobilizimit jozyrtar politik – lëvizjen qytetare të serbëve nga Kosova.³⁵¹

Pas spastrimit të elitës komuniste, që kishte refuzuar draftin mbi serbizimin, faza dytë e “Revolucionit antiburokratik”, që filloi menjëherë pas mbledhjes së tetë të KQ LKS, karakterizohet nga iniciativa e kryesisë së RS të Serbisë, për inicimin e ndryshimeve në Kushtetutën e Serbisë (janar 1988), si dhe tubimi shkencor në ASSHA (mars 1988) me titull: “Problemet aktuale të kushtetutës dhe ndryshimet kushtetuese”.³⁵²

Millosheviqi, menjëherë zbarkoi në mobilizimin masiv të serbëve (përmes një serie të mitingjeve masive) në mbështetje të një platforme të ngjashme me atë të Memorandumit: qëllimi i tij ishte që të mposhtet diskriminimi i supozuar kundër serbëve në Jugosllavi (në veçanti në Kosovë), integrimi i Kosovës dhe i Vojvodinës në Serbi, si dhe përforcimi i Federatës jugosllave. Në këtë frymë, ringjallja kombëtare serbe filloi një fushatë sistematike në shtyp dhe në tubime masive. Debatimi për qëllimet kombëtare serbe lulëzoi në Serbi si kurrë më parë.³⁵³

Derisa për fazën e parë, Millosheviqi, kishte nevojë në përvetësimin e anëtarësisë së Lidhjes Komuniste të Serbisë, sidomos, të organeve drejtuese të saj, në fazën e dytë, ai kishte nevojë për një lëvizje të jashtme, që do t’i tregonte opinionit jugosllav pozitën e vështirë juridike të Serbisë dhe nevojën për ndryshimet kushtetuese. Në këtë pikë, interesat e tij u përputhën me interesat e lëvizjes serbe të Kosovës, të cilët kërkonin që zëri i tyre të ndihej në gjithë hapësirën jugosllave, me shpresë të realizimit të kërkesave të tyre. Në këtë mënyrë, u arrit një aleancë midis LK të Serbisë dhe lëvizjes serbe të Kosovës, sidomos, kur kjo e fundit gëzonte mbështetjen e Kishës dhe inteligjencës serbe. Në këtë mënyrë, Millosheviqi, arriti ta fitonte edhe besimin e forcave nacionaliste të inteligjencës serbe, pasi që kërkesat e serbëve kosovarë ishin pothuajse gjithëherë të drejtuara kah ndryshimet kushtetuese, të cilat do ta garantonin unitetin e Serbisë, por edhe njëkohësisht në përpjekjet që ta ndryshojnë mbizotërimin etnik në Kosovë. Interpretimi i tyre kryesor i “tragjedisë serbe” bazohej në deklaratimet se shqiptarët etnikë me Kushtetutën e vitit

³⁵¹ Владимир Рибич, “Политичка мобилизација црногорских комуниста” у *Антибурократској револуцији*, Питања у етнологији и антропологији, н.с. Вол. 7, Ис 4 (2012), ф. 1081.

³⁵²S. Biserko, *Kovanje Antijugoslovenske zavere...*, f. 143.

³⁵³ A. Pavković, “From Yugoslavism to Serbism: the Serb national idea 1986-1996”, *Nations and Nationalism* 4 (4), 511-28 © ASEN 1998, fq. 514

1974 e kishin fituar kontrollin mbi krahinën dhe se e vetmja mënyrë, për ta ndalur “spastrim etnik” të serbëve nga Kosova ishte rivendosja e dominimit serb në këtë krahinë.³⁵⁴

Në shërbim të kësaj aleance, Millosheviqi, vuri gjithë logjistikën e nevojshme: Sholeviqit, Kecmanit dhe Budimiroviqit u eci fati: ata filluan të përcjellën nga mediet, të organizojnë mitingje, të marshojnë me flamuj në duar, të udhëtojnë; thjesht, ata u vunë në shërbim të drejtpërdrejtë të Millosheviqit.³⁵⁵

Në këtë mënyrë, lëvizja e serbëve të Kosovës (Otpor) u ngrit në një strukturë paralele dhe u bë instrument në tentimet për rrëzimin e udhëheqjeve politike në Vojvodinë dhe Mal të Zi, për të thyer kështu bllokadën kushtetuese që pengonte unifikimin e Serbisë.³⁵⁶

Veprimtaria kryesore me të cilën ishte ngarkuar ky grup ishte organizimi i “*mitingjeve të së vërtetës*”, që kishin për qëllim sensibilizimin e opinionit jugosllav për gjendjen në Kosovë, por qëllimi i fshehtë ishte edhe ndryshimi i udhëheqjeve krahinore dhe të asaj malazeze. Realizimi i aktiviteteve të tilla u lehtësua nga pushteti në Serbi, i cili tubimet e tilla i quante si “shprehje spontane e popullit”, edhe pse kishte fakte të shumta se një veprimtari e tillë ishte e organizuar paraprakisht. Kuadrot e Millosheviqit të emëruar në ndërmarrjet më të mëdha publike ofruan mbështetje logjistike për këtë spontanitet të organizuar. Për shembull: “Politika” shkruante se ndërmarrja novisadase “Jugoalat” pranoi iniciativën që të organizojë shkuarjen dhe kthimin nga mitingu në Titoverbas (gusht 1988), kurse për spontanitetin e tyre flasin konkluzionet e kreut të Lidhjes së Sindikatave të Serbisë: “Mitingjet mbahen deri në rregullimin e situatës” (9.9.1988), pastaj fjalët e Dragan Tomiqit, njërit nga bashkëpunëtorët më të afërt të Millosheviqit: “Do të ketë tubime të tjera” (14.9.1988), etj.³⁵⁷

Një rol të madh në organizimin, transmetimin e informacioneve dhe mbrojtjen e kërkesave që dilnin nga mitingjet e luajtën mediet serbe, në veçanti gazeta “Politika”, e cila ishte shndërruar në zëdhënëse të mitingjeve. Po ashtu, kjo gazetë u përgjigjej akuzave nga qarqe të ndryshme nga hapësira jugosllave. Informonte vendin dhe kohën kur do të mbaheshin mitingjet dhe çdo gjë rreth tyre.³⁵⁸

³⁵⁴V. Pesic, “Serbian Nationalism and the Origins of ...”, f. 16.

³⁵⁵Filip Švarn, Srce Tame - Paravojne formacije i MUP Srbije [VREME](https://www.vreme.com) | BR 618 | 7. NOVEMBAR 2002 <https://www.vreme.com/cms/view.php?id=325039>, qasja 30 korrik 2018.

³⁵⁶V. Vujacic, Reexamining the "Serbian Exceptionalism" Thesis, UC Berkeley, Publication Date 2004-06-01 Permalink <https://escholarship.org/uc/item/1mg8f31q>, qasja 10 qershor 2018.

³⁵⁷Olivera Milosavljević, Antibirokratska revolucija 1987-1989 godine, <https://vdocuments.site/antibirokratska-revolucija-by-olivera-milosavljevic.html>, qasja 20 mars 2019.

³⁵⁸ Политика, Београд, 1 септембар 1988, ф. 9; Политика, Београд, 3 септембар 1988, ф. 5.

Vojvodina u bë shënjestra e parë e planit të Millosheviqit, për ndryshimin e garniturës politike krahinore, që do t'i hapte rrugën ndryshimeve kushtetuese. Duke marrë si pretekst mosrealizimin e “Programit jugosllav për Kosovën”, serbët e Kosovës organizuan protestën e parë në Novi Sad, të emëruar si: “Mitingu i solidaritetit”, më 9 korrik 1988. Në fillim u brohoritën parulla të zakonshme: “Një shtet, një kushtetutë!”, “Serbia me tre pjesë, do të jetë unike përsëri!”, etj.³⁵⁹

U përdorën edhe brohoritje të tjera, që për pushtetin në Vojvodinë u cilësuan të rrezikshme e që synonin destabilizimin e krahinës, prandaj ajo doli kundër mitingjeve të tilla. Në fakt, një javë para mitingut të 9 korrikut, pushteti në Vojvodinë kishte dhënë indikacione të qarta kundër tendencave për ndryshimin e udhëheqjes krahinore. Në mbledhjen e KK të LSPP u potencua se: “*Atyre nuk u intereson Serbia e fortë, por Serbia e madhe. Kjo nënkupton sundimin mbi të tjerët edhe në RSS dhe RSFJ. Ne në Vojvodinë nuk do t'i kontribuojmë kësaj e as nuk guxojmë të luajmë me atë letër*”.³⁶⁰

Kundërshtimi ndaj kërkesave nga mitingu vazhdoi edhe më tej nga pushteti në Vojvodinë, i cili i shihte si ngjarje të paprecedentë, që grupi i qytetarëve nga Kosova të kërkojë nga populli i Vojvodinës që ta ndryshojë udhëheqjen që e ka zgjedhur vetë! Kërkesat serbe u cilësuan edhe si një presion që të aprovohen ndryshimet e propozuara kushtetuese para shqyrtimit demokratik publik.³⁶¹ Për më tepër, në disa raste udhëheqjet komunale edhe pse shpreheshin kundër organizimit të mitingjeve në qytetet e tyre, ato ishin të pafuqishme për t'i ndalur ato, sikurse ishte rasti me Verbasin.³⁶² Njëkohësisht, u prononcua edhe Kryesia e KQ të LKJ, duke theksuar se nuk janë të dëshirueshëm mitingjet një nacionale. Ky organ i konsideronte politikisht si tejet të dëmshme tubimet, demonstratat dhe format e tjera të presioneve demokratike, me të cilat keqpërdoret pozita e vështirë e serbëve dhe e malazezëve në Kosovë, çrregullohen marrëdhëniet ndërnacionale dhe zhvillohet fushatë e papërgjegjshme në një pjesë të mjeteve të informimit.³⁶³

Këto mitingje, forma e mbajtjes dhe parullat kishin shkaktuar brengosje te zyrtarët e lartë partiakë federativë, sidomos, të atyre me origjinë jo serbe, sikurse sekretari i kryesisë së KQ

³⁵⁹A. Stefanović, *Antibirokratska Revolucija...*, f. 13-14.

³⁶⁰*Rilindja*, Prishtinë, 2 korrik 1988, f. 4.

³⁶¹*Rilindja*, Prishtinë, 13 korrik 1988, f. 1.

³⁶²*Rilindja*, Prishtinë, 25 gusht 1988, f. 4; *Rilindja*, Prishtinë, 28 gusht, f. 3.

³⁶³*Rilindja*, Prishtinë, 13 korrik 1988, f. 1.

LKJ, Shtefan Koroshec, të cilët tani e konsideronin nacionalizmin serb më të theksuar se sa ai shqiptar.³⁶⁴

Përkundër sugjerimeve të KQ LKJ vazhduan tubimet e serbëve nën parullën e “Solidaritetit me serbët e Kosovës” apo “Mitingjet e së vërtetës”. Gjatë muajve korrik-gusht 1988 u organizuan mitingje në qytete të ndryshme të Serbisë dhe të Vojvodinës. Ato u shtrinë edhe në Mal të Zi. Më 19 gusht 1988 mbahet mitingu i parë protestues në Titograd, ku morën pjesë 15 mijë njerëz. Ajo që vihet në pah është rritja e orekseve nacionaliste e hegjemoniste serbe. Në mesin e parullave tashmë të njohura: “Kosova është Serbi”, “Vojvodina është Serbi”, dolën edhe parullat: “Duam armë, e “Mali Zi është Serbi”, gjë që futi një brengë të madhe në udhëheqjen politike malazeze.³⁶⁵

Krahas Malit të Zi, organizatorët e protestave serbe tentuan që ato t’i shtrijnë edhe në Slloveni, me pretekstin se populli slloven “nuk është i njoftuar me të vërtetën e Kosovës”. Ndryshe nga udhëheqja malazeze, udhëheqja sllovene nuk lejoi një veprimtari të tillë, duke kërcënuar se serbët nuk do të lejoheshin ta kalonin kufirin slloven. Sllovenët kishin ofruar mundësinë që serbët t’i paraqisnin qëllimet e tyre në forume politike dhe televizion, por ata kishin refuzuar një mundësi të tillë, sepse ishin të interesuar të shkaktonin dhunë.³⁶⁶

Por, serbët nuk hoqën dorë menjëherë nga Sllovenia. Këshilli për organizimin e mitingjeve të protestave të serbëve e malazezëve nga Kosova i dërgoi një telegram LSSP të Sllovenisë, ku ofronte dy variante të komunikimit me popullin slloven. Sipas variantit të parë, “një të shtunë të ardhme në Slloveni do të shkonin njëmijë kosovarë”, kurse sipas variantit të dytë: “ftohen njëmijë qytetarë të Sllovenisë për të ardhur në Fushë Kosovë, ku do të njoftoheshin së afërmi me jetën tonë”³⁶⁷. Por, edhe kjo tentativë nuk pati sukses, sepse emancipimi politik slloven ishte tepër i lartë. Rreth 41 punëtorë publikë, shkencorë e politikë të përcjellë nga gazetarë të medieje publike, si: “Dnevnik”, “Nedeljni Dnevnik”, “Kompas”, etj., erdhën në ekskursionin informativ në Kosovë, për t’u informuar sa më objektivisht rreth situatës aktuale, ekonomike, politike e të sigurisë në Kosovë.³⁶⁸

Derisa gjatë korrikut e gushtit 1988, protestat, krahas toneve për ndryshime kushtetuese e për një Serbi unike, shoqëroheshin edhe me parulla kundër burokracisë, për të drejtat e

³⁶⁴Rilindja, Prishtinë, 29 gusht 1988, f. 1.

³⁶⁵Rilindja, Prishtinë, 20 gusht 1988, f. 3; Rilindja, Prishtinë, 26 gusht 1988, f. 1.

³⁶⁶ Warren Zimmermann, *Origins of a catastrophe-Yugoslavia and its destroyers*, Times Books, 1999, f. 52-53.

³⁶⁷Rilindja, Prishtinë, 20 gusht 1988, f. 6.

³⁶⁸Rilindja, Prishtinë, 7 shtator 1988, f. 5.

punëtorëve dhe për ruajtjen e Jugosllavisë së shokut Tito. Ato kah shtatori marrin një ngjyrim tjetër. Qysh në mitingun e 3 shtatorit 1988, në Smederevë, që u pasua nga ai në: Zrenjanin, Cervenke dhe disa qytete të tjera të Vojvodinës, filloi një sulm më i haptë dhe më i qartë kundër shqiptarëve, duke u etiketuar me projektin e Shqipërisë së Madhe nën drejtimin e Fadil Hoxhës, duke sulmuar ndryshimet kushtetuese, që u dhanë të drejta shqiptarëve dhe duke u ankuar për dëbimin e 100.000 serbëve e malazezëve gjatë kohës së okupacionit. Tani filloi edhe këndimi i këngëve nacionaliste. Fotografitë e Titos u zëvendësuan me ato të Millosheviqit, Vojvoda Nishiqit, Betejës së Kosovës, Njegoshit, kurse parullat mbizotëruese ishin: “Rroftë Serbia!”, “Një Kushtetutë!”, “Serbia unike!”, “Na jepni armë!”, “Të shkojmë në Prishtinë!”, “Slobodan Millosheviç – jemi me ty!”, etj., krahas kërkimit të dorëheqjes së Azem Vllasit, Kolë Shirokës, B. Kruniqit, etj.³⁶⁹

Brohoritjet për Millosheviqin dhe bartja e fotografive të tij ishin aq masive, sa që sipas gazetës "Politika", ai i kishte drejtuar apel popullit duke thënë se: “Kjo lloj përkrahjeje e tejkalon tepër shumë rolin e individit”.³⁷⁰

Karakteristikë tjetër e tubimeve të cekura më lart, ishte edhe pjesëmarrja e qytetarëve me veshje kombëtare serbe e malazeze, më së shumti me “shajkaqën” serbe dhe “kapicën” malazeze, si dhe me veshje e simbole të kishës ortodokse. Kishte edhe qytetarë të mbështjellë me flamurin e Serbisë, si dhe skica të shumta me katër shkronja “S”, të ndara me kryq, që nënkuptonin: “Vetëm bashkimi i shpëton serbët!”.³⁷¹

Strategjia e mitingjeve ishte planifikuar me kujdes. Në qytetet me popullsi shumë etnike, propaganda serbe u kujdes t’i pasqyronte ato, jo vetëm si të serbëve, por edhe të qytetarëve të tjerë, apo se në mesin e shqiptarëve kishte edhe njerëz të ndershëm, që solidarizoheshin me pozitën e vështirë të serbëve. Në këtë mënyrë, ata i manipulonin masat, sidomos, mediat serbe i dhanë rëndësi fjalimit të Ajshe Popoviqit, në mitingun e Bellacerkves, e cila duke e quajtur veten shqiptare i luti nënat shqiptare të Kosovës: “*Që të mos lejojnë urrejtje në zemrat e fëmijëve të tyre, duke thënë se kështu do ta ndërpresin fatkeqësinë, në të cilën rininë shqiptare po e çojnë separatistët e nacionalistët*”.³⁷²

³⁶⁹Rilindja, Prishtinë, 4 shtator 1988, f. 6.

³⁷⁰O. Milosavljević, Antibirokratska revolucija 1987-1989 godine, <https://vdocuments.site/antibirokratska-revolucija-by-olivera-milosavljevic.html>, qasja 20 mars 2019.

³⁷¹Rilindja, Prishtinë, 5 shtator 1988, f. 4.

³⁷²Rilindja, Prishtinë, 26 shtator 1988, f. 2.

Tjetër tipar i kësaj strategjie në vendet shumë etnike ishte edhe shkrimi i parullave në gjuhët e pakicave, si në: gjuhën hungareze, ruse, sllovaqe, etj.³⁷³

Krahas mitingjeve, u mbajtën tubime protestuese edhe në kuadër të organizatave punuese, sidomos, industrive me shumë punëtorë. Tëtohej me çdo kusht të manipuloheshin të gjitha masat. Edhe ata që nuk dilnin në mitingje, duhej t'i dëgjonin porosinë përmes tubimeve në organizata. Në këtë mënyrë, në industrinë e thëngjillit në Sombor u tubuan njëmijë punëtorë për të “protestuar kundër shpërnguljes së serbëve e malazezëve”.³⁷⁴

Po ashtu, në njërën nga fabrikat më të mëdha në Novi Sad: “Jogoalat” u mbajt një mbledhje e punëtorëve, ku u shpreh mosbesimi ndaj udhëheqjes së Vojvodinës dhe ku u miratuan qëndrimet e udhëheqjes së Serbisë lidhur me “luftën kundër kundërrevolucionit në Kosovë”.³⁷⁵ Kurse, në tubimin e komunistëve në industrinë mishit në Banat, iu dha përkrahje e madhe KQ LKS dhe u kërkua përcaktimi i Serbisë si shtet.³⁷⁶

Masiviteti i këtyre tubimeve, e sidomos i parullave dhe i brohoritjeve nacionaliste ringjalli edhe njëherë debatin në skenën politike jugosllave rreth përkrahjes apo dënimit të këtyre mitingjeve. Në mbledhjen e përbashkët të kryesisë së RS të Serbisë dhe të KQ LKS, në fillim të shtatorit 1988, mbizotëroi konstatimi se gjendja në Kosovë po keqësohet, për çka edhe protestat e popullatës serbe e malazeze në mjedise të ndryshme të vendit janë të arsyeshme, ngaqë manifestojnë pakënaqësinë e kësaj popullate.³⁷⁷

Po në të njëjtën mbledhje, edhe Millosheviqi u shpreh me një përkrahje të hapur për mitingjet. *“Veçse janë shprehje e solidaritetit me qytetarët, të cilëve u është rrezikuar gjithë çfarë ata kanë, përfshirë edhe vetë jetën e tyre. Këto mitingje, po ashtu, janë edhe shprehje e pakënaqësisë që organet shtetërore, politike, institucionet e organizatat kompetente, para se gjithash udhëheqjet e tyre, nuk i kanë marrë me kohë të gjitha masat e nevojshme, që revolucionit, jo vetëm të ndalet qysh në fillim, por kanë lejuar që situata të eskalojë”*, - shprehej Millosheviqi.³⁷⁸

Për më tepër, Millosheviqi, pikëpamjet e tij për mitingjet i paraqiti në tre këndvështrime:

(1) Nuk pajtohej se tubimet ishin jo institucionale, por se ato ishin tubime masive të popullit për

³⁷³Rilindja, Prishtinë, 5 shtator 1988, f. 1.

³⁷⁴Rilindja, Prishtinë, 4 shtator 1988, f. 1.

³⁷⁵Политика, Београд, 10 септембар 1988, f. 16.

³⁷⁶Политика, Београд, 12 септембар 1988, f. 8.

³⁷⁷Rilindja, Prishtinë, 6 shtator 1988, f. 1.

³⁷⁸ Слободан Милошевић, Године расплета, четврто издање, београдски издавачко-графички завод <http://www.skripta.info/wp-content/uploads/2017/01/Slobodan-Milosevic-Godine-raspleta.pdf>, f. 246.

t'i shprehur mendimet për zhvillimet në shoqëri, dhe se këto ishin tubime të punëtorëve, të rinisë, të luftëtarëve, të komunistëve, të fshatarëve, pra të popullit; (2) Se ato nuk janë një nacionale, por shumë nacionale, sidomos në Vojvodinë, dhe (3) Tubimet në Serbi kanë karakter masiv. Megjithatë, nuk ndalemi e as që kemi ndërmend të ndalemi. Çdo gjë në Serbi këtë verë do të jetë masive. Vetë fakti se çdo zhvillim ka karakter masiv nuk do të thotë se njëkohësisht përmban edhe karakter negativ. Fakti se në këto mitingje u dëgjuan edhe parulla të papranueshme, armiqësore dhe çetnike, si për shembull: "Vdekje shqiptarëve!", nuk guxon të nënvlerësohet dhe nuk guxon të mos emërtohet, por kjo nuk i komprometon këto tubime.³⁷⁹

Derisa Serbia doli haptas në mbrojtje të mitingjeve, kryesia e KQ LKJ ishte më e moderuar, në raport, me mitingjet se sa ishte më herët. Përveç se u vlerësuan si shprehje e pakënaqësisë së arsyeshme të pjesëtarëve të këtyre kombeve në Kosovë, u kritikua, po ashtu, tendenca për shprehjen e toneve nacionaliste.³⁸⁰

I ndryshëm nga këto dy instanca ishte reagimi i udhëheqjes politike të Bosnjë-Hercegovinës. Kryesia e KQ të LK të Bosnjë-Hercegovinës vlerësoi se tubimeve në baza një nacionale duhet kundërvënë edhe me mjete ligjore dhe se një tubim i paralajmëruar për t'u mbajtur në Jajcë, më 10 shtator, ka për qëllim mbjelljen e mosbesimit ndërnacional dhe si të tillë qytetarët e BH-së nuk e dëshirojnë dhe e gjykojnë. U kërkua nga kryesia e KQ LKJ, ajo e KQ LKS dhe KK LK të Kosovës që të pengohet mbajtja e tubimeve në BH.³⁸¹

Udhëheqja kosovare ndoqi linjën e KQ LKJ lidhur me mitingjet. Në një prononcim për mediet serbe, Rrahman Morina, sekretar i SPB, deklaronte se respektonte qëndrimet e KQ LKJ dhe se tubimet një nacionale janë të dëmshme, sepse shumë lehtë mund të ndodhë që të dalin probleme të mëdha.³⁸² Presioni politik serb ishte aq i fuqishëm, sa që udhëheqja politike kosovare duhej të përdorte tone të moderuara ndaj mitingjeve, paraprakisht, duke potencuar luftën kundër nacionalizmit shqiptar e pastaj, duke shprehur brengën për nacionalizmin serb dhe parullat shqetësuese që dalin nga mitingjet e serbëve.³⁸³ Pra, liderët kosovarë tentonin t'i shmangeshin ballafaqimit direkt me propagandën serbe. Mbanin një pozitë disi të ekuilibruar dhe shtonin retorikën ndaj nacionalizmit serb. Një qëndrim i tillë është diktuar nga kushtet politike, sidomos, kur sugjerimet e zyrtarëve krahinorë nuk përfillëshin, sidomos, kur udhëheqja

³⁷⁹ Po aty, f. 248-250

³⁸⁰ *Rilindja*, Prishtinë, 1 shtator 1988, f. 1.

³⁸¹ *Rilindja*, Prishtinë, 3 shtator 1988, f. 1.

³⁸² *Rilindja*, Prishtinë, 4 shtator 1988, f. 4.

³⁸³ *Rilindja*, Prishtinë, 20 shtator 1988, f. 4.

federative nuk kishte as vullnet e as interes që t'i hyhet të vërtetës për Kosovën dhe për Serbinë. Një rast konkret i një mospërfilljeje të tillë ishte Plenumi i XVI i LKJ, ku edhe pse ishte marrë vendimi për ndërprerje të tubimeve nacionale, ato, përkundrazi, u intensifikuan edhe më tej.³⁸⁴

Në tetor të vitit 1988, mitingjet e arritën kulmin e tyre në Vojvodinë. Në ditët e para të këtij muaji, demonstruesit u mbledhën në Novi Sad dhe kërkuan dorëheqjen e udhëheqjes krahinore. Ishte ky mitingu i tretë që po mbahej në këtë qytet dhe në të cilin, sipas medieve serbe, morën pjesë 80.000 njerëz. Sipas gazetës beogradase “Politika”, tubimi në Novi Sad ishte një reagim spontan i qytetarëve që kishin ardhur nga Baçka Pallanka, Verbasi, Zrenjanini, Vershaci, etj., ndaj kritikave të udhëheqjes krahinore kundër Mihal Kertesit (kryetar i LK në Baçka Pallanka) e Radoman Pankovit (kryetar i komunës së Baçka Pallankës), që kishin folur lidhur me pengesat për ndryshime kushtetuese, ca ditë më parë.³⁸⁵

Protestuesit nuk u shpërndanë gjatë tërë natës. Ata qëndruan para ndërtesës së KK LKV, duke mbajtur transparente të ndryshme, parulla tashmë të njohura nga arsenalu i tubimeve të deritashme të serbëve e malazezëve nëpër viset e ndryshme të vendit.³⁸⁶

Më 7 tetor 1988 udhëheqja politike krahinore dha dorëheqje kolektive.³⁸⁷ Rënia e garniturës politike të Vojvodinës u quajt ndryshe edhe “*Jogurt revolucion*”, pasi që demonstruesit e Millosheviqit e qëlluan ndërtesën e Kuvendit të Vojvodinës me shishe jogurti.³⁸⁸

Menjëherë pas udhëheqjes krahinore, dorëheqje dha edhe udhëheqja partiake komunale e Novi Sadit.³⁸⁹ Dorëheqjet në fjalë shënuan fillimin e spastrimit të LK të Vojvodinës nga elementet autonomiste dhe zëvendësimin e tyre me ithtarë të politikës së Millosheviqit. U bënë ndryshime në të gjitha nivelet krahinore e komunale, organizatave shoqërore e politike, me të cilën paralelisht u bë edhe diferencimi ideopolitik.³⁹⁰

Qëllimi u arrit, udhëheqja e Vojvodinës dha dorëheqje kolektive. Edhe përkundër arritjes së qëllimit, protestat vazhduan në të gjithë Vojvodinën, në shenjë përkrahjeje për ndryshimet kushtetuese. Në këtë periudhë ndryshon edhe emërtimi i protestës, në vend të “mitingjeve të solidaritetit”, tani tubimet e tilla u quajtën: “mitingjet e vëllazërim-bashkimit”.³⁹¹

³⁸⁴Zëri i Rinisë, nr. 1341, 12-19 maj 1990, Intervistë me Remzi Kolgecin, f. 28.

³⁸⁵Politika, Beograd, 6 Oktobar 1988, f. 9

³⁸⁶Rilindja, Prishtinë, 7 tetor 1988, f. 1.

³⁸⁷Politika, Beograd, 7 Oktobar 1988, f. 1; Rilindja, Prishtinë, 7 tetor 1988, f. 1.

³⁸⁸H. Clark, *Civil Resistance in Kosovo...*, f. 46-47.

³⁸⁹Politika, Beograd, 8 Oktobar 1988, f. 5.

³⁹⁰Rilindja, Prishtinë, 30 tetor 1988, f. 3.

³⁹¹A. Stefanović, *Antibirokratska Revolucija...*, f. 15.

Po të njëjtën kohë, në Mitrovicë u tubuan rreth 5 mijë serbë e malazezë, për të shprehur kërkesat e tyre tashmë të njohura, për Serbi të fortë e unike dhe ndërrimin e shumë udhëheqësve të krahinës e të vendit, me çka sipas tyre do të zgjidheshin vuajtjet e popullit serb në Kosovë, përkatësisht do t'i jepej fund dramës kosovare.³⁹²

Rënia e udhëheqjes së Vojvodinës inkurajoi protestuesit, të cilët menjëherë po në atë vllugun e madh të zhvillimeve ia mësynë, më 8 tetor, Malit të Zi. Protestuesve iu bashkëngjiten punëtorët e fabrikës: "Radoje Dakiç" dhe studentët. Rreth 10.000 protestues kërkonin dorëheqjen e KQ LK të Malit të Zi, për shkak të angazhimit të pamjaftueshëm për zgjidhjen e dramës së Kosovës, si dhe të udhëheqjes partiake të Titogradit. Ndër parullat dhe brohoritjet kryesore veçohen: "E keni shitur Kosovën!", "Sllobo-sllobodo!", "T'i ndërrojmë hajnat!", etj.³⁹³

Policia u detyrua ta përdorte dhunën për shpërndarjen e protestuesve. Për ta parandaluar një zhvillim, sikurse në Novi Sad, qeveria malazeze autorizoi policinë, që ta bllokonte rrugën Nikshiq-Titograd. Ky veprim u cilësua si një veprim në kuadër të masave për parandalimin e rrethanave të jashtëzakonshme.³⁹⁴

Kulmi i mitingjeve u zhvillua në Beograd, në nëntor të vitit 1988. Sipas shtypit partiak, në këtë miting morën pjesë mbi një milion njerëz, ku më pas u shndërrua në një demonstratë kundër liderëve partiakë të Kosovës dhe në favor të ndryshimit të kushtetutës. Mesazhi nga ky tubim ishte i qartë. Shqiptarët e Kosovës nuk ishin vetëm armiq, por ishin armiku numër 1. Pastaj, në mënyrë të ndyrë e primitive, ata filluan një fushatë, për ta bërë Kosovën etnikisht të pastër, duke i dëbuar serbët e malazezët përmes veprave të ndryshme kriminale dhe duke e ruajtur shkallën e tyre të natalitetit, që ishte më e larta në Evropë.³⁹⁵

Përpjekjet për rrëzimin e pushtetit në Mal të Zi u riaktivizuan në janar të vitit 1989. Protestave në Mal të Zi iu prinin punëtorët e metalurgjisë. Protestës iu bashkuan edhe studentët dhe një numër i madh i qytetarëve malazezë, si dhe punëtorët e kolektivave të tjerë. Në sheshin para Kuvendit u mblodhën rreth 40 mijë veta. Përmes parullave: "*Duam dorëheqje!*", "*Poshtë njerëzit e kolltukëve!*", "*Kush guxon t'i rrahë punëtorët!*" etj., këta kërkonin dorëheqjen e të gjitha strukturave udhëheqëse të Malit të Zi. Skenari i Millosheviqit po ecte sipas planifikimit. Ja çka thotë për Millosheviqin njëri nga folësit, në protestën e 10 janarit 1989, që u mbajt në Titograd:

³⁹²Rilindja, Prishtinë, 10 tetor 1988, f. 1.

³⁹³Rilindja, Prishtinë, 8 tetor 1988, f. 1.

³⁹⁴Политика, Београд, 11 Октобар 1988, f. 10; Rilindja, Prishtinë, 9 tetor 1988, f. 1.

³⁹⁵H. Clark, *Civil Resistance in Kosovo...*, f. 19; Политика, Београд, 20 Ноембар 1988, f. 1.

"Nuk e do kombi malazez Sllobodan Millosheviqin vetëm pse është serb, por ngase ai flet edhe punon ashtu siç mendon populli. Ai na është i dashur edhe nga fakti se na ka zbuluar atë që të tjerët nuk dinin, ose nuk dëshironin të dinë! Populli e do edhe ngase lufton për Serbi e Jugosllavi unike e të fortë dhe se po pengon gjenocidin në Kosovë (kinse ndaj serbëve -shënim i autorit)".³⁹⁶

Mënjanimin e konjunkturave të RSFJ-së dhe zëvendësimi i tyre me marioneta të Beogradit po realizohej suksesshëm. Milan Kučan, lideri i komunistëve slloven të ashtuquajturin "revolucion antiburokratik" e shpjegonte kështu: "Revolucioni antiburokratik demokratik është vetëm ai, i cili zhduk raportet shoqërore mbi të cilat është vendosur burokratizimi, kolltukët dhe nevoja për liderë, e jo ai, i cili rirreshton, risistematizon e ricakton këto kolltukë, me atë që në vendin e ish-liderëve sjell liderë të rinj".³⁹⁷ Pra, nuk ishte asgjë tjetër, pos një skenar i shpikur për t'i eliminuar strukturat, që ishin projugosllave dhe për t'i zëvendësuar me ato proserbe.

Pas revoltës studentore, ndërprerjes së punëve në ndërmarrjet publike dhe konflikteve me policinë, pushteti malazez lëshoi pe. Pozitat e Marko Orlandiqit, Vidoje Zharkoviqit dhe të Miljana Radoviqit u pasuan nga të rinjtë: Momir Bullatoviq, Milo Gjukanoviq dhe Svetozar Maroviq.³⁹⁸

Kah fundi i fazës së dytë, organizatat komunale si: Lidhja Socialiste e Popullit Punonjës dhe LK komunale, gradualisht morën përsipër nga lëvizja e serbëve të Kosovës e Metohisë organizimin e mitingjeve. Në këtë mënyrë mitingjet gjithnjë e më tepër u bënë shprehje të mobilizimit formal politik. Në Vojvodinë ky ishte rezultat i një presioni të mobilizimit joformal politik, që solli konflikte brenda institucioneve dhe organizatave politike. Në anën tjetër, në Serbinë qendrore, pushteti republikan organizoi tubime masive për të parandaluar përhapjen e mobilizimit joformal politik.³⁹⁹

Me zhvillimin e rrethanave të reja, kur tanimë Millosheviqi ishte forcuar mjaftueshëm, ai e gjykoi të papranueshëm mosdëgjueshmërinë e "Otporit" nga Kosova, të cilët kishin filluar të dalin nga kontrolli. Prandaj, Millosheviqi përdori mekanizma të tjerë në organizimin e mitingjeve. Mitingu në Nova Pazova, në fillim të vitit 1989, ishte mitingu i parë i organizuar nga strukturat lokale të partisë socialiste, e jo nga ana e serbëve të Kosovës; e dyta, nga ky miting e tutje, do të vërehet pjesëmarrja e një grupi të meshkujve, të cilët në media u quajtën: "Djemtë

³⁹⁶Rilindja, Prishtinë, 11 janar 1989, f. 6.

³⁹⁷Rilindja, Prishtinë, 31 janar 1989, f. 5.

³⁹⁸Rilindja, Prishtinë, 14 janar 1989, f. 1; R. Dragović, *Osmo sednica CK KP Srbije*, Fejton elektronik, http://www.novosti.rs/dodatni_sadrzaj/clanci.119.html:686773-Teror-nad-Srbima-na-Kosovu, 10 korrik 2018.

³⁹⁹В. Рибич, Политичка мобилизација црногорских комуниста..., f. 1082.

nga Nova Pazova” dhe “Obiliqët serbë”. Sjellja e tyre, sipas rrethanave të kohës, ishte në kufij të nacionalizmit pasi që bartnin fotografitë e Karagjorgjit, Njegoshit, Vuk Karaxhiqit, dhe bënë thirrje me parullën: “Vetëm bashkimi e shpëton Serbinë!”, “Nuk kërkojmë asgjë tjetër deri tek ajo që ishte e Car Dushanit dhe, ndoshta, për herë të parë edhe parulla kundër komuniste: “Mjaft me hijen e zezë që na dërgon te pesëcepëshi!”.⁴⁰⁰

Eliminimi i serbëve të Kosovës nga loja politike e Millosheviqit u konfirmua edhe nga vetë Sholeviqi, i cili shihej i zemëruar se asnjë serb nga Kosova nuk ishte ftuar në kremtimin e Kushtetutës së re të Serbisë, më 28 mars 1989. Në manifestimin e Gazimestanit, serbët e Kosovës ishin marginalizuar plotësisht. Kështu tregon eksponenti kryesor i serbëve të Kosovës, Sholeviq: *"Në Gazimestan ne kemi qenë jashtë loje. Lëvizja jonë ishte shpërbërë. Çdo gjë ishte në duar të partisë. Shërbimet e saj punonin...Mua gjithçka m'u bë e qartë, më 28 mars 1989: Kremte e madhe në qendrën "Sava". Kushtetutë e re. Krahinat u rikthyen në Serbi. Kurse në mesin e 1300 të ftuarve nuk kishte asnjë serb nga Kosova. Kuptova se regjimit nuk i duheshim më dhe çdo gjë po ec me të vjetrën"*.⁴⁰¹

Në të njëjtën kohë, gradualisht, filloi të forcohet edhe elementi i nacionalizmit. Në të vërtetë, Millosheviqi vazhdoi që në fjalimet e tij të promovojë vlerat e socializmit vetëqeverisës jugosllav, por, krahas, ftesës për solidarizim me serbët nga Kosova e Metohia, ai gjithnjë e më tepër evokoi të kaluarën heroike serbe. Me përhapjen e mobilizimit formal politik përtej organeve partiake e shtetërore, ku në të u futën edhe qytetarë, që nuk ishin pjesë apo simpatizantë të LK. Kjo krijoi parakushtet që Millosheviq të promovojë si një lider kombëtar, e jo vetëm si njeriu i parë i LKS. Në fund të “Revolucionit antiburokratik” nacionalizmi mbizotëroi mbi elementet e kontinuitetit ideologjik.⁴⁰²

⁴⁰⁰A. Stefanović, *Antibirokratska Revolucija...*, f. 14.

⁴⁰¹S. Ast, Miroslav Šolević: Režim nas je iskoristio, Vreme broj 454, 18. septembar 1999. https://www.vreme.com/arhiva_html/454/11.html, qasja 10 maj 2018.

⁴⁰²В. Рибич, Политичка мобилизација црногорских комуниста..., f. 1084.

4.3. Përgatitjet për suprimimin e rendit politik - kushtetues në Kosovë dhe greva e minatorëve

Ndryshimi i garniturës udhëheqëse në Vojvodinë dhe në Mal të Zi, respektivisht, instalimi i vartësve të tij në pushtetin e këtyre dy njësisve federale, i dha dorë të lirë Millosheviqit që vëmendjen e tij ta orientonte në drejtim të KSA të Kosovës. Hapi i parë, në këtë drejtim ishte shkatërrimi i udhëheqjes kosovare, përmes lirimit nga funksionet, më 17 nëntor 1988, të dy figurave kryesore të Komitetit Krahinor të Kosovës: Azem Vllasit e Kaqusha Jasharit (kryetare e KK të LKK), dhe zëvendësimit të tyre me figura të dëgjueshme, të cilët do të bëhen pjesë e realizimit të skenarit për rrënimin e rendit politik-juridik në Kosovë. Në fakt, lirimi i këtyre figurave ishte bërë nën maskën e “përtëritjes kadrovike” të strukturave komuniste në Kosovë. KQ i LKJ e fajësonte Komitetin Krahinor të LKK dhe Kryesinë e saj për keqësimin e gjendjes në Kosovë. Pasi që parimet e përtëritjes kadrovike nuk lejonin që një person t’i ushtrojë dy pozita, atëherë Kryesia e KK LKK vendosi që Azem Vllasi të lirohet nga detyra e anëtarit të kësaj kryesie. Por, për shkak të kontributit të tij në punën e deritanishme të KK LKK, vendosi që ai të mbetet në anëtarësinë e KQ të LKJ.⁴⁰³

Ishte e qartë se Millosheviqi përmes manovrimeve, me sukses po i realizonte planet e tij për eliminimin politik të figurave kryesore në Kosovë. Por, shqiptarët i kuptuan këto makinacione të tij, që qartazi ishin të orientuara drejt heqjes së autonomisë, sidomos, kur ato figura të larta politike u zëvendësuan me njerëz të dëgjueshëm si: Rrahman Morina*, Ali Shukriu* dhe Hysamedin Azemi, të cilët kishin për detyrë të “shprehnin vullnetin politik të popullit në Kosovë”. Si rrjedhojë, në Kosovë, filluan tubimet e shqiptarëve kundër ndryshimeve

⁴⁰³ *Arkivi i Kosovës* (më tej: AK), Fondi: Komiteti Krahinor i LK të Kosovës. Dosja 447. Informatë nga mbledhja e Komitetit Krahinor që u mbajt me 1 dhjetor 1988, për organizimin e tubimeve masovike nga data 17 - 21 nëntor 1988, f. 7.

***Rrahman Morina**. Në vitin 1981, ai u emërua si ministër i punëve të brendshme dhe kështu morri pozitën më të lartë të forcave të armatosura shqiptare në Kosovë. Në të njëjtin vit, gjatë demonstratave në Kosovë, ai ka urdhëruar policinë që të ndaloj demonstratat, pa u konsultuar me qeverinë e atëhershme kosovare. Në fund te janarit te vitit 1989 Rrahman Morina ish-shefi i policisë së Kosovës u bë udhëheqës i Lidhjes Komunistëve të Kosovës, pas largimit të Azem Vllasit me urdhërin e Millosheviqit. Nga shqiptarë konsiderohej dorë e zgjatur e Serbisë dhe për këtë arsye u kërkua dorëheqja e tij me ngulm nga minatorë të cilët ishin ngujuar në zgapellë. Dorëheqja u dha në mbledhjen e jashtëzakonshme të kryesisë së organizatës së partisë në Prishtinë gjë që le të kuptohet karakteri i nxituar i këtij veprimi. U rehabilitua menjëherë në pozitën që kishte qenë. Vdes në rrethana të dyshimta. mendohet se është helmuar me urdhër të Millosheviqit , pasi që nuk iu duhej më.

***Ali Shukria**, lindi me 1919 në Mitrovicë, - 2005, aktivist dhe luftëtar i Luftës së Dytë Botërore. Ali Shukriu në gusht të vitit 1981, pas demonstratave, të ashtuquajtura në atë kohë nga regjimi si "kundër-revolucionare", u emërua në postin e Kryetarit të Kryesisë së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës. Në këtë post qëndrojë për 1 mandat, deri në maj të vitit pasues, 1982, kur Kolë Shiroka do emërohet në këtë postë. Vdes në Beograd, në vitin 2005.

në udhëheqjen krahinore, që ishte parakusht për të kundërshtuar edhe ndryshimet kushtetuese. Në këtë mënyrë, qysh në ditën e lirimt nga funksioni të Azem Vllasit e Kaqusha Jasharit, më 17 nëntor 1988, minatorët e Trepçës marshuan në këmbë për në Prishtinë në mbrojtje të udhëheqjes krahinore.⁴⁰⁴ Në periudhën 17-21 nëntor 1988 në këmbë u çuan edhe studentët, shoqëria, por edhe klasat punëtore dhe profesionale të shqiptarëve, të cilët ishin integruar mirë në sistemin socioekonomik jugosllav dhe që ndikoheshin drejtpërdrejt nga ndryshimet politike me të cilat kërcënohej Millosheviqi.⁴⁰⁵

Situata politike dhe e sigurisë në Kosovë kishte arritur kulmin e rrezikshmërisë, nga njëra anë revoltat shqiptare, kurse nga ana tjetër, mitingjet dhe organizimet e serbëve. Dallimi midis këtyre dy zhvillimeve shpjegohet mjaft qartë nga historiani britanik Noel Malcolm: *“Me t’u përhapur fjala për këto ndërrime, në Kosovë menjëherë shpërthyen protesta të masave. Për dallim nga mitingjet e turmave në Vojvodinë dhe në Mal të Zi, këto protesta ishin organizuar për mbrojtjen e udhëheqjes lokale partiake - dhe për më tepër ato nuk ishin organizuar nga lart, për to nuk ishte paguar asnjëri dhe turma nuk ishte sjellë aty me autobusë”*.⁴⁰⁶

Me fjalë të tjera, këto ishin vetorganizim popullor, pa dirigjimin e strukturave partiake dhe pa përdorimin e logjistikës transportuese. Vullneti i pastër bëri që minatorët të ecnin në këmbë rreth 100 km vajtje-ardhje. Atyre iu bashkuan edhe grupe njerëzish nga 23 komunat e Kosovës⁴⁰⁷, edhe përkundër motit të ftohtë. Protestat e shqiptarëve të kësaj periudhe kaluan pa asnjë incident të vetëm. Kjo ishte dëshmi se shqiptarët ishin të disiplinuar dhe nuk ishin ashtu, sikurse i paraqisnin serbët, por ndryshe nga ata.⁴⁰⁸

Ndërkohë, derisa shqiptarët u ngritën në këmbë për të mbrojtur parimet kushtetuese të vitit 1974, në kundërpërgjigje, Millosheviqi vazhdoi me inskenimin e një mitingu të madh që u mbajt, më 19 nëntor në Beograd, i quajtur: *“Bratstvo i jedinstvo (vëllazërim-bashkim)*. Raif

⁴⁰⁴ A. Vllasi, Minatorët e kthyen vëmendjen e botës demokratike nga Kosova, <https://www.koha.net/arberi/146835/vllasi-minatorete-e-kthyen-vemendjen-e-botes-demokratike-nga-kosova/>, qasur 20 shkurt 2019.

⁴⁰⁵ Abetarja e Pushtetit: Libërth mbi politikën, njerëzit dhe partitë në Kosovë, IKS, [Iniciativa Kosova për Stabilitet]. Prishtinë, 2011, f. 22. .

⁴⁰⁶ N. Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër...*, f. 357.

⁴⁰⁷ AK, Fondi: Komiteti Krahinor i LK të Kosovës. Dosja 447. Informatë nga mbledhja e Komitetit Krahinor që u mbajt me 4 dhjetor 1988, për organizimin e tubimeve masovike nga data 17 - 21 nëntor 1988 (fjalimi i Minir Dushit), f. 7.

⁴⁰⁸ Pierre Dufour, *Kosova -Paqja e shpërfillur*, Rozafa, Prishtinë, 2010, f. 22-23.

Dizdareviq* e kujton bisedën me Millosheviqin, rreth mundësisë së eskalimit të demonstratës. *"Unë këmbëngula, ju e organizuat demonstratën, ju do e kontrolloni atë! Ai tha, nëse nuk na jep kompetencat që duam nuk do të jemi përgjegjës për veprimet e turmës që nuk mund ta kontrollojmë atë".*⁴⁰⁹Dizdareviq në tubim mbajti një fjalim, që në esencë ishte për ruajtjen e kohezionit të nacionaliteteve që jetonin në Jugosllavi: *"Etërit tanë vdiqën për të krijuar Jugosllavinë. Ne nuk do të zbresim në rrugën e konfliktit kombëtar, ne do të marrim rrugën e vëllazërimit dhe unitetit".*⁴¹⁰

Mirëpo, këto fjalime nuk po i akceptonte turma e etur për nacionalizëm. Ata po e kërkonin liderin e tyre. Njerëzit po e thërrisnin emrin e tij. Ai doli para masës për ta mbajtur një fjalim patetik e nacional - shovinist. Turmës iu drejtua me këto fjalë: *"Askush të mos jetë i befasuar që Serbia këtë vit u ngrit në këmbë për shkak të Kosovës. Kosova është qendra e historisë së saj, kulturës së saj, kujtesës së saj. Çdo komb e ka një dashuri që ngroh zemrën për jetë. Për Serbinë kjo është Kosova. Prandaj, Kosova do të mbetet në Serbi".*⁴¹¹ Në vazhdim, ai tha: *"Asnjë forcë në tokë nuk mund ta ndalojë popullin serb. Njerëz të Serbisë - do të luftojmë për kauzën tonë dhe do të fitojmë".*⁴¹²

Në të njëjtin miting, Millosheviqi foli me tone kërcënuese, duke paralajmëruar përdorimin e forcës: *"Kjo nuk është koha për pikëllim. Është koha për luftë. Kjo vetëdije e kapi Serbinë verën e kaluar dhe kjo vetëdije është kthyer në një material forcë, që do të ndalë terrorin në Kosovë dhe do të bashkohet Serbia... Njerëzit, madje, do të japin pëlqimin për të jetuar në varfëri, por ata nuk do të pranojnë të jetojnë pa liri. Ne do të fitojmë, edhe përkundër faktit se armiqtë e Serbisë jashtë vendit po komplotojnë kundër saj... Ne u themi atyre se ne hyjmë në secilën betejë me qëllim të fitimit të saj".*⁴¹³

Pra, me këtë fjalor të qartë e konciz, Millosheviqi po i paralajmëronte dhe po i kërcënonte "kundërshtarët" e saj, se për realizimin e qëllimeve ishin të gatshëm edhe për luftë. Përdorimi i

*Raif Dizdareviç (i lindur më 9 dhjetor 1926) është një politikan boshnjak i cili shërbeu si presidenti i parë boshnjak i Jugosllavisë. Dizdareviç ishte pjesë e LNÇ -së gjatë Luftës së Dytë Botërore. Pas luftës, si anëtar i Partisë Komuniste dhe aleat i Josip Broz Tito, ai u ngrit në funksione të larta politike. 1988-89, ishte kryetar i Presidencës Kolektive të Jugosllavisë.. Gjatë kohës së tij si kreu i shtetit, Jugosllavia kishte një borxh të jashtëm prej mbi 21 miliard dollarë amerikanë dhe një normë vjetore inflacioni prej 217 përqind.

⁴⁰⁹The Death Of Yugoslavia 1/6 Enter Nationalism - BBC Documentary, <https://www.youtube.com/watch?v=vDADy9b2IBM>, qasja 20.04.2018.

⁴¹⁰Po aty.

⁴¹¹ Miting Bratsva i jedinstva, https://sr.wikipedia.org/sr-el/Митинг_Братства_и_јединства, qasje 17 maj 2018.

⁴¹²The Death Of Yugoslavia 1/6 Enter Nationalism - BBC Documentary, <https://www.youtube.com/watch?v=vDADy9b2IBM>, qasja 20.04.2018.

⁴¹³ V. Pesic, "Serbian Nationalism and the Origins of ...", f. 18.

dhunës së paralajmëruar dhe i luftës, "justifikohej" nga ngritja e mitit se Kosova është: "Djep i Serbisë". Ky mit që buron nga thellësia e shekujve, është bërë ushqim për nacionalizmin serb në vazhdimësi. Këtu është edhe origjina e luftërave të përgjakshme dhe shkatërrimit të Jugosllavisë së AVNOJ-it.

Në të njëjtën kohë, duke i bërë një analizë të thellë protestave shqiptare në Kosovë, Komiteti Krahinor i LKK doli me shumë konstatime e konkluzione. Ndër të tjerash u konstatua se si shkas i drejtpërdrejtë i tubimeve masive dhe protestave të nacionalitetit shqiptar ishte lirimi i Kaqusha Jasharit nga funksioni i kryetares së Kryesisë së KK LKK dhe i Azem Vllasit nga funksioni i anëtarit të kryesisë së KK LKK. Kërkesa e tyre ka qenë që ata të rikthehen në funksion.⁴¹⁴

Për më tepër, u konkludua se një nga shkaqet shumë të rëndësishme të krijimit të klimës së tendosjes është politizimi negativ i masave, lidhur me çështjet e ndryshimeve kushtetuese. Shqetësimi i shqiptarëve për ndryshimet kushtetuese nuk është pasojë e mospajtit me projektamendamentet për Kushtetutën e RS të Serbisë, por i bindjes së krijuar se është fjala për rrezikimin e të drejtave, lirive, gjuhës e të shkrimit, të barazisë shqiptarëve dhe të autonomisë së krahinave, si element konstituiv i Federatës jugosllave.

Paralelisht me këto zhvillime, në rendin e ditës në skenën e trazuar politike kosovare ishte edhe debati publik rreth projektamendamenteve të propozuara. Në mjedise të ndryshme u analizuan përparësitë dhe dëmet që mund t'i kishte Kosova me këto ndryshime. Sigurisht, që fjalën kryesore në këto debate e kishin intelektualët, sidomos, ata të fushës përkatëse. Profesori i së drejtës juridike, Syrja Pupovci, deklaronte se çdo gjë qëndronte brenda parimeve të vitit 1974. Për më tepër, ai theksonte se debati publik (deri më 30 prill) do të zhvillohet me dialog demokratik, i argumentuar, i hapur e konstruktiv, por se njëkohësisht duhet t'u mbyllet kanalet të gjithë atyre që mendojnë të imponojnë mendimet dhe tezat e tyre armiqësore, nacionaliste ekstreme.⁴¹⁵

Është paradoksale kjo, që një jurist i njohur si, Pupovci del me konstatime të tilla, ndërkaq qytetarët e thjeshtë e kishin kuptuar se me këto ndryshime insistohej për një "rregullim" të raporteve ndërmjet KSA të Kosovës dhe RS të Serbisë, e që do çonte te një

⁴¹⁴AK, Fondi: Komiteti Krahinor i LK të Kosovës. Dosja 447. Informatë nga mbledhja e Komitetit Krahinor që u mbajt me 4 dhjetor 1988, për organizimin e tubimeve masovike nga data 17-21 nëntor 1988, f. 9.

⁴¹⁵Z. Cana, *Apeli 215 i intelektualëve shqiptar...*, f. 14.

ricentralizim të Serbisë. Prandaj, populli shqiptar, kundërshtimet i shprehu në forma të ndryshme. Por, edhe nga perspektiva e mëvonshme, qëndrimet e tij u demantuan plotësisht.

Debate, diskutime e kërkesa të ndryshme rreth këtyre ndryshimeve u bënë edhe në Serbi. Në këtë mënyrë edhe elita e inteligjencës serbe* u përfshi në vorbullën e nacionalizmit dhe të shovinizmit, duke ia paraqitur Kuvendit të Jugosllavisë dhe mbarë opinionit jugosllav: "Propozimin për vendosjen e barazisë së vërtetë të popujve të Jugosllavisë". Në këtë dokument thuhej dhe kërkohej: 1) Zvogëlohen dhe kufizohen të drejtat e disa popujve, para se gjithash atij serb; 2) Kufijtë e caktuar në mes të njësive federale, në pjesën më të madhe nuk u përgjigjen kufijve etnikë, kështu që jashtë Serbisë mbetën 24 për qind të popullit serb; 3) Të ndryshohet përfaqësimi në federatë dhe ai të bëhet sipas numrit të popullsisë, përkatësisht nacionalitetit; 4) dhe në njësitë e tjera federale të krijohen krahinat dhe provincat autonome.⁴¹⁶

Thelbi i këtij dokumenti paraqet, në fakt, edhe alibinë përmes së cilës Millosheviqi erdhi në pushtet. Por, njëkohësisht tregon edhe se sa endemik ishte nacionalizmi në Serbi, që kishte depërtuar në të gjitha institucionet e vendit, si ato: akademike, kulturore, shpirtërore e politike.

Krahas debateve në skenën politike të Kosovës, po diskutohej edhe çështja e përgjegjësisë për marshimin e minatorëve, në nëntor të vitit 1988. Strukturat politike kosovare të udhëhequra nga Rrahman Morina në mbledhjen e KQ të LKJ, që u mbajt në fund të janarit i gjykoi protestat e minatorëve, të mbajtura në nëntor 1988, si thelluese të ndarjes dhe të mosbesimit ndërnacional, rrezikimit të popullsisë së nacionalitetit serb e malazet dhe se rëndësishme mbetet: *"Lufta kundër nacionalizmit e separatizmit shqiptar, eliminimi i veprimit kundërrevolucionar dhe flakja e të gjitha shkaqeve që nxisin shpërnguljen e serbëve dhe të malazetve, si dhe krijimi i kushteve për kthim në Kosovë"*.⁴¹⁷

Tema e njëjtë u diskutua edhe në Plenumin e Komitetit Krahinor të LK të Kosovës, që u mbajt më 11 shkurt 1989. Konstatimet e pjesëmarrësve, aty rreth motiveve dhe qëllimeve të atij reagimi qytetar ishin brenda optikës së pushtetit të asaj kohe, që, natyrisht, binin ndesh me bindjen e punëtorëve dhe të qytetarëve të Kosovës. Kjo qasje e udhëheqjes politike të Kosovës,

* Aty bënë pjesë shkrimtarë, kritikë, filozofë, sociologë, historianë, aktorë de regjisorë teatri, publicistë etj. ja emrat e tyre: Andrija Gams, Zagorka Gollubović, Vojislav Koshtunica, Matija Bećković, Miqa Popović, Dobrica Qosiq, Neca Jovanov, Ivan Janković, Mladen Serbinović, Gojko Nikolić, Predrag Pallavestra, Nikolla Milloshević, Radovan Samarxhiq, Kosta Çavoshki, Dragosllav Strejović, Tanasije Mlladenović, Borisllav Mihailloviq - Mihiz, Lubomir Tadiq (i lindur në Kosovë), Dragosllav Mihailloviq dhe Mihaillo Marković.

⁴¹⁶ Z. Cana, *Apeli 215 i intelektualëve shqiptar...*, f. 15.

⁴¹⁷ *Rilindja*, Prishtinë, 31 janar 1989, f. 6.

për të mos i shikuar problemet reale në Kosovë, si dhe duke u bërë kualifikime të ndryshme punëtorëve të ndershëm, do ta përkeqësonte akoma më shumë situatën në Kosovë.⁴¹⁸

Diskutimi i mësipërm u zhvillua në rrethana të një gjendjeje të rëndë politike në Kosovë, që u pasua nga një akt i Kuvendit të Serbisë i 3 shkurtit 1989, që miratonte amendamentet, që i jepnin Serbisë kontroll më të drejtpërdrejtë mbi sektorin e sigurisë, financave, drejtësisë dhe të planifikimit shoqëror të krahinave autonome.⁴¹⁹ Në fakt, ky akt vetëm sa i përshpejtoi hapat për shfuqizimin e autonomisë së Kosovës.

Në mbrojtje të autonomisë së Kosovës, minatorët u rreshtuan përsëri të parët, duke u mbyllur më 20 shkurt 1989, në zgafelle për ditë të tëra, në shenjë revolte ndaj regjimit të asaj kohe.⁴²⁰ Udhëheqjes politike kosovare iu deshën rreth 36 orë për të zbritur në horizontet e Trepçës. Në këtë mënyrë, një delegacion i përbërë nga: Aziz Abrashi, kryetar i Këshillit punëdrejtues të Trepçës, Burhan Kavaja, drejtor i minierës së Stari Tërgut, Remzi Kolgeci, kryetar i Kryesisë së Kosovës, Rrahman Morina, kryetar i KK LKK, Bajram Selani dhe Minir Dushi, anëtarë të Kryesisë së Kosovës, zbriti në minierë për t'u takuar me minatorët. Fillimisht, minatorët ngritën çështjen për gjendjen e rëndë që mbretëronte në Kosovë, për etiketimet e ndryshme, që u ishin bërë atyre, pas marshimit në nëntorin e kaluar, si dhe për paradoksin e vlerësimit të ngjarjeve apo të diskriminimit mbi baza të aspektit etnik. Kjo më së miri pasqyrohet nga deklarata e minatorit, Xhafer Salihu, i cili i deklaroi delegacionit: *“Tubimet tona janë quajtur nacionaliste e antijugosllave, kurse ato të serbëve e malazezëve, ku u kërkua edhe armë, u quajtën tubime solidariteti dhe të vëllazërim-bashkimit”*. Kam bindjen, vazhdoi ai: *“Se dy shoqata nga Fushë Kosova po u bëjnë rezistencë qëndrimeve më të larta partiake. Do të duhej që LKJ të marrë masa e të mos lejojë, që gjithkush të përdhosë prestigjin e saj”*.⁴²¹

Në fund, xehetarët kërkesat e tyre ia parashtuan në mënyrë të drejtpërdrejtë Remzi Kolgecit, kryetar i Kryesisë së Kosovës. Ndër kërkesat kryesore ishin: (1) Të mos preken parimet themelore të Kushtetutës së vitit 1974; (2) Largimi i Rrahman Morinës (kryetar i Kryesisë së KK LKK), Ali Shukriut (anëtar i Kryesisë së KQ LKJ) e Hysamedin Azemit (anëtar i Kryesisë së KK LKK) nga funksionet e tyre; (3) Të ndërpritet politika e gabueshme ndaj popullit shqiptar; (4) Të zbardhet lista e minatorëve përgjegjës për ngjarjet e nëntorit të kaluar, etj. Duke iu

⁴¹⁸Rilindja, Prishtinë, 12 shkurt 1989, f. 2.

⁴¹⁹M. Vickers, *Midis serbëve dhe shqiptarëve...*, f. 286.

⁴²⁰30 vjet nga greva historike e minatoreve të Trepçës, [://www.gazetaexpress.com/lajme-30-vjet-nga-greva-historike-e-minatoreve-te-trepces-628456/](http://www.gazetaexpress.com/lajme-30-vjet-nga-greva-historike-e-minatoreve-te-trepces-628456/), qasja 20 qershor 2019.

⁴²¹Rilindja, Prishtinë, 22 shkurt 1989, f. 3- 6.

përgjigjur minatorëve, në mënyrë të vendosur Remzi Kolgeci deklaroi: *“Nuk do të ndryshohen parimet themelore të Kushtetutës së vitit 1974, sado që, në Kushtetutën e RS të Serbisë propozohet të bëhen disa ndryshime, të cilat janë në procedurë e sipër. Mirëpo, tha ai kurrsesi nuk do të lejojmë që me ndryshimet, të cilat do të pasojnë, të cenohet barazia e kombeve dhe e kombësive në Kosovë, përdorimi i gjuhës dhe i shkrimit, simboleve kombëtare dhe veçoritë e tjera të autonomisë. Çdo ndryshim kushtetues do të bëhet vetëm në bazë të forcës së argumenteve”*.⁴²²

Pavarësisht, të këtij premtimi dhe lutjeve nga anëtarë të tjerë të delegacionit, madje, duke ua përkujtuar minatorëve edhe familjet e tyre, ata refuzuan të dalin nga minierat. Ata ishin të vendosur në kërkesat e tyre, kurse vetëm gazetarët e “Rilindjes” dhe të TV “Lubjanës” u lejuan të zbresin në horizont për t’i parë nga afër kushtet e grevës. Ja si i përshkruan një gazetar kushtet e grevistëve në horizontin e njëmbëdhjetë: *“Horizonti i njëmbëdhjetë i minierës së Stari-Tërgut hynë thellë nën tokë mbi 800 metra. Atje kushtet e jetesës janë nga më të rëndat dhe më të rrezikshmet për shëndetin e njeriut, sidomos, për një numër kaq të madh njerëzish. Megjithatë, ata nuk duan të dalin jashtë po nuk u përmbushën kërkesat. Problem i veçantë është furnizimi me artikuj ushqimorë dhe ujë të pijes, por edhe ajri. Ka disa ditë që, xehetarët, në shenjë proteste refuzojnë të marrin ushqimin në restorantin e tyre shoqëror e ushqim nuk kishin marrë as nga shtëpia. Dje, për ta u sigurua një furnizim më i rregullt. Dy mjekë, që ishin në galeri për t’u dhënë ndihmë mjekësore disa të sëmurëve, na thanë se xehetarët kanë jetën në rrezik. Po ashtu, na njoftuan se disa sosh, që kishin nevojë për ndihmë mjekësore, dolën jashtë, morën injeksionet ose terapinë përkatëse dhe sërish i kthyen të shokët e tyre”*.⁴²³

Qarqe të ndryshme nacionaliste serbe, përmes medieve të tyre tentonin që kësaj greve t’i jepnin një karakter tjetër - atë të mbajtjes së detyruar të minatorëve serbë e malazezë, gjë që u përjashtua nga drejtori i punës kërkimore në minierën e Stari Tërgut, Milivoje Nedeljković, i cili ishte kategorik për media: *“Asnjë serbë e malazez nuk është ndaluar kund me dhunë. Ata kanë kryer punën e tyre dhe kanë dalë. Aty më nuk ka serbë e malazezë”*.⁴²⁴

Në këtë mënyrë, minatorët shqiptarë edhe njëherë dëshmuar se përpjekjet e tyre për ruajtjen e autonomisë së Kosovës nuk rrezikonte fizikisht pjesëtarët e komuniteteve të tjera.

⁴²²Rilindja, Prishtinë, 22 shkurt 1989, f. 5.

⁴²³Rilindja, Prishtinë, 22 shkurt 1989, f. 5.

⁴²⁴Rilindja, Prishtinë, 23 shkurt 1989, f. 5.

Sidoqoftë, gjendja e minatorëve grevistë, numri i të cilëve shkonte deri në 1200, po vështirësohej gjithnjë e më tepër.

Greva e minatorëve zgjoi edhe interesimin e opinionit dhe të medieive ndërkombëtare. Gazeta "Rilindja" e 24 shkurtit 1989, paraqet disa përmbledhje të raportimeve nga agjencitë më të njohura botërore. Sipas kësaj gazete, agjencia angleze e lajmeve "Rojters" përmend zotimin e punëtorëve se do të bëjnë grevë përderisa nuk do të marrin me shkrim garanci se me ndryshimet e Kushtetutës së Serbisë nuk do të zvogëlohet autonomia e Kosovës. Kurse, ajo franceze "*Frans-Pres*" theksonte se pritet që shefi i partisë jugosllave, Stipe Shuvar, të arrijë në Kosovë, e cila që nga e hëna është paralizuar nga greva politike, e pashembullt, e pjesëtarëve të kombësisë shqiptare. Po ashtu, edhe agjencia sovjetike e lajmeve "TASS" thekson se minatorët po bëjnë grevë kundër ndryshimit të Kushtetutës së Serbisë, ngaqë theksojnë se ato, në një masë të konsiderueshme kufizojnë autonominë e Krahinës. Edhe Radio Tirana me raportimet e mbështetura, kryesisht, të "Tanjugut", i mbulonte gjerësisht këto ngjarje. Radio Uashingtoni njoftonte për "solidarizimin e një grupi minatorësh finlandezë" me xehetarët e "Trepçës".⁴²⁵

Raportim të hollësishëm bënte edhe agjencia e lajmeve amerikane "*Asoshieted Pres*". Korrespondenti i kësaj agjencie raportonte nga Mitrovica e Titos se 10 mijë punëtorë anëmbanë Krahinës u hodhën në grevë. Mbi 1000 punëtorë të minierës së "Trepçës" edhe më tutje qëndrojnë në Galeri të minierës, vazhdon raportin kjo agjenci. Shtatëmbëdhjetë minatorëve iu dha ndihma për shkak të molisjes. Në raportet më të reja të kësaj agjencie theksohet: "Minatorët që filluan këtë aksion protestues të hënën, dënojnë disponimin gjithnjë më të fuqishëm antishqiptar që, sipas pohimeve të tyre, po i ushqejnë mjetet e informimit në Serbi. Ata protestojnë, po ashtu, për shkak të politikës, e cila i ka karakterizuar si: "*demonstrues, nacionalist dhe separatist*", kur në nëntorin e kaluar dolën në rrugë."⁴²⁶

Një gazetar i TV "Lubjanës", Istok Tori, shkruante për bisedën që kishte pasur me një minator i cili deklaronte: "*...është e pakuptueshme nga çdo aspekt njerëzor, moral e politik sjellja indiferente e udhëheqjeve të niveleve të ndryshme të vendit ndaj protestës specifike të minatorëve dhe kryeneçësia e disa kuadrove nga Kosova, që të mos japin dorëheqje edhe pse kjo*

⁴²⁵*Rilindja*, Prishtinë, 24 shkurt 1989.

⁴²⁶*Rilindja*, Prishtinë, 24 shkurt 1989, f. 8.

*unanimisht po u kërkohet nga klasa punëtore, të cilët më të dashur e paskan kolltukun e tyre se sa fatin dhe jetën e minatorëve...."*⁴²⁷

Solidarizimi me minatorët e "Trepçës" ishte i jashtëzakonshëm. Ky akt i lartë i vetëflijimit shkaktoi solidarizim të fuqishëm të punëtorëve dhe të studentëve të Kosovës, por edhe më gjerë. Mijëra minatorë nga minierat e tjera u ngujuan në galeritë e tyre, në shenjë solidarizimi me minatorët e "Trepçës". "Trepça", respektivisht Mitrovica ishte shndërruar në këto momente dramatike simbol i rezistencës dhe i vetëmohimit atdhetar.⁴²⁸ Me qindra telegrame përkrahjeje arritën nga shkollat e ndryshme fillore e të mesme nga mbarë KSA e Kosovës, pastaj nga ndërmarrjet e ndryshme. Solidaritet me minatorë të "Trepçës" shprehu edhe Qendra e studentëve në Prishtinë. Mijëra studentë u takuan në kohën e darkës para mensës, duke refuzuar të marrin ushqimin e paraparë.⁴²⁹

Përkrahja për minatorët erdhi edhe nga Sllovenia. Më 27 shkurt 1989 në Lubjanë u mbajt mitingu për "*të vërtetën dhe solidaritetin*", në mbështetje të minatorëve të "Trepçës", kurse u nënshkrua edhe në peticion prej më shumë se 450.000 vetëve. Greva e minatorëve e kishte edhe mbështetjen e udhëheqjes politike sllovene. Kryetari i LK të Sllovenisë, Milan Kučan, lidhur me grevën e minatorëve deklaronte se: "*Grevistët nuk po mbrojnë vetëm të drejtat e shqiptarëve në Kosovë, por po e mbrojnë Jugosllavinë dhe çdo republikë, duke përfshirë edhe Slloveninë.*"⁴³⁰

Ky deklaram shkaktoi reagime të ashpra të qarqet nacionaliste serbe. Dushan Miteviq (zëvendës drejtor i Televizionit të Beogradit-shënim i autorit), këto akte i quajti tradhti të Sllovenisë. Ai deklaronte se: "*Kam vendosur t'i tregoj shikuesve tanë serbë se çfarë po ndodh në Republikën e Sllovenisë*". Edhe mediat e tjera, që ishin në dorën e Millosheviqit e akuzonin Slloveninë dhe Kučanin, duke e quajtur provokator të qëllimshëm. Duke mbrojtur separatizmin në Kosovë, ai po e mbron edhe separatizmin në Slloveni.⁴³¹ Sllovenia ishte njëra nga republikat në kuadër të federatës, që filloi ta sfidojë sheshazi politikën hegjemoniste dhe ekspansioniste të Serbisë.

Derisa sa minatorët vazhdonin të qëndronin në galeritë e nëntokës, të apostrofuarit nga të cilët kërkoheshin dorëheqja, vazhdonin me kryeneçësi dhe mospërfillje të mos reflektonin përballë

⁴²⁷ Po aty.

⁴²⁸ Ibrahim Gashi, *Kosova-Rruga tek pavarësia. Roli i Lëvizjes së Minatorëve të Trepçës në procesin e shtetformimit 1988-1989* (vrojtime të studiusve të huaj), Prishtinë, 2012, f. 62.

⁴²⁹ *Rilindja*, Prishtinë, 24 shkurt 1989, f. 10.

⁴³⁰ The Death Of Yugoslavia 1/6 Enter Nationalism - BBC Documentary, <https://www.youtube.com/watch?v=vDADy9b2IBM>, qasja 20.04.2018.

⁴³¹ Po aty

gjendjes së krijuar në Kosovë. Në mbledhjen e Aktivit Politik të LK të Kosovës, ku u debatua për gjendjen e rëndë në Krahinën e Kosovës, Rrahman Morina i quante kërkesa të natyrës politike, të cilat tashmë janë dëgjuar edhe në nëntor të vitit të kaluar, pra edhe në tubime të punëtorëve të kombësisë shqiptare. Po ashtu, foli edhe për ndryshimet kushtetuese, dhe i vendosur tha se këto ndryshime kushtetuese nuk cenojnë barazinë kombëtare. Ai më tutje theksoi: "*Sa i përket kushtetutës (me të cilën ka të bëjë njëra nga kërkesat) me plot durim u gjetën zgjidhjet me të cilat sigurohet që RS e Serbisë në tërë territorin e vet të ushtrojë funksionet e domosdoshme shtetërore, e po ashtu, sigurohet që në mënyrë konsekuente të realizohet esenca e autonomive, të cilat janë në përbërje të RS të Serbisë dhe të cilat janë faktor konstituiv i Federatës*".⁴³²

Morina, në bazë të deklarimeve të tij, tregonte konsekuencë në realizimin e objektivave, të cilat i ishin ngarkuar nga udhëheqja e Serbisë. Siç po vërehej për të preokupimi kryesor ishte jeta e pakicës serbe e malaziase, por pa u shqetësuar asnjëherë për shumicën që ishte shqiptare. Ilustrim i kësaj është kryeneçësia e tij për mosdhënie të dorëheqjes, edhe pse kishte disa ditë, që minatorët ia kërkonin edhe përmes grevës.

Më 24 shkurt 1989, në Prishtinë zbarkuan kryetari i Kryesisë së KQ të LKJ, Stipe Shuvar dhe Millosheviqi. Para aktivit të partisë në Prishtinë, Shuvari, fillimisht, foli për ndryshimet kushtetuese, që sipas tij ishin pozitive. Ai para anëtarëve të partisë parashtrroi pyetjet si: "*Përse shqiptarët vajtojnë autonominë? Përse kaq shumë ide të rreme në gjirin e tyre? Përse shqiptarët thërrasin se nuk heqin dorë nga Kushtetuta e vitit 1974?*"⁴³³ Në kohën kur Kroacia, vendi nga vinte Shuvari, e sidomos, Sllovenia kishin dhënë përkrahje ndaj kauzës së minatorëve, ky ishte rreshtuar në anën e destruktivitetit, që bënte Serbia dhe udhëheqësit e saj. Në frymën e bindjes se gjoja shqiptarët nuk humbin asgjë me ndryshimet kushtetuese ishte edhe diskutimi i Millosheviqit. Ai ndër të tjera thekson: "*Unë duhet t'u tregoj gjithë shqiptarëve në Kosovë që frika e tyre në këtë drejtim është plotësisht e pabazuar. Shqiptarët me të vërtetë nuk do humbasin as të drejtën e gjuhës së tyre, as shkollat e tyre, as zhvillimin e tyre kulturor. Unë ju them juve, shokë, kjo është kështu dhe ju do bindeni që kam të drejtë*"⁴³⁴

Pas këtij takimi, Shuvari pa Millosheviqin, zbriti në horizontet e nëntokës, për t'i takuar minatorët. Ai u mundua t'i qetësojë xehetarët se ndryshimet kushtetuese nuk cenojnë autonominë

⁴³²Rilindja, Prishtinë, 25 shkurt 1989, fq.2

⁴³³ Viktor Meier, Fundi i Jugosllavisë - Goditja në Kosovë, Lubjanë 2006, f.134

⁴³⁴ Kosta Nikolic, " Ne damo Kosovo". Ustavne promene u Srbiji 1989 (II), Istorija 20. Veka, 3/2012, fq. 181.

e Kosovës, kurse çështja e dorëheqjeve ishte përgjegjësi e personave nga të cilët kërkohej ajo. Ai, po ashtu, tentoi t'i bindë minatorët se KQ i LKJ nuk kishte asnjë lloj liste të minatorëve, një pohim që u konfirmua edhe nga Remzi Kolgeci që e shoqëronte atë.⁴³⁵

Shuvari dhe delegacioni që ishin më të e mbyllën takimin pa arritur ndonjë marrëveshje rreth kërkesave të tyre. Minatorët e vazhduan grevën edhe më tutje, pasi që ishin betuar se deri në realizimin e kërkesave të tyre nuk do të dalin nga galeritë e nëntokës.

Sidoqoftë, duke parë se minatorët ishin të vendosur në kërkesat e tyre, tre të apostrofuarit parashtruan dorëheqjet e tyre.⁴³⁶ Ky akt bëri që minatorët të ndërpresin grevën dhe të dalin nga horizontet e nëntokës. Në këtë vendim nuk duhet anashkaluar as premtimin e Shuvarit se kërkesat e tyre do të shqyrtohen seriozisht. Por, dorëheqjet e tyre ishin vetëm një lojë sa për t'i nxjerrë minatorët nga zgafellja, sepse dorëheqjet nuk u pranuan nga udhëheqja jugosllave dhe me udhëzimet e tyre dorëheqjet e cekur u pezulluan, çka do të thotë se ata do të vazhdonin të qëndronin në funksionet e tyre, derisa të përmyllet në Kuvendin e Kosovës, ratifikimi i ndryshimeve kushtetuese.

Të njëjtën ditë që ndodhi dorëheqja, kryesia e Shoqatës së Shkrimtarëve Kroatë, bëri një reagim, duke e këshilluar Slobodan Millosheviqin, që të ofronte dorëheqjen e tij. Në reagimin e tyre thuhej: "*Ne nuk e kërkojmë dorëheqjen e Millosheviqit, sepse nuk e bëmë ne dhe nuk do ta zgjidhnim kurrë, por ne e këshillojmë ta ofrojë menjëherë atë. Jo vetëm që nuk solli paqe dhe shpresë në Kosovë, por e solli situatën në prag të luftës civile*"⁴³⁷.

4.4 Suprimimi e autonomisë së Kosovës, si uverturë për pushtimin e Kosovës dhe rezistenca e shqiptarëve (demonstratat e marsit dhe të prillit të vitit 1989)

Me përfundimin e grevës, Millosheviqi dhe udhëheqja kosovare e nënshtruar ndaj tij ishin përcaktuar të ecnin në dy drejtime: (1) Të arrestonin ata që konsideroheshin si "kundërrevolucionar" dhe prishës të rendit shoqëror, pra t'i hiqnin pengesat e mundshme që mund t'u dilnin gjatë rrugës, dhe (2) Që Kuvendi i Kosovës t'i miratonte ndryshimet kushtetuese,

⁴³⁵ *Rilindja*, Prishtinë, 26 shkurt 1989, fq.2

⁴³⁶ Arkivi: Greva e Minatorëve 1989, <https://www.youtube.com/watch?v=lhi0DgWZtYA>, min: 21:40 – 23:30, publikuar 22 nëntor 2016.

⁴³⁷ Kosta Nikolic, " Ne damo Kosovo". Ustavne promene u Srbiji 1989 (II), Istorija 20. Veka, 3/2012, fq. 183.

që tashmë, ishin bërë në Kushtetutën e RS të Serbisë, sipas së cilës kompetencat e pushteteve në Kosovë reduktoheshin tejmasë.

Sa i përket të parës, u pa që paralajmërimi i Millosheviqit, i cili e bëri në miting ishte real. Më 1 mars u burgosën: Azem Vllasi, Aziz Abrashi, Burhan Kavaja dhe kuadro të tjerë të "Trepçës". Po atë ditë nisi vargu i burgosjeve dhe i "izolimeve" të shqiptarëve.

Vala e arrestimeve dhe presioni për ndryshime kushtetuese u pasua nga një mbledhje e jashtëzakonshme e parlamentit Federativ, të mbajtur më 2 mars 1989. Kjo mbledhje e jashtëzakonshme pati edhe pjesën e aj të mbyllur për publikun. Para delegatëve, Lazar Mojsovi (anëtar i Kryesisë së Jugosllavisë) paraqiti ekspozenë për gjendjen në Kosovë. Ai foli për një dokument sekret që tani ishte në posedim të Kryesisë së Jugosllavisë, i hartuar nga Azem Vllasi dhe udhëheqës të tjerë komunist, në fillim të shkurtit 1989. Sipas tij, ishte dokument i vërtetë i shtabit për aksion dhe i njëjti parashihej të realizohej në tri faza. **Faza fillestare**, rrok organizimin e grevës së përgjithshme pasive, duke qëndruar në oborret e fabrikave, ndërmarrjeve, shkollave dha fakulteteve, pastaj bojkotin e tregut etj. Kjo fazë u realizua në tërësi dhe pati si epilog qëndrimin e minatorëve në zgafelle. **Faza e dytë**, do të filluaka, që më 15 mars, kur pritet që Kuvendi i Kosovës të debatojë për Kushtetutën e Serbisë, duke zhvilluar aksione të reja, të cilat do t'u lidhkan simbolikisht me shpërthimin e kundërrevolucionit të vitit 1981. Së fundi, do të vjen deri te momenti i kryengritjes së armatosur me kushtrimin e përgjithshëm: "*Ne shqiptarët mund të flasim vetëm përmes grykës së pushkës. S'ka më pajtim. Po ofrohet çasti i madh*".⁴³⁸

Paraqitja e kësaj ekspozeje nga Mojsovi ishte përlligjje e të ashtuquajturave "masave të posaçme" që po aplikoheshin në KSA të Kosovës, sepse deklarimi i gjendjes së jashtëzakonshme kishte penguar ekzekutimin e këtij plani. Maqedonasi, Mojsov, gjithashtu, tha se shërbimi sekret shqiptar në Tiranë ishte implikuar në këtë plan.⁴³⁹

Ndaj "Planit Mojsov" u vunë pikëpyetje të shumta për autenticitetin e tij. U konsiderua si një dokument i fabrikuar nga vetë Mojsovi. Stane Dolanci i tha presidencës së republikës sllovene, më 20 mars se atë që e ka thënë Mojsovi në Beograd nuk e kishte thënë pikëpamjen e

⁴³⁸ Z. Cana, *Apeli 215 i intelektualëve shqiptar...*, f. 166-167.

⁴³⁹ V. Meier, *Yugoslavia a history of its demise*, vepër e cituar, f. 87.

presidencës jugosllave, por, thjesht, ishte iniciativë personale e Mojsovit, me sa duket i inkurajuar nga Kadiveviqi.⁴⁴⁰

Për skenar të njëjtë fliste edhe sekretari krahinor i Punëve të Brendshme, Jusuf Karakushi* gjatë intervistës së tij për gazetën ditore "Rilindja". Gjatë intervistës, ky foli për faktorët nxitës të protestave të nëntorit dhe të grevave të shkurtit, për nxitësit dhe organizatorët, mundësitë e ndikimit të faktorëve të jashtëm, si dhe për masat që po ndërmerren dhe ato që do të ndërmerren më tutje. *"...sipas shënimeve të Shërbimit të Punëve të Brendshme në ngjarjet e nëntorit dhe të shkurtit rol kryesor kanë disa persona në strukturat politiko-shoqërore nga Krahina, komunat dhe nga disa organizata punuese, si dhe persona që kanë qenë ose gjenden në vende kryesore në organizatat punuese të ekonomisë dhe në organizata e tjera...shënimet që kemi në dispozicion flasin se të gjitha këto kanë qenë mjaft mirë të organizuara, të sinkronizuara dhe të paramenduara, me qëllim që të komprometohet politika e LK-së në Kosovë dhe të mos miratohen amendamentet në Kushtetutën e RS të Serbisë, pa marrë parasysh harmonizimin e bërë të propozimit të amendamenteve"*⁴⁴¹ – është një fragment ky ai përgjegjësinë e hedh te personat me funksione drejtuese, por, moskaktimi i emrave apo funksioneve lë hapësirë për etiketimin e secilit person, që mund të jetë pengesë në zbatimin e planeve të Beogradit.

Karakushi shkoi më tej në rastin e grevave të "Trepçës", duke paraqitur edhe skenarin se ishte organizuar greva, midis minatorëve dhe udhëheqësve të tyre dhe, mbi atë se si duhej të shkonte rrjedha për realizimin e qëllimeve, që konsistonin në dorëheqjen e tre funksionarëve shqiptarë, duke akuzuar drejtpërdrejt: Azem Vllasin, Burhan Kavajën dhe Aziz Abrashin.⁴⁴²

Duhet cekur faktin se një intervistë e tillë ishte realizuar më 22 mars 1989, një ditë para mbledhjes së Kuvendit të Kosovës, ku delegatët duhej të jepnin pëlqimin apo refuzimin për ndryshimet kushtetuese. Sigurisht, një deklaram i tillë nuk ishte i rastësishëm, por i planifikuar mirë dhe ishte në funksion të arritjes së dy objektivave: (1) Që për shkak të situatës së rrezikshme, që buronte nga organizimet e "separatistëve" shqiptarë të vihej rendi dhe rregulli përmes "masave të posaçme" të rekomanduara nga Kryesia e RSFJ në mbledhjen e 8 janarit të vitit 1989, si dhe (2) të bëhej presion edhe më i fuqishëm në prag të mbledhjes së Kuvendit të Kosovës.

⁴⁴⁰ Po aty, f. 87.

* Jusuf Karakushi ishte ministër i punëve të brendshme në KSA të Kosovës, gjatë viteve të thyerjeve të mëdha.

⁴⁴¹ *Rilindja*, Prishtinë, 23 mars 1989, fq.6.

⁴⁴² *Rilindja*, Prishtinë, 23 mars 1989, fq.6.

Argumentimi për presionin e drejtpërdrejtë nga të gjitha instancat mund të dëshmohet edhe nga deklarata e kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Vukashin Jokanoviq, një ditë para mbledhjes së Kuvendit, duke i paralajmëruar delegatët se “... *gjitha organizatat dhe forumet kishin dhënë pëlqimin për ndryshimet kushtetuese, prandaj delegatët duhet ta vërtetojnë këtë në mbledhjen e nesërme*”, dhe se “...*votimi do të jetë i hapur....*”.⁴⁴³

Në këtë mënyrë, Jokanoviqi, shmangte mundësinë që delegatët të shprehin qëndrimin e tyre të vërtetë përmes votimit të fshehtë, e në të njëjtën kohë, votimi i hapur, mund t'i vërë ata para rrezikut të drejtpërdrejtë fizik, nëse do të votonin kundër ndryshimeve.

Ndërkohë, edhe Komisioni për çështje kushtetuese të Kuvendit të KSA të Kosovës kumtoi se është dhënë pëlqimi për amendamentet IX - XLIX në Kushtetutën e RS të Serbisë. Në debat u tha se me ndryshimet e propozuara kushtetuese nuk ndryshojnë parimet kushtetuese, ku sigurohet që RS e Serbisë, si shtet e bashkësi vetëqeverisëse, të realizojë funksionet e domosdoshme në mbarë territorin dhe realizimi konsekuent i esencës së autonomisë së krahinave, që janë në përbërje të saj edhe elemente konstituive të Federatës.

Të nesërmen, më 23. 3. (e enjte), në orën dhjetë i filloi punimet Kuvendi. Vukashin Jokanoviq, e deklaroi të hapur punën e përbashkët të tri dhomave dhe me të vetmen pikë të rendit të ditës, atë të shqyrtimit të amendamenteve IX dhe XLIX në Kushtetutën e RS të Serbisë dhe për dhënien e pëlqimit nga ana e Kuvendit të KSA të Kosovës. Interesimi për ta përcjellë këtë mbledhje kishte zgjuar kërshërinë e qindra gazetarëve, fotoreporterëve e xhiruesve nga mbarë vendi.

Kuvendi i Kosovës përbëhej nga tri dhoma:

1. Dhoma e Punës së Bashkuar të Kuvendit të KSA të Kosovës (gjithsej: 90 delegatë)
2. Dhoma e Komunave të KSA të Kosovës (gjithsej: 47 delegatë)
3. Dhoma Shoqërore - Politike të Kuvendit të KSA të Kosovës (gjithsej: 49 delegatë)

Në tabelën e mëposhtme po i paraqesim emrat e të gjithë pjesëmarrësve në të tri dhomat e Kuvendit të KSA të Kosovës.

⁴⁴³*Rilindja*, Prishtinë, 22 mars 1989, fq.1.

Regjistri i delegatëve të dhomës së punës së bashkuar të Kuvendit të KSA të Kosovës

1	Aleksandar GOGIÇ	19	Enver MUNIPI	37	Brahim EMINI	55	Melihate DURAKU	73	Slobodanka JANIÇIJEVIÇ
2	Ahmet HODA	20	Fidai MJEKIQI	38	Kimete SHEFKIU	56	Niman ZHEGROVA	74	Sadik ZUKA
3	Agron DAKA	21	Ejup QORRI	39	Kadri BISLIMI	57	Nazim KARJAGDIU	75	Shpresa SALIHU
4	Abdullah BUNJAKU	22	Fazli KRASNIQI	40	Kadri BREZNICA	58	Nergjivane MULLASHABANI	76	Shkëlzen GUSINJA
5	Abaz KASTRATI	23	Fazli RUGOVA	41	Lumnie HOXHA	59	Riza OSMANI	77	Shaqir REXHEPI
6	Adem SHEHU	24	Flamur GORANCI	42	Liman HAXHAJ	60	Remzi HASANI	78	Shirine CAKA
7	Bogosav Bogosavljeviç	25	Neki QELA	43	Liljana LUKIÇ	61	Raif VRMICA	79	Tahir ZEJNULLAHU
8	Bashkim ZADRINA	26	Feta PAJAZITI	44	Lumturie MALOKU	62	Ratko MILIÇ	80	Ukë BYTYÇI
9	Bajram BUÇANI	27	Fadil DËRMAKU	45	Mehdi UKA	63	Rushit SHALA	81	Ymer XHAFIÇI
10	Burim NUZA	28	Hajriz SUKA	46	Mile BLANUSA	64	Riza LLUKA	82	Ymri EMINI
11	Bajram OSMANI	29	Hava HOXHA	47	Muhamet ARIFI	65	Slavica STOLIÇ	83	VUJOVIC Ugleca
12	Dragan STEVIÇ	30	Haki TAHIRUKAJ	48	Muharrem SYLA	66	Sokol GASHI	84	BOSKOVIC Vladimir
13	JOSANOVIÇ Dragoljub	31	Hajdar SEJDIU	49	Miodrag RAKIÇEVIÇ	67	Saibe DOBROSHI	85	Vjollca TULI
14	Dusanka STEVIÇ	32	Ilmi REXHEPI	50	Miodrag JOVANOVIQ	68	Sami PLLANA	86	Zef NIKOLLAJ
15	Dragica DURLEVIÇ	33	Isen SHABANI	51	Miftar KRASNIQI	69	Sylejman DRAGAJ	87	Zana DODA
16	Emin SADIKU	34	Halit MALOKU	52	Murtez HURUGLICA	70	Sylejman BALA	88	CUCKIC Zivko
17	Emine KRASNIQI	35	Hasan BAJRAMOVIÇ	53	Menduh SHOSHI	71	Sylejman MAXHUNI	89	Valbona RRACI
18	Drita BISLIMI	36	Ismet KRASNIQI	54	Momcilo NIKOLIÇ	72	Srebra IVANOVIÇ	90	Xhafer XHAFERI

Regjistri i delegatëve të dhomës së Komunave të KSA të Kosovës

1	Avdi BERISHA	10	Dede LASKU	19	Hyrmete QIPA	28	RADOJICA Zizic	37	BISERCIC Srbosav
2	Agim BEKTESHI	11	MILACIC Dragomir	20	Hylki HAMZAJ	29	MILOSAVLJEVIC Radman	38	Shyqri HAZIRI
3	Agim GJIKOLLI	12	STEVANOVIC Dobrivoje	21	NOJIC Ljubomir	30	Nazmi GAFURRI	39	Tefik MORINA
4	Adem HYSENI	13	RADULOVIC Dusan	22	Melihate TERMKOLLI	31	Rexhep BEGAJ	40	VITSEVIC Tomo
5	Avdylkader GASHI	14	Ejup SAHITI	23	Miradije GJIKOKAJ	32	Rrahim ZEKA	41	Tahir RAMÇAJ
6	ZIGAN Branko	15	Fahredin BEHXHETI	24	Mefail OSMANI	33	Ramadan BIRDUNI	42	Dr. Ymer QAVOLLI
7	Bajram HETEMI	16	Faruk DACI	25	Mehmet SEJDIU	34	Selveti PEÇI	43	Vjollce GREZDA
8	Qemajl SAHATQIU	17	Fetah SHABANI	26	DANIC Nikola	35	Skender ZARIQI	44	Valbone KIDA
9	STEVIC Dusan	18	OSMANAGIC Hatdza	27	Ramadan BYTYÇI	36	Sefedin BAJRAKTARI	45	Milic ZAJIC
								46	ZeneI QORROLI
								47	Jakup LOSHI

Regjistri i delegatëve të dhomës shoqërore - politike të Kuvendit të KSA të Kosovës

1	Abaz KAZAZI	11	Fadil QURANOLLI	21	Ismail MIKULLOVCI	31	Nazmije JANJEVA	41	Selim KIDA
2	Ali KRASNIQI	12	Ukshin SHALA	22	Kemal DEVA	32	Nedjo BORKOVIC	42	Svetislav DOLASEVIC
3	Alltene DURAKU	13	Hazir OBRAZHDA	23	Melit GALLOPENI	33	Olivera DIMIC	43	Sherafedin SYLEJMANI
4	Agim KASTRATI	14	Halit AHMETI	24	Dr. Ragip HALILI	34	Rabit REXHEPI	44	Mr. Shefki BYTYQI
5	Ahmet MURSELI	15	Halim JUSUFI	25	Miradie ISTOGU	35	Rade ZVICER	45	Hamit HOTI
6	Ali UKMATA	16	Izet QELIQI	26	Mehmet ZEQIRI	36	OTOVIC Rosanda	46	Tahir NALLBANI
7	PERIC Aleksandar	17	Ilirianë LLOZANA	27	Miloslav MILOJEVIC	37	MILOVANOVIC Ratomir	47	Xhemshit DURIÇI
8	Behxhet ZEQIRI	18	Ivan Dzinovic	28	Nazmi HOXHA	38	Seniha BULJA	48	Xhafer ALIÇKAJ
9	Xhemë KRASNIQI	19	VIDENOVIC Ilija	29	Nazmie BAJRAMI	39	STOJANOVIC Stanko	49	Zyrafete HASANI
10	Fatmir BEJTA	20	VUKASIN Jokanovic	30	MURATI Nexhair	40	SCEPANOVIC Slavica		

- Të dhënat tabelore janë nxjerrë nga revista e përjavshme "Zëri i Rinisë", 16 qershor 1990, f. 19.

Pas një ekspozije të gjatë, që bëri Jokanoviq, ku më shumë ishte pangjirik, në atë se këto ndryshime janë më se të nevojshme dhe të domosdoshme për stabilizim. Fjalën e mori edhe Hazer Susuri, i cili foli për realizimin e detyrave nga programi jugosllav për Kosovën. Më pastaj filloi debati, ku shumica e delegatëve lexuan nga një letër - autorizim nga baza, me të cilën autorizoheshin t'i përkrahnin ndryshimet kushtetuese, sepse në thelb nuk preknin autonomitetin e KSA të Kosovës. Të pakët ishin ata delegat që i kundërshtuan këto ndryshime. Në fund u hodh në votim dhe me shumicë votash ishin pro amendamentimit të Kushtetutës, dhjetë vota ishin kundër* dhe dy abstenime. Kështu raportonte gazeta ditore e Prishtinës, "Rilindja".

Mirëpo, përtej këtyre raportimeve të kontrolluara të "Rilindjes", se me këto ndryshime nuk preken parimet fundamentale të autonomisë së Kosovës, situata në realitet ishte ndryshe. Ndryshimi i këtyre amendamenteve do ta ngushtonin së tepërmi pushtetin e Kosovës: ato do t'i mundësonin Serbisë që të kontrollonte policinë, gjyqet dhe mbrojtjen civile të Kosovës, si edhe fushat e tjera të pushtetit shoqëror, ekonomik, politik, arsimor, të drejtës për dhënien e "udhëzimeve administrative" dhe përdorimit të një gjuhe zyrtare⁴⁴⁴.

Po çka ndodhi atë ditë? Si ishin kushtet? Në çfarë rrethanash u organizua seanca e Kuvendit? A kishte jo delegat që votuan atë ditë? A u numëruan votat kundër, të gjitha? Këto do t'i shohim më poshtë.

Situata e sigurisë ishte e rëndë, në ditën e 23 marsit. Afër Kuvendit të Kosovës ishin vendosur tanke dhe autoblanda, gjithashtu, në hyrje të Kuvendit qëndronin një numër i madh agjentesh, të cilët lëviznin vazhdimisht. Një ish - delegat i Prishtinës, Fidai Mjekiqi, që kishte votuar pro ndryshimeve kushtetuese, sqaron gjithçka përmes një letre, që ia kishte dërguar revistës "Zëri i Rinisë", më 27.5.1990, ku tregon edhe për presionet e vazhdueshme, që i ishin bërë për ta detyruar të votonte pro ndryshimeve. Rreth presionit që i ishte bërë ai deklaroi: *"Me 20 mars, para derës së banesës sime u gjendën dy persona, aty rreth orës 16,00 pasdite. Njëri prej tyre mbante një fletore në duar, ndërsa tjetri një çantë dhe në gjuhën serbokroate më pyetën se a jam unë delegat i Kuvendit të Kosovës apo jo?[,,,]*

[...] Çmendoni për ndryshimet kushtetues? Unë iu përgjigja shkurt: Do ta shohim në Kuvend, Pas qeshjes ironike shtoi: "A e dini ju se të gjithë janë pajtuar me ndryshimet kushtetuese dhe se

* Dhjetë delegatët që votuan kundër ndryshimeve që cenonin autonomitetin e KSA të Kosovës ishin: Ukë Bytyçi, Sadik Zuka, Bajram Buçani, Melihate Tërmkollli, Remzi Hasani, Menduh Shoshi, Riza Lluka, Shkelzen Gusia, Mehdi Uka dhe Agim Kastrati.

⁴⁴⁴ N. Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër...*, f. 358.

*ka mbetur që vetëm edhe ju delegatët t'ia kryeni formalitetin dhe vazhdoi, vepra ashtu siç kanë vendosur të mëdhenjtë e mos e merr vetën në qafë, sepse kjo punë ka marrë fund".*⁴⁴⁵

I njëjti person tregon edhe për ditën e votimit. Ai pohon se para dyerve të Kuvendit Krahinor ishin vendosur autoblanda dhe mitralozë mbi to. *"Po ashtu një numër i madh agjentësh të sigurimit...po sa kam arritur te dyert e Kuvendit, më janë afruar tre inspektorë, të cilët me një zë të vrazhdë me pyetën se a jam delegat i Kuvendit a jo? Derisa verifikuan edhe dokumentet se vërtet jam delegat, i reklamoinin automatikët e vegjël, të cilët i mbanin nën pallto, në mënyrë që të krijonin panik sa më të madh te ne delegatët. Një kontroll të këtillë shtazarak e përjetonin edhe gazetarët, si ata tanët, ashtu edhe ata të republikave të tjera, por edhe ata të shteteve të huaja, të cilët i vendosën në një kthinë të rrethuar prej xhamash, prej nga edhe u përkufizohej mundësia që ta përcillnin procesin e mbledhjes e që ashtu edhe ndodhi, sepse më vonë edhe shikuesit nuk patën mundësi që përmes ekranit televiziv ta përcjellin atë çast "aprovimesh", i cili nuk ka zgjatur më tepër se dyzet sekonda".*⁴⁴⁶

Pra, gjithçka ishte e planifikuar mirë dhe me skenar. Ka të ngjarë që këta agjentë të sigurimit dhe shumë të tjerë u bënë pjesë e votimit për ta mbërritur shumicën e dy të tretave, që ishte e nevojshme për ndërrimet kushtetuese. Këtë e konfirmon edhe Malcolm, me sa vijon: *"Një numër i madh "i mysafirëve", si nga pjesëtarët e sigurimit shtetëror, ashtu edhe nga funksionarët e lartë të partisë nga Serbia, u përzier me delegatët brenda ndërtesës dhe, sipas disa dëshmime, ca nga zyrtarët e Serbisë, morën pjesë në votimet e Kuvendit të Kosovës. Amendamentet kushtetuese u miratuan në këto kushte dhe rrethana, megjithëse, pa dy të tretat e shumicës normale të votave, që ishin të domosdoshme për ndryshime".*⁴⁴⁷ Pierre Dufour shkruan: *"Objekti është i kontrolluar nga forcat jugosllave, nën rrethim nga ushtria. Policët e armatosur përzihen me deputetë. Deputetët janë detyruar të votojnë me dorën lart, nën mbikëqyrjen e ngushtë të autoriteteve policore, të cilat kishin deklaruar se po i mbanin peng familjet e tyre. Si pengje të një gjendjeje të rrezikshme për familjen e tyre dhe për një masakër në Kosovë, deputetët kishin sprapsjen për zgjidhje të vetme [...]"*⁴⁴⁸

Duke folur për presionet që u ushtruan mbi Kuvendin e Kosovës për dhënien e pëlqimit për amendamentet në Kushtetutën e RS të Serbisë, Esat Stavileci, gjithnjë duke iu referuar

⁴⁴⁵Zëri i Rinisë, 16 qershor 1990, fq.17

⁴⁴⁶Po aty.

⁴⁴⁷N. Malcolm, Kosova një histori e shkurtër..., f. 359.

⁴⁴⁸P. Dufour, Kosova -Paqja e shpërfillur..., f. 25.

Gazmend Zajmit thekson: "*Vetë ky presion edhe po të mos ekzistonin mangësitë esenciale dhe notore kushtetuese - juridike rreth deklarimit në Kuvend, vendimin mbi dhënien e pëlqimit në amendamentet e bënë të paqëndrueshëm në aspektin kushtetues – juridik*". Në këtë shkoqitje kushtetuese - juridike, autori në mënyrë të argumentuar përmend disa trajta të presionit: makropresioni politik dhe organet politike dhe kushtetuese të Federatës dhe të KSA - ve përmes organizimit të zinxhirit të makromitingjeve gjatë vitit 1988 në Serbi e gjetkë, me pretekst të kujdesit për serbët në Kosovë, e në të vërtetë me synime dhe kërkesa të shembjes së autonomisë politike të Kosovës dhe të Vojvodinës, në emër të "Serbisë unike", "të një Serbie - një Kushtetutë"[...] kërcënimi dhe ndërrimet e imponuara kadrovike, varësisht nga shkalla e përkrahjes së përmbajtjeve të caktuara në pikënisjet e ndërrimeve kushtetuese dhe në amendamentet e Kushtetutës së RS të Serbisë; diktati shtetëror - partiak për dhënie të pëlqimit për amendamentet; deklarimi i Kuvendit të Kosovës në kushte të futjes paraprake të gjendjes së jashtëzakonshme (me ç'rast konstatohet se në historikun e akteve dhe deklarimeve konstitucionale të shteteve dhe regjioneve nuk ka ndodhur më parë dhe as që është lejuar në rrafshin kushtetues - juridik); presion i posaçëm psikologjik mbi delegatët e Kuvendit, si përmes bisedave të veçanta autoritare personale, para seancës së Kuvendit, ashtu edhe përbrenda rrjedhës së seancës.⁴⁴⁹

Në një fotografi të Hazir REKËS*, e bërë më 23 mars, ku në ballinë të fotos është Remzi Kolgeci, Sinan Hasani dhe Rrahman Morina, vërehet qartë prapa tyre, duke votuar për miratimin e amendamenteve edhe Mehmet Ajeti* (kryetari partisë në Mitrovicën e TITOS), babai i Besim AJETIT, përfaqësues i Kosovës në kryesinë e LRS të Serbisë, vëllai i Husamedin AZEMIT dhe i Sherefedin AJETIT, drejtor i burgut në Mitrovicën e Titos. Emri i tij nuk figuron në listën e delegatëve të Kuvendit, pra ky nuk ka pasur të drejtë të votojë dhe në këtë mënyrë i ka kontribuar shkeljes së rëndë të punës së këtij Kuvendi.⁴⁵⁰

Një aspekt tjetër ishte edhe mënyra e votimit. Votimi i hapur me ngritje dore nuk ishte në pajtim me rregulloren e punës së Kuvendit. Pastaj pa u numëruar fare votat, u konstatua prej tij

⁴⁴⁹E. Stavileci, *Çështja e Kosovës në veprën e Gazmend Zajmit*, f. 68.

* Hazir Reka, fotograf njohur nga Kosova. Si gazetar profesionist filloi që nga viti 1984. Punoi për gazetën "Bota e re", pastaj për të përjavshmen "Zëri i rinisë". Në vitin 1988 punoi për agjencinë prestigjioze të lajmeve "Reuters".

*Mehmet Ajeti që kishte votuar pro ndryshimit të amendamenteve kushtetuese pa pasur drejtë vote ishte vëllau i Hysamedin Azemit. Ishte thënë po ashtu se ky i fundit kishte katër vëllezër, por secili prej tyre e kishte një mbiemër tjetër. (Për këtë shih tek Xhevat Hasani, *Një jetë në shërbim të lirisë kushtuar Naser Hanit*, f. 133).

⁴⁵⁰ Revista e përjavshme "Zëri i Rinisë", 16. 05.1990, Prishtinë.

se shumica janë "për". Gjithashtu, te votat kundër, me shpejtësi u tha se vetëm dhjetë ishin kundër, dy abstenime dhe kështu u mbyll procesi i votimit dhe i "numërimit" të votave. O.J. Schmit, duke përshkruar gjendjen që mbretëronte në ditën e 23 marsit dhe procedurat, që u ndoqën atë ditë, i krahason me ato të Adolf Hitlerit, kur e mori pushtetin në vitin 1933. *"Njëjtë sikur me rastin e miratimit të ligjit autorizues, me të cilin Adolf Hitleri mori pushtetin absolut në vitin 1933. Edhe në mbledhjen e Kuvendit të Kosovës, më 23 mars të vitit 1989, në sallë ishin të pranishëm në numër masiv dhe kërcënues policia dhe shërbimi sekret, sa që vetëm 10 delegatë shqiptarë morën guximin të votonin "kundër". Të tjerët, ndërkaq, ishin përcaktuar të abstenonin, por në votimin e manipuluar u numëruan vetëm votat përkrahëse dhe kundërshtuese. Këtu me të drejtë mund të flitet për një puç kushtetues"*.⁴⁵¹

Derisa kuadrot partiake shqiptare u nënshtruan dhe u treguan të paafte për ta mbrojtur autonominë e vitit 1974, e cila sublimonte disa të drejta politike, kulturore e arsimore, i menjëhershëm ishte reagimi i qytetarëve të Kosovës. Të pakënaqur me veprimet e fundit të RS të Serbisë, shumë mjedise në Kosovë u bënë arenë e përplasjeve të qytetarëve shqiptarë dhe punëtorëve të rendit. Shqiptarët e Kosovës nuk mund ta pranonin faktin e ndryshimit të Kushtetutës së vitit 1974, sepse atë e konsideronin si diçka qenësore, që i largonte nga tutela serbe. Prandaj, dolën në rrugë për t'i mbrojtur parimet fundamentale të saj. Të kota ishin thirrjet për qetësi që i bënte udhëheqja e nënshtruar e Kosovës. Në një kumtesë të përbashkët të kryesisë së KSA të Kosovës dhe të Pleqësisë për çështje të mbrojtjes së rendit kushtetues të krahinës, këtë revoltë të shqiptarëve e kualifikuan si: *"Atak i drejtpërdrejtë kundër rregullimit të rendit kushtetues, politikës së LKJ-së dhe zbatimit të masave të posaçme të RSFJ për stabilizimin e gjendjes në Kosovë. Demonstratat e sotme karakterizohen me një brutalitet dhe agresivitet të paparë deri më tash. Nacionalistët dhe separatistët shqiptarë me aksionet e veta të organizuara dhe të koordinuara armiqësore po tentojnë të thellojnë edhe më shumë urrejtjen ndërnacionale dhe të rrezikojnë jetën e qytetarëve të të gjitha kombeve dhe të kombësive tona, duke u shërbyer me metodat më brutale. Madje, sot ata shkuan qa larg sa që shtinë me armë dhe në organet e pushtetit, ku pati edhe dy viktima në Podujevë dhe në Mitrovicën e Titos"*.⁴⁵²

⁴⁵¹O.J.Schmit: KOSOVA...vepër e cituar, fq.243.

⁴⁵²Rilindja, Prishtinë, 28 mars 1989, fq.1.

Ky diskurs që përdorej ndaj punëtorëve, studentëve, intelektualëve, qytetarëve shqiptarë ishte fyes e denigrues, si dhe përdorimi i dhunës nga organet e rendit, vetëm sa e rrisnin masën e revoltës në Kosovë.

Organet e rendit në atë kohë lëshonin vendime për kufizimin ose ndalimin e njerëzve në vende publike, si grumbullimin e tre e më shumë personave, ndërprerjen e shkollave dhe fakulteteve, po ashtu, ndalimin e tubimeve në ditët e tregut. Këto masa të posaçme i arsyetonin për të evituar koncentrimin e madh të njerëzve në një vend, nga ku pastaj eskaloni në demonstrata. Për situatën kritike që mbretëronte në KSA të Kosovës, flisnin edhe mediet e huaja, të cilat i përcillnin në mënyrë permanente ngjarjet këtu. Njëherazi ato shprehnin edhe brengosjen për përshkallëzimin e mëtejshëm të situatës, që do ishte me pasoja për tërë RSFJ-në dhe Gadishullin Ballkanik.

Derisa KSA e Kosovës po përballej me demonstrata të shqiptarëve, si pasojë e suprimimit të autonomisë së vitit 1974, Kuvendi i RS e Serbisë, në një mbledhje solemne, të mbajtur më 28 mars, në Qendrën e Kongreseve "Sava", shpalli amendamentet në Kushtetutën e RS të Serbisë. Autonomia e Kosovës tani ishte reduktuar vetëm në një kujtim.⁴⁵³

Në këtë tubim, ku ishte pjesëmarrës nga Kosova, Sinan Hasani, kryetari i Kuvendit të RS të Serbisë, Borisav Joviqi mbajti fjalimin kryesor, i cili këtë ditë e quajti: "*Datë e madhe e historisë*". "Ai në fjalën e tij tregoi esencën e ndryshimeve kushtetuese që u miratuan: "*Duke shpallur ndryshime kushtetuese, ne i kemi rikthyer sovranitetin shtetëror dhe kushtetues republikës sonë. Që nga sot, Serbia është një Republikë unike socialiste, me dy krahina autonome që janë pjesë përbërëse e saj, autoriteti shtetëror i së cilës shtrihet në të gjithë territorin e tij*"⁴⁵⁴. Pastaj, në vazhdim të fjalës së tij, ai theksoi që me këto ndryshime do të sigurojmë "të drejtat", "liritë" dhe "barazinë", por njëherazi dërgonte porosi për shqiptarët dhe paralajmëronte për pamundësinë e realizimit të qëllimeve të tyre. "*Definitivisht janë duke u shkatërruar iluzionet për mundësinë e realizimit të politikës "Kosova Republikë", si shkallë drejt rrugës së copëtimit të Jugosllavisë. Copëtimi i Serbisë nuk do të shkatërrojë më unitetin e Jugosllavisë, as forcën e saj, ku duhet të ketë barazi për të gjitha kombet dhe kombësitë, pra edhe për: serbë, malazezë, shqiptarë, hungarezë, myslimanë, turq e për të gjithë të tjerët.*"⁴⁵⁵

⁴⁵³ N. Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër...*, f. 359.

⁴⁵⁴ Nikolic, Kosta: "Ne damo Kosovo". *Ustavne promene u Srbiji 1989 (II)*, Istorija 20. Veka, 3/2012, fq.187.

⁴⁵⁵ *Rilindja*, Prishtinë, 29 mars 1989, fq.4

Tubimi që qendrën “Sava” ishte solemn. Kishte shumë të ftuar nderi. Por, ato që mungonin në mesin e 1300 të ftuarve ishin përfaqësuesit e serbëve të Kosovës. Sholeviqi deklaronte se ata nuk ishin ftuar, se regjimit nuk i duheshin më.⁴⁵⁶ Pra, ata që i hapën rrugë ngjitjes së Millosheviqit në skenë, e si rrjedhojë edhe të krimeve që pasuan nga regjimi i tij, të dëshpëruar po ndiqnin përmes televizionit evenimentin në qendrën “Sava”.

Derisa Serbia mbylli anën ceremoniale të ndryshimeve në kushtetutë, me masa të dhunshme arriti që përkohësisht ta "qetësojë" gjendjen në Kosovë. Organet në Kosovë po bënin bilancin. Para një interesimi të jashtëzakonshëm të medieve vendore dhe ndërkombëtare, më 31 mars, përfaqësues nga kryesia e KSA të Kosovës dhe Komiteti Krahinor e sekretariati për punë të brendshme, mbajtën një konferencë për shtyp, me ç'rast dhanë hollësira për pasojat e trazirave, që ndodhën në KSA të Kosovës gjatë ditëve të fundit. Ata lajmëruan 2 punonjës të rendit të vrarë dhe 112 të plagosur, ndërsa 22 qytetarë të vrarë dhe 98 morën plagë të rënda dhe të lehta. Për bilancin e të vrarëve gjatë demonstratave të muajit mars - prill, *Malcolmi* jep këto të dhëna: " Numri zyrtar i të vrarëve në fund të marsit ishte 21 demonstrues dhe dy policë: nga fundi i prillit numri arriti deri në 100."⁴⁵⁷ Një numër edhe më të madh të të vrarëve e jep *Petritsch*, i cili i referohet *Amnesty International*, ku rreth 140 persona e gjetën vdekjen, ndërsa qindra të tjerë u plagosën. Mijëra vetë u dënuan pas proceseve "rrufe" me 20 - 60 ditë heqje lirie. Hapi tjetër u drejtua kundër intelektualëve dhe personaliteteve udhëheqëse të ekonomisë dhe politikës, të cilët u arrestuan në shtëpitë e tyre ose në vendet e punës në orët e para të mëngjesit dhe u çuan menjëherë në burgje, ku u izoluan pa iu dhënë të drejtën e mbrojtjes.⁴⁵⁸ Radio “Lubjana” njoftoi për 140 të vdekur dhe gati 400 të plagosur. Me këtë nisi gjakderdhja në Kosovë. I përkrahur nga shumica e shoqërisë serbe, e cila përkundej në eufori nacionale, Millosheviqi kishte vënë në lëvizje spiralen e dhunës, dukshëm i përkrahur nga serbët e Kosovës.⁴⁵⁹ Në maj të vitit 1989, parlamenti zgjodhi Millosheviqin, president të RS të Serbisë.

Më 28 qershor të po këtij viti u bë celebrimi i 600 vjetorit të betejës së Kosovës në Gazimestan, e që ishte akti i fundit i nënshtrimit të Kosovës. Histeria nacionaliste në Serbi ishte në kulmin e saj, gjatë verës së vitit 1989, me një ortek me libra, filma dhe shfaqje që përkujtonin betejën për të shënuar festimin. Eshtrat e princit Lllazar - udhëheqësit serb në atë ditë fatkeqësie,

⁴⁵⁶S. Ast, Miroslav Šolević: Režim nas je iskoristio, Vreme broj 454, 18. septembar 1999. https://www.vreme.com/arhiva_html/454/11.html, qasja 10 maj 2018.

⁴⁵⁷ N. Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër...*, f. 359.

⁴⁵⁸ W. Petritsch & R. Pichler, *Rruga e gjatë në luftë...*, f. 52.

⁴⁵⁹ O. J. Schmit, *Kosova - Histori e shkurtër e një treve...*, f. 244.

u zhvarrosën dhe parakaluan përreth republikës. Serbia u rilind dhe fitorja mbi shumicën shqiptare të Kosovës kishte marrë hakun në atë ditë - gjashtë shekuj më parë!⁴⁶⁰

Vendimi ishte i Kishës Ortodokse, që eshtrat e Lazarit të bartën nga 28 qershori i vitit 1988 e deri më 29 qershor 1989, nëpër të gjitha "tokat serbe" në Jugosllavi. Ato arritën në Gazimestan, më 19 qershor 1989, rreth mesditës, ku "pushuan" e pastaj u nisën për në Manastirin e Graçaniçës, ku u priten nga një numër i madh serbësh.⁴⁶¹

Ky përkujtim i gjashtëqindvjetorit të Betejës së Kosovës, në Vidovdan, më 28 qershor 1989, ishte skena për të cilën Millosheviç do të luante rolin e shpëtimtarit të popullit serb. Ai preku në vetëdijen kombëtare serbe, që u kthye në mënyrë dramatike në një Kosovë të kontrolluar nga shqiptarët dhe për të marrë hak, duke siguruar pozitën e tij si "*Knez Lazar i Ri*".

Fillimisht, Kisha serbe i shëtiti eshtrat e Car Llazarit nëpër vende të ndryshme, ku edhe vuri në lëvizje një numër të madh serbësh si pelegrinë. Pse ky involvim i Autoqefalisë pravosllave serbe? Pse ju dha kaq hapësirë e madhe? Të gjitha veprimet e pushtetit serb që shkaktuan gjakderdhje në Kosovë dhe në viset e tjera të Jugosllavisë e morën bekimin nga kreu i kishës ortodokse serbe. Pravosllavia i dha "legjitimitetin" "shpirtëror", krahas atij "shkencor", që i dha Akademia Serbe atij gjenocidi, që u shkaktua nga politika gjenocidale e Millosheviqit. Në pyetjen e mësipërme, se pse Kisha u implikua në atë vorbull nacionaliste, autori Naim Balidemaj jep një përgjigje, si më poshtë: "*Me qëllim që ambiciet serbe ta fitojnë simpatinë në planin ndërkombëtar dhe kombëtar. Që të "dëshmojnë" se është djep i Serbisë, për të cilën ajo e ka "të drejtën historike" dhe për këtë të "drejtë", filluan të ndërtojnë sa më shumë kisha serbe. Ia atribuuan Serbisë, Betejën e Kosovës, të zhvilluar më 1389, duke e quajtur këtë betejë si "Golgota serbe".*⁴⁶² Aty u vendos një pllakë përkujtimore me një mbishkrim ku thuhej: "*Kush është serb dhe i fisit serb dhe nuk erdhi për të luftuar në Kosovë, ai mos u bekoftë as me pasardhës mashkullorë, as femërorë. Asgjë mos mbiftë prej dorës së tij, as verë e kuqe, as të lashtat, pasardhësit e tij vuajtshin sa të jenë gjallë!*"⁴⁶³ Kjo tregonte se sa thellë kishte shkuar mitizimi i kësaj ngjarjeje dhe çfarë përmasash kishte marrë histeria nacionaliste serbe. Kryetari i

⁴⁶⁰ Peter B. Lugar, *The History and Effects of the Kosovo Polje Mythology*, MAJ, SHBA, B.A., Kolegji Lafayette, Easton, Pennsylvania, 1992 - Fort Leavenworth, Kansas, 2005, f. 76.

⁴⁶¹ M. Ndreca, *Terror dhe gjenocid shtetëror (1912 - 1999)*..., f. 263.

⁴⁶² Naim Balidemaj, *Tragjedia Kosovare: Rugova - Millosheviç*, Datori, Prishtinë, 2001, f. 24.

⁴⁶³ O.J.Schmit, *vepër e cituar*, fq 244.

Qeverisë serbe, Desimir Jevtiqi, duke folur në akademinë solemne në Beograd, më 26 qershor 1989 vlerësoi se: "miti i Kosovës është më i fuqishëm se e vërteta historike".⁴⁶⁴

Kosova për nacionalistët serbë ishte një "djep" historik dhe kulturor i popullit serb dhe për këtë arsye kishte një domethënie të veçantë dhe të madhe simbolike për ideologjinë serbomadhe.⁴⁶⁵ Njeriu i duhur që do t'i printe kësaj historie nacionaliste ishte Millosheviqi. Howard Clark në librin e tij: "*Civil resistance on Kosovo*", thotë: "*Sllobodan Millosheviqi nuk krijoi valën e nacionalizmit në Serbi, por ai vendosi ta ngasë atë dhe ta konvertojë atë në forcë*".⁴⁶⁶

Përkrahja ndaj Millosheviqit dhe kursit të tij nationalist kishte marrë përmasa të jashtëzakonshme në Serbi. Nuk kishte mjedis politik, intelektual, fetar, por edhe te njerëzit e thjeshtë ishte i mirëpritur. Se sa thellë ishte ngulitur në mendjet e serbëve urrejtja ndaj shqiptarëve, e ilustron Warren Zimmermann* në librin e tij: "*Origins of a catastrophe*", ku shkruan: "Më kujtohet në një darkë, kur e takova një historiane arti. Një grua e gjatë, tërheqëse dhe e ndjeshme, e cila kishte qenë në Nju Jork shumë herë dhe e donte Amerikën dhe kulturën e saj. Pas një spektri të gjerë dhe interesante bisedash, për një shumëllojshmëri temash, e pyeta se si ajo do të merrej me problemin e Kosovës. "E thjeshtë," tha ajo. "Do t'i rreshtoja të gjithë shqiptarët pas një muri dhe do t'i pushkatoja".⁴⁶⁷

Millosheviqi, para një numri të madh serbësh, që ishin tubuar aty me afishe dhe banderola nacionaliste mbajti një fjalim me përmbajtje, po ashtu nacionaliste.

Duke folur për ngjarjen e Kosovës që tani serbët e kishin shndërruar në mit, turma e madhe e hipnotizuar nga nacionalizmi ulërinte njëzëri: "*Car Llazar sa pa fat ishte, Sllobën përkrah nuk e kishte*".⁴⁶⁸ Më tutje, Millosheviqi u shpreh: "*Gjatë gjithë historisë së tyre, serbët asnjëherë nuk kanë pushtuar ose shfrytëzuar të tjerët. Në dy luftërat botërore ata kanë çliruar vetën dhe aty ku mundnin kanë ndihmuar edhe të tjerë të çliroheshin...Heroizmi i Kosovës nuk na lejon të harrojmë se dikur ne ishim trima dhe të nderuar dhe nga të paktët, që kanë shkuar nëpër beteja*

⁴⁶⁴ M. Ndreca, *Terror dhe gjenocid shtetëror (1912 - 1999)*..., f. 262.

⁴⁶⁵ J. Fischer, *Vitet kuq - gjelbër - politika e jashtme*..., f. 98.

⁴⁶⁶ H. Clark, *Civil Resistancein Kosovo*..., f. 18.

* Warren Zimmermann, shërbeu për herë të parë në Jugosllavi në vitin 1960; ai u kthye serish si ambasador i Shteteve të Bashkuara nga viti 1989 deri në vitin 1992.

Pas tridhjetë e tre vjetësh në Shërbimin e Jashtëm të SHBA, ai u largua nga qeveria në vitin 1994. Ai është profesor në praktikën e Diplomacisë Ndërkombëtare në Universitetin e Kolumbias. Ai dhe gruaja e tij, Teeny, jetojnë në zonën e Uashingtonit, D.C.

⁴⁶⁷ W. Zimmermann, *Origins of a catastrophe*..., f. 17.

⁴⁶⁸ T. Judah, *Kosovo: What everyone needs to know*..., f. 82.

të pamposhtur. Gjashtë shekuj më vonë ne jemi përsëri në beteja dhe grindje. Këto nuk janë beteja të armatosura, megjithëse, një gjë e tillë nuk duhet përjashtuar ende".⁴⁶⁹ Te memoriali u vendosën kurora nga tre përfaqësuesit e lartë të Jugosllavisë: Janez Dërnovshek (që ishte kryetar radhe i kryesisë së RSFJ), Slobodan Millosheviqi dhe Velko Kadijeviq (sekretar i Ministrisë së Mbrojtjes).

Kjo ngjarje nuk u la pa u komentuar edhe nga shtypi i huaj, ku vënin në pah se shqiptarët përbëjnë 90% të popullsisë së Kosovës, mirëpo e injoruan plotësisht këtë manifestim, duke mos marrë pjesë askush aty.⁴⁷⁰ Edhe shtypi i Shqipërisë i dha hapësirë mediatike kësaj ngjarjeje. Gazeta zyrtare e Tiranës "Zëri i Popullit", e solli një artikull të gjatë, ku ndër të tjera thuhej: "Lufta e Kosovës është argument i qartë se shqiptarët kanë qenë "popull dominues" që nga shekulli XIV, kurse organizimin e manifestimit e quante një përpjekje me qëllim që të nxitej nacionalizmi serb, si dhe të bindej opinionin vendas dhe i huaj për të drejtën historike të Serbisë në Kosovë".⁴⁷¹ Këto ishin vetëm porosi për popujt e tjerë, por edhe nxitje për serbët që shtypja mbi shqiptarët në Kosovë të bëhet edhe më mizore.⁴⁷²

Ky paralajmërim serioz, që u bë në Gazimestan, do të jetë fatal për RSFJ - në, të cilën Millosheviqi projektonte ristrukturimin e kësaj Federate, me një dominancë absolute të Serbisë. Për t'u realizuar këto plane hegjemoniste, RSFJ, në fillim të dekadës së ardhshme do të përfshihet në një qerthull luftërash të përgjakshme dhe shkatërrimtare.

4.4. Politika e Millosheviqit për serbizimin e Jugosllavisë

Ideja e zëvendësimit të "jugosllavizmit" që ishte etabluar nga viti 1918 me atë të serbizimit nuk ishte e re. Ideja e jugosllavizmit kishte origjinë kroate, gjë që serbët nga viti 1986, gjegjësisht me "Memorandumin" e ASSHA, e flakën tutje, duke e konsideruar të dëmshëm për Serbinë dhe filluan afirmimin e një mendim të ri, i cili u quajt "serbizim". Mendim ky që kërkonte ripërtëritjen e Serbisë dhe të bashkimit të tokave serbe në një shtet të vetëm. Para se të shpërthenin revolucionet "antiburokratike", në Kosovë, Vojvodinë dhe në Republikën e Malit të Zi, përfaqësuesit serbë qenë pakicë në udhëheqjen kolektive të Jugosllavisë. Presidenca

⁴⁶⁹Po aty, f. 82.

⁴⁷⁰ M. Ndreca, *Terror dhe gjenocid shtetëror (1912 - 1999)*..., f. 263.

⁴⁷¹Po aty, f. 263.

⁴⁷² D. Malnar, *SHBA-ja dhe Kosova*..., f. 70.

Federative përbëhej prej tetë anëtarësh, nga një për çdo republikë dhe nga një prej dy krahinave autonome. Para revolucionit "antiburokratik", Serbia mund të hidhej poshtë me votë për çdo çështje. "Duke pezulluar autonominë e dy krahinave: të Vojvodinës e të Kosovës," ka thënë presidenti slloven Millan Kučan, "Serbia do të zotëronte katër nga tetë votat në presidencën Federative - krahasuar me republikat e tjera, që kishin nga një votë secila. Kjo do të thoshte që Jugosllavia të kthehej në Serbo - sllavi"⁴⁷³

Udhëheqja kolegjinale jugosllave u bë jashtë funksionale. Ajo ishte e pafuqishme ta ndalonte Serbinë dhe politikën hegjemoniste të saj. Millosheviqi, duke i pasur katër vota në xhep shkoi në Kongresin XIV të Jashtëzakonshëm të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, që u mbajt në janar të vitit 1990. Pas një përplasjeje të madhe lindje (Serbi, Mali i Zi, Kosovë dhe Vojvodinë) - perëndim (Slloveni dhe Kroaci), u ndanë rrugët. Delegacioni serb dhe Millosheviqi, i sollën kongresit të partisë një mesazh shumë të qartë, që LKJ duhet të bëhej një organizatë e bashkuar, pavarësisht, nga çfarë mund të mendonte publiku i gjerë. Përndryshe, ajo nuk mund të vazhdonte të ekzistonte më.

L. Igleburgeri (Lawrence Sidney Eagleburger) ndihmës sekretari i shtetit në kohën e Presidentit amerikan, George Bush, gjatë vizitës që bëri me 25 shkurt 1990 në Beograd, përveç takimit me Millosheviqin kishte takim edhe me përfaqësues të opozitës, ku pjesë e këtij takimi ishte edhe Ibrahim Rugova, si përfaqësues i shqiptarëve të Kosovës. Ndihmës sekretari i shtetit mes tjerash nënvizon se SHBA - ja nuk do të rekomandonte shpërbërjen e Jugosllavisë, por nëse ajo ndodh - nuk do ketë tjetër zgjidhje pos "të jetojnë me këtë fakt". Megjithëse kjo deklaratë u mundua të justifikohet nga rrethet e ndryshme në SHBA, sepse ende qendrimi zyrtar i Uashingtonit ishte për ruajtjen e kohezionit federal të Jugosllavisë. Mirëpo, disa qarqe në Jugosllavi këtë deklaram e morën si dritë jeshile.⁴⁷⁴

Sllovenia dhe Kuçani, duke e parë që ishte e pamundur të arrinin diçka për shkak të bllokut serb me katër vota, atëherë e lëshuan mbledhjen, pas tyre edhe kroatët. Ky largim, jo vetëm që pengoi përpjekjet e Millosheviqit për ricentralizimin e Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë, por shënoi edhe fundin e të vetmes forcë politike panjugosllave, e cila deri atëherë,

⁴⁷³ Misha Glenny, vepër e cituar, fq.628

⁴⁷⁴ Dario Malnar, vepër e cituar, fq.109.

u angazhua për një shtet të përbashkët⁴⁷⁵. Pra, këtu ishte fundi i Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë.

Derisa gjendja po shkonte duke u acaruar për shkak të përpjekjeve serbe për "*serbizimin*" e organeve të federatës, Millosheviqi dhe Tugjmani po planifikonin të përvijonin kufij të rinj në hapësirën gjeografike të Jugosllavisë. Të dy u takuan fshehurazi, për të parë nëse kishte mbetur ndonjë hapësirë për marrëveshje ndërmjet tyre. Më 24 mars 1991, ata u takuan në Karagjorgjevo, rezervati i gjuetisë së Titos në Vojvodinë. Përzgjedhja e këtij vendi nga Tugjmani është për t'u habitur, sepse, pikërisht, nga ky vend Tito dha urdhër për t'u shtypur "*pranvera kroate*" e vitit 1971. Aty qenë të një mendimi që Bosnjë - Hercegovina mund të copëtohej, sipas vijës së përcaktuar në *sporazumin* Cvetkoviç - Maçek të vitit 1939 - gjysma i shkonte Kroacisë, gjysma Serbisë.⁴⁷⁶ Në të vërtetë, Millosheviqi kërkoi 66% të territorit të Bosnjës, njëherësh siguronte Tugjmanin se nuk kishte asnjë pretendim territorial ndaj Kroacisë.⁴⁷⁷ Mesiçi, këtë e dëshmon në Hagë, në kohën kur ishte i ftuar si dëshmitar në procesin gjyqësor kundër Millosheviqit. Po ashtu, Mesiçi i është përsëritur vite më vonë një propozim i tillë nga presidenti i Serbisë, Boris Tadiç, gjatë vizitës që e kishte në Kroaci.⁴⁷⁸

Tugjman gaboi këtu që i besoj Millosheviqit. Ai mendonte se do ta evitonte luftën në Kroaci duke bërë marrëveshje me të për ta ndarë Bosnje - Hercegovinën. Tugjman nuk e braktisi idenë e ndarjes së Bosnjës deri në fund të ditëve të tij; në vend që t'i bënte muslimanët aleatë, ai ia bëri ata kurban Millosheviqit.⁴⁷⁹

Në Slloveni dhe Kroaci, sidomos tek e para filloi të etablohet një pozicion i ri sa i përket të ardhmës së RSFJ - së. Ata dëshironin shndërrimin e federatës jugosllave në konfederatë. Me këtë devizë Sllovenia hyri në zgjedhjet e prillit të vitit 1990, ku koalicioni i partive që e mbështeste këtë opcion i fitoi mbi 50% të votave. Këto ishin zgjedhjet e para me një sistem pluralist që po mbaheshin në Jugosllavinë komuniste që nga krijimi i saj.

Zgjedhjet që u mbajtën në Kroaci, po ashtu në muajin prill të vitit 1990, i kishte fituar lëvizja HDZ (Hrvatska Demokratska Zajednica - Bashkimi Demokratik Kroat) e Franjo Tugjmanit, që ishte formuar me 28 shkurt 1989. Ajo ishte një amalgamë e ekstremistëve vendas

⁴⁷⁵ Aleksandar Pavković, *From Yugoslavism to Serbism: the Serb national idea 1986-1996*, Nations and Nationalism 4 (4), 511-28 © ASEN 1998, fq. 515.

⁴⁷⁶ M. Glenny, *vepër e cituar*, fq. 633.

⁴⁷⁷ Viktor Meier, *Fundi i Jugosllavisë...* vepër e cituar, f.246.

⁴⁷⁸ Shaban Murati, *Profile të diplomacisë europiane në Ballkan*, UET/Press, Tiranë 2009, fq.107

⁴⁷⁹ Viktor Meier, *vepër e cituar*, fq.247.

të të gjitha llojeve, si dhe përfaqësues të emigrantëve ultranacionalistë kroatë, shumë prej të cilëve me origjinë hercegovinase, që kishin qenë pjesë e grupeve ustashe gjatë Luftës së Dytë Botërore.

APJ më nuk ishte forcë neutrale, sepse ajo filloj të mbaj anën e Serbisë e cila përpiqej ta ruante federatën jugosllave, por të centralizuar dhe nën kontrollin e plot të saj. Me urdhër të gjeneralit Kadijeviq, njesitet e armatës jugosllave ndërhynë në Slloveni e Kroaci. Udhëheqja sllovene drejtoj akuza ndaj tij dhe APJ - së, duke i cilësuar veprimet e tyre si të njëanshme dhe për tejkalim kompetencash. Reagimet e ashpëra sllovene erdhën, pasi që Sllovenia ishte kontribuesi më i madh financiar në buxhetin e APJ - së.

Tani më, republikat e Jugosllavisë perendimore ishin përcaktuar për solucionin e pavarësisë. Pas disa takimeve që i kishin Milan Kučan dhe Franjo Tugjman u koordinuan për shpalljen e pavarësisë së vendeve të tyre. Me 25 qershor 1991, parlamenti slloven u mbledh në seancë plenare ku e miratoi deklaratën e pavarësisë. Po atë mbrëmje edhe parlamenti kroat veproi njëjtë duke shapllur pavarësinë e Kroacisë. Kështu, Sllovenia dhe Kroacia duke u mbështetur në të drejtën kushtetuese të kombeve jugosllave për vetëvendosje, shfrytëzuan të drejtën e tyre për shpëtim nga RSFJ.

Të kota ishin përpjekjet e kryeministrit reformator të Qeverisë Federale, Ante Markoviq, që përmes reformave t'ia zgjaste jetën Jugosllavisë. Edhe pse reformat e tij anti -inflacion dhanë efekt, duke e ulur inflacionin nga 2800% në 4 %⁴⁸⁰. Kundër tij ishin të gjithë: Lubjana, Zagrebi dhe Beogradi. Në dhjetor 1991, Markoviqi dha dorëheqje, duke e kuptuar se nuk mund të bënte asgjë për të parandaluar caktimin e të 86% të buxhetit federal, për qëllime lufte, gjë që sapo ishte vendosur⁴⁸¹.

Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë (RSFJ) mori fund. Me këtë akt, përfundimisht mori fund edhe eksperimenti për unifikimin e sllavëve të jugut, që kishte filluar në vitin 1918.

Të qara të mëdha u shfaqën edhe në APJ, që pas LKJ - së ishte kolona e dytë themelore e unitetit të Jugosllavisë. APJ dhe LKJ që ishin dy forca, të cilat kujdeseshin për kohezionin e brendshëm në Jugosllavi, tanimë ishin të paaftë ta luanin edhe më tutje këtë rol, sepse u shndërruan në të burgosur të konfliktit ndëretnik.⁴⁸²

⁴⁸⁰ Jasminka Udovički & James Ridgeway, Makthi...vep.e cit. fq.103.

⁴⁸¹ Po aty, fq.106.

⁴⁸² Darko Gavrilović, Ljubiša Despotović, Yugoslavia - beginning of the end, Istorija 20. veka, 2/2011, fq. 118.

Milloseviqi po e instrumentalizonte dhe po e përdorte ushtrinë për interesat e tij politike. Prova e tij e parë për ta përdorur armatën ishte Kosova, gjatë vitit 1989, kur ishte përfshirë nga demonstratat e shqiptarëve, që ishin si pasojë e rrënimit të rendit kushtetues. Në pranverën e vitit 1989 ata dërguan tankset në Kosovë. U vranë dhjetëra të rinj shqiptarë nga përleshjet që pasuan.

Siç u përmend edhe më sipër, në kohën e ministrit të mbrojtjes, Veljko Kadijeviç, iu hap rruga interferimeve të Milloseviqit në ushtri. APJ u bë mekanizëm në duart e tij për t'i realizuar ambicjet shoviniste. Më 1991, pa u konsultuar fare me presidencën jugosllave, gjenerali Kadijeviç urdhëroi ushtrinë të dilnin në rrugët e Beogradit, ku protestonte opozita kundër totalitarizmit të Milloseviqit. Në programin e Milloseviqit dhe të Kadijeviqit, gjithçka rinovohej: "Edhe Serbia homogjene, pastrimi etnik dhe zhvendosja e dhunshme dhe në fund - pra – hegjemonia"⁴⁸³, - nënvizonte Stipe Mesiç në librin e tij: *"Si është shkatërruar Jugosllavia"*. Pritshmëritë, që pas ardhjes së tij, do të bëhej depolitizimi i ushtrisë, meqë ishte kuadër i arsimuar në SHBA, ishin të gabuara. Pikërisht në kohën e tij, APJ u politizua skajshmërisht. Kadijeviç, manovroi për vendosjen e ushtrisë në konfrontime direkte politike. Në kujtimet e tij, ai zbulon se ishte antidemokratik, antiperëndimor, prosovjetik dhe me qëndrime komuniste dogmatike. Ai mund të shihet si një nga fajtorët kryesor për rënien e Jugosllavisë.⁴⁸⁴

Me "serbizimin" e Armatës, Milloseviqi mendonte se duke pasur në dorë këtë mekanizëm force mund ta krijonte Serbinë e madhe, për të cilin ishin në dijeni edhe amerikanët. Igëllberger ishte i saktë kur deklaronte se: *"Udhëheqja e Serbisë shkon në krijimin e Serbisë së madhe...Milloseviqi është i gatshëm ta lëshojë Slloveninë dhe një pjesë të Kroacisë, që të pavarësohen, por me kushtin që në Serbinë e madhe të hyjnë Bosnja e Hercegovina, pjesë të Kroacisë dhe, ndoshta, edhe Maqedonia"*⁴⁸⁵ (duke llogaritur edhe Malin e Zi, Vojvodinën dhe Kosovën - shënim imi). , prandaj do të vazhdojnë objektivat serbe drejt

Jugosllavia ishte kapluar nga një makth nacionalist, e shtyrë nga ideja për bashkimin e të gjithë serbëve në një shtet, respektivisht, krijimin e një Serbie të Madhe. Ky objektivi i Serbisë do nxisë luftëra të përgjakshme ndëretnike, me pasoja të rënda dhe të paparashikueshme për popujt e Jugosllavisë.

⁴⁸³ Mesiç, Stipe: *Si është shkatërruar Jugosllavia*, Zagreb, botimi i dytë, 1994, fq.324.

⁴⁸⁴ Viktor Meier, *vepër e cituar*, fq. 58

⁴⁸⁵ Mesiç, *vepër e cituar*, fq. 321 - 322

PËRFUNDIME

Idetë iluministe që depërtuan në arealin ballkanik në fillim të shekullit XIX nxitën popujt ballkanikë në zhvillimin e emancipimit të tyre kombëtar. Në rastin e serbëve, zhvillimi i emancipimit kombëtar u shoqërua me aspirata për restaurimin e perandorisë mesjetare të Dushanit. Por, e veçanta e këtyre përpjekjeve është se ato u shoqëruan me elemente shoviniste. Në procesin e shtetndërtimit, serbët ishin jo tolerant ndaj gjuhëve, kulturave dhe religjioneve të tjera. Qysh në vitet e para të shtetit autonom serb, nga qytetet serbe u dëbuan të gjithë shqiptarët e myslimanët, kurse objektet e trashëgimisë së tyre kulturore e religjioze u rrënuan. Një jotolerancë, buronte nga Kanuni Vasojeviq (1829), që legalizonte kulturocidin ndaj elementeve jo serbë. Kjo do të përforcohet me elaboratin e Vuk Karaxhiqit, për të marrë një formë më të detajuar përmes ndikimit të lëvizjes pansllaviste. Në këtë mënyrë, u lind projekti “Naçertanie” (1843), që i jepte detyrë serbëve restaurimin e perandorisë mesjetare të Dushanit nën prizmin e “së drejtës historike”. Programi që parashihte bashkimin e sllavëve të jugut nën hegjemoninë serbe e shihte në kuadër të shtetit serb edhe Kosovën dhe pjesën veriore të Shqipërisë. Pamundësia që shteti serb të shtrihet kah territoret e banuara me serbë në Bosnjë, bëri që ai të orientohet kah jugu, pra, kah tokat shqiptare. Në këtë mënyrë fillojnë përpjekjet e organizuara për pushtimin e tokave shqiptare, që do të pasohen nga konflikti shqiptaro-serb, i cili do të zgjasë deri në ditët e sotme.

Programi i Garashaninit u shndërrua në një udhërrëfyes dhe themel për shumë programe të tjera antishqiptare, që u paraqitën pas gjysmës së dytë të shekullit XIX dhe gjithë shekullit XX. Pushtimi i viseve shqiptare të Toplicës, të Vrajës, të Kurshumlisë, etj., si dhe aneksimi i tyre më 1878 u shoqërua me dëbimin e të gjithë shqiptarëve nga këto treva. Politikë e njëjtë e spastrimit etnik në territorin e Kosovës së sotme e më gjerë u zhvillua edhe gjatë luftërave ballkanike. Mijëra shqiptarë u vranë nga ushtria serbe. Qindra lokalitete shqiptare u shkatërruan. Mijëra të tjerë u dëbuan për në Turqi. Ata që mbetën iu nënshtruan terrorit, konvertimeve të dhunshme, etj.

Politika antishqiptare vazhdoi edhe në periudhën midis dy Luftërave Botërore. Shqiptarët në Kosovë e në viset e tjera të Jugosllavisë iu nënshtruan programeve të ndryshme, që parashihnin: vrasjet, dëbimin, shpronësimin, kolonizimin e këtyre trevave me serbë dhe asimilimin e shqiptarëve. Objektivat që buronin nga “Naçertania” u përpunuan sipas

rrethanave të reja dhe kështu lindën programet dhe projektet, si: Programi sekret për vrasjen e shqiptarëve (1920); programi për shpërnguljen e shqiptarëve, i viti 1937 i autorit Vaso Çubriloviq; elaborati i Ivo Andriqit për Shqipërinë (1937); programi i Stefan Moljeviqit (1941); shumë programe të tjera e deri te Memorandumi i vitit 1986 i Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve, etj.

Përfundimi i Luftës së Parë Botërore e gjeti Kosovën përsëri nën okupimin serb, por tani nën emrin e Jugosllavisë socialiste. Edhe pse liderët e saj trumbetonin se shteti socialist njih barazinë dhe të drejtat e gjithë nacionaliteteve që jetojnë në to, në rastin e shqiptarëve ndodhi e kundërta. Nacionalizmi serb, i veshur nën petkun e komunizmit, arriti që përmes forcës ushtarake ta nënshtrojë Kosovën, e më pas përmes proceseve të ndryshme politike edhe ta aneksojë atë (1945). Kërkesat e popullit shqiptar për të përcaktuar të ardhmen e tij u dënuan rëndë. Pasi një periudhë e vrasjeve, e dëbimeve, e persekutimeve dhe e shtypjes së të drejtave njerëzore e kombëtare. Shqiptarët përsëri u bënë objekt i planeve shoviniste serbe, të po të njëjtëve autorë, që tani mbanin edhe poste ministrore në shtetin e ri – është fjala për Vasa Çubrilloviqin dhe projektin e tij për dëbimin e pakicave nga Jugosllavia e re. Si rezultat i këtij programi dhe i programeve të njëjta (në periudhën 1950-1960), sikurse ishte ai i mbledhjes së armëve nga popullata shqiptare, nga Jugosllavia u shpërngulën për në Turqi rreth 200.000 shqiptarë, që jetonin në Kosovë e në Maqedoni.

Tendencat serbe për shpërnguljen e shqiptarëve dhe serbizimin e Kosovës, dëshmohen edhe nga aktivitetet e Entit krahinor për ruajtjen e monumenteve, i cili gjatë viteve 1950-1960, duke pasur një strukturë ekskluzivisht serbe të ekspertëve të saj kulturorë, kreu punime të shumta restauruese në objektet religjioze ortodokse, të “pretenduar si serbe” dhe në disa objekte me origjinë osmane. Kjo kishte tendencën të tregonte se serbët ishin këtu para osmanëve. Me ardhjen e tyre, osmanët ndërtuan objektet e tyre, kurse shqiptarët as që kanë “ekzistuar” në këto vise para ardhjes së osmanëve. Një veprimtari e heshtur, por, shumë domethënëse, hovi i së cilës do të ndërpritet me punësimin e kuadrove shqiptare gjatë viteve 1960.

Gjendja e vështirë, presionet dhe persekutimet ndaj shqiptarëve do të vazhdojnë deri kah mesi i vitit 1966, kur gjatë një plenumi të udhëheqjes partiake jugosllave, të mbajtur në Brione, shkarkohet Aleksandër Rankoviqi, figurë e lartë politike në Jugosllavi, mbikëqyrës i punës së shërbimit sekret jugosllav, si dhe organizator i dhunës antishqiptare. Rrethanat e

reja faktorizuan elementin shqiptar në Jugosllavi. Ata u bënë pjesë e ekuilibrave të rinj politik në Jugosllavi, që kishin për qëllim uljen e rolit të faktorit serb në Federatën jugosllave. Ndryshimet e disa amendamenteve kushtetuese, siguruan disa të drejta kombëtare, sikurse ishin: arsimi në gjuhën shqipe, hapja e universitetit dhe e institucioneve të tjera shkencore e kulturore, përdorimi i flamurit kombëtar, e më e rëndësishme ishte se krahina autonome fitoi disa kompetenca legjislativë, etj. E veçanta e këtyre arritjeve ishte edhe ngritja e ndërgjegjes kombëtare shqiptare në Kosovë, që ishte rezultat i bashkëpunimit shkencor midis Kosovës dhe Shqipërisë, gjatë viteve 1970-1981, gjatë së cilës periudhë qindra pedagogë shqiptarë qëndruan në Kosovë, e po ashtu, edhe qindra studentë kosovarë studiuan në Shqipëri me bursa të shtetit shqiptar. Pa dyshim, frytet e këtij bashkëpunimi, në aspektin kombëtar, do të piquen qysh në fillim të viteve 1980, me artikullimin e kërkesave kombëtare të shqiptarëve të Kosovës.

Kushtetuta e vitit 1974 vlerësohet si e arritura më e madhe e popullsisë shqiptare në Kosovë. Ndryshimet kushtetuese të vitit 1974 i siguruan Kosovës një avancim në statusin e krahinës autonome, në aspekt të kompetencave legjislativë e ekzekutive, e për më tepër të qenit subjekt i barabartë në Federatën jugosllave. Krahina Socialiste Autonome e Kosovës, sipas Kushtetutës së vitit 1974 kishte kompetenca ta organizonte jetën shoqërore e politike në Kosovë. Kompetencat e saj shtriheshin në gjitha sferat, si: arsimi, shëndetësia, planifikimi hapësinor, mbrojtja, siguria publike, drejtësia, e drejta e miratimit të ligjeve, kompetenca në politikën e jashtme, etj., kurse varësia me Serbinë ishte formale dhe jo hierarkike. Për më tepër, krahinat autonome, pra, Kosova e Vojvodina, kishin edhe të drejtën e vetos në nivel federativ e republikan.

Të drejtat legjislativë dhe ekzekutive, që i fitoi Kosova me Kushtetutën e vitit 1974 shkaktuan një brengosje serioze të qarqet nacionaliste serbe, të cilat e kishin filluar procesin e riorganizimit të tyre, qysh më 1969, me rastin e ndryshimeve kushtetuese në Jugosllavi. Te këto qarqe lindi frika se ngritja e vetëdijes kombëtare shqiptare mund të çojë në shkëputjen e Kosovës nga Serbia, sidomos, kur Kosova posedonte tipare të një organizimi autonom shtetëror. Prandaj, përmes një presioni të heshtur, qarqet politike serbe filluan përpjekjet për ndryshimin e Kushtetutës së vitit 1974, në veçanti të pjesëve, që kishin të bënin me kompetencat e krahinave dhe lidhjen e tyre me Serbinë. Propozimet dhe arsyetimet e këtyre

ndryshimeve u përfshinë në Librin e kaltër (1977), por që u hodhën poshtë nga udhëheqja federative, në krye me Titon.

Fillimi i viteve 1980 shënon një kthesë radikale në historinë e Kosovës dhe të popullit të saj. Vdekja e Titos (1980) dhe demonstratat shqiptare të vitit 1981 e vënë shtetin jugosllav para një sfide të madhe. Mungesa e një arbitri suprem dhe paaftësia e liderëve komunistë jugosllavë, që t'i përshtaten ndryshimeve të reja, sidomos, kur kriza ekonomike kishte filluar ta dërgonte këtë shtet drejt tatëpjetës ekonomike-financiare, bëri që nacionalizmi serb të ngrejë kokën dhe të vihet në kërkim të përmirësimit të “gabimeve”, që i ishin bërë popullit serb. Në këtë mënyrë, gjatë demonstratave të vitit 1981 u ushtrua një dhunë e ashpër nga njësitet policore federale, që u pasua me aksione politike, sikurse që ishte diferencimi ideopolitik. Një pjesë e madhe e popullit shqiptar u shndërrua në subjekt persekutimi nga instancat policore e gjyqësore. Qëllimi i të gjitha këtyre masave ishte shkatërrimi i inteligjencës shqiptare, e në veçanti i institucioneve, që ndërtuan një inteligjencë të tillë. Nuk ishte, pra, rastësi që diferencimi politik ishte më i ashpër në Universitetin e Prishtinës, nga i cili u përjashtuan shumë kuadro me cilësi profesionale dhe kombëtare. Të gjitha këto veprime u ndërmorën nën maskën e “luftimit të nacionalizmit dhe separatizmit shqiptar”, që shpesh ndodhi, që shqiptarët t'i persekutojnë bashkatdhetarët e tyre, në kuadër të sloganit të cekur më lart.

Në anën tjetër, demonstratat e vitit 1981, ishin pretekst për zgjimin e nacionalizmit serb, në fakt, për ndryshimin e pozicioneve të veprimtarisë së tij. Tani qarqet nacionaliste serbe fillojnë me veprimet dhe prononcimet e hapura antishqiptare. Shenjat e para të një riorganizimi të tillë shfaqen te Shoqata e Shkrimtarëve të Serbisë, e cila filloi të argumentojë për gjendjen e keqe të popullit serb, pozitën e papërshtatshme juridike të Serbisë dhe padrejtësitë që i ishin bërë shtetit dhe popullit serb. Kauzës së shkrimtarëve iu bashkua edhe Akademia e Arteve dhe e Shkencave të Serbisë, si dhe Kisha Ortodokse Serbe, e cila viteve paraprake kishte qëndruar e heshtur, kurse tani kërkonte të rivendoste autoritetin e saj, që e kishte pasur gjatë së kaluarës historike. Në fakt, ndonëse, kishte qëndruar e heshtur, ajo në prapaskenë kishte punuar dhe mbledhur materiale mbi “padrejtësitë dhe presionet nga shqiptarët ndër vite”, të cilat do të luajnë rol në shpëlarjen e trurit të serbëve, kinse për presionet shqiptare. Në këtë mënyrë u krijua një koalicion trepalësh, që autorë të ndryshëm do ta quanin: “lulja serbe trepalëshe”.

Njëkohësisht me mobilizimin e nacionalizmit serb në Serbi, u mobilizua edhe nacionalizmi në mesin e serbëve të Kosovës, nën emrat: “Otopor” dhe “Bozhur”, që simbolizonin rezistencën kundër shqiptare dhe “gjakun e derdhur serb” për Kosovën. Objektivi i shprehur i këtyre grupeve, ku bazën e kishin në Fushë Kosovë, ishte parandalimi i shpërnguljes së serbëve e malazezëve nga Kosova dhe rikthimi i atyre që dëshirojnë, por në thelb synimi i fshehur ishte kthimi i Kosovës nën juridiksionin serb dhe ndryshimi i strukturës etnike të Kosovës. Konsolidimi i serbëve të Kosovës do të vërehet tek në tetor të vitit 1985, përmes një peticioni drejtuar autoriteteve jugosllave, ku ankohen për pozitën e serbëve në Kosovë dhe sinkronizimit të bashkëveprimeve me qarqet nacionaliste serbe, në mars të vitit 1986. Marsi i vitit 1986 shënon koalicionin e rrymave nacionaliste serbe: Kishën Ortodokse Serbe, rrymat radikale në Lidhjen Komuniste të Serbisë, si dhe inteligjenca serbe, që do t'i instrumentalizojë lëvizjen e serbëve të Kosovës në drejtim të arritjes së objektivave hegjemoniste serbe. Në këshillimin e këtyre qarqeve, serbët në Kosovë filluan me inskenimin e incidenteve etnike, me inskenimin e presioneve të llojeve të ndryshme nga shqiptarët, që shkonin deri në shkallën e vrasjeve dhe të përdhunimeve sistematike. Për qëllim kishin ta bindin opinionin publik jugosllav për nevojën e ndërhyrjes në Kosovë, me qëllim të vendosjes së rendit dhe të rregullit.

Gjatë kësaj periudhe, serbët e Kosovës inskenuan një varg incidentesh, sikurse: presionet për shpërngulje, uzurpimi i pronës, djegia e pronës dhe e pasurisë me qëllim të detyrimit të shpërnguljes, dhuna ndaj personelit kishtarë serbë, shkatërrimi i varrezave serbe, diskriminimi, etj., e në veçanti përdhunimet, përfshirë edhe personelin kishtarë serbë. Propaganda mbi fenomenin e përdhunimeve etnike kishte arritur në atë nivel, sa përdhunimi të ishte sistematik. Por, një fenomen i tillë, jo vetëm që ishte i pabazuar, por pavërtetësinë e tij e dëshmuar, madje, edhe hulumtime të bëra nga autorë neutralë serbë, të cilët edhe fenomenin e shpërnguljeve e lidhin më tepër me faktorin ekonomik se sa atë politik.

Derisa ankesa të tilla për “zullumin shqiptar” ishin të përditshme dhe kishin filluar edhe të bëheshin të zakonshme, megjithatë, ndodhën dy raste, me të cilat Beogradi zyrtar manipuloi skajshëm në arritjen e objektivave të tij shoviniste. Fjala është për rastin Danilo Milinçiq dhe atë Gjorgje Martinoviq. Në rastin e parë, një vrasje, ku sipas të gjeturave gjyqësore ishte kryer për motive vetëmbrojtëse, u propagandua deri në atë shkallë, sa që shqiptarët i vrisnin serbët, madje, edhe në shtëpitë e tyre dhe se një gjë e tillë ishte pothuajse e zakonshme në

Kosovë dhe se kjo bëhej me pretekst të uzurpimit të pronës dhe të pasurisë së serbëve. Në mediet serbe pasqyroheshin serbët e “pambrojtur” nga askush, përballë presionit shqiptar. Një propagandë e fuqishme bëri që shqiptari i akuzuar padrejtësisht të ekzekutohej me vendim gjyqësor, madje, përkundër konventave shtetërore e ndërkombëtare, që nuk lejonin që një i sëmurë apo invalid të ekzekutohej. Rasti i dytë, kishte të bënte me aktin e vetëstimulimit seksual, ku si pasojë pati shishen e birrës së mbetur në anusin e një serbi lokal, në rajonin e Gjilanit. Përkundër ekspertizave mjekësore, që përjashtonin se ky akt ishte shkaktuar me dhunë nga të tjerët (në këtë rast nga shqiptarët), qarqet nacionaliste serbe nuk pushuan, në kërkim të gjetjes së provave, edhe pse viktimja, fillimisht, kishte pranuar se ishte një akt personal, duke mos përfshirë ndonjë palë të tretë, apo edhe kur gjetjet e drejtësisë kishin provuar se në vend të ngjarjes nuk kishte qenë kush tjetër, pos vetë viktimës. Martinoviqi u keqpërdor skajshëm. Për ngjarjen e tij u thurën tregime, madje, u bënë edhe dokumentarë, ku synim kishin të tregonin se deri në cilën shkallë serbët e Kosovës “po duronin presionin shqiptar, vetëm për të mos i braktisur trojet stërgjyshore” apo edhe të dokumentohej vetëfljimi dhe sakrificat e serbëve për Kosovën. Dokumentarë të tillë preknin moralin e çdo njeriu normal, që nuk kishte njohuri mbi propagandën serbe. Në këtë mënyrë, opinionin publik në Jugosllavi gjithnjë e më shumë po mbushej me mllef kundër shqiptarëve. E ky ishte edhe qëllimi i nacionalizmit serb, që në një ballafaqim të mundshëm në të ardhmen, të kishte arsyetimin për veprimet e ndërmarra, sikurse do të ndodhë viteve të mëvonshme.

Kërkesat dhe qëllimet që pretendoheshin të arriheshin përmes këtyre incidenteve, peticioneve, thirrjeve nacionaliste, etj., u artikuluan në Memorandumin e vitit 1986 të hartuar nga Akademia Serbe e Shkencave dhe e Arteve. Ndonëse, u lëshua në publik, në formë jo zyrtare, sigurisht për të testuar reagimin e opinionit jugosllav, Memorandumi i bënte një analizë zhvillimit historik të popullit serb dhe hidhte kornizat për një orientim të ri historik të popullit serb. Një ndër arsytet kryesore për shkrimin e këtij pamfleti ishte situata e vështirë ekonomike dhe mundësia për shpërbërjen e Jugosllavisë, e në këto rrethana populli serb do të copëtohej. Prandaj, qëllimi kryesor i këtij Memorandumi ishte ngritja e çështjes serbe. Brenga ishte më e thellë, kur jashtë kufijve administrativë të Serbisë jetonin mbi 24% serbë apo numri i serbëve jashtë Serbisë ishte më i madh se numri i sllovenëve, shqiptarëve, etj. Si rrjedhojë, Memorandumi “fajin” për gjitha të këqijat, që përjetoj populli serb ia hodhi

Kushtetutës së vitit 1974 dhe rrethanave që buruan nga ajo. Në këtë mënyrë, jo vetëm se vlerësohej se Serbia ishte copëtuar në tre pjesë, por se edhe serbët, si popull ishin copëtuar në pesë pjesë. Zgjidhja e kësaj çështjeje do të shndërrohet në një faktor kryesor për gjakderdhje të shumta në hapësirat jugosllave, pasi që Memorandumi konstatonte se rivendosja e integritetit të plotë nacional serb, pavarësisht, në cilën njësi federale banonin, është e drejtë e tyre juridike e kushtetuese. Kjo, sigurisht, nuk mund të arrihej në mënyrë paqësore, duke favorizuar serbët, kundrejt nacionaliteteve të tjera. Prandaj, një synim i tillë ishte çelësi i trazirave dhe i veprimeve të armatosura serbe në Jugosllavi. Me fjalë tjera, Memorandumi, shtroi rrugën për zbatimin e projektit për bashkimin e popullit serb, respektivisht, të zgjerimit territorial serb, qoftë me marrëveshje politike apo përmes forcës ushtarake.

Një nga problemet e trajtuara në Memorandum - ajo e autonomisë së Kosovës, kishte qenë në fakt preokupim kryesor i klasës politike serbe, që nga miratimi i saj, për të marrë një trajtë më serioze pas vitit 1981. Klasa politike e Serbisë, përmes rrugëve politike, projekteve ekonomike dhe projektreformave të ndryshme, kishte tentuar pa sukses ta ndryshonte, së paku, atë pjesë të kushtetutës që rregullonte raportet e krahinave me Serbinë, respektivisht, kishte dështuar ta reduktonte autonominë e krahinave. Presioni i qarqeve nacionaliste serbe në Serbi dhe në Kosovë ndikuan që te klasa komuniste serbe të paraqiten divergjencia rreth mënyrës për të arritur deri te këto ndryshime. Derisa kreu i komunistëve serb, Ivan Stamboliç, ndiqte rrugën politike të bindjes së subjekteve federative për nevojën e ndryshimeve kushtetuese, Slobodan Millosheviç, një figurë e re politike dhe para se gjithash mik i Stamboliçit, zgjodhi rrugën e bashkëveprimit me qarqet nacionaliste serbe. Interesi ishte i dyanshëm: ngjitja në pushtet për Millosheviqin dhe realizimi i aspiratave nacionaliste të qarqeve serbe. Në këtë mënyrë, këto qarqe përgatitin një skenar, ku realizohet në Fushë Kosovë, në prill të vitit 1987. Në një tubim, ku merrte pjesë Millosheviqi dhe garnitura politike kosovare, inskenohet rrahja e serbëve nga policët shqiptarë. Në këtë moment, ndërhyu Millosheviqi me frazën: “Askush nuk guxon t’ju rrahë”. Kjo frazë u bë e njohur dhe me ndihmën e qarqeve akademike, nacionaliste, kishtarë, ushtarake, publike, etj. Millosheviqi arriti që në mbledhjen VIII të KQ të Lidhjes Komuniste të Serbisë (shtator 1987) ta rrëzojë Stamboliçin nga pozita, si dhe të ngjitet në funksionin e kreut të komunistëve të Serbisë.

Me t'u ngjitur në kreun e Lidhjes Komuniste të Serbisë, detyrë e parë e Millosheviqit ishte spastrimi i këtyre radhëve dhe instalimi i njerëzve të tij besnikë, e tek më pas, fokusimi drejt detyrës së tij kryesore – atë të suprimimit të autonomisë së krahinave të Kosovës e të Vojvodinës. Në realizimin e këtij qëllimi, Millosheviqi, pati mbështetjen e të gjitha qarqeve nacionaliste serbe: në radhë të parë, të lëvizjes së serbëve nga Kosova, e cila shpresën për realizimin e interesave të saj shoviniste i shihte te Millosheviqi. Nën dirigjimin dhe me mbështetjen logjistike së klikës së Millosheviqit, kjo lëvizje filloi organizimin e “mitingjeve të së vërtetës”, ku pretendonin të paraqisnin jetën e vështirë, presionet dhe viktimizimin e popullsisë serbe në Kosovë. Pra, qëllimi publik ishte të vetëdijesohej opinioni jugosllav rreth kësaj çështjeje. Qëllimi sekret ishte që udhëheqjet krahinore të bindeshin për nevojën e ndryshimeve kushtetuese, apo në të kundërtën të rrëzoheshin ato. Në këtë mënyrë, që nga korriku i vitit 1988, serbët e Kosovës organizuan mitingje në gjithë Serbinë, Malin e Zi, Kosovë dhe në Vojvodinë. Në këtë mënyrë, lëvizja e serbëve të Kosovës u shndërrua në një strukturë paralele dhe u bë mekanizëm për rrëzimin e udhëheqjeve politike në Vojvodinë e në Mal të Zi.

Duhet cekur edhe evolucionin e këtyre mitingjeve. Fillimisht, ato u pasqyruan si mitingje të solidaritetit, të vëllazërim- bashkimit, të ruajtjes së Jugosllavisë e të jetës së përbashkët të kombeve dhe të kombësive. Në këtë periudhë, mbizotëronin fotografitë e Titos, flamujt e Jugosllavisë, etj. Më pas ato fillojnë gradualisht të marrin ngjyrimet nacionaliste, sidomos, antishqiptare, kurse fotografitë e Titos zëvendësohen me ato të Millosheviqit, të Vojvoda Nishiçit, të Betejës së Kosovës, etj., e sidomos mbizotëronin këngët dhe parullat nacionaliste, si dhe veshjet kombëtare serbe e malazeze. Ajo që bie në sy është se, Lidhja Komuniste e Jugosllavisë, ishte e paaftë dhe e pafuqishme t'i kundërvihet tendencave nacionaliste serbe dhe agresivitetit gjithnjë në rritje të politikës zyrtare të Serbisë. Një politikë e tillë agresive bëri që edhe klasa politike e Kosovës të ndjekë linjën e LKJ dhe të jetë e moderuar në qëndrimet ndaj mitingjeve, në mënyrë që të shmangte reagimin politik e mediatik serb.

Në tetor 1988, përmes mitingjeve dhe propagandës së ashpër serbe, Millosheviqi arriti ta rrëzojë udhëheqjen krahinore të Vojvodinës, instancat dhe strukturat politike të kësaj krahine të zëvendësoheshin nga ithtarë politikë të Millosheviqit. Ishte kjo fitorja e parë e Millosheviqit, i cili tanimë kishte dy zëra në Federatë: Atë të Serbisë dhe të Vojvodinës. Inkurajimi nga sukcesi në Vojvodinë e orientoi lëvizjen serbe kah Mali i Zi, në tentativë për

rrëzimin e pushtetit legjitim dhe zëvendësimin e tij nga ithtarë të Millosheviqit, që u arrit në janar 1989. Me këtë akt u fuqizua dukshëm pozita e Millosheviqit në Federatë. Tanimë ai i kishte duart e lira që me gjithë forcën dhe agresivitetin të ballafaqohet me udhëheqjen politike të Kosovës. Por, në këtë periudhë vërehet edhe një fakt interesant. Lëvizja serbe duke parë rolin e saj në këto mitingje kishte filluar të shprehte mosdëgjueshmëri ndaj Millosheviqit, ku si rezultat, ai në organizimin e këtyre mitingjeve zëvendësoi këtë lëvizje me strukturat legale të Lidhjes Socialiste të Popullit Punonjës. Në këtë mënyrë serbët e Kosovës u anashkaluan nga Millosheviqi.

Pas nënshtrimit të Vojvodinës e të Mali të Zi, Millosheviqi u drejtua kah Kosova, ndërsa veprimi i tij i parë ishte shkatërrimi i udhëheqjes politike kosovare. Në fakt një qëllim i tillë kishte filluar qysh kah mesi i nëntorit 1988, kur përmes maskës së përtëritjeve kadrovike kishte arritur t'i lironte nga detyra Azem Vllasin (anëtar i Kryesisë së KK LKK) dhe Kaqusha Jasharin (kryetare e KK LKK). Në vend të tyre instaloi kuadro të dëgjueshme, sikurse: Rrahman Morinën, Ali Shukriun dhe Hysamedin Azemin, etj., të cilët do të bëheshin pjesë e skenarit për rrëzimin e rendit politik e kushtetues të Kosovës. Popullsia shqiptare e Kosovës ishte e vetëdijshme se prapa këtyre skenarëve parashihej anulimi i autonomisë, përmes ndryshimeve kushtetuese, prandaj u ngrit në mbrojtje të udhëheqjes së saj. Në periudhën 17-21 nëntor 1988, minatorët e Trepçës marshuan në këmbë për në Prishtinë. U ngritën në protesta studentë, nxënës e qytetarë. Si kundër përgjigje, Millosheviqi, organizoi një miting të madh në Beograd, ku përveç gjuhës nacionaliste kërcënoi hapur edhe me luftë, në rast se nuk do të realizoheshin qëllimet politike të Serbisë.

Në fillim të vitit 1989, debati mbi ndryshimet kushtetuese kishte arritur në një pikë të nxehtë. Ishte e qartë se ndryshimet e propozuara do të reduktonin kompetencat legislative e ekzekutive të Kosovës. Prandaj, ekzistonte edhe një polarizim në klasën politike kosovare nëse duhet përkrahur apo jo këto ndryshime. Në këto rrethana, më 20 shkurt 1989, minatorët e Trepçës ngujohen në horizontin e tetë të nëntokës kosovare, duke kërkuar dorëheqjen e Rrahman Morinës, Ali Shukriut e të Hysamedin Azemit, në përpjekje për të parandaluar ndryshimet kushtetuese e me këtë edhe mbrojtjen e autonomisë së Kosovës. Solidarizimi i studentëve, punëtorëve e qytetarëve me minatorët bëri që tre kuadrot e apostrofuara të japin dorëheqje, por që më pas, pas daljes së minatorëve nga minierat, t'i tërhiqnin ato. Ky akt dëshmon për më tepër karakterin e tyre njerëzor, nëse jo atë kombëtar.

Pavarësisht, zhvillimeve, Millosheviç ishte i vendosur për të vazhduar luftën në realizimin e synimeve të tij. Përmes veprimeve policore me arrestimin e personave, që ishin të përfshirë në zhvillimet e kohës, sikurse arrestimi i Azem Vllasit dhe i drejtuesve të “Trepçës”: Burhan Kavajës e Aziz Abrashit dhe të veprimtarëve të tjerë, ai tentonte t’ua bënte me dije edhe të gjitha figurave të tjera se fati i njëjtë i priste, nëse nuk miratohen ndryshimet kushtetuese. Në këtë mënyrë, në prag të mbledhjes së Kuvendit të Kosovës, ku duhej vendosur mbi këto ndryshime u bë një presion i paparë mbi delegatët e Kuvendit të Kosovës. Pjesëtarë të shërbimeve sekrete serbe shkonin nëpër shtëpi të delegatëve dhe i kërcënonin ata drejtpërdrejt, apo kur ata hynin në Kuvend, shërbimi sekret serb gjatë kontrollimeve të sigurisë ua bënte të ditur se jeta e tyre ishte në rrezik.

Në këto rrethana, më 23 mars 1989, u mbajt mbledhja e Kuvendit të Kosovës. Kuvendi i Kosovës ishte i rrethuar me tanke. Në ndërtesën e Kuvendit gjendeshin pjesëtarë të sigurimit serb që kërcënonin delegatët shqiptarë. Për më tepër, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Vukashin Jokanoviç, veproi në kundërshtim me praktikën e punës së Kuvendit të Kosovës. Përveç se favorizoi gjatë diskutimeve, ata që ishin pro ndryshimeve, ai nuk respektoi rregulloren e votimit dhe vendosi që votimi të jetë i hapur. Në këtë mënyrë, ai parandaloi delegatët të shprehnin vullnetin e tyre të lirë, duke ua bërë me dije persekutimin e mundshëm, në rast të votimit kundër. Jokanoviçi ishte në nivel të detyrës, në aspekt të realizimit të pretendimeve serbe. Gjatë procedurës së votimit, ai pyeti hapur se kush është pro dhe numëroi që shumica ishin pro. Kurse në rastin se kush ishte kundër numëroi deri në dhjetë. Me këtë e përmbylli votimin, duke theksuar se ndryshimet u miratuan.

Por, një gjë që u vërejt më pas ishte se në mesin e delegatëve gjendeshin persona që fare nuk kishin të bënin me Kuvendin e Kosovës, ku në rastin e votimit ata kishin ngritur dorën pro ndryshimeve.

Pra, pavarësisht, të gjithave, zyrtarisht u shpall se Kuvendi i Kosovës miratoi ndryshimet, të cilat solemnisht u vërtetuan më 28 mars 1989 në qendrën Sava në Beograd. Millosheviçi përmbushi misionin – autonomia e Kosovës u anulua.

Ndryshe nga elita politike kosovare, populli i Kosovës nuk u pajtua me këto ndryshime. Në përpjekje të ruajtjes së autonomisë u zhvilluan demonstrata të fuqishme, ku mbetën të vrarë 22 shqiptarë e 98 të tjerë morën lëndime të rënda. Sidoqoftë, Serbia vazhdoi me zbatimin e

masave represive. Si rezultat u persekutua, u burgos dhe u dënua një numër i madh shqiptarësh.

Nënshtimi i Kosovës bëri që nacionalizmi serb të konsiderojë veten si një fuqi, që nuk kishte të ndalur, prandaj do të vazhdojnë objektivat serbe drejt bashkimit të të gjithë serbëve në një shtet, respektivisht, krijimit të një Serbie të Madhe. Kjo, si pasojë, pati gjakderdhjen dhe viktimizimin e popullsisë të pafajshme: kroate, boshnjake dhe shqiptare nga regjimi shovinist serb.

SHKURTESAT DHE AKRONIMET

ASSHA	Akademia Serbe e Shkencave dhe e Arteve
APJ	Armata Popullore e Jugosllavisë
KOS	Kisha Ortodokse Serbe
KSA	Krahina Socialiste Autonome
LSPP	Lidhja Socialiste e Popullit Punonjës
LKJ	Lidhja Komuniste e Jugosllavisë
LKK	Lidhja Komuniste e Kosovës
LKS	Lidhja Komuniste e Serbisë
LSHS	Lidhja e Shkrimtarëve të Serbisë
PKJ	Partia Komuniste e Jugosllavisë
PKSH	Partia Komuniste e Shqipërisë
RAMK	Rajoni Autonom i Kosovës e Metohisë
RPS	Republika Popullore Socialiste
RSFJ	Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë
UP	Universiteti i Prishtinës
UDB	Uprave Drzavne Bezbednosti (Drejtoria e Sigurisë së Shtetit)

BIBLIOGRAFI

I. Burimet Arkivore të papublikuara

- Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës
(Fondi i Komitetit Krahinor të Kosovës 1981 -1988)
- Arhiv Republike Slovenije
(Fondi: Централни Комитет Комунистички Лиге, Škatla 872-KOSOVO)
- Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shqipërisë
(Fondi i Komitetit Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë)
- Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë
(Viti 1971, dosja.661)

II. Burimet e publikuara

- **Petranović Branko, Zečević Momčilo:** *Jugoslovenski federalizam ideje i stvarnost*, Tematska zbirka dokumenata, Prvi Tom 1914-1943, Prosveta, Beograd, 1987.
- **Syla, Sabit & Kaba, Hamit:** *Demonstratat e Kosovës në Arkivin Kombëtar të Londrës, Instituti i Historisë "Ali Hadri"- Prishtinë, 2017*
- **Шиптарски геноцид над србима у 20. веку** Документа Архиве Епархије рашко-призренске и косовско-метохијске, Уредник: Мирјана Литричин, Београд, 2011.
- **Zenelaj, Eqrem:** *Shtypi i Austrisë për demonstratat e shqiptarëve të Kosovës më 1968, 1981 dhe 1989, FAIK KONICA, Prishtinë, 2011.*
- **Robert Elsie & Bejtullah Destani,** KOSOVA një histori dokumentare, KOHA, Prishtinë 2019.

III. Botime historiografike

- **AHRENS, Geert - Hinrich:** *DIPLOMACI mbi tehun e thikës-Pengimi i Konfliktit etnik dhe Grupi i Punës për minoritetet i Konferencës për Jugosllavinë, TOENA, Tiranë, 2010.*
- **Akademia e Shkencave të Shqipërisë** - *Qendra e Enciklopedisë Shqiptare, KOSOVA në vështrim enciklopedik, Toena, Tiranë 1999.*
- **Anzulovic, Branimir:** *Serbia Hyjnore - Nga miti te gjenocidi, "KOHA", Prishtinë, 2017.*
- **Bajgora, Sabri** - *Barbaria serbe ndaj monumenteve islame në Kosovë (Shkurt '98 – Qershor '99), Bashkësia Islame e Kosovës, Prishtinë, 2000.*
- **Bajrami, Hakif:** *"Naçertania" - program politik serb që shpie në shfarosjen e shqiptarëve 1844 - 1999, Prishtinë 2004.*
- **Bajrami, Hakif:** *Politika e shfarosjes së shqiptarëve dhe kolonizimi serb i Kosovës(1844-1995), Prishtinë.*
- **Bakalli - Arifi, Emine:** *Çështje nga historia moderne dhe bashkëkohore shqiptare, INSTITUTI ALBANOLOGJIK, Prishtinë, 2011.*
- **Baleta, Abdi:** *Shqiptarët përballë shovinizmit serbo - grek, KOHA, 1995.*
- **Balidemaj, Naim:** *Tragjedia kosovare, Rugova - Millosheviç, Prishtinë, 2001.*
- **Bamja, Menduh:** *Pozita kushtetuese juridike dhe faktike e bashkësive fetare në ish-Jugosllavi me vështrim të posaçëm të Bashkësisë Islame, Prizren, 2011.*
- **Bartl, Peter:** *SHQIPËRIA nga mesjeta deri sot, "Drita", Prizren 1999.*
- **Basha, Keçmezi Sabile:** *Kosova 1945-1990, Instituti i Historisë - Prishtinë, 2017.*
- **Basha, Keçmezi Sabile:** *Të burgosurit politikë shqiptarë në Kosovë 1945 - 1990, "Logos-A", 2009.*
- **Bernard Lory,** *Evropa Ballkanike që nga viti 1945 e deri në ditët tona. Dituria 2007.*

- **Bilandzic, Dusan;** *Historija Socijalisticke Federativne Republike Jugosllavija, Glavni procesi 1918 - 1985, Zagreb, 1985.*
- **Biserko, Sonja:** *Kovanje Antijugoslovenske zavere, Knjiga 1, Helsinski odbor za ljudska prava u Srbiji, Beograd.*
- **Boriçi, Gjon:** *Lufta për paqen në ish - Jugosllavi 1987 - 1990.*
- **Braha, Shaban:** *Gjenocidi serbomadh dhe qëndresa shqiptare 1844 - 1990, Tiranë, 1992.*
- **Brestovci, Sadulla:** *Marrëdhëniet shqiptaro - serbo - malazeze (1830 - 1878), Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1983.*
- **Buxhovi, Jusuf:** *Kosova nga Konferenca e Londrës e deri te protektorati ndërkombëtar, Prishtinë, 2012.*
- **Cabanes, Pierre** (Olivier Chaline, Bernard Doumerc, Alain Ducellier, Michel Sivignon) **Historia e Adriatikut, Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit, Tiranë 2005.**
- **Cana, Zekeria :** *Apeli 215 i intelektualëve shqiptarë, RILINDJA, Prishtinë 2001.*
- **Cana, Zekeria:** *Shpalime historike, Vëll. II, Prishtinë, 1998.*
- **Castellan, Georges:** *Histori e Ballkanit, Çabej, Tiranë, 1997*
- **Clark, Howard;** *Civil Resistancein Kosovo, Pluto Press, London, 2000.*
- **Çeku, Et'hëm:** *Teza e doktoraturës: " Kosova në sfondin e diplomacisë së Jugosllavisë dhe të Shqipërisë 1945 - 1981, Prishtinë. 2008.*
- **Çeku, Et'hëm,** *Demonstratat e vitit 1968 në Arkivin e Kosovës, Prishtinë, 2009.*
- **Çubrilloviç, Vaso:** *Problemi i pakicave kombëtare në Jugosllavinë e re, botoi Kolegjiumi i Redaksisë së "Zërit të Kosovës", Tetor 1987.*
- **Dufourn, Pierre :** *KOSOVA - Paqja e shpërfillur, Prishtinë: Rozafa , 2010.*
- **Fischer, Joschka:** *Vitet kuq - gjelbër , KOHA, Prishtinë, 2008.*

- **Gashi, Ibrahim:** *KOSOVA - Rruga te pavarësia. Roli i Lëvizjes së Minatorëve të Trepçës në procesin e shtetformimit 1988-1989 (vrojtime të studiuesve të huaj). Prishtinë, 2012.*
- **Geci, Faruk:** *Tirana - kryeqyteti i gjeopolitikës së shqiptarëve, Projekt studimor Qendra Kombëtare e Sigurisë dhe e Mbrojtjes, Tiranë, 2014.*
- **Glenny, Misha:** *Histori e Ballkanit 1804 - 1999, Nacionalizmi, luftërat dhe Fuqitë e Mëdha, Tiranë, 2007.*
- **Grup autorësh:** *FADIL HOXHA - Një jetë në shërbim të atdheut, Prishtinë 2007.*
- **Hajrizi, Mehmet:** *Histori e një organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Toena, Tiranë, 2008.*
- **Hajrullahu, Arben:** *Pagja afatgjate në Ballkanin Perëndimor përmes integritit në BE, Përkthyes nga gjermanishtja në shqip: Rexhep Bajrami, Botuar në Prishtinë, 2015.*
- **Hasani, Xhevat:** *"Një jetë në shërbim të lirisë kushtuar Naser Hanit", Shoqata e të Burgosurve Politikë e Kosovës, Prishtinë 2013.*
- **Horvat, Branko:** *Kosovsko Pitanja, GLOBUS, Zagreb, 1987.*
- **Hoxha, Enver:** *TITISTËT - shënime historike, "8 Nëntori", Tiranë, 1982.*
- **Hoxhaj, Enver:** *Politika Etnike dhe shtetndërtimi i Kosovës , Pejë 2008.*
- **Instituti i Historisë - Prishtinë, " Serbia dhe Shqiptarë"** (Pasqyrë e politikës së Serbisë ndaj shqiptarëve prej vitit 1878 deri në vitin 1914), Libri i parë, Prishtinë, 2011.
- **Jelavich, Barbara:** *Historia e Ballkanit, Shekulli tetëmbëdhjetë-nëntëmbëdhjetë, Botimet Përpjekja, Tiranë, 1999.*
- **Judah, Tim:** *KOSOVA - luftë dhe hakmarrje, KOHA, 2000, Prishtinë.*
- **Judah, Tim:** *Kosovo: What everyone needs to know, Oxford University Press, New York, 2008.*
- **Karastojanov, Stefan:** *KOSOVA (një analizë gjeopolitike), Shkup, 2007.*
- **Krasniqi, Jakup:** *Tezë doktorature "Shtypi shqiptar për zhvillimet në Kosovë 1981-1991", Prishtinë 2008.*

- **Lalaj, Ana**, *KOSOVA-rruga e gjatë drejt vetëvendosjes 1941 -48*, Tiranë, 2000.
- **Lalaj, Ana**: *Dosjet e luftës, Botimet Toena, Tiranë, 2014.*
- **Lakër, Uolltër** (Éalter Laqueur); *Evropa në kohën tonë - Histori e viteve 1945 - 1992, "DITURIA",Tiranë, 1996.*
- **Malnar, Dario**; *SHBA -ja dhe Kosova, KOHA, Prishtinë, 2013.*
- **Malcolm, Noel**: *Kosova një histori e shkurtër, Koha, Prishtinë, 2001.*
- **Meier, Viktor**: *Yugoslavia a history of its demise, "Routledge" London and Neë York, 1999.*
- **Meier, Viktor**: *Fundi i Jugosllavisë - goditja në Kosovë, Liria, Lubjanë, 2006*
- **Milo, Paskal**:*Politika e jashtme e Shqipërisë 1912-1939, Vëllimi I, Toena, Tiranë, 2013.*
- **Motesi, Mary**:*Kosova-prelud i luftës 1966 - 1999, Prishtinë, 2017.*
- **Murati, Shaban**: *Profile të diplomacisë evropiane në Ballkan, UET/Press, Tiranë 2009.*
- **Nasi, Lefter**: *Aspekte të shtypjes kombëtare e politike të shqiptarëve në Kosovë (1981 - 1986), Tiranë 2011.*
- **Ndreca, Mikel**: *Terror dhe gjenocid shtetëror (1912 - 1999), Prishtinë, 2001.*
- **Peter B. Lugar**, *The History and Effects of the Kosovo Polje Mythology, MAJ, SHBA, B.A., Kolegji Lafayette, Easton, Pennsylvania, 1992 - Fort Leavenöorth, Kansas, 2005.*
- **Petranović, Branko**: *ISTORIJA JUGOSLAVIJE, knjiga III - SOCIJALISTIČKA JUGOSLAVIJA 1955-1988.*
- **Petritsch, W.&Pichler, R.** *Rruga e gjatë në luftë (Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare 1989 -1999, KOHA, Prishtinë.*
- **Pešić,Vesna** : *Ethnic Mobilization in Serbia, MIRICO: Human and Minority Rights in the Life Cycle of Ethnic Conflicts*

- **Pešić, V.** *Serbian nationalism and the origins of the jugosllav crisis. Unitet state, Institut of pace, Ęashington, 2005.*
- **Pllana, Nusret:** *Terrori i Serbisë pushtuese mbi shqiptarët 1844 - 1999, Prishtinë, 2012.*
- **Ramet P. Sabrina:** *The Disintegration of Yugoslavia from the Death of Tito to the Ęar for Kosovo, ĘestvieĘ Press, 1999.*
- **Ramosaj, Fetnete :** *Organizatata ekstremiste serbe në Kosovë, Prishtinë 2005.*
- **Rizaj, Gazmend.** *"Shqipëria e Sipërme 1800 - 1913", Instituti Albanologjik - Prishtinë, 2011.*
- **Schmit, Jens Oliver:** *KOSOVA - Histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike, KOHA, Prishtinë, 2012.*
- **Sokolaj, Afërdita:** *Tezë doktore, Ęështja e Kosovës dhe media shqiptare (1981-2000), Tiranë, 2014.*
- **Stavileci, Esat & Pajazit Nushi:** *Të vërteta për Kosovën, Prishtinë, 2000.*
- **Stavileci, Esat:** *Ąështja e Kosovës në veprën e Gazmend Zajmit, Prishtinë 1997.*
- **Stefanović, Andrej:** *Antibirokratska Revolucija, Univerzitet u Beogradu, Fakultet političkih nauka, Beograd, 2011.*
- **Surroi, Flaka;** redaktore, *Politika serbomadhe prej Garashaninit deri te Akademia, KOHA, Prishtinë 2019.*
- **Syla, Sabit;** *Shteti shqiptarë dhe Ąështja e Kosovës 1939-1981, Instituti i Historisë-Prishtinë, 2012.*
- **Sherifi, Isak:** *Tezë doktore "Zhvillimet politiko-diplomatike në ish-Jugosllavi me theks të veçantë Kosova dhe Maqedonia 1981-2008" Tiranë, 2013.*
- **Shkodra, Zija:** *Qytetet Shqiptare të Rilindjes, Tiranë, 1990.*
- **Todorova, Maria:** *Ballkani Imagjinar, Instituti i Dialogut dhe i Komunikimit, Tiranë, 2006.*

- **Tomaniq, Milorad:** *Kisha serbe në luftë dhe luftërat brenda saj, Camaj-Pipa, Shkodër, 2006.*
- **Udovički, Jasminka & Ridgeway, James:** *Makthi etnik i Jugosllavisë. Albin, 1998.*
- **Uka, Sabit:** *“Planet antishqiptare të shteteve fqinje në shekullin XIX”, Shqiptarët në rrjedhat ballkanike, Instituti Albanologjik Prishtinë, 1996.*
- **Vllasi, Azem:** *KOSOVA: Fillimi që nuk harrohet. KOHA, Prishtinë, 2017.*
- **Vickers, Miranda,** *Midis serbëve dhe shqiptarëve (Një histori e Kosovës), TOENA.Tiranë, 2004.*
- **Wachtel , Anderë Baruch:** *Ballkani në historinë botërore, TOENA, Tiranë, 2012.*
- **Zekaj, Ramiz:** *Zhvillimi i kulturës islame te shqiptarët gjatë shekullit XX, Tiranë 2002.*
- **Zimmermann, Warren:** *Origins of a catastrophe- Yugoslavia and its destroyers, Times Books, 1999*

IV. Revista shkencore – kulturore

- **Bajrami, Hakif:** *"Ilija Garashanini dhe politika e tij shtetërore 1844 - 1874" VJETAR -Godishnjak i Arkivit të Kosovës XXIV/88 Prishtinë,1988. 103 - 138.*
- **Blagojević, Marina:***The other side of the truth: Migrations of Serbs from Kosovo, Kosovo-Kosova, Confrontation or Coexistence, edited by Greg Duijzing, Peace Research Centre, University of Nijmegen, 1996.*
- **Bogetić,Dragan:** *“Nacionalno pitanje i Jugoslavija 1945-1989”, Istorija 20. Veka, Časopis Instituta za Savremenu Istoriju, br. 1-2, 1999, Beograd.*
- **Borozan, Đorđe:** *Jugoslavija i Albanija u XX vijeku, Istorija 20. Veka, Časopis Instituta za Savremenu Istoriju, br. 1-2, 1999, Beograd.*
- **Brestovci, Sadullah:** *"Disa momente të marrëdhënieve shqiptaro - serbe-malazeze në fund të viteve të 50-ta dhe në fillim të viteve të 60-ta të*

shekullit XIX (1856 - 1862). Gjurmime Albanologjike - seria e shkencave historike IV - V - 1974/75, Prishtinë 1977, 93 -122.

- **Darko Gavrilović, Ljubiša Despotović:** YUGOSLAVIA – BEGINNING OF THE END, *Istorija 20. veka*, 2/2011.
- **Dizdarević, Ismet:** Etnocentrički stavovi akademika Dobrice Ćosića, Ćosićev Rat, Zbornik radova sa naučne i stručne rasprave o knjizi “Bosanski Rat” Dobrice Ćosića, održane 3. Maja 2012 godine u Rektoratu Univerziteta u Sarajevu, Sarajevo 2013.
- **Dušan T. Bataković:** Kosovo and Metohija: Serbia’s Troublesome Province, *BALCANICA XXXIX* (2008), Belgrade 2009
- **Gorani, Hajrullah** “Është koha të shohim syhapur dhe mirëfillt gjendjen tone”, *BULETIN i Fakultetit Filozofik XXII/1992*, Prishtinë 1994, 292 -294.
- **Halili, Nijazi:** Kriza e Kosovës në shek. XIX dhe Platformat serbe. Revistë shkencore periodike, *Botimi i Akademisë Diplomatike shqiptare, Global Challenge*, nr./5, 2013.
- **Islami, Hivzi:** Studime demografike, 100 vjet të zhvillimit demografik të Kosovës, *Botimi i dytë i plotësuar, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës*, Prishtinë, 2008.
- **Ивановић, Милош:** Конзерваторски радови на споменицима култура Косова и Метохије, објављени 1959 и 1960 године. Antikitete të Kosovës-Metohisë, Vëllimi I, II, III, Enti Krahinor për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore, Prishtinë, 1961.
- **Krizman, B:** “Elaborat Ive Andrica o Albaniji iz 1939 godine”, *Casopis za Suvremenu Povijest*, Br. 9, Zagreb, 1977.
- **Kullashi, Muhamedin:** The production of hatred in Kosova (1981-1991), *Kosovo-Kosova, Confrontation or Coexistence*, edited by Greg Duijzing, Peace Research Centre, University of Nijmegen, 1996.
- **Nushi, Pajazit:** Etiologjia e krimit të pushtetit serb ndaj shqiptarëve në Kosovën e viteve të 90-ta të shekullit XX, Gjenocidi i pushtetit serb ndaj shqiptarëve në Kosovë gjatë viteve të 90-ta, *Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Seksioni i Shkencave Shoqërore*, Prishtinë, 2001.
- **Nikolić, Kosta:** KAKO JE SLOBODAN MILOŠEVIĆ IZABRAN ZA VOĐUSRPSKIH KOMUNISTA. *ISTORIJA 20. VEKA*, Godina XXIV 2006, Beograd. Broj 1.

- **Nikolic, Kosta:** "Ne damo Kosovo". *Ustavne promene u Srbiji 1989 (II), Istorija 20. Veka, 3/2012*
- **Pavković, Aleksandar:** From Yugoslavism to Serbism: the Serb national idea 1986-1996, *Nations and Nationalism 4 (4), 511-28 © ASEN 1998.*
- **Perović, Latinka:** "Dobrica Ćosić o Josipu Brozu Titu – Skica za istraživanje političkog i intelektualnog odnosa", *Ćosićev Rat, Zbornik radova sa naučne i stručne rasprave o knjizi "Bosanski Rat" Dobrice Ćosića, održane 3. Maja 2012 godine u Rektoratu Univerziteta u Sarajevu, Sarajevo 2013.*
- **Petrović, Vladimir:** ULOGA MEDIJA U UČVRŠĆENJU VLASTI SLOBODANA MILOŠEVIĆA , *Istorija 20.Veka, 2/2013*
- **Рибнић, Владимир:** Политичка мобилизација црногорских комуниста у "Антибурократској револуцији", *Питања у етнологији и антропологији, н.с. Вол. 7, Ис 4 (2012).*
- **Rizaj Gazmend,** "Dokumente italiane mbi reprezaljet serbe në territoret e okupuara ballkanike 1912-1913", *Buletini, XXVII-XXVIII, 1997/98.*
- **Svetko Kovač, Bojan B. Dimitrijević:** SLUČAJ ALEKSANDRA RANKOVIĆA PREMA DOKUMENTIMA KOS-a: DA LI JE BILO PRISLUŠKIVANJA? *Istorija 20. veka, 1/2015.*

V. Shtypi i kohës

- **"Rilindja"** (Prishtinë) 1981- 1989
- **"KOHA"** (Prishtinë) 1991
- **"Zëri i Rinisë"** (Prishtinë) 1990
- **"Jedinstvo"** (Prishtinë) 1987-1989
- **"Politika"** (Beograd) 1988
- **"Ilustrovana Politika"** (Beograd) 1987
- **"NIN"** (Beograd) 1986
- **"Naša Borba"** (Beograd) 1997

- **“Vreme”** (Beograd) 1995

VI. Fejtonistika

- Dobrica Ćosić, Piščevi Zapisi (1981-1991), Fejton elektronik, [http://www.novosti.rs/dodatni_sadržaj/clanci.119.html:275783-Haranga-protiv-SANU, qasja 10 korrik 2018.](http://www.novosti.rs/dodatni_sadržaj/clanci.119.html:275783-Haranga-protiv-SANU,_qasja_10_korrik_2018)
- Rade Dragović, *Osma sednica CK KP Srbije*, Fejton elektronik, [http://www.novosti.rs/dodatni_sadržaj/clanci.119.html:686773-Terror-nad-Srbima-na-Kosovu, 10 korrik 2018.](http://www.novosti.rs/dodatni_sadržaj/clanci.119.html:686773-Terror-nad-Srbima-na-Kosovu, 10_korrik_2018)
- Rade Dragović, *Memoradum SANU - tri decenije posle*, Fejton elektronik [http://www.novosti.rs/dodatni_sadržaj/clanci.119.html:625479-Pocetak-medijsko-politickog-trilera, qasja 10 shtator 2018.](http://www.novosti.rs/dodatni_sadržaj/clanci.119.html:625479-Pocetak-medijsko-politickog-trilera, qasja_10_shtator_2018)
- UDBA U UDBI - Svedočenja Slavka Zečevića, Fejton elektronik, [http://www.novosti.rs/dodatni_sadržaj/clanci.119.html:276545-Vojaska-obezbedila-mir-i-red, qasja 12 gusht 2018](http://www.novosti.rs/dodatni_sadržaj/clanci.119.html:276545-Vojaska-obezbedila-mir-i-red, qasja_12_gusht_2018)
- Srđan Cvetković, *“Traže ujedinjenje albanskih zemalja”*, Fejton elektronik, [http://www.novosti.rs/dodatni_sadržaj/clanci.119.html:652457-Traze-ujedinjenje-albanskih-zemalja, qasja 20 gusht 2018.](http://www.novosti.rs/dodatni_sadržaj/clanci.119.html:652457-Traze-ujedinjenje-albanskih-zemalja, qasja_20_gusht_2018)
- Venceslav Glišić, *“Politički osinjak u Predsedništvu”*, Fejton elektronik, [http://www.novosti.rs/dodatni_sadržaj/clanci.119.html:689674-Politicki-osinjak-u-Predsednistvu, qasja 10 shtator 2018.](http://www.novosti.rs/dodatni_sadržaj/clanci.119.html:689674-Politicki-osinjak-u-Predsednistvu, qasja_10_shtator_2018)

VII. Burime on - line

- 30 vjet nga greva historike e minatorëve të Trepçës, [:/www.gazetaexpress.com/lajme-30-vjet-nga-greva-historike-e-minatoreve-te-trepces-628456/](http://www.gazetaexpress.com/lajme-30-vjet-nga-greva-historike-e-minatoreve-te-trepces-628456/), qasja 20 qershor 2019.
- Arkivi: Greva e Minatorëve 1989, <https://www.youtube.com/ëatch?v=IhiODgËZtYA>, min: 21:40 – 23:30, publikuar 22 nëntor 2016.
- Ast Slobodanka, Miroslav Šolević: *Režim nas je iskoristio*, Vreme broj 454, 18. septembar 1999. https://www.vreme.com/arhiva_html/454/11.html, qasja 10 maj 2018.

- Barišić Srđan, *Srpska pravoslavna crkva i Jugoslavija*, http://www.yuhistorija.com/serbian/kultura_religija_txt00c5.html, qasja 15 qershor 2018.
- Božur u tradiciji srba, <https://www.bastabalkana.com/2016/03/bozur-u-tradiciji-srba-crveno-cvece-natopljeno-junackom-krvlju/>, qasja 10 maj 2018
- Brestovci Sadullah: “Marrëdhëniet Shqiptaro-Serbo-Malazeze gjatë viteve 1839-1856”, Google Internet, http://sadulla.brestovci.info/index.php?title=Marr%C3%ABdh%C3%ABnjet_Shqiptaro-Serbo-Malazeze_gjat%C3%AB_viteve_1839-1856,qasja_25_nëntor_2018.
- Cani, Bahri - Čovek koji je "polozio ispit", Naša Borba, 24 april 1997, http://www.yurope.com/nasa-borba/arhiva/Apr97/2404/2404_26.HTM, qasja 18 maj 2018.
- Čolović Ivan , Tako je govorio Milošević, publikuar më 27.06.2012, <https://pescanik.net/tako-je-govorio-milosevic/>, qasja 20 shtator 2018.
- Dosije Kosovo: Flaša kao simbol početka stradanja i egzodusa Srba sa Kosova <https://embargo.rs/dosije-kosovo-flasa-ka-simbol-pocetka-stradanja-i-egzodusa-srba-sa-kosova/>, qasja 30 shtator 2018
- Јевтић Атанасије, *Страдања Срба на Косову и Метохији од 1941. до 1990. Године*, Интернет издање "Јединство" - Приштина 1990. https://www.rastko.rs/kosovo/istorija/stradanje_srba/index_c.html
- Hasani Enver, “Reflections on Serbian nationalism and the policy of ethnic cleansing” <http://sam.gov.tr/ep-content/uploads/2015/06/REFLECTIONS-ON-SERBIAN-NATIONALISM-AND-THE-POLICY-OF-ETHNIC-CLEANSING-ENVER-HASANI.pdf>, qasja 20 tetor 2018.
- Kadriu Bajram: *Si e trajtova rastin e Gjorgje Martinoviqit*, publikuar më 2 maj 2015, <http://zeri.info/aktuale/30983/bajram-kadriu-si-e-trajtova-rastin-e-gjorgje-martinoviqit/>, qasja 2 maj 2015.
- Милинчић Данило, http://www.zlocininadsrbima.com/Zrtva.aspx?ImeZrtve=%D0%94%D0%B0%D0%BD%D0%B8%D0%BB%D0%BE_%D0%9C%D0%B8%D0%BB%D0%B8%D0%BD%D1%87%D0%B8%D1%9B, qasja 10 shtator 2018.

- Милошевић Слободан, Године расплета, четврто издање, београдски издавачко-графички завод <http://www.skripta.info/ep-content/uploads/2017/01/Slobodan-Milosevic-Godine-raspleta.pdf>
- Митинг Братства и јединства, https://sr.wikipedia.org/sr-el/Митинг_Братства_и_јединства, қасје 17 мај 2018.
- Myrtaj Nezir, *Ende nuk dihet ku ndodhet varri i Ferat Mujës*, <https://www.radiokosovaelire.com/nezir-myrtaj-ende-nuk-dihet-ku-ndodhet-varri-i-ferat-mujes/>, қасја 20 коррик 2018.
- *Od Kosova do Jadovna, putni zapisi jeromonaha Atanasija Jevtića*, Preštampano iz lista "Pravoslavlje" (broj 400, 15. XI 1983; 404, 15. I 1984, i 405, 1. II 1984). <http://www.kosovo.net/sk/rastko-kosovo/istorija/kosovo-jadovno.html>, қасја 29 прилл 2018.
- Olivera Milosavljević, Antibirokratska revolucija 1987-1989 godine, <https://vdocuments.site/antibirokratska-revolucija-by-olivera-milosavljevic.html>, қасја 20 mars 2019.
- Pavlović Momčilo, "Kosovo under autonomy 1974-1990", *Research Team 1*, <https://www.cla.purdue.edu/si/Team1Reporte.pdf>
- Petranovic, Branko: Istorija Jugoslavije, Knjiga III, 1945-1988, Beograd (<https://www.scribd.com/doc/110870961/Branko-Petranovic-Istorija-Jugoslavije-III-Knjiga>)
- Qeriqi Ahmet, *Djallëzia dhe hipokrizia e titistit, Azem Vllasi*, publikuar më 21/10/2012 në <https://ëëë.radiokosovaelire.com/ahmet-qeriqi-djallezia-dhe-hipokrizia-e-titistit-azem-vllasi/>
- Srpski političari ubijali istinu o Đorđu Martinoviću <http://arhiva.glas-javnosti.rs/arhiva/2005/08/22/srpski/D05082101.shtml>., қасја 10 gusht 2018.
- Švarn Filip, Srce Tame - Paravojne formacije i MUP Srbije [VREME](http://www.vreme.com/cms/vieë.php?id=325039) | BR 618,7.NOVEMBAR2002<https://www.vreme.com/cms/vieë.php?id=325039>, қасја 30 коррик 2018.
- [The Death Of Yugoslavia 1/6 Enter Nationalism - BBC Documentary](http://www.bbc.com/news/world-europe-44888888), <https://www.youtube.com/watch?v=vDADy9b2IBM>, қасја 20.04.2018.

- Vasojevički Zakon u 12 točaka, Google Internet https://www.rastko.rs/rastko-cg/povijest/vszak_c.html, qasja 20 dhjetor 2018.
- Vllasi Azem, Minatorët e kthyen vëmendjen e botës demokratike nga Kosova, <https://www.koha.net/arberi/146835/vllasi-minatoret-e-kthyen-vemendjen-e-botes-demokratike-nga-kosova/>, qasur 20 shkurt 2019.
- Vlahović, Dragan-*Na vest o smrti Đorđa Martinovića*, publikuar më 8 shtator 2000, <http://arhiva.glas-javnosti.rs/arhiva/2000/09/10/srpski/R00090803.shtm>
- Vujacic, Veljko:“Serbian nationalism, Slobodan Milosevic and the origins of the Yugoslav War”, *The Harriman Review*, Vol.8, No.4, December 1995 <http://studylib.net/doc/8550754/serbian-nationalism--slobodan-milosevic-and-the-origins-o...f>
- Zarić Zorica, “*Ko je ovaj čovek? Miroslav Šolević*”, <http://arhiva.glas-javnosti.rs/arhiva/2002/06/30/srpski/T02062902.shtml>, qasja 4 korrik 2018.
- Zdravkovic Miodrag, Umro drug Tito, <https://www.youtube.com/ëatch?v=92NR7S2YhsU>, qasja 20 gusht 2019.
- Zogaj Agim, Bisedë me Fadil Hoxhën, <https://telegrafi.com/fadil-hoxha-prill-1994-tito-dhe-kardeli-thane-cka-ju-duhet-republika-kujdes-prej-serbise/>, qasja 20 tetor 2018.